

KONTRIBUES:

Administrata e Këshillit të Qarkut, nën kujdesin e Këshillit të Qarkut Dr. Resul Llogo

N/Kryetari Këshillit të Qarkut	Astrit Ajdini	
Departamenti i Zhvillimit dhe Programacionit	Shkëlqim Nora	Pergjegjes
	Kristofor Muka Specialist	
	Theodhora Muka	Specialiste
Departamenti i Shërbimeve	Besim Brahimi	Pergjegjes
Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë e Juridik	Besnik Shehu	Pergjegjes
Departamenti i Burimeve Njerëzore	Fredi Mehilli	Pergjegjes
Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun e Mjedisin	Shpresa Mino	Pergjegjes
Departamenti i Financës	Thanas Dhroso	Pergjegjes
Departamenti i Mbrojtjes e Administrimit të Tokës	Thanas Hanxhara	Pergjegjes
Departamenti i Urbanistikës	Filip Çami	Pergjegjes
Komunat e Qarkut		
Drejtoritë e Qarkut		
Universiteti “Eqerem Çabej”		
Zyra e Zhvillimit në Bashki		

GRUPI I EKSPERTËVE:

Prof. Dr. Kristaq Kikina, Rektori Universitetit “Eqerem Çabej”
 Prof. Assoc. Dr Naxhi Mamani
 Elvira Shaplo, historiane
 Ilir Gushi, ekonomist
 Kristaq Çombi, ekonomist
 Vladimir Qirjaqi, Drejtor i Monumenteve, dega Gjirokastër

KËSHILLUES:

Përkthyer nga:

Valbona Mazreku
 Xheara Avxhiu

Analist për OZHM:

Engjell Skreli, Drejtor Ekzekutiv i Insitutit Shqiptar për Politikë Publike

Analist për çështjet gjinore:

Edit Olah, UNICEF

Fotograf:

Zyhdi Hyka

Parathënie

Këshilli i Qarkut Gjirokastër që nga fillimi i vitit 2001 e ka parë hartimin e politikave rajonale dhe harmonizimin e tyre me politikat shtetërore si një përparësi kyçe; duke vënë në jetë këtë dëshirë, Këshilli i Qarkut miratoi studimin “Strategjia e Zhvillimit për Qarkun e Gjirokastrës”. Specialistët e administratës punuan me zell për këtë studim duke bashkëpunuar ngushtë me Zyrën e Zhvillimit në prefekturë, specialistët e bashkisë, të komunave, të njësive administrative dhe të Universitetit Eqerem Çabej. U kërkuan rekomandime nga tre bashkitë dhe u bënë këshillime me komunitetin e çdo komune dhe bashkie, me OJF, me përfaqësues të PNUD-it dhe me Fondin Shqiptar të Zhvillimit. Media lokale organizoi një sërë programesh lidhur me gjendjen e qarkut dhe perspektivat e zhvillimit të tij. Me të njëjtin qëllim, në 14 qershor 2001 u mbajt një konferencë rajonale. Studimi u diskutua në një forum rajonal që, në shtator 2002, u pasua me miratimin e strategjisë së qarkut nga Këshilli i Qarkut; më vonë ajo u botua nga Shtëpia Botuese Toena. Botimi iu dërgua çdo komune, bashkie dhe njësie administrative. Gjatë viteve të fundit studimi ka shërbyer si bazë për të përcaktuar prioritetet e pushtetit vendor dhe njësive administrative. Këshilli i qarkut e di që ky studim nuk është i përsosur, por ai ka qenë një ndihmesë e madhe pasi tashmë kemi një dokument pune dhe që do ta përmirësojmë në vitet në vijim. Në fakt, qarku i Gjirokastrës ishte i pari në Shqipëri që formuloi strategjinë e vet të zhvillimit.

Meqenëse strategjia e zhvillimit nuk është një dokument i pandryshueshëm dhe me synimin e identifikimit më të mirë të rrymave dhe prirjeve të zhvillimit, strategjia u shqyrtua për të siguruar një zotim më të madh të palëve të interesuara që merrnin pjesë. Kjo strategji e përditësuar do të përdoret për të harmonizuar më mirë politikën me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Shoqëror-

Ekonomik (SKZhShE) dhe Procesin e Stabilizim Asocimit (PSA) me Bashkimin Europian (BE) si edhe për të forcuar bashkëpunimin me Kombet e Bashkuara dhe fushatën globale Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit. Përfundimi i Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut Gjirokastër vjen pas një kërkimi intensiv të kryer nga stafi i qarkut, ekspertët vendor, specialistët e universitetit dhe kontribues të tjerë të cilët i falenderoj për nivelin e lartë profesional. Dua të vlerësoj gjithashtu ndihmesën e madhe të dhënë nga përfaqësuesit e PNUD-it. Gjithsesi, nuk mund ta mbyll këtë fjalë pa përmendur angazhimin e përfaqësuesve të pushtetit vendor, të prefekturës dhe stafin e institucioneve rajonale. Një falenderim i veçantë i shkon medias së shkruar dhe publikut që treguan mbështetjen e patundur për strategjinë. Një nga veçoritë më mbresëlënëse të këtij procesi studimi ishte karakteri i tij gjithëpërfshirës.

Do të doja të theksoja faktin që Strategjia e Zhvillimit të Qarkut për Gjirokastrën është një dokument me rëndësi jo vetëm për administratën e këshillit të qarkut dhe bashkitë e komunat, por edhe për gjithë komunitetin rajonal, si përfitues kryesor. Do të doja të përsëritja bindjen e këshillit të qarkut dhe mbështetjen maksimale që institucionet e tjera vendore do të ofrojnë për vënien në jetë me sukses të strategjisë. Duke shprehur vlerësimin më të lartë për përfundimin e tij, shpresoj që ky dokument do të shërbejë si ndihmë për çdokënd që është i interesuar të kontribuojë në zhvillimin e Gjirokastrës për të sjellë një të ardhme më të mirë për të gjithë ne.

DR. RESUL LLOGO
Kryetar i Këshillit të Qarkut
Qarku Gjirokastër

Lista e Shkurtimeve

OBK	Organizatat me Bazë Komuniteti
DHTI	Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë
OSC	Organizatat e Shoqërisë Civile
CEDAW	Konventa mbi Eleminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave
SIM	Sistemet e Informacionit Mjedisor
BE	Bashkimi European
PPB	Prodhimi i Përgjithshëm Bruto
GIS	Sistemi i Informacionit Gjeografik
QSH	Qeveria Shqiptare
HDI	Indeksi i Zhvillimit Njerëzor
HIV/SIDA	Virusi i Imunodeficiencës Njerëzore / Sindroma e Fituar e Mungesës së Imunitetit
ICT	Teknologjitë e Informimit dhe Komunikimit
INSTAT	Instituti i Statistikave Kombëtare
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
PQV	PNUD Programi i Qeverisjes Vendore
MDC	Dokument i Përmbledhur për Zhvillimin e Mijëvjeçarit
OZHM	Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit
MSh	Ministria e Shëndetsisë
OJF	Organizata Jofitimprurëse
SKZHSE	Strategjia Kombëtare e Zhvillimit Shoqëror-Ekonomik
RBM	Menaxhim mbi Bazë Rezultatesh
SZhQ	Strategjia e Zhvillimit të Qarkut
PSA	Procesi i Stabilizim-Asocimit
Sida	Ajencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar
SME	Bizneset e vogla dhe të mesme
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
PNUD	Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetit

Hyrje

Përgjatë viteve '90 u zhvilluan një sërë samitesh dhe konferencash ndërkombëtare të OKB-së që u morën me çështjet më urgjente dhe të spikatura shoqërore, ekonomike dhe mjedisore me të cilat përballeshin vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim. Kulmi ishte Samiti i Mijëvjeçarit, i zhvilluar më shtator 2000, ku 147 krerë shtetesh të përbërë nga 191 kombe, duke përfshirë Shqipërinë, adoptuan Deklaratën e Mijëvjeçarit. Në vijim të deklaratës ishte përcaktimi i 8 synimeve specifike që njihen si Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM-të). OZHM-të përfaqësojnë angazhime të matshme drejt të cilave Shqipëria dhe gjithë vendet e tjera do të punojnë për t'i arritur në vitin 2015.

Në nivel kombëtar, Kuvendi i Shqipërisë, në korrik 2003 miratoi një rezolutë për OZHM-të duke përforcuar zotimin e vendit për ta patur zhvillimin si diçka parësore. Rezoluta bazohet në vlerësimin që "përgjegjësitë e ndërmarra para komunitetit ndërkombëtar sipas deklaratës së mijëvjeçarit kërkojnë zotim të përgjithshëm të strukturave shtetërore të shoqërisë civile që Shqipëria t'i arrijë OZHM-të në vitin 2015". Për rrjedhojë, qeveria shqiptare ka ndërmarrë një përfshirje të plotë të OZHM-ve në Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Shoqëror-Ekonomik (SKZhShE). E thënë më shkurt, Strategjia e Zhvillimit të Qarkut (SZhQ) për OZHM-të në Gjirokastrë përfaqëson një zbulim pasi i ka marrë OZHM-të dhe i ka përdorur si themele të ideimit të politikës në nivel vendor dhe të nisjes së një ndryshimi të qëndrueshëm. Po ashtu, Strategjia e Zhvillimit të Qarkut e OZHM-ve në Gjirokastrë ka ndërlidhur interesat rajonale dhe shqetësimet vendore me ato të zotimeve politike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Veç kësaj, OZHM-të mbështesin edhe objektivin e përgjithshëm të Shqipërisë për

hyrje në BE.

Roli i PNUD-it është që të veprojë si rrjet i OKB-së për Zhvillim Global për të lidhur dhe bashkërenduar përpjekjet kombëtare dhe rajonale me qëllim arritjen e OZHM-ve në vitin 2015 dhe për të shtruar themelet e një bashkëpunimi të gjerë me qeverinë shqiptare, shoqërinë civile dhe donatorët. Asistenca për të integruar OZHM-të në kuadrin kombëtar dhe atë vendor, duke përfshirë SKZhShE, ka mjaft rëndësi pasi ndonëse Objektivat janë identifikuar globalisht si realiste dhe të kapshme, ato po ndryshohen dhe përshtaten me kontekstin kombëtar dhe kushte të veçanta të rajoneve. Në bazë të kësaj, SZHR të OZHM-ve të Gjirokastrës, duke i përdorur këto objektiva si një sistem i gjithanshëm, i orientuar nga rezultati për politikëbërjen dhe llogaridhënien, u shqyrtua për herë të dytë. Këshilli i Qarkut e drejtoi formulimin e strategjisë me ndihmën e ekspertëve lokalë në një mënyrë pjesëmarrëse që i përfshiu qytetarët e çdo bashkie dhe të komunave për të përforcuar dhe nxitur pronësinë lokale.

Duke gjykuar në bazë të nismës së qarkut të Gjirokastrës për krijimin e të parës Strategji të Zhvillimit të Qarkut, të ndjekur nga përpjekje ambicioze për ta përditësuar, duket qartë që mundësitë për përparim në qark janë të mëdha. Bukuria natyrore, burimet e bollshme, vendndodhja e favorshme gjeografike, të lidhura me bashkërendimin e gjerë të ofruar nga OZHM-të do të thonë që zhvillimi i qëndrueshëm i qarkut ka marrë rrugë dhe është i arritshëm.

Anna Stjarnerkliut
Koordinator i OKB
OKB, Shqipëri

Përmbajtja

1.	Parathënie	4
2.	Lista e shkurtimeve	5
3.	Hyrje	6
4.	Përmbajtja	7
5.	Përmbledhje	8
6.	Hyrje dhe Procesi i Zhvillimit të Strategjisë	11
7.	Gjendja Aktuale në Qarkun e Gjirokastrës	14
	<ul style="list-style-type: none"> • Varfëria • Demografia • Arsimi • Shëndeti • Bujqësia • Infrastruktura • Mjedisi 	
8.	Qarku i Gjirokastrës: Drejt 2015	90
	<ul style="list-style-type: none"> • Strategjia e Zhvillimit të qarkut të Gjirokastrës 	
9.	Shtojca	120
	<ul style="list-style-type: none"> • Shënim metodologjik për Përzgjedhjen dhe Prioritizimin e Projektit • Përshkrimi i treguesve dhe një shënim për Treguesit dhe Korpusin e të Dhënave 	

Përmbledhje

Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit dhe Dokumenti i Përmbledhur për Zhvillimin e Mijëvjeçarit

Deklarata e Mijëvjeçarit e Kombeve të Bashkuara, e adoptuar nga Shqipëria dhe udhëheqësit botërorë në Samitin e Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara në vitin 2000, rroku aspiratat e bashkësisë ndërkombëtare për shekullin e ri. Ajo parashikoi një botë të bashkuar nga vlera të përbashkëta dhe që lufton me vendosmëri të përtëritur për të arritur qëndrueshmëri, paqe dhe standarde të përshtatshme jetese për çdo burrë, grua dhe fëmijë. Ky zotim përfshin bërjen e përmirësimeve rrënjësore afatgjata në nivelet e varfërisë, në shëndet dhe arsim, në përparimin e paqes, të të drejtave të njeriut dhe të mbrojtjes së mjedisit. Të përfshira në këtë Deklaratë janë një seri zotimesh globale që titullohen Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM-të). Këto Objektiva duhen arritur në vitin 2015 dhe janë përbërës jetik i nismës globale të këtij shekulli për zhvillim dhe përfaqësojnë objektiva specifike dhe të matshme.

Angazhimi në emër të Shqipërisë, dhe të të gjithë shteteve, për të arritur OZHM-të u konfirmua në mars 2002 në Marrëveshjen e Monterrey, ku kombet pjesëmarrëse përforcuan bashkëpunimin për arritjen e objektivave. Marrëveshja e arritur në Monterrey u pasua nga formulimi i Dokumentit të Përmbledhur të Mijëvjeçarit që i kërkon bashkësisë ndërkombëtare të përqendrohet në marrjen e masave për përmbushjen e suksesshme të OZHM-ve nëpërmjet një sistemi të ndarjes së përgjegjësisë.

Strategjia e Zhvillimit të Qarkut të Gjirokastrës synon të përmbushë shumë nga rekomandimet e Dokumentit të Përmbledhur duke i shqyrtuar ato në lidhje me veçoritë dhe nevojat specifike të qarkut. Kësisoj, strategjitë shfaqen jo vetëm të rëndësishme por edhe të arritshme në nivelet rajonale dhe vendore. Rezultati është një SZHR që është në një linjë me SKZHSE dhe Rezolutën e korrikut 2003 të Kuvendit, që së bashku përbëjnë përgjegjësinë e Shqipërisë në arritjen e OZHM-ve.

Në mënyrë kuptimplotë, prioritetet për zhvillim dhe ndryshim u përcaktuan në nivelet e bazës përmes një procesi këshillimi në shkallë të gjerë. Rezultati për Gjirokastrën është që banorët ndihen drejtpërdrejt autorë të projekteve dhe programeve, duke nxjerrë në pah metodologji që i plotëson vetë nevojat dhe duke nxitur investimet në komunitetet e tyre.

Ka rëndësi të njihet fakti që organet e pushtetit vendor i kanë përdorur OZHM-të për të forcuar më tej institucionet. Kjo do të thotë që rishikimi i SZHR-së do të bëhet rregullisht në mënyrë të tillë që mjetet më efektive për përparimin e qarkut të përmbushen në një periudhë sa më të shkurtër kohore, pa komprometuar cilësinë apo detaje të tjera. Kësodore, do të harmonizohen axhendat e ndryshme të institucioneve në nivel komunal, qarku, kombëtar dhe global. Në pajtim me objektivat e Dokumentit të Përmbledhur për llogaridhënien në politikë, SZHR-ja u lejon banorëve të qarkut që të ndjekin përparimin në arritjen e OZHM-ve përmes një kornize programi që u përgjigjet disa treguesve. Meqenëse një nga parakushtet për arritjen e OZHM-ve është qeverisja e mirë, banorët mund gjithashtu të shohin përditësime tremujore që shqyrtojnë dhe masin kryerjen e detyrës nga përfaqësuesit e tyre të zgjedhur.

Ndonëse Dokumenti i Përmbledhur vë re nevojën e financimit nga dhuruesit, SZHR të Gjirokastrës shkon përtej këtyre pritjeve tipike. Ajo përdor OZHM-të si një instrument për mobilizim të burimeve duke bashkuar financime nga disa burime si, sektori privat, komunitetet në qarkun e Gjirokastrës, qeverinë shqiptare dhe organizatat jofitimprurëse. Duke integruar gjerësisht prioritetet e thëna në Dokumentin e Përmbledhur, kjo SZHR shpalos jo vetëm angazhimin e Shqipërisë por edhe përkushtimin e Qarkut për arritjen e OZHM-ve.

OZHM-të e Qarkut Gjirokastër, Synime, objektiva dhe tregues					
Objektiva		Synime	Tregues		
OZHM	Objektivat e qarkut Gjirokastër▶	Përshkrimi	2004	2015
• Zhdukja e varfërisë së skajshme dhe e urisë	1) Varfëria ulet në 50% dhe varfëria e skajshme zhduket;	i). Përgjysmimi në vitin 2006 i njerëzve që jetojnë nën minimumin 2USD / ditë përmes rritjes së prodhimit nga bujqit e vegjël dhe duke mbështetur veprimtari intensive dhe të orientuara ndaj tregut për nivelin më të lartë.	Niveli i papunësisë (%)	12.7	8
	2) Punësim i ekuilibruar gjinor, rritje e zhvillimit tregtar dhe industrial përmes krijimit të markave konkurruese rajonale;	ii). Përgjysmimi në vitin 2010 i njerëzve që jetojnë me më pak se 3 USD / ditë dhe ulje e pasigurisë financiare përmes krijimit të vendeve të punës. Zhvillimi i SME-ve duke kultivuar burimet e pasura natyrore dhe kulturore dhe duke forcuar konkurrencën mes markave gjirokastre, janë çelësat e një zhvillimi të qëndrueshëm afatgjatë.	% e familjeve që përfitojnë ndihmë sociale	12.20	6
	3) Intensifikim i planifikimit territorial dhe i zhvillimit infrastrukturor.	iii). Zhvillimi Infrastrukturor bazohet në planifikimin e integruar të territorit të qarkut.	Niveli i vdekshmërisë foshnjore për 1000 lindje	14.95	4.5
• Arritja e një arsimit 8 - vjeçar në nivel sa më universal	1) 100% e djemve dhe e vajzave përfundojnë shkollën fillore;	i). Zhdukje e tërësishme e braktisjes së shkollës dhe përmirësim i cilësisë së arsimit me synim dhënien në vitin 2006 të 4 viteve të arsimit fillor për të gjithë fëmijët; ndërsa në vitin 2010 kjo të arrihet edhe për arsimin 8 vjeçar.	% e ndjekjes së shkollës në zonat fshatare për arsimin e nivelit të dytë (15-19 vjeç)	40.04	70
	2) Rritje e regjistrimit në shkollat e mesme dhe universitet;	ii). Zhdukja, në vitin 2015, e pabarazisë gjinore në të gjitha nivelet e arsimit.	Raporti nxënës / mësues në shkollat e mesme	19.1:1	16.1:1
	3) Programi mësor harmonizohet për t'iu përgjigjur nevojave të tregut;	iii). Rritje thelbësore e regjistrimit të studentëve në shkollat e mesme dhe universitet dhe harmonizimi i trainimit profesional me nevojat e tregut.	% e mësuesve me diplomë universiteti në arsimin 8-vjeçar	35.33	70
	4) Romët - trajtim i çështjeve specifike të arsimit.				

<ul style="list-style-type: none"> • Ulje e vdekshmërisë foshnjore • Përmirësim i shëndetit mëmësor • Luftimi i HIV/AIDS dhe i sëmundjeve të tjera 	1) Përmirësim i aksesit për kujdes shëndetsor në zonat urbane dhe rurale;	i). Përmirësim i aksesit dhe i cilësisë së shërbimeve të kujdesit parësor shëndetsor si për popullatat qytetëse ashtu dhe ato fshatare.	Raporti i shtretërve për 1000 banorë	1.9	6.7
	2) Përmirësim i infrastrukturës, i pajisjeve dhe kushteve të shërbimit të kujdesit shëndetsor;	ii). Duke përmirësuar rrënjësisht cilësinë e shërbimeve shëndetsore në spitale, në përputhje me skemën e reformës kombëtare.	Shkalla e vdekshmërisë foshnjore për 1000 lindje	14.95	4.5
	3) Përmirësim i ofrimit të kujdesit shëndetsor, duke përfshirë cilësinë e stafit mjekësor;	iii). Pakësim dhe më pas zhdukje e vdekshmërisë foshnjore dhe asaj të mëmës.	Raporti i dentistëve për 1000 banorë	.19	.40
	4) Pakësim, me synim zhdukjen e vdekshmërisë foshnjore dhe të nënës; 5) Lehtësim i vuajtjeve të romëve për akses në shërbimet mjekësore; 6) Zhdukje e dhunës kundër grave.	iv). Aftësim dhe ndërgjegjësim në nivel më të lartë në autoritetet vendore dhe në shoqërinë civile për dhunën ndaj grave.	Raporti i farmacistëve për 1000 banorë	.07	.40
<ul style="list-style-type: none"> • Sigurim i Qëndrueshmërisë Mjedisore 	1) Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm i integruar në politikat dhe programet rajonale;	i). Integrim i parimit të zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programet e qarkut, veçanërisht në vështrim të humbjes së burimeve mjedisore.	% e tërë tokës së mbuluar me pyje	25.77	40
	2) Përfitim i burimeve të përtëritshme mjedisore;	ii). Kthim në kah të kundërt i procesit të humbjes së burimeve të përtëritshme mjedisore, duke i kushtuar vëmendje të veçantë mbrojtjes dhe rritjes së hapësirave të gjelbra, pyjeve dhe zonave a parqeve të mbrojtura natyrore.	% e faunës së rrezikuar: Gjitarë Shpendë Zvarranikë	22.5% 5.3% 100%	0 0 0
	3) Vendosje e përshtatshme e mbetjeve dhe furnizim me ujë të pishëm të sigurt për të gjithë qytetarët e qarkut të Gjirokastrës.	iii). Furnizim i banorëve, si të qytetit dhe të fshatit, me ujë të pishëm me cilësi të lartë dhe pakësim i reziqeve të shëndetit i shkaktuar nga vendosja e pavend e mbetjeve inerte.	Peshq	45.5%	0
<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësim i Qeverisjes 	1) Vendosje e një administrate publike vendore të pavarur dhe transparente;	i). Të sigurohet që burra e gra në shoqërinë civile kanë aftësinë dhe pozitën që të marrin pjesë aktivisht dhe barazisht, të kontribuojnë dhe të mbikëqyrin proceset politike dhe punën e pushtetit vendor.	numri i mbledhjeve të Këshillit të Qarkut që janë mbajtur për të shqyrtuar ecurinë drejt vënies në jetë të SZHR-së	0	4
	2) Fuqizim i pushtetit vendor dhe rritje e pjesëmarrjes së qytetarëve.	ii). Të ngrihet një administratë publike vendore profesionale, e besueshme dhe transparente, që nuk ndikohet nga interesa politike apo vejtake dhe që është e aftë t'u ofrojë të gjithë qytetarëve, pavarësisht përkatësisë të tyre politike, një shërbim publik të paanshëm.	numri i Organizatave Vepruese të Shoqërisë Civile (CSO)	16	50
	3) Nxitje e zhvillimit të sipërmarrjes në qark;	iii). Të rritet aftësia e pushtetit vendor që të gjenerojë shanse për zhvillimin ekonomik të qarkut;	numri i Qendrave të Pritjes së Popullit në veprim	2	10
	4) Përmirësim i mbledhjes së statistikave për gjinitë dhe vënie në jetë e politikave të gjithëmbarshme që kanë në synim çështjet gjinore	iv). Prani e gjerë e elementit Gjinor në të gjitha programet, politikat dhe buxhetet e qarkut; të promovojë priorizimin në zonat e ndjeshme për këtë çështje në mënyrë që zhvillimi i qëndrueshëm dhe demokratik i qarkut të ngrihet në nivel më të lartë.	% e anëtareve femra në Këshillin e Qarkut	4.6% 2 gra nga gjithsej 43 anëtarë të Këshillit të Qarkut	50

Paraqitje

Deklarata e Vizionit për Gjirokastrën

“Në vitin 2015 Qarku i Gjirokastrës do të ketë vlera të pertëritura kulturore, arsimore dhe shëndetsore, zhvillim ekonomik të qëndrueshëm, një industri bashkëkohore të përpunimit të prodhimeve bujqësore, një mjedis të pasur, turizëm të vazhdueshëm, nivel të lartë punësimi dhe jo varfëri”

Zanafillat e Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut

Prej kohësh, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë, duke vënë re problemet që kanë dalë në pah në qark, i vetëdijshëm për begatinë e burimeve të zonës dhe si rezultat i mundësive të dukshme për përmirësim rrënjësor, ka menduar për një strategji zhvillimi. Për pasojë, qarku i Gjirokastrës është ndër të parët në vend që mori nismën e hartimit të një strategjie zhvillimi të qarkut. Rezultati është një dokument që është përfunduar nga pjesëmarrja e shoqërisë civile, specialistëve, organizatave jofitimprurëse dhe nëpunësve të të gjitha niveleve të qeverisjes.

Nevoja për një strategji të miratuar gjerësisht u intensifikua pas disa seminareve dhe konferencave të mbajtura në Gjirokastrë, të cilët synonin shenjimin e problemeve dhe të metave që ekzistonin në qark pavarësisht nga potenciali i tij masiv. Përgjatë gjithë hapave fillestare të procesit që i prinë studimit të strategjisë së zhvillimit, palët e interesuara dhe pjesëmarrësit vijuan të çiknin një sërë temash të ndërlydhura. Këto tema përfshinin çështje demografike të qarkut, mungesat në bujqësi, perspektivat në arsim, problemet shëndetsore, shanset e planifikimit urban, gjendjen e infrastrukturës, standardet shëndetsore, marrëdhëniet ndërkufitare, problemet mjedisore dhe kulturën e përgjithshme të shoqërisë në Gjirokastrë. Shumë herë, në këto takime mes anëtarëve të shoqërisë civile, organizatave jofitimprurëse, profesorëve, inxhinierëve, specialistëve të shëndetit dhe aktorëve të sektorit privat, u pranua që janë pikërisht këto çështje kyçe ato që shqetësojnë përparimin afatgjat në qark.

U vendos që mënyra më efikase për trajtimin e këtyre vështirësive dërrmuese ishte një strategji për

zhvillimin shoqëror-ekonomik të qarkut, duke përfunduar nga njësitë administrative vendore dhe ekspertët që punojnë në bashki dhe komuna. Studimi u krye nga nëntë ekipe, secili prej të cilëve u këshillua me specialistë dhe përfaqësues të komunitetit. Veç kësaj, u mbajtën 15 tryeza të rrumbullakta të ndërlydhura me takimet që u organizuan me OJF që vepronin brenda dhe jashtë qarkut. Këtu përfshihen përfaqësues nga PNUD, FSHZH, Fondacioni SOROS, OSBE, Fondacioni “Friedrich Herbert”, Fondacioni “Pacard” dhe mjaft të tjerë. Me përfundimin e mbledhjes së të dhënave dhe analizave thelbësore u arrit në përfundimin që strategjia, si një dokument gjithëpërfshirës dhe i plotë, të miratohej njëzëri.

Qëllimi i përditësimit të sotëm

Nevoja për një angazhim më të madh të institucioneve ndërkombëtare, si PNUD, BB, FMN, Organizata për Zhvillim Ekonomik dhe Bashkëpunim dhe padyshim BE ka qenë e pranishme gjatë gjithë këtij dhjetëvjeçari. Për pasojë, këto institucione e drejtuan vëmendjen e tyre tek çështjet shoqërore sfiduese që karakterizojnë moszhvillimin. Synim i fokusit të tyre ishte të studionin rrethanat dhe mosmarrëveshjet globale dhe rajonale në mënyrë që të përcaktonin objektivat e mijëvjeçarit të ri. OZHM-të u projektuan në bazë të këtyre objektivave me një afat fillestar 15 vjeçar. 147 krerët e shteteve dhe përfaqësuesit e 191 kombeve, duke përfshirë Shqipërinë, i miratuan këto Objektiva. Në këtë kontekst, në qershor 2003, Këshilli i qarkut përgatiti një raport për qarkun e Gjirokastrës dhe OZHM-të për periudhën 2003-2010.

Në vijim të bashkëpunimit të Këshillit të Qarkut me programin e qeverisjes vendore të PNUD-it në Gjirokastrë, strategjia e zhvillimit të qarkut mori trajtë të re. Këshilli i Qarkut ishte i ndjeshëm ndaj faktit që OZHM-të duhet të harmonizoheshin me synimet që ishin shpallur në strategji. Një numër tryezash pune, seminaresh dhe këshillimesh u organizuan posaçërisht për të shenjuar si pikë referimi të dhënat statistikore si dhe të merrej një qëndrim për përshtatshmërinë e treguesve në mënyrë që ata të pasqyrojnë saktësisht perspektivat e komunitetit të qarkut. U pranua gjithashtu që ndërsa OZHM-të ishin thelbësore për avancimin e qarkut, ishte e detyrueshme që nëse donin të plotësonin disa prioritete të parapërcaktuara, duhet të tejkaloheshin disa Objektiva.

ARSYET PËR RISHIKIMIN E STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT TË QARKUT

Përditësimi dhe ribotimi i Strategjisë fillestare të Zhvillimit të Qarkut u bënë të nevojshme për tre arsye parësore. Së pari, që e rëndësishme që OZHM-të të përfshiheshin në publikimin fillestar për të pasqyruar standartet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe për të siguruar një fokus të gjerë. Së dyti, rishikimi ka ndërmend të puqë politikat e zhvillimit kombëtar për zhvillimin shoqëror-ekonomik me ato të qarkut bazuar në rezolutën e korrikut 2003 të Kuvendit dhe në përputhje me procesin e stabilizim-asocimit me BE-në. Së treti, ky publikim i ri pasqyron strategjitë ekonomike të përgatitura nga ministrinë, shqyrton procesin vijues të decentralizimit si edhe strategjitë e miratuara në vitet e fundit nga disa komuna, bashki dhe njësi administrative.

Ky raport përcakton mënyrat e arritjes së objektivave që janë përkrah prioriteteve në nivel qarku, kombëtar dhe ndërkombëtar. Është projektuar në mënyrë të tillë që të jetë konkret në zbatim dhe i gjerë në lidhje me përfituesit e synuar. Vetë raporti është një përbërës i strategjisë së zhvillimit që është një dokument i gjallë, i epshëm dhe i aftë t'u përshtatet ndryshimeve të ardhshme në qark dhe që do të kërkonin ndryshim të programit. Brenda tematike bazë, që rrok çështje si varfëria, demografia, asimi, shëndeti, bujqësia, infrastruktura dhe mjedisi, formon platformën e

hartimit të projekteve të komunitetit.

Në dritën e rihartimit të strategjisë, Këshilli i Qarkut besoi që kishte hollësi të tjera me rëndësi që lypnin diskutim. Këtu përfshiheshin shqyrtimi i proceseve të raportimit rajonal dhe kombëtar, përcaktimi i asaj që duhet të përfshijë një politikë monitorimi duke marrë parasysh rëndësinë e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në të gjitha fazat e procesit të zhvillimit dhe zhvillimin e metodave që fuqizojnë pozitën e shoqërisë civile në mënyrë që ajo të përfshihet në politikëbërje, planifikim programesh dhe vëzhgim të suksesit të strategjisë.

Kronologjia e Ngjarjeve Kryesore të Procesit të Formulimit

Data	Veprimtaria
2 qershor 2001	Seminar me titull, "Gjirokastra, vlerat po zbehen: Probleme dhe Përgjegjësi," që u fokusua në meritat e padiskutueshme të qarkut dhe politikat e sotme të qeverisjes.
14 korrik 2001	Konferencë me titull, "Gjendja dhe Perspektivat e Zhvillimit Shoqëror-Ekonomik në qarkun e Gjirokastrës," që u përqendrua tek politikat e zhvillimit të qarkut në sektorin e punësimit dhe zbutjen e varfërisë.
19 shtator 2001	Takim i Këshillit të Qarkut që miratoi strategjinë, si dhe një seri diskutimesh me sociologë, agronomë, ekonomistë dhe inxhinierë.
tetor 2002- maj 2003	Vënia në jetë e Strategjisë së parë të Zhvillimit të Qarkut Gjirokastrë.
3 qershor 2003	Tryezë pune për Shoqërinë Civile me titull "Roli i Shoqërisë Civile në procesin e OZHM-ve: Raportimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar".
qershor 2003	Përgatitja e një raporti të Këshillit të Qarkut bazuar në qarkun e Gjirokastrës dhe OZHM-të për periudhën 2003-2010.
19 janar 2004	Ngritja e Forumit të Përhershëm Publik të Qarkut për Ribotimin e Strategjisë, që synonte krijimin e një programi pune për ribotimin e Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut.
21 shkurt 2004	Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut në sfondin e OZHM-ve.
Gjatë vitit 2004	Duke iu referuar "Manualit për Hartimin e Strategjive të Zhvillimit të Qarkut", publikim i Ministrisë së Ekonomisë dhe mësimit e qarqeve të tjera, u përgatit një projekt i ri. Ndonëse ai nxorri në pah një përvojë të re, pas miratimit, u kërkuan rekomandime të mëtejshme nga qytetarët, me qëllim që të pasqyroheshin vlerat konkrete të popullsisë së qarkut.

Roli i Këshillit të Qarkut

Këshilli i Qarkut është organi më i lartë vendimmarrës në qarkun e Gjirokastrës dhe ka një mori funksionesh. Ai punon për të forcuar vullnetin politik në qark dhe vepron në mbështetje të procesit

demokratik. Këshilli i kontribuon zhvillimit ndër-rajonal dhe punon për të ngritur më lart pjesëmarrjen e shoqërisë civile nëpërmjet integritet të përpjekjeve të komunave dhe bashkive. Një tjetër fushë e prekshme është ndërmarrja e nismave që nxisin larminë kulturore. Ndër të tjera, Këshilli i Qarkut e ka drejtuar vëmendjen e tij tek marrëdhëniet me

vendet fqinje. Hapa të qëndrueshme janë ndërmarrë për t'i dhënë formë bashkëpunimit ndërkuftar me Greqinë dhe duke parë interesin e Shqipërisë për t'u pranuar si anëtare e Bashkimit Europian.

Rrethi i lexuesve dhe partnerët e pasur parasysht

Strategjia e Zhvillimit të Qarkut të Gjirokastrës është menduar për të gjithë, por veçanërisht për qytetarët e qarkut pasi ata do të jenë përfuturit kryesorë të vënies në jetë të projektit. E thënë më shkoqur, do të jenë qytetarët që do ta bëjnë qeverinë vendore të japë llogari në afatet e caktuara kohore, duke mbikëqyrur bashkë me aktorët e shoqërisë civile, suksesin në çdo fazë të procesit të zhvillimit. Raporti do të shërbejë gjithashtu si mjet i dobishëm për qeverinë vendore në planifikimin afatgjatë, pasi përvijon detyrat parësore dhe përmban metodat që duhet arritur. Akoma më tutje janë donatorët dhe organizatat ndërkombëtare që mund të përdorin strategjinë për t'u informuar për qarkun. Duke vepruar kështu, ato mund të mbajnë qëndrime të familjarizuara për nismat e mundshme që duhen mbështetur, duke u bazuar në burimet dhe afatet kohore. Gjithsesi, lypset të kuptohet që ky raport vlen për të gjithë qytetarët e Shqipërisë dhe ata jashtë saj. Ai mund të përdoret për të treguar shkathhtësinë e qarkut të Gjirokastrës dhe se si një bashkësi njerëzish mund të bëhen bashkë për të mirën e përbashkët dhe për të kontribuar për një produkt përfundimtar që do të çojë drejt një qarku më të fortë dhe më të bashkuar.

Fokusi

Kur të lexojë këtë strategji lexuesi duhet të jetë i

vetëdijshëm për faktin që, ndonëse ky raport trajton një mori të problemeve më tipike të qarkut, ai nuk zgjidh çdo çështje ekzistuese. Si rezultat i burimeve të kufizuara financiare dhe njerëzore, strategjia përfshin nevojat dhe prioritetet më të ngutshme që janë përcaktuar nga vetë komunitetet. Megjithatë, duke pasur parasysht që kjo Strategji e Zhvillimit të Qarkut përfaqëson një botim të ri të përditësuar, do t'u nënshtrohet modifikimeve të nevojshme që do të ndodhin si rezultat i situatës dinamike në qark.

Përvijim i raportit

Kjo Strategji ndahet në dy krerë të gjerë:

1. Gjendja aktuale

Kjo pjesë përshkruan gjendjen e sotme të qarkut të Gjirokastrës bazuar në shtatë sektorë të ndryshëm por të ndërlidhur me njëri-tjetrin;

2. Shikim drejt 2015-ës

Në këtë kre ka analiza të hollësishme të prioriteteve specifike të qarkut, bazuar në objektivat dhe synimet, dhe që kulmojnë në strategji konkrete për trajtimin e këtyre çështjeve. Ka rëndësi të pranohet që qytetarët e qarkut kanë përzgjedhur objektiva dhe synime të veçanta që i kanë çmuar si parësore ndërmjet gjithë shqetësimeve që kanë. Janë përgatitur tabela treguesish që do të shërbejnë si mjet për të mbikëqyrur ecurinë drejt arritjes së OZHM-ve si dhe një kornizë programi të hollësishme që përshkruan projekte të mundshme që duhen kryer për të përmbushur synimet.

Pjesa I

Gjendja e sotme në
qarkun e Gjirokastrës

Varfëria

Varfëria në Shqipëri, si shpjegohet në Raportin e Ecurisë 2003 të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim Shoqëror Ekonomik (SKZhShE), nënkupton më shumë se sa thjesht pabarazi në shpërndarjen e të mirave.¹ Ajo është një koncept shumëpërmasor që shpreh standarde themelore të jetesës siç janë ushqimi, veshja dhe strehimi; ajo përfshin elemente si humbja e shpresës, përjashtimi nga jeta ekonomike dhe shoqërore, paaftësi për të ruajtur traditat shoqërore, mungesë infrastrukture dhe siguri e ulët.² Varfëria qarkon edhe aspekte të privimit që shkojnë përtej harxhimeve materiale siç janë vuajtjet psikologjike të të qenit i varfër, një ndjenjë cënueshmërie ndaj ngjarjeve të jashtme dhe pafuqi kundrejt institucioneve të shtetit dhe shoqërisë.³

Banka Botërore mendon që përmirësimet në shkallë të gjerë të mirëqenies nuk do të ndodhin përsa kohë që të varfërit nuk kanë akses në shërbime cilësore në shëndetsi, arsim, ujë, higjienë dhe energji. Në mungesë të përmirësimeve të tilla, shpëtimi nga sëmundjet dhe analfabetizmi, që janë dy nga rrugët më të rëndësishme nëpërmjet të cilave të paprivilegjuarit mund të largohen nga varfëria, do të mbeten ëndërr për shumicën.⁴

Shtirirja e varfërisë në qarkun e Gjirokastrës, gjithsesi nuk mund të përshkruhet thjesht si një dukuri e përgjithshme që prek njëlloj të gjithë të varfërit. Përkundrazi, varfëria përcaktohet nga një mori luhatjesh në gjithë qarkun. Terreni i thyer, klima e ashpër, hapësira e jetesës si dhe largësitë e mëdha nga qendrat shëndetsore, godinat e arsimit dhe qendrat urbane, në tërësi ndikojnë tek varfëria në qark.⁵ Për më tej, kategoritë e veçanta sociale që përfshijnë, ndërmjet të tjerave, ndarjet moshore, etnike, gjinore dhe të aftësive, perpiqen të ndërlikojnë përkufizimin e varfërisë në qark.

Indeksi i Zhvillimit Njerëzor (HDI)

Zhvillimi njerëzor është një proces i zgjerimit të

zgjedhjeve njerëzore duke shtrirë potencialin njerëzor. Tre aftësitë themelore të zhvillimit njerëzor janë që njerëzit të kenë një jetë të shëndetshme, të jenë të arsimuar dhe të kenë standarde të mira jetese. Nëse këta elemente bazë nuk arrihen, mjaft zgjedhje dhe mundësi mbeten të paarrtshme. Sfera e zhvillimit njerëzor, gjithsesi, shkon më tutje duke pranuar që zonat themelore të zgjedhjes luhaten nga mundësi politike, ekonomike dhe shoqërore për të qenë krijues dhe prodhues, deri në pasjen e një vetërespekti, fuqie dhe ndjenje përkatësie në bashkësi.

PNUD-i përshkruan Indeksin e Zhvillimit Njerëzor si një indeks përzjerjeje që mat arritjet mesatare të një vendi duke u bazuar në tre dimensione bazë të zhvillimit njerëzor: një jetë e gjatë dhe e shëndetshme që matet nga jetëgjatësia që nga lindja, dijet, që matet me nivelin arsimor të të rriturve dhe shkalla e kombinuar e regjistrimit në shkollat e nivelit të parë, të dytë dhe të tretë; dhe një standard i përshtatshëm jetese, që matet nga PPP për frymë në paritetin e fuqisë blerëse (PPP) në USD.

Indeksi ndërtohet duke përdorur tregues të gjendshëm botërisht dhe një metodologji të thjeshtë dhe transparente. Kësisoj, ndërkohë që koncepti i zhvillimit njerëzor është mjaft më i gjerë se sa ç'mund ta masë çdo indeks i përzjer, HDI ofron një alternativë bindëse për të hyrë si masë e mirëqenies njerëzore.⁶ Llogaritja e HDI-së bazohet në të dhëna nga Vëzhgimi i Matjes së Standardeve të Jetesës (VMSJ /LSMS) 2002, i kryer nga INSTAT-i. Sipas LSMS 2002 të dhënat gjeografike për Shqipërinë kategorizohen si vijon:

- **Tirana:** Bashkia e Tiranës;
- **Zona bregdetare:** Delvinë, Durrës, Fier, Kavajë, Laç, Lezhë, Lushnje, Mallakastër, Sarandë dhe Vlorë;
- **Zona qendrore:** Berat, Devoll, Elbasan, Gjirokastrë, Kolonjë, Korçë, Krujë, Kuçovë, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Peqin, Përmet, Pogradec, Pukë, Skrapar, Shkodër dhe Tepelenë; dhe
- **Zona malore:** Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kukës, Librazhd dhe Tropojë

¹Raporti Kombëtar i Shqipërisë: Në eje drejt arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, Ministria e Punëve të Jashtme & Departamenti i SKZhShE-së në Ministrinë e Financave, Shqipëri, 2004.

²Një vlerësim cilësor i varfërisë në 10 zona të Shqipërisë, Banka Botërore, Uashington D.C., qershor 2001.

³Njësia e Sektorit të Zhvillimit Njerëzor: Rajoni i Europës dhe Azisë Qendrore, Shqipëria – Vlerësim i Varfërisë, Vëll. 1, Banka

Botërore, nëntor 2003.

⁴Raporti i Zhvillimit Botëror 2004: që Shërbimet të jenë për të të varfërit, Grupi i Bankës Botërore (online).

⁵Njësia e Sektorit të Zhvillimit Njerëzor: Rajoni i Europës dhe Azisë Qendrore, Shqipëria – Vlerësim i Varfërisë, Vëll. 1, Banka Botërore, nëntor 2003.

⁶Zyra e raportit të Zhvillimit Njerëzor, 2004 (online).


HDI sipas Zonës Gjeografike⁷

	E ardhura Kombëtare Gjithsej (1,000 Lek)	Faktori i Shpërndarjes	PPB gjithsej në PPP	PPB gjithsej në PPP për frymë	Indeksi i PPB-së	Indeksi i jetë-gjatësisë	Indeksi i Arsimit	Indeksi HDI
Tiranë	50,487,381	43.58%	6,550,701,752	10,194	0.772	0.823	0.894	0.830
Bregdet	40,569,276	35.02%	5,263,834,734	7,835	0.728	0.823	0.842	0.798
Qendrore	23,512,352	20.30%	3,050,710,881	2,131	0.511	0.823	0.840	0.725
Malore	1,279,708	1.10%	166,041,160.9	454	0.252	0.823	0.819	0.632
Gjithsej	115,848,716	100.00%	15,031,288,528	4,830	0.647	0.823	0.843	0.771

Qarku i Gjirokastrës, i përbërë nga rrethet Gjirokastrë, Përmet dhe Tepelenë, bie në kategorinë gjeografike "Qendër". Si i tillë, HDI i qarkut është 0.725 pra gjithsej një nivel i tretë. Për ta trajtuar në një kontekst rajonal, Greqia fqinje ka një HDI prej 0.902 (e 24-ta në botë), Kosova ka një HDI prej 0.733 (e 90-a në botë), ndërsa Maqedonia ka një HDI prej 0.793 (e 60-a në botë). Në nivel komune, siç tregohet në hartë, shumica e bashkive të Tepelenës dhe Gjirokastrës kanë një HDI midis 0.748-0.762. Kjo është nën mesataren kombëtare të HDI-së (0.771) por mbi mesataren HDI për zonën gjeografike qendrore (0.725). Midis këtyre dy bashkive ka edhe komuna ku HDI arrin mes 0.763-0.801. Shumica e


bashkisë Përmet ka një HDI mes 0.763-0.801, që është afërsisht e barabartë me mesataren kombëtare të HDI-së dhe mbi mesataren e HDI-së për kategorinë Qendër. Në veriun dhe jugun e skajshëm të bashkisë Përmet, ka komuna ku HDI është më i ulët (0.748-0.762). HDI më i ulët (0.711-0.747) mund të gjendet në disa komuna të Gjirokastrës dhe në rrethinat e qytetit të Gjirokastrës. Kjo mesatare e veçantë është mjaft më e ulët se mesatarja kombëtare e HDI-së dhe afërsisht e barabartë me mesataren e HDI-së për kategorinë Qendër. Kjo gjendje tregon qartë që qarku nuk është i paprekur nga ndarjet e thella që ekzistojnë mes të pasurve dhe të varfërve dhe të pasurve dhe të varfërve të skamur.

⁷ Raporti Kombëtar për Zhvillimin Njerëzor, 2004.



Raporti Kombëtar i Zhvillimit Nierëzor. 2002.

Indeksi ZHNJ në Nivel Komune



INSTAT: REPOBA, 2001 and National Human Development Report, 2002.

Brenda kufijve të HDI-së përfshihet një përbërës që njihet si “të ardhura të ulta”. Të ardhurat e ulta, të krahasuara me varfërinë që ka veçori mungesën e nevojave bazë, i quajmë njerëzit si “të varfër” nëse të ardhurat apo shpenzimet familjare për frymë bien nën një nivel specifik (që quhet vija e varfërisë). Kjo matje e varfërisë merr parasysh numrin e njerëzve si dhe sa poshtë vijës së varfërisë bien ata.⁸ E thënë thjesht, “të ardhurat e ulta” u përgjigjen niveleve të ulta ose tejet të ulta të të ardhurave vetjake dhe vepron si masë e varfërisë. Në këtë vështrim, studimet arrijnë në përfundimin që “të ardhurat e ulta” në Shqipëri janë të shpeshta dhe qarku i Gjirokastrës nuk bën përjashtim.⁹

Në bazë të të ardhurave, 25% e familjeve ose 41,697 vetë nga popullsia totale prej 166,788 në qarkun e Gjirokastrës janë mjaft të varfër dhe nuk mundën as të përmbushin nevojat elementare për ushqim. Edhe më alarmues është fakti që 58% e familjeve ose 96,737 veta janë midis:

1. qenies të aftë të përmbushin nevojat ushqimore por nuk mund të mbulojnë shpenzimet e tjera të nevojshme; dhe
2. qenies të aftë të përmbushin nevojat themeltare familjare si ushqimi dhe veshja por nuk mund të mbulojnë shpenzime të tjera.

Pjesa që mbetet prej 17% (28,354 veta), nga ana tjetër janë të aftë të përmbushin si nevojat familjare ashtu edhe nevoja të tjera. Për ta vënë në një kontekst, banorët që jetojnë me më pak se 3USD/ditë janë ata që formojnë kategorinë e 58%-it. Kësisoj, aftësia e tyre për të përmbushur nevojat jetësore është krejtësisht e varur nga punësimi i sigurt pasi humbja e vendit të punës i vendos ata menjëherë tek kategoria 25% që janë të paaftë të përmbushin nevojat elementare për ushqim.

Kur masim të ardhurat e ulta, në të ardhmen duhet të mbledhim të dhëna të veçuara që tregojnë përqindjen e familjeve që drejtohen nga gra nga të gjitha familjet që jetojnë nën nivelin e varfërisë. Familjet e drejtuara nga gra dhe pa mundësi ndihme në të holla nga jashtë priren të jenë më të varfra sesa familjet e drejtuara nga burrat. Familjet e drejtuara nga gra janë gjithashtu më të cënueshme nga papunësia dhe pakësimi i ndihmës sociale sesa familjet me burra kryefamiljar. Shpërbërja e të dhënave të mësipërme në drejtim të gjinisë mund të ketë implikime të rëndësishme politike dhe do të lejonte ndërhyrje me synimin që familjet me gra kryefamiljare të kenë mbrojtje të përshtatshme ekonomike dhe sociale.

Varfëria priret të jetë më e shtrirë në zonat fshatare dhe shpesh është më e lartë se në qendrat urbane. Përgjithësisht, njerëzit nuk kanë mjete për të përfiturat të ardhura për përmirësimin e gjendjes së tyre ekonomike. Për pasojë, varfëria në fshatra ka vijuar të sundojë në kushte jetese që mezi po përmirësohen. Veç gjendjes së pasigurt ekonomike që tregon nivel të lartë varfërie, vihet re në rritje e mendimit të popullsisë së qarkut Gjirokastrë që nuk ka shpresë për të ardhme më të mirë. Kjo mendësi ka pasur dhe ka gjasa të vazhdojë të kontribuojë në rritjen e shkallës së emigrimit, çka ka shkaktuar braktisjen e dukshme të zonave si Lopës në Tepelenë, Frashër në Përmet dhe Zagori në Gjirokastrë.¹⁰

Indeksi i Zhvillimit Gjitor (GDI)

Indeksi i zhvillimit gjitor 2003 që mat të njëjtët tregues si indeksi i zhvillimit njerëzor dhe i përshtat ata për pabarazinë gjinore, e rendit Shqipërinë të 73-ën nga 175 vende.¹¹ Në kontekstin rajonal, Greqia fqinje është e 24-ta, ndërsa Italia e 21-ta. Ndonëse GDI nuk dihet për Maqedoninë dhe Bosnje-Hercegovinën, çka do të lejonte një përqasje më të mirë në rajon,

⁸ Raporti Kombëtar për Zhvillimin Njerëzor, 2004.

⁹ Përygjia shqiptare për OZHM-të, Qendra për Rritjen e Zhvillimit Njerëzor, Tiranë, maj 2002.

¹⁰ Regjistri statistikor i rrethëve, Këshilli i qarkut, 2003.

¹¹ Raporti për Zhvillimin Njerëzor, 2003.

Shqipëria mbetet pas vendeve të tjera ballkanike si Bullgaria e Rumania që përkatësisht renditen në vendet 51 dhe 57 me një barazi më të mirë gjinore.

GDI tregon qartë që varfëria në Shqipëri ka përbërës gjinor. Ka rëndësi të vihet re që ndonëse gratë kur bëhet fjalë për shkallën e ndjekjes së arsimit fillor, dytësor dhe tretësor ua kalojnë meshkujve me 3% (në shkallë kombëtare), ato nuk duket se përfitojnë nga niveli më i lartë arsimor në tregun e punës; në këtë treg të ardhurave të tyre mezi kalojnë 50% të të ardhurave të meshkujve. Në të ardhmen, Indeksi i Zhvillimit Gjinor në aspektin gjeografik duhet të përgatitet për të shqyrtuar në ç'masë zhvillimi njerëzor në qarkun e Gjirokastrës shpreh pabarazinë gjinore.

Marrja e ndihmës sociale

Një tregues i gjerë i varfërisë është matja e përqindjes së popullatës që varet nga ndihma sociale. Ndonëse ai nuk arrin të tregojë shkaqet e kësaj, shërben për të treguar sesa banorë varen në këtë burim të ardhurash për të jetuar. Në qarkun e Gjirokastrës, në të treja bashkitë, ka një numër shqetësues banorësh që varen nga ndihma sociale. Në Tepelenë, psh afro 15% e banorëve të bashkisë varet nga asistenca sociale; kjo dukuri haset veçanërisht në komunat Buzë, Kurvelesh, Krahës, Lopës dhe Luftinje. Në bashkinë e Përmetit, varësia nga ndihma sociale shfaqet sidomos në komunat Frashër, Ballaban, dhe Sukë (afro 11% e banorëve). Ndërsa për bashkinë e Gjirokastrës, varësia nga ndihma sociale haset sidomos në komunat Lazarat, Picar dhe Cepo (afro 3.7% e banorëve).¹²

Banorët që përfitojnë ndihmë sociale të pjesshme ose të plotë¹³

	2000			2003		
	Gjithsej	Qytet	Fshat	Gjithsej	Qytet	Fshat
Tepelenë	3,594	2,766	828	3,024	2,160	864
Përmet	8,718	3,222	5,496	7,014	3,426	4,488
Përmet	4,704	2,370	2,334	4,296	2,070	2,226
Gjithsej	17,016	8,358	8,658	15,234	7,656	7,578

Varësia nga pensionet

Ndonëse shqyrtimi i numrit të personave që varen nga pensionet në qark nuk arrin të tregojë shkaku e saktë të varfërisë, ai tregon masën në të cilën njerëzit varen nga asistenca për të jetuar. Për pasojë, numri i atyre që marrin pension në një zonë të caktuar, bashkë me shumën që përfitojnë janë tregues i gjerë i varfërisë. Në qark një pjesë e mirë e të varfërve përbëhen nga të moshuar, të paftë dhe të ve ose të veja. Nga kjo pjesë e popullsisë shumica varen nga pensioni si burim kryesor, dhe nganjëherë i vetëm, i të ardhurave.

Në qarkun e Gjirokastrës, gjithsej 26,480 persona, ose 23.9% e popullatës varen nga pensioni. Në zonat qytetëse 16,198 banorë varen nga pensionet për të përmirësuar jetën e tyre dhe këta janë afro


14.6% e krejt popullsisë. Shumica dërrmuese e këtyre banorëve të qyteteve merr pension të plotë (12,121), të ndjekur nga ata që marrin një pension të pjesshëm (2,946) dhe ata që marrin pension paaftësie (1,095). Pensioni i plotë mesatar mujor në qytete është 7,055 lekë, ai i pjesshëm 3,551 lekë dhe pensioni i paaftësisë 5,846 lekë. Ndërmjet 10,282 personave që jetojnë në fshat dhe marrin pension (9.3% e popullatës së qarkut), 9,012 marrin pension të plotë, 995 pension të pjesshëm dhe 77 pension paaftësie. Pensioni i plotë në fshat është 1,940 lekë, ai i pjesshëm 871 lekë dhe pensioni i paaftësisë është 1,954 lekë.¹⁴ Këto të dhëna tregojnë, ashtu si dhe HDI e ulët e qarkut, që mjaft banorë që varen nga pensionet për të jetuar rrojnë të zhytur në varfëri.

¹² Regjistri statistikor i rrethëve, Këshilli i qarkut, 2003.

¹³ Regjistri statistikor i rrethëve, Këshilli i qarkut, 2003.


¹⁴ Treguesit sipas Prefekturave: 2002-2003, INSTAT, 2004.

Shpërndarja e GDP



Raporti Kombëtar i Zhvillimit Njerëzor, 2004.

Indeksi GDP në Nivel Komune



INSTAT: REPOBA, 2001 and National Human Development Report, 2002.

Prodhimi i Përgjithshëm Bruto (PPB)

Rritja ekonomike matet me rritjen e ekonomisë të një vendi ose rajoni. Ndaj, një tregues i gjerë i përmasave të ekonomisë është prodhimtaria (fuqia prodhuese). Mjeti matës që përdoret më gjerësisht për prodhimtarinë është Prodhimi i Përgjithshëm Bruto (PPB). PPB është një

matje standarde që shpreh vlerën totale të të mirave dhe shërbimeve në treg të prodhuar nga punëtorët dhe kapitali në një vend a rajon, përgjatë një periudhe një vjeçare. Për rrjedhojë, PPB vepron si një tregues i fortë i mirëqenies ekonomike të një kombi apo rajoni.


PPB kombëtar sipas zonave gjeografike¹⁵

	E ardhura kombëtare gjithsej (1,000 Lek)	Faktori i shpërndarjes	PPB gjithsej (PPP US\$)	PPB në PPP për frymë	Indeksi
Tiranë	50,487,381	43.58%	6,550,701,752	10,194	0.772
Bregdetare	40,569,276	35.02%	5,263,834,734	7,835	0.728
Qendrore	23,512,352	20.30%	3,050,710,881	2,131	0.511
Malore	1,279,708	1.10%	166,041,160.9	454	0.252
Gjithsei	115.848.716	100.00%	15.031.288.528	4.830	0.647

Sic tregon tabela, PPB e zonës qendrore renditet e treta me disnivel ndërmjet katër kategorive gjeografike. Në nivel komune, harta tregon që shumica e bashkive të Tepelenës dhe Gjirokastrës bien midis PPB-së 0.458-0.532; kjo është nën mesataren e PPB-së kombëtare (0.647) por afërsisht e barabartë me mesataren e PPB-së për kategorinë qendrore (0.511). Ka disa komuna që arrijnë një PPB mes 0.533-0.633, që bie vetëm pak nën mesataren e PPB-së kombëtare por sipër mesatares së PPB-së për kategorinë qendrore. Thuajse e tërë bashkia Përmet,

përveç një komune ka një PPB relativisht të lartë që vërtitet mes 0.533-0.633. PPB më e ulët mund të gjendet në Gjirokastrë (0.446-0.457); kjo është mjaft më e ulët se mesatarja kombëtare dhe nën mesataren e PPB-së për kategorinë qendrore. Jo rastësisht, treguesit e kësaj harte përkrijnë drejtpërdrejt me HDI-në mesatare të çdo komune. Kështu, ekonomia e qarkut të Gjirokastrës nuk është e shëndetshme. Gjithsesi, një analizë e hollësishme e shkaktarëve që kontribuojnë në këtë gjendje është e nevojshme para se të arrihet në përfundime.

Shpërndarja e familjeve sipas tipit të aksesit në ujë të pishëm



INSTAT: REPOBA, 2001

Hapësira e jetesës

Varfëria mund të shihet edhe në këndvështrimin e hapësirës së jetesës dhe veçanërisht duke vlerësuar përmasat e banesave. Ky tregues mund të jetë i rëndësishëm kur gërshetohet me madhësinë e familjes, sistemet e ngrohjes dhe furnizimin me ujë. Dorë për dorë, në qarkun e Gjirokastrës, familjet kanë një sipërfaqe jetese prej 40-69 metra katrorë, dhe, në një masë më të gjerë deri në 70-99 metra katrorë. Mjaft pak familje shijojnë luksin e strehimit në një sipërfaqe nga 100-130 metra katrorë ose më shumë se 130 metra katrorë. Ka familje në Lunxhëri, Zagori dhe Qendër në Gjirokastrë, Çarçovë dhe Ballaban në Përmet dhe mjaft komuna në Tepelenë, kanë më pak se 40 metra katrorë hapësirë për të jetuar.

Sistemet e ngrohjes

Një mënyrë tjetër për të treguar nivelin e varfërisë është mungesa e aksesit në shërbimet bazë. Pamundësi për të siguruar nevoja bazë si ngrohja, uji, streha dhe veshja dhe gërshetimi i tyre ilustron jo vetëm varfërinë, por edhe thellësinë ku ka arritur ajo. Ngrohja ka qenë një problem i vjetër në Shqipëri dhe përmirësohet mjaft ngadalë. 99.9% e popullsisë nuk ka ngrohje qendrore dhe më shumë se 50% ia dalin duke përdorur drurin si burim kryesor të ngrohjes.¹⁶ Gjendja në qarkun e Gjirokastrës nuk del nga kjo rrymë. Siç tregon harta, në të tre rrethet përdoren sisteme individuale ngrohjeje (që përfshijn drurin, ndonëse prerja e drurëve është e paligjshme; shiko kapitullin "Mjedisi"), dhe, në një shkallë mjaft të ulët, sisteme ngrohjeje qendrore.

Vetëm në Memaliaj të Tepelenës dhe Odrie të Gjirokastrës ka familje që jetojnë pa asnjë lloj sistemi ngrohjeje. Duke gjykuar nga numri i familjeve që jetojnë në Memaliaj dhe Odrie, krahasuar me zona më të populluara, mund të thuhet se, së paku, numri i familjeve që nuk kanë ngrohje është i vogël. Themi këtë, sepse asnjë familje në rajon nuk duhet të jetojë pa pasur ngrohje, veçanërisht duke pasur parasysh stinën e dimrit të ftohtë e të lagësht.

Ia vlen të shënohet që ndonëse qarku po ecën mirë në lidhje me aksesin në ngrohje, kjo nuk duhet marrë si tregues i qartë dhe pozitiv për nivelin e varfërisë. Statistika si këto tregojnë që varfëria në Gjirokastrë është komplekse dhe që ka shumë të ngjarë të marrë trajta të tjera. Për shembull, varfëria mund të shfaqet më fort si

sëmundje, arsim nën standarde ose si furnizim i pamjaftueshëm me ujë.

Aksesi për ujë

Aksesi për ujë të pastër dhe të besueshëm mund të ketë një efekt madhor në mjaft aspekte të jetës së përditshme dhe në cilësinë e saj. Kjo është baraz me ndryshimin mes të jetuarit me sëmundje ose duke u kujdesur për një të sëmurë në familje përkundër të qenurit i shëndetshëm dhe i fortë dhe me aftësinë për të pasur veprimtari ekonomike. Për shkak të rolit shoqëror, gratë janë agjentët kryesorë në administrimin e burimeve ujore pasi janë ato që e mbledhin dhe e përdorin ujin në familje. Mundësitë e pakta për ujë dhe cilësia e ulët e tij ndikon në sasinë e punës që gratë shpenzojnë për të marrë ujë dhe ndikon gjithashtu tek shëndeti i tërë familjes. Në rast sëmundjesh me origjinë nga uji, sikurse në të gjitha rastet e sëmundjeve, janë zakonisht gratë që kujdesen për familjarët e sëmurë. Kështu, çdo mungesë uji ose vështirësi për të pasur ujë të sigurt nënkupton që gratë në qarkun e Gjirokastrës shpesh duhet të mbajnë mbi supë barrën shtesë. Ndonëse ka një mori burimesh ujore që janë të njohur për cilësi pastërtie dhe kurative, qarku nuk arrin të furnizojë zonat qytetëse dhe fshatare me ujë të vazhdueshëm dhe të trajtuar. Cilësia e dobët e ujit rrjedh nga mungesa e mjediseve për trajtimin e ujrave të zeza, rrjetet e amortizuara që ndotin ujin e pijshëm dhe klorinimi i papërshtatshëm. Kjo shpie në sëmundje me origjinë nga uji, si schistosomiasis/bilharzia, kolera, dhe giardia, që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në prodhimtari. Për pasojë, kushtet jo të mira të sektorit të furnizimit me ujë, që ka pasur probleme madhore me kapacitetin, mbulimin, aksesin, cilësinë dhe administrimin vazhdojnë të veprojnë si pengesë për rritjen e qëndrueshme të qarkut.

Ndërsa uji i pijshëm i vazhdueshëm ka qenë përherë problematik, situata është përkeqësuar edhe më tej vitet e fundit. Rritja e kërkesës për ujë të pijshëm, bashkë me shumë pak investime në infrastrukturën e ujit të pijshëm, gjatë kohës së komunizmit, janë të parat që fajësohen. Vetëm 53.1% e shqiptarëve kanë në shtëpi ujë të rrjedhshëm, afro 16% e kanë jashtë shtëpisë dhe 30% (shifër shqetësuese) nuk kanë kurrfarë aksesin në ujë të rrjedhshëm. Kjo mungesë investimesh shoqërohet me keqadministrim të burimeve ekzistuese, ndërsa zona të mëdha në vend vuajnë nga mungesat e gjata të ujit. 47% e popullsisë ka ujë të vazhdueshëm të rrjedhshëm, ndërkohë që pjesa tjetër e vendit ka vetëm 6 orë ujë në

¹⁶ Raporti Kombëtar për Zhvillimin Njerëzor, 2004.

ditë. Si përherë, familjet më të varfra vuajnë më shumë nga mungesa e furnizimit dhe e burimeve për të siguruar shërbimet më elementare të ujit.¹⁷ Furnizimi me ujë dhe kanalizimet në qytetet dhe fshatrat e qarkut të Gjirokastrës janë krejt të papërshtatshme pasi nuk

arrijnë të përmbushin as kërkesat më minimale të banorëve, ndërsa dëmtojnë edhe mjedisin. Tabela vijuese ilustron gjendjen në lidhje me rrjetin e furnizimit me ujë. Ajo dëfton që më pak se gjysma e rezervuarve dhe stacioneve të pompimit sot janë në punë.

Rezervuare dhe Stacione pompimi në qark¹⁸

	Rezervuare		Stacione pompimi	
	Gjithsej	Në punë	Gjithsej	Në punë
Gjirokastrë	31	31	16	2
Tepelenë	14	8	29	4
Permet	25	5	22	7
Gjithsej	70	44	67	13

Pavarësisht riparimeve të rrjetit ujqor, qendrat urbane marrin ujë në orare mjaft të kufizuara të ditës. Psh pjesë të qytetit të Gjirokastrës dhe Libohova (Gjirokastrë) marrin ujë për jo më shumë se 2 orë në ditë; pjesë të Tepelenës dhe Memaliajt (Tepelenë) dhe Përmeti dhe Këlcyra (Përmet) marrin ujë për jo më shumë se tre orë në ditë. Nuk është për tu habitur që gjendja në fshatra është mjaft më e keqe.¹⁹ Harta vijuese tregon që shumë familje në Gjirokastrë (përveç afro 1/4 e Cepos) dhe shumica në Përmet (përveç 1/3 në Frashër) kanë akses uji në banesë, jashtë saj, me pus apo depozita uji. Gjithsesi një përqindje tepër alarmuese e familjeve në Tepelenë nuk kanë fare akses uji. Rastësisht, Tepelena është edhe rrethi në të cilin ndodhen përqindja më e madhe e familjeve që nuk kanë lehtësira ngrohjeje. Në zona si Lopës, Krahës dhe Luftinjë ku 50-75% e familjeve vuajnë për ujë gjendja është kritike dhe nevojitet ndërhyrje e menjëhertë. Vlen të theksohet, që problemet me mbylljen e rrjeteve të jashtëligjshme të ujit në qark e ndërlikon çështjen, pasi kur siguria e ujit komprometohet rriten ndjeshëm edhe rreziqet për shëndetin.

Romët dhe Varfëria

Qeveritë vendore dhe ato kombëtare nuk kanë mundur të adaptojnë qëndrime të brendshme të vazhdueshme e të qëndrueshme ndaj komunitetit të romëve; meqë asnjë vend tjetër evropian nuk ka zhvilluar ndonjë zgjidhje të suksesshme për këtë çështje përsëritja është e pamundur. Pavarësisht kësaj, prirjet që shihen njësoj në të gjitha vendet dhe që kanë si veçori përjashtimin dhe diskriminimin e gjerë të romëve, lënë të kuptohet që çështjet e romëve deri më tash janë neglizhuar apo injoruar.

Midis minoriteteve (të përlllogaritura deri në 2% të popullsisë shqiptare), romët përbëjnë shumicën e këtyre grupeve të marxhinalizuara në vend. Ndërsa shumë familje perpiqen të krijojnë kushte jetese për veten e tyre, mjaft prej tyre kanë emigruar në Greqi. Disa mendojnë se janë të aftë vetëm të lypin në rrugë për mbështetje dhe më pas kthehen në komunitetin që kanë lënë pas. Duhet thënë që, analiza e të ardhurave të familjeve rome jep informacion vendimtar për sa i takon varfërisë dhe cilësisë së jetës, por të dhënat mbi të ardhurat dhe shpenzimet e familjeve në nivel kombëtar (dhe sidomos rajonal) të ndara sipas etnive dhe gjinisë janë tepër të pakta.²⁰ Si e tillë, është zhvilluar një raport i BB 2004²¹ mbi bazën e një vetëvlerësimi të romëve. Del se romët e kuptojnë varfërinë në mënyra të ndryshme. Në përkufizimin e tyre për varfërinë përfshihet lufta për ekzistencë si pamundësia për të siguruar ushqim, veshmbathje, strehim, stresi emocional dhe ndjenja e të qenurit të përjashtuar nga jeta ekonomike dhe sociale. Varfëri mund të thotë të jesh i cënueshëm, i pasigurtë dhe i paaftë për të vazhduar traditat familjare.²² Po ashtu, është e evidente që pamundësia për të siguruar ushqimin, veshmbathjen dhe strehimin çon në përjashtimin dhe diskriminimin e romëve nga shumica e komuniteteve.

Romët në Shqipëri mund të ndahen në katër nivele social-ekonomike në bazë të aftësisë së tyre për të përmbushur nevojat. Familje “tejet të varfra” janë ato familje që nuk mund të blejnë ushqime apo që nuk mund të mbulojnë nevojat e ditës. Në mënyrë të ngjashme, “familjet e varfra” dallohen nga fakti që ata mund të kenë ushqim por nuk mund të blejnë veshmbathje. Nga ana tjetër “familjet jo të

17 Raporti Kombëtar për Zhvillimin Njerëzor, 2004.

18 Regjistri statistikor i rrethëve, Këshilli i Qarkut, 2003.


19 Regjistri statistikor i rrethëve, Këshilli i Qarkut, 2003.

20 Romët në Europën Qendrore dhe Lindore: Si të shmangësh kurrthin e varësisë – Raport Rajonal i Zhvillimit Njerëzor, PNUD, dhjetor 2002.

21 Hermine De Soto, Ilir Gedeshi, Sabine Beddies, & Daniel Perez, Romët dhe egzistimi në Shqipëri: Nga përjashtimi social drejt përfshirjes sociale ose Dilema e Monedhës së Artë, Raporti I-rë: Rekomandime dhe Implikime Politike, Banka Botërore, prill 2004


22 Punë teknike Nr. 520, Varfëria në Shqipëri: Një vlerësim cilësor, Banka Botërore, 2002.

Shpërndarja e familjeve sipas sipërfaqes së banimit



INSTAT: REPOBA, 2001

Shpërndarja e familjeve sipas tipit të sistemit ngrorës



INSTAT: REPOBA, 2001

varfra mund të mbulojnë nevojat e ditës, dhe familjet relativisht të pasura përshkruhen si familje që kanë mundësi të kursejnë të holla. Krahasuar me përqindjen e tejet të

varfërve në shumicën e popullatës (29%), 75% e romëve e konsiderojnë veten si tejet të varfër. Kjo përllogaritje e nivelit të varfërisë është tepër e lartë.

Vetë-Vlerësim i Kushteve Social-Ekonomike të Romëve²³


Vlerësimi i kushteve social-ekonomike	% e atyre që zgjedhën këtë vlerësim	Kategoria social-ekonomike
Nuk sigurojnë dot ushqim	40	Tejet të varfër
Nuk përballojnë dot nevojat e ditës	35	Tejet të varfër
Përballojnë ushqimin, por jo veshjet	7	Të varfër
Mund të përballojnë nevojat e ditës	14	Jo të varfër
Kanë mjaft të holla për të kursyer	4	Relativisht të pasur
Gjithsej	100	

Njëherë
Rrallë
Shpesh
Kurrë

Statistikat qeveritare tregojnë që rreth 20% e popullsisë marrin asistencë ekonomike. Në të gjitha rajonet e vendit, del që familjet e romëve përbëjnë një përqindje të lartë të të gjithë familjeve që marrin ndihmë sociale, krahasuar me vendin që ato zënë në gjithë popullsinë.²⁴ Kur besimi në ndihmën sociale shoqërohet me nivele të ulta aspiratash, planet që i vihen vetes për një jetë më të mirë zbehen më lehtë.

Kjo çështje përbën një pikë kyçe të intolerancës etnike, përjashtimit të romëve dhe diskriminimit, pasi shumica i sheh romët si përfitues të asistencës sociale dhe i rradhisin ata njëherësh ndër personat që nuk kontribuojnë në të. Rezultati është që shumica vazhdon t'i perceptojë romët si parazitë duke çuar në argumenta të arsyeshëm ekonomik për intolerancë dhe diskriminim etnik.²⁵

Në tabelën e mëposhtme²⁶, del qartë se në rajonin e Gjirokastrës më shumë se 40% e të anketuarve mendojnë që ata diskriminohen shpesh



23 Hermine De Soto, Ilir Gedeshi, Sabine Beddies, & Daniel Perez, Romët dhe evgjitet në Shqipëri: Nga përjashtimi social drejt përfshirjes sociale ose Dilema e Monedhës së Artë, Raporti I-rë: Rekomandime dhe Implikime Politike, Banka Botërore, prill 2004.

24 Hermine De Soto, Ilir Gedeshi, Sabine Beddies, & Daniel Perez, Romët dhe evgjitet në Shqipëri: Nga përjashtimi social drejt përfshirjes sociale ose Dilema e Monedhës së Artë, Raporti I-rë: Rekomandime dhe Implikime Politike, Banka Botërore, prill 2004.

25 Romët në Europën Qendrore dhe Lindore: Si të shmangësh kurthin e varësisë – Raport Rajonal i Zhvillimit Njerëzor, PNUD, dhjetor 2002.


26 Hermine De Soto, Ilir Gedeshi, Sabine Beddies, & Daniel Perez, Romët dhe evgjitet në Shqipëri: Nga përjashtimi social drejt përfshirjes sociale ose Dilema e Monedhës së Artë, Raporti I-rë: Rekomandime dhe Implikime Politike, Banka Botërore, prill 2004.

Rezultati është që duhet gjetur një kompromis delikat për t’ju ofruar romëve, një mbrojtje sociale të nevojshme duke u siguruar ndërkohë mbështetje për investim.²⁷

Vetë-vlerësimi pohon që të ardhurat e familjeve rome janë më pak se gjysma e të ardhurave kombëtare të familjeve urbane. E ardhura mesatare mujore e familjeve rome është 16,492 lekë, ndërkohë që shpenzimet e tyre mesatare janë 25,867 lekë. 64%

e shpenzimeve të tyre mujore shkon për ushqime. Nga pikëpamja e gjenerimit të të ardhurave, romët i sigurojnë të ardhurat e tyre nga tregtimi i rrobave të përdorura, mbledhja e kanaçeve dhe shisheve, lojës në vegla muzikore, dhe punëve rastësore kryesisht në ndërtim. Përveç shpenzimeve për ushqim romët i shpenzojnë të ardhurat e tyre të mbetura në pagimin e borxheve, në shëndet, lehtësira dhe transport.

Shpenzimet Mesatare Mujore të Familjeve Rome (US\$)²⁸



Për sa i takon hapësirës së banimit, 75% e romëve jetojnë në shtëpi me një apo dy dhoma, me një mesatare 6.04 persona për familje. Rreth 40% e këtyre shtëpive janë pa ujë të pijshëm brenda. Kësaj i shtohet fakti që shkalla e lartë e varfërisë lidhet negativisht me shëndetin e fëmijëve, psh sa më të mëdha të jenë familjet aq më e madhe është mundësia për kequshqyerje. Në mënyrë të ngjashme, martesat të hershme, që janë normale, prostituimi dhe trafikimi i fëmijëve janë rrugët për kapërcimin e kësaj varfërie të pakalueshme.²⁹

Pasojat e Varfërisë: Trafikimi Njerëzor

Problemi i trafikimit në Shqipëri është i ashpër dhe mjaft i njohur. Varfëria, migrimi, krimi i organizuar, kalimi i kufijve, mungesa e informacionit mbi të drejtat e njeriut dhe afërsia me shtete të pasura kontribuojnë në këtë prije. Meqenëse trafikimi është një veprimtari klandestine është e vështirë të gjenden

shifra të sakta mbi numrin e qenieve njerëzore të trafikuar. Përgjatë dekadës së fundit nga 1.000 deri në 10.000 gra dhe fëmijë janë trafikuar në vendet e Europës Perëndimore. Në përgjithësi, gratë dhe vajzat trafikohen për qëllime shfrytëzimi seksual dhe fëmijët trafikohen me qëllimin për t'i detyruar për punë.

Gratë dhe vajzat që jetojnë në zonat rurale bien pre e trafikantëve, pasi ato janë të cënueshme për shkak të varfërisë dhe nivelit të papunësisë në familjet rurale. Në kërkim të një jete më të mirë, ato mund të bien pre e premtimeve të rreme për martesë apo punë jashtë shtetit. Fëmijët e familjeve që jetojnë në varfëri rrezikojnë gjithashtu të trafikohen pasi familjet mund t'a shohin si një të ardhur shtesë mundësinë e punësimit të fëmijës së tyre jashtë shtetit. Si rezultat i papunësisë së lartë ndër femrat dhe fakti që varfëria është në maja presupozohet që në rajon ka trafikim. Gjithsesi, masa në të cilën është prekur Gjirokastra nga trafikimi njerëzor duhet të eksplorohet në të

27 Hermine De Soto, Ilir Gedeshi, Sabine Beddies, & Daniel Perez, Romët dhe evgjitet në Shqipëri: Nga përjashtimi social drejt përfshirjes sociale ose Dilema e Monedhës së Artë, Raporti I-rë: Rekomandime dhe Implikime Politike, Banka Botërore, prill 2004.

28 Hermine De Soto, Ilir Gedeshi, Sabine Beddies, & Daniel Perez, Romët dhe evgjitet në Shqipëri: Nga përjashtimi social

drejt përfshirjes sociale ose Dilema e Monedhës së Artë, Raporti I-rë: Rekomandime dhe Implikime Politike, Banka Botërore, prill 2004.

29 Romët në Europën Qendrore dhe Lindore: Si të shmangësh kurthin e varësisë – Raport Rajonal i Zhvillimit Njerëzor, PNUD, dhjetor 2002

ardhmen. Duhet të bëhen përpjekje për të trajtuar këtë çështje dhe të zhvillohen programe duke u bazuar në katër shtylla - parandalim, mbrojtje, riatdhësim dhe riintegrim.

Punësimi

Është e qartë që varfëria dhe punësimi janë tepër të lidhura me njëra-tjetrën. Në Shqipëri, niveli i papunësisë për ata që quhen 'të varfër' është dy herë më i madh se niveli i atyre që quhen 'jo të varfër'. Në mënyrë të ngjashme, niveli i papunësisë për ata që quhen 'tejet të varfër' është tre herë më i madh se papunësia për 'jo të varfërit'. Po ashtu, ka rëndësi të bëhet dallimi mes 'papunësisë' dhe 'pak-punësimit'. Papunësia është e zakonshme në zonat qytetëse, siç dhe pasqyrohet në treguesit e papunësisë. 'Pak-punësimi' gjithësesi është një dukuri tipike rurale siç dhe sugjerohet nga një numër mjaft i madh familjesh fermere (71,887) që marrin asistencë të pjesshme ekonomike. Si e tillë, lidhja mes varfërisë dhe punësimit është mjaft imponuese në zonat rurale dhe të thella pasi përcaktimi tipik i 'pak-punësisë' nuk arrin të marrë në konsideratë mosshfrytëzimin në nivelin e duhur dhe pak-punësimin e kapitalit njerëzor.³⁰

Sipas SKZHSE-së më të fundit³¹, pak-punësia kombëtare ka rënë në këto tri vitet e fundit nga 16.3% në 14.9%. Sidoqoftë, ka patur dhe një rënie të fuqisë punëtore nga 1,101,082 në

1,089,255 veta. Veçanërisht kur niveli i punësimit është relativisht i lartë në përgjithësi aftësia për punë është e ulët. Për shembull, pjesa dërmuese e fuqisë punëtore në rajonin e Gjirokastrës kanë përfunduar vetëm arsimin bazë apo dhe më pak (shih kapitullin e "Arsimit"). Për sa i takon papunësisë, ajo takohet më shpesh tek gratë (19.1% grave përkundrejt 13.6% tek burrat), dhe të rinjtë.

Punësimi sipas zonave gjeografike

Siç e tregon dhe tabela më poshtë, kategoria qendrore (përfshirë rajonin e Gjirokastrës) renditet e treta nga katër zonat gjeografike për sa i takon përqindjes së njerëzve që janë të punësuar me kohë të plotë (56% e të punësuarve gjithsej). Renditet e dyta nga katër kategoritë përsa i takon përqindjes së të punësuarve me kohë të pjesshme, baraz me 44% e të punësuarve në zonën qendrore. Megjithëse shumica e të punësuarve punojnë me kohë të plotë sesa të pjesshme, ndryshimi është tepër i vogël (56% kundrejt 44%). Pjesa më e madhe e banorëve që punojnë me kohë të pjesshme krahasuar me zonën bregdetare, malore dhe Tiranën, demonstron një sërë faktorësh me rëndësi. Punësimi me kohë të pjesshme përkundrejt punësimit me kohë të plotë do të thotë më pak siguri pune, më pak ose aspak përfitime, shtangësi të orëve të punës dhe shpesh pagesë më të vogël.

Punësimi sipas zonave gjeografike (% e popullatës mbi 14 vjeç që janë në moshë pune)³²

	Zona			
	bregdetare	qendrore	malore	Tirana
Të punësuar me kohë të plotë	36.4	31.9	28.1	33.7
% e të punësuarve gjithsej	67.5	56.0	48.6	86.9
Të punësuar me kohë të pjesshme	17.5	25.1	29.6	5.1
% e të punësuarve gjithsej	32.5	44.0	51.4	13.1
Gjithsej të punësuar	54.0	57.0	57.7	38.8

³⁰ Raporti Kombëtar i Shqipërisë: Ecuria drejt arritjes së OZHM-ve, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Departamenti i SKZbShE-së në Ministrinë e Financave, Shqipëri 2004.

³¹ Raporti Kombëtar i Shqipërisë: Ecuria drejt arritjes së OZHM-ve, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Departamenti i SKZbShE-së në

Ministrinë e Financave, Shqipëri 2004.

³² Njësia e sektorit të Zhvillimit Njerëzor: Europa dhe Rajoni i Azisë Qendrore, Shqipëria – Vlerësimi i varfërisë, Vëll. 1 nga 1, Banka Botërore, nëntor 2003.

Papunësia sipas demografisë

Tabela më poshtë tregon që nga 4,351 vetë të papunë, më shumë se 50% janë gra (2,513) dhe më shumë se 33% janë kryefamiljarë (1,668). Pjesa më e madhe e të papunëve janë mbi moshën 35 vjeç. Bazuar në numrin e të papunëve në rajon, 49.3% kanë mbaruar arsimin fillor, 48.6% arsimin e mesëm dhe 2.1% universitetin. Papunësia ndeshet më shumë tek gratë sesa tek burrat dhe më shpesh në moshat e reja. Të dhënat e vitit 2003 tregojnë që niveli i papunësisë për gratë është 19.1% ndërsa për burrat 13.6%.

Historikisht, papunësia ka qenë më e lartë tek femrat se tek meshkujt, dhe ky raport gjinor ka prirje që të thellohet tani që aplikohet një përkufizim më i zbutur i papunësisë. Gratë përballen me më shumë vështirësi në përpjekjet e tyre për t'u integruar në tregun e punës, sidomos kur lëvizin në vende të reja. 41% e grave të migruara krahasuar me 23% e burrave të migruar janë të papunë.³³ Gjithashtu, përfaqësimin e ulët të gruas në tregun e punës e rrisin çështje që kanë të bëjnë me

sigurinë sociale dhe institucionet e kujdesit social, si mungesa e çerdheve dhe kopshteve dhe ndikimi i qëndrimeve dritëshkurtra. Rrjedhimisht, niveli kombëtar i papunësisë dhe hasja e papunësisë në kohë afatgjatë tek femrat është më e lartë se tek meshkujt.³⁴ Në përgjithësi, rajoni i Gjirokastrës, karakterizohet nga papunësi më e lartë tek femrat se tek meshkujt, e ngjashme kjo me prirjen në nivel kombëtar që ndikon gratë në një masë të madhe. Në shqyrtimin e papunësisë sipas gjinisë, bashkia e Tepelenës ka një nivel papunësie tek meshkujt diçka më të lartë se tek femrat. Gjithsesi, rrethet e Gjirokastrës dhe Përmetit kanë një nivel papunësie më të lartë ndër femrat se tek meshkujt. Zhdukja e pabarazisë gjinore në tregun e punës mund të rrisë si të ardhurat e grave dhe kontributin e tyre në të ardhurat bazë të rajonit. Studimet tregojnë se nga rritja e të ardhurave të grave përfiton e gjithë familja pasi të ardhurat e grave priren të shpenzohen për ushqim, shëndet dhe shkollim.

Papunësia sipas rretheve për vitin 2003³⁵

	Gjithsej	Rrethi		
		Gjirokastrë	Tepelenë	Përmet
Të papunë	4,351	1,997	1,437	917
Gra	2,513	1,315	706	492
Kryefamiljarë	1,668	658	637	373
15-19 vjeç	457	408	40	9
20-24 vjeç	823	505	264	54
25-34 vjeç	1,111	469	412	230
Mbi 35 vjeç	1,960	615	721	624

Popullsia pasive në ekonomi

Popullsia "Pasive në ekonomi" i referohet atyre individëve që janë të paafte të kërkojnë punë si, shtëpiakë, të moshuar, studentë apo handikapë. Kjo është veçanërisht e vërtetë në Odrië (një nga dy vendet ku ka mungesë ngrohje) dhe në Zagori për rrethin e Gjirokastrës, ku rreth 75% e popullsisë është ekonomikisht pasive. Shifra është po ashtu e lartë për rrethin e Tepelenës, sidomos në Kurvelesh dhe Lopës (ku më shumë se gjysma e banorëve janë pa furnizim me ujë) dhe në Memaliaj (ku shumica e banorëve kanë mungesë në sistemin e ngrohjes). Këta persona ekonomikisht pasiv janë të varur nga njerëz të tjerë apo burime të jashtme për

të mbajtur dhe përmirësuar jetesën e tyre. Në të ardhmen duhet shqyrtuar dhe shpërndarja e popullsisë pasive sipas gjinisë për qarkun e Gjirokastrës. Ka evidenca që tregojnë se në nivel kombëtar shkalla e aktivitetit të grave ra nga 88.7% në 1989, në 56% në 2001.³⁶ Numerikisht, 210,523 gra kanë hequr dorë nga veprimtaria aktive gjatë tre viteve të fundit. Shpjegimet për këtë dukuri variojnë nga kthim në vlerat e traditës familjare, vështirësitë që hasin gratë për punësim deri tek varësia nga paratë e dërguara. Shumica e banorëve të qarkut të punësuar janë në punësim të vazhdueshëm, sidomos në Tepelenë dhe

³³ Migrimi në Shqipëri, INSTAT, 2004.

³⁴ Raporti Kombëtar i Zhvillimit Njerëzor, 2004.

³⁵ Treguesit sipas Prefekturave: 2002-2003, INSTAT, 2004.

³⁶ Migrimi në Shqipëri, INSTAT, 2004.

Përmet. Lloji i dytë i punësimit është puna stinore për një numër të vogël banorësh. Nivelin më të lartë e ka Çarçova në rrethin e Përmetit, ku tre të katërtat e banorëve janë të punësuar stinorë. Ka gjithashtu një numër të konsiderueshëm njerëzish, në të gjithë qarkun, që punojnë në punë të përkohshme, gjë që ndeshet më shumë në Lopës të Tepelenës, në Përmet në rrethin e Përmetit, dhe në gjithë rrethin e Gjirokastrës. Në një shtirje më të vogël, por ende të konsiderueshme, ka një sërë njerëzish që janë të punësuar në punë rastësore në bashkinë e Gjirokastrës.

E rëndësishme është që ata që janë të varur nga puna me kohë të pjesshme, stinore apo rastësore janë gjithmonë në dizavantazh për sa i takon stabilitetit të punës dhe përfitimeve krahasuar me ata që kanë punë me kohë të plotë të sigurt. Rreziku qëndron në faktin se këto familje janë përherë të ekspozuara ndaj riskut të papunësisë për një periudhë kohe pa patur kursime të mjaftueshme për t'i mbajtur gjallë. Këtu duhet patur parasysh se mbase mundësia tjetër për të


gjetur një punë me kohë të pjesshme, stinore apo të rastit mund të varet mjaft nga koha, të korrat dhe faktorë të tjerë që nuk varen nga njeri.

Theksojmë edhe njëherë që kompleksiteti më i lartë i varfërisë është në Frashër të Përmetit. Punësimi i vazhdueshëm aty është në nivele të larta, gjë që do të thotë të ardhura të sigurta, dhe papunësia tek femrat nuk ekziston. Megjithatë, prapë, numri i familjeve që kanë mungesë të furnizimit me ujë është tepër i lartë. Në këto kushte, del e qartë që, të shqyrtosh treguesit e varfërisë në zbrazëti do të çonte në një kuptim të shformuar të gjendjes në qark.

Punësimi sipas moshës


Duke shqyrtuar grupmoshat e ndryshme të të punësuarve në rajon, vëmë re se shumica e të punësuarve janë midis 31-45 vjeç dhe mbi 45 vjeç. Grupmosha 15-30 vjeç e ndjek nga pas. Në përgjithësi, shihet të ketë një ekulibër të përzier të grupmoshës aktualisht të punësuar në të gjitha bashkitë e qarkut

Shpërndarja e popullsisë sipas statusit të punësimit




INSTAT: REPOBA, 2001

Shpërndarja e popullsisë sipas tipit të punësimit



INSTAT: REPOBA, 2001

Shpërndarja popullesisë sipas moshave



INSTAT: REPOBA. 2001

Romët dhe punësimi

Në Europën Qendore dhe Lindore, papunësia e romëve arrin në vlerën 50-90%. Pasi toka që punonin gjatë kohës së kooperativave bujqësore të perudhës së socializimit iu kthye pronarëve, ata ranë viktimë të pushimeve masive nga puna dhe po përjetojnë vështirësi të mëdha për të gjetur punë. Këtë e tregon shkalla e papunësisë në rang kombëtar. Në vitin 2002, papunësia në Shqipëri ishte afro 16%, ndërkohë që ky tregues për romët ishte 71%. Kjo vjen pjesërisht nga diskriminimi në tregun formal të punës. Sipas vetëvlerësimeve, 30% e romëve mendojnë që etnia e tyre është pengesa më e madhe për punësim. Për më tepër, evidencat tregojnë që disa sipërmarrje private parapëlqejnë shqiptarë dhe jo romë, dhe në disa raste nuk pranojnë fare romë.³⁷ Thelbi i çështjes është të përcaktohet se kur diskriminimi i romëve e tejkalon aftësinë dhe dhuntitë e burrave dhe grave romë.

Zakonisht, burrat dhe gratë romë janë në tregun informal të punës duke u marrë me punë të rastit, ekzekutime muzikore, mbledhje skrapë dhe lypje. Gjithsesi, këto punë sjellin vetëm të ardhura të kufizura dhe karakterizohen nga pasiguri e lartë ekonomike. Shumë veta e trajtojnë këtë mëdyshje duke u fokusuar tek aftësitë tradicionale të romëve (psh. kovaçë, tregtarë kuajsh, etj.), ndonëse mjaft prej këtyre aftësive nuk mund të shiten në treg dhe shpesh janë penguese në një shoqëri të industrializuar.

Në vend që të përqendrohen tek artizanatet e dala kohe, fokusi i tyre në një afat të shkurtër mund të vendoset mbi bazën e natyrës fleksibile dhe të orientuar drejt natyrës të romëve; kjo na bën të kuptojmë që romët mund të konkurrojnë dhe të shquhen në industrinë e shërbimeve që po njih vetëm zgjerim. Kësisoj, avantazhi i tyre do të rridhte jo nga përballimi kulturor i aftësive të tyre por nga natyra e tyre prej sipërmarrësi. Në të ardhmen, gjithsesi, rritja e shkallës së punësimit dhe të vazhdimësisë të niveleve më të larta të arsimit do të jenë mënyra kryesore që do t'u sigurojë burrave dhe grave romë perspektiva punësimi në sektorë më fitimprurës.³⁸

Çështja me të cilën përballen romët dhe mundësitë e tyre për punësim në qarkun e Gjirokastrës janë mjaft të panjohura. Ndaj, nevojitet që të ndërmerren

analiza të imtësishme të kësaj çështjeje brenda kontekstit të përgjithshëm të mundësive për punësim për të gjithë qytetarët e qarkut.

Strategjia e Zhvillimit të Turizmit

Zhvillimi i turizmit për Qarkun e Gjirokastrës është një nga rrugët më efikase për realizimin e objektivit primar të S.ZH.Q, për reduktimin e varfërisë në zonat rurale dhe urbane. Realizimin e objektivave në zhvillimin e turizmit e bëjnë të mundur burimet e shumta që ofron zona duke përbushur të gjitha kriteret për zhvillimin e të gjitha formave specifike të tij si:

- **Zhvillimi i turizmit kulturor;**
- **Zhvillimi i turizmit të gjelbër;**
- **Zhvillimi i eko-turizmit.**

Qarku i Gjirokastrës, i cili për Shqipërinë, mund të quhet një nga portat e lidhjes me Europën, komunikon me shtetin Grek, anëtar i Komunitetit Europian, nëpërmjet tre pikave doganore: pika doganore e Kakavies, Tri Urat dhe Sopikut. Kjo bën të mundur hyrjen e turistëve në të gjitha zonat turistike të Qarkut duke shfrytëzuar infrastrukturën e përshtatshme rrugore të shtetit fqinjë, Greqisë. Potenciali i madh turistik i qarkut shprehet përveç të tjerash edhe në ekzistencën e 150 monumenteve natyrore të gjallë dhe jo të gjallë, 4200 ha gëzon statusin si Park Kombëtar, 7060 ha gëzon statusin si rezervat shkencor, 13500 ha janë zonë peisazhore e mbrojtur.

Zhvillimi i turizmit kulturor

Ky lloj turizmi ishte më i përhapuri deri tani në qarkun tonë dhe kryesisht në qytetin e Gjirokastrës, pasi është nga të vetmit qytete të Europës që vazhdon të ruaj një zonë të gjerë me ndërtime mesjetare, me një arkitekturë të rrallë, me pasuri të çmuara të trashëgimisë kulturore dhe historike. Vetë qyteti është një amfiteatër gigant i ndërtuar në 5 shpate mali dhe në qendër të tij ndodhet kështjella historike nga ku e ka zanafillën ky qytet. Ndërtimet e reja të hotelarisë e stimulojnë zhvillimin e këtij turizmi, por gjendja aktuale e disa banesave të vjetra të këtij qyteti dhe mungesa e investimeve për mirëmbajtjen e tyre e ulin së tepërmi nivelin e

³⁷ Hermine De Soto, Ilir Gedeshi, Sabine Beddies, & Daniel Perez, *Romët dhe Evgjitet në Shqipëri: Nga përjashtimi shoqëror në Përfshirjen shoqërore ose Dilema e monedhës së artë, Raporti I:*

Rekomandime dhe Implikime Politike, Banka Botërore, prill 2004
³⁸ Romët në Europën Qendore dhe Lindore: Shmangia nga Kurthi i Varësisë – Një raport rajonal për zhvillimin njerëzor, PNUD, dhjetor 2002.

vizitave turistike në qytet. Riparimi i kështjellës nëpërmjet investimeve nga programet Europiane të bashkpunimit ndërkufitar me Prefekturën e Janinës, dhënia e fondeve restauruese nga Qeveria në vitin 2004 dhe përpjekjet që bëhen për përfshirjen e këtij qyteti nën kujdesin e UNESCO, janë mundësira të plota për lulëzimin e turizmit në këtë qytet. Burimet e zhvillimit të turizmit kulturor plotësohen më tej edhe me pasuritë arkeologjike në zbulim e sipër të luginës së Drinos ku epiqendra është qyteti i lashtë i Antigonesë dhe amfiteatri i Adrianopolit. Në kuadrin e burimeve të zhvillimit të turizmit kulturor plotësojnë edhe një sërë objektesh kulti të shpërndara në të gjitha rajonet e Qarkut ku më kryesoret janë: kishat e Labovës, të Leusës, të Benjës. Manastiret e Cepos, të Çatistës, të Pepelit. Teqet e Melanit, të Zallit, të Hormovës etj. Në të gjitha këto objekte dhe në të tjera ndodhen edhe afreske kishtarë me ikona të mrekullueshme dhe shumë të vjetra. Të gjitha këto objekte historike, të cilat duhet të mirëmbahen, plotësojnë kushtet për t'u vizituar nga turistët në fondin kohor rreth tri ditë.

Zhvillimi i Turizmit të Gjellbër

Burimet e rajonit tonë plotësojnë kushtet për zhvillimin e të gjitha formave të turizmit të gjellbër si:

- Zhvillimi i turizmit alpin;
- Zhvillimi i turizmit lumor sportive;
- Zhvillimi i turizmit eksplorues.

Terreni malor i Qarkut të Gjirokastrës dhe sidomos i kanioneve të malit të Nemëçkes mbi fshatin Kaludh nga ana e Përmetit, e kanioneve të luginës së Bençës, krijojnë mundësira jo vetëm për turizmin alpin, por edhe të mundësive të organizimit të kampionateve botërore të alpinizmit, tani më e studiuar edhe nga specialistë të huaj. Sistemi specifik i lumit të Vjosës me investime jo shumë të mëdha krijon mundësi të plota për zhvillimin e turizmit lumor sportiv. Shpellat e shumta me stalagmite dhe stalaktite në Progonat dhe Nivicë të Kurveleshit, shumica të paeksploruara krijojnë mundësinë e organizimit të turizmit eksplorues. Zhvillimin e turizmit të gjellbër e stimulojnë edhe ekzistenca e një sërë monumentesh natyrore, që natyra ia ka falur Qarkut të Gjirokastrës si:

- ✦ Pejsazhi turistik i Ujit të Ftohtë të Tepelenës;
- Pejsazhi turistik i liqenit artificial të Viroit;
- Parku natyror kombëtar i Hotovës në rrethin e

Përmetit;

- Pylli me bredha i Sotirës dhe pejsazhi turistik i këtij fshati.

Po kështu fusha e Çajupit, Llufa e Nivicës në Kurvelesh dhe ujrat termale të Benjës në rrethin e Përmetit, për aftësitë e mëdha kurative që ato mbartin mund të bëhen vatra të rëndësishme për tërheqjen e turistëve.

Zhvillimi i Turizmit Rural (Eko-Turizmit)

Në të kaluarën ky lloj turizmi realizohej duke ardhur grupe të vogla turistësh të cilët qëndronin nëpër fshatra disa ditë dhe aty jetonin e punonin së bashku me fshatarët. Fshatarët mësonin prej turistave për vendet e tjera shumë herë të panjohura për ta, ndërsa turistët do të mësonin për jetën e fshatit, për zakonet, për mënyrën e të ushqyerit dhe jetesën. Në kohën e sotme turistët shkojnë në fshat në grupe të mëdha me autobuza, qëndrojnë aty shumë pak, shëtisin marrin fotografi dhe largohen. Nuk ka asnjë shkëmbim midis fshatarëve dhe turistave dhe kështu fshatarët nuk përfitojnë asgjë nga vizita e tyre. Sot në botë nën moton e ruajtjes dhe mbrojtjes së mjedisit është zhvilluar, ekoturizmi. Ky lloj turizmi është një industri në rritje përqark gjithë globit. Eko-turistët janë të interesuar të zbulojnë ambjentin natyror dhe të marrin pjesë në jetën tradicionale. Ata vlerësojnë dhe kënaqën me “vështirësitë” që e shoqërojnë këtë ambjent si vendet e izoluara në fshat si edhe infrastruktura e kufizuar. Njëkohësisht ata kanë respekt për natyrën dhe ambjentin edhe të këtyre fshatrave. Ata janë të interesuar të mësojnë rreth kulturës lokale, të takojnë njerëz, të bashkëjetojnë me natyrën dhe janë të gatshëm të shkëmbejnë eksperiencën e tyre.

Nëpërmjet inisiativave të eko-turizmit, fenomenet e shoqëruara me varfërinë rurale mund të shndërrohen në avantazhe ekonomike, pasi infrastruktura e keqe, mungesa e energjisë dhe e ujit mund të përkthehen prej tyre në gjuhën e “aventurës” dhe të eksplorimit. Por përveç këtyre faktorëve zhvillimin e eko-turizmit si një nga burimet themelore të të ardhurave në fshatra të veçantë e favorizojnë edhe potencialet e tjera si:

- Në të gjitha fshatrat tona malore ka shtëpi të cilat nuk shfrytëzohen, që me një investim jo shumë të madh mund të krijojnë kushte për fjetje për turistët dhe të realizojnë të ardhura me kosto

- shumë të vogël;
- Eko-turizmi në qarkun tonë është unik në karakter, pasi vendet kulturore dhe natyrore janë origjinale dhe thuajse të gjitha vendet natyrore janë të paprekura;
 - Çmimet e shërbimit në Shqipëri janë padyshim shumë më të ulta se në çdo vend tjetër të Europës duke u bërë një faktor tërheqës për turizmin;
 - Personat që do të kryejnë shërbimet nuk nevojitet të kenë një aftësi të lartë profesionale, por thjesht disa trajnime të shkurtra për turizmin, duke siguruar kështu të ardhura të mëdha në një kohë të shkurtër për zhvillimin e ekonomisë së tyre;
 - Prodhimet e kuzhinës si edhe përpunimi i produkteve blegtorale dhe frutikulturës në qarkun tonë përbëjnë një mundësi të madhe për zhvillimin e eko-turizmit pasi janë shumë të pastra dhe të kërkuara. Prodhimi i djathit, gjalpit, nxjerrja e dhallës, prodhimi i reçelrave, prodhimi i verës dhe i rakisë, janë një mundësi më shumë për zhvillimin e këtij lloji turizmi.

Mundësitë për zhvillimin e turizmit në Qarkun tonë janë të mëdha. Turizmi do të përbëjë në perspektivë një nga burimet themelore të rritjes të të ardhurave jo vetëm për ata që do të merren me trajtimin e tyre, por edhe për pushtetet vendore në komuna dhe bashki nëpërmjet të ardhurave nga tatimet e ndryshme sipas legjisacionit i cili sigurisht në të ardhmen do të persoset. Bazë e këtij konstatimi është edhe eksperiencia e shkëlqyer e rajonit tone kufitar në Prefekturën e Janinës. Pushtetet vendore të të gjitha niveleve duhet të bëhen promotorët e këtij zhvillimi nëpërmjet:

- Organizimit e manaxhimit bashkëkohor për të gjitha llojet e turizmit;
- Trajnimit e personave të veçantë dhe të apasionuar për turizmin në të gjitha llojet e ekzistencës së tij;
- Futjen në internet në mënyrë të vazhdueshme të të gjitha vlerave turistike që ofron Qarku i Gjirokastrës;
- Botimin e guidës turistike të Qarkut të cilin do ta realizojë Këshilli i Qarkut brenda vitit 2005.

Hapjen e agjensive turistike dhe gjetja e partnerëve ndërkombëtarë për shkëmbime turistike.

- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore në përgjithësi dhe asaj që të çon në zonat turistike në veçanti duke

venë emërtime të zonave dhe të fshatrave në të gjitha akset rrugore;

- Përcaktimi i zonave dhe i fshatrave turistike, si edhe përmirësimi i ambjenteteve të fjetjes, të ushqimit, të ujit të pijshëm, dhe ambiente çlodhës dhe argëtues;
- Gjetja e donatorëve për zbatimin e studimit të shfrytëzimit të ujrave termale të Bënjës në Përmet, investime në lumin e Vjosës etj;
- Fillimi i punimeve për ndërtimin e parqeve dhe infrastrukturës moderne në Ujin e Ftohtë dhe në parkun e Viroit;
- Gjetja e donatorëve për ndërtimin e fshatrave turistike në Çajup, Hotovë dhe Lluftë.
- Zhvillimin e turizmit në rajonin tonë do ta mundësonte së tepërmi rikostruksioni i aeroportit të Gjirokastrës sipas studimit të hartuar;
- Vlerësimi i zonave me karakter historik dhe ambiental

Qarku i Gjirokastrës përshkohet nga një skaj në tjetrin prej një sërë monumentesh me vlera historike dhe arkeologjike si dhe me vlera ambientale dhe peisazhiste. Në zonën muzeale të Gjirokastrës si përfaqësuesen më të dukshme të vlerave historike artistike, arkitektonike e urbanistike të papërsëritshme, të pasura nga monumente të tjera arkeologjike, historike e të kultit me vlera të çmuara si Antigonea, Teatri i Adrianopolit, zonat arkeologjike të Leklit, Matohasanaj, Nivicës etj. deri tek kalaja e Ali Pashës në Tepelenë, kisha e Labovës së Kryqit, e Zervatit, Goranisë, Poliçanit, Manastiri i Cepos, i Spilesë, kompleksi i kishave të Sotirës etj. krijojnë resurse për zhvillimin e turizmit në qarkun e Gjirokastrës. Të kombinuara këto me një sërë zonash të tjera me veçori ambientale si zona e Sotirës, Çajupit, Viroit, Bredhit të Hotovës, Zonës së Lengaricës, Shpella e Pëllumbave dhe pylli i Maqellarës e Bredhi i Kalasë, Shpella e Spilesë, Uji i Ftohtë i Tepelenës dhe Llufa e Kurveleshit e shumë të tjera i japin turizmit në zonë një dimension tjetër. Dy lumenjtë kryesorë që përshkojnë qarkun, ai i Drinos dhe Vjosës krijojnë përveç resurseve ekonomike në drejtim të shfrytëzimit të energjisë së ujrave të tyre e kultivimit të peshkut edhe mundësi për zona plazhiste që në njëfarë mase shfrytëzohen që tani. Të gjykuara nga këndvështrimi i përdonimit të tyre për qëllime turistike ato përbëjnë një burim të konsiderueshëm të ardhurash ekonomike për rajonin. Për këtë arsye dhe derisa të krijohet infrastruktura e nevojshme për zhvillimin e turizmit në zonë, detyrë imediate është evidentimi dhe ruajtja e tyre.

Demografia

Qarku i Gjirokastrës ndodhet në pikën më juglindore të Shqipërisë. Kufizohet me qarqet e Fierit, Korçës, Vlorës dhe me Greqinë që shtrihet në lindje dhe juglindje. Krejt sipërfaqja e qarkut arrin afërsisht 332,677 hektarë ose 2,880 kilometra katrorë ndërsa lumenjtë Vjosa dhe Drino kalojnë mespërmes tij. Qarku ka klimë tipike mesdhetare ku dimri karakterizohet nga reshje shiu dhe vera shpesh ka thatësi.

Qarku ka tre rrethe, të përbëra nga 6 bashki dhe 26 komuna (popullsi prej 166,788 vetash), ku shumica e banorëve jetojnë në fshatra:

- Rrethi i Gjirokastrës ka 2 bashki dhe 11 komuna (80,898 banorë);
- Rrethi i Tepelenës ka 2 bashki dhe 8 komuna (46,879 banorë); dhe
- Rrethi i Përmetit ka 2 bashki dhe 7 komuna (39,011 banorë).³⁹

Qendër administrative e qarkut është qyteti i Gjirokastrës. Aty, Këshilli i Qarkut është organi më i lartë vendimmarrës dhe përbëhet nga 43 anëtarë, prej të cilëve 6 janë kryebashkiakë, 26 janë kryekomunarë dhe 11 janë anëtarë që përfaqësojnë këshillat bashkiakë dhe të komunave.

Të dhëna demografike për qarkun⁴⁰

	1990	1995	2000	2003
Popullsia	158,833	166,434	169,586	166,788
Bashki	51,590	64,373	69,748	70,244
Femra		31,837	35,050	35,240
Meshkuj		32,536	34,698	34,789
Komuna	107,243	102,061	99,838	96,544
Femra		49,621	48,806	47,931
Meshkuj		52,441	51,029	48,848
Lindje gjithsej	3,802		1,784	1,531
Lindje në qytet	1,167			599
Lindje në fshat	2,635			932
Të ardhur			1,725	2,310
Të larguar nga migracioni			3,152	3,997
Fshatra	272	272	272	271
Familje			40,315	41,476

³⁹ Regjistri statistikor i rretheve, Këshilli i Qarkut, 2003.

⁴⁰ Zyra e gjendjes civile të Rretheve, Këshilli i Qarkut, 2003.

Shpërndarja e Popullsisë sipas Gjinisë

Përbërja gjinore

Popullsia e Shqipërisë është e ekuilibruar në aspektin gjinor me një përqindje të grave paksa më të madhe prej 51%.⁴¹ Ngjashmërisht, popullsia e qarkut Gjirokastrë ka ndarje gjinore pothuaj 50/50, ku gratë janë pak më shumë. Siç e tregon dhe harta, pavarësisht se sa e dendur apo e rrallë është popullsia e një komune, përbërja gjinore mbetet thuajse gjithandej e njëjtë. Kjo përbërje tregon që gratë përfaqësojnë gjysmën e burimeve dhe të potencialit të këtij qarku. Ky potencial do të mbetet i pavënë në jetë nëse gratë kufizohen nga pabarazia në sferat shoqërore, ekonomike dhe politike. Mundësi të barabarta për arsim, kujdes shëndetsor, punësim dhe në vendimmarrje do të shërbejnë për të përforcuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe të drejtë të qarkut.

Rrymat e popullsisë

Migrimi është ndoshta dukuria më e rëndësishme politike, shoqërore dhe ekonomike në Shqipërinë paskomuniste dhe ka qenë një fakt mbisundues i jetës së përditshme në dhjetëvjeçarin e fundit. Që nga viti 1990, afro një e pesta e popullsisë së vendit është larguar dhe jeton jashtë shtetit dhe kanë ndodhur lëvizje në shkallë të gjerë të popullsisë nga zonat fshatare në ato qytetëse. Veç kësaj, ka mjaft qytetarë të qarkut të Gjirokastrës që mund të quhen punëtorë stinorë ose të përkohshëm jashtë shtetit. Gjithsesi, efektet e këtyre migrimëve në ekonomi janë të thella dhe lidhen me nivelet e varfërisë në qark. Mbajtja e familjeve nëpërmjet dërgimit të të hollave nga jashtë menjëherë u bë një mjet me rëndësi për qëndrueshmërinë e ekonomisë familjare. Migrimi, qoftë nga fshati në qytet apo nga Shqipëria drejt Greqisë, është ndoshta strategjia më e rëndësishme e përdorur nga familjet fshatare dhe përfaqëson një formë të përshtatjes ekonomike ndaj ndryshimeve në ekonomi.⁴² Një studim i INSTAT-it ka nxjerrë në pah që në Shqipëri ka modele migrimi me veçanti gjinore.⁴³ Ndërsa të rinjtë kryesojnë në numrin e të migruarve jashtë

shtetit, 54% e migrantëve të brendshëm janë të reja. Ka gjithashtu probleme të brendshme të lidhura me gjininë që dalin si rezultat i migrimit dhe emigrimit, pasi kryesisht janë meshkujt në moshë pune ata që nisen në kërkim të një veprimtarie ekonomike më të mbarë:

- Veçanërisht në fillim, burrat përballen me më shumë vështirësi dhe trysni të lartë të jetës migruese dhe emigruese;
- Gratë mbeten në një pozicion më të dobët në familje pasi ato presin për ndihmë në të holla dhe për rikthimin e burrave;
- Gratë përjashtohen nga jeta shoqërore, gjë që rrjedh nga mungesa e bashkëshortëve të tyre;
- Kontakti i grave me botën kufizohet mjaft pasi ato mbeten pa profesion dhe merren vetëm me punë bujqësore, gjë që ofron rroga të ulta;⁴⁴
- Gratë mund të mbeten pa mbrojtje nga veprimtari kriminale si p. sh. trafikimi i qenieve njerëzore.

Për qarkun, eksodi në masë i njerëzve që lëvizën nga zonat fshatare në ato qytetëse ishte as më pak e as më shumë por kaotik, i papritur dhe i shpejtë. Për shembull, disa zona si Frashëri (Përmet), Lopësi dhe Kurveleshi (Tepelenë) dhe Zagoria, Pogoni e Picari (Gjirokastrë) humbën rreth 60% të banorëve të tyre që iu drejtuan zonave më të populluara. Shumica e popullsisë që shkoi në qendrat qytetëse përgjithësisht ishte nga 18-35 vjeç, njerëz që kërkonin një jetë më të mirë për veten dhe për fëmijët e tyre. Gjithsesi, pasojë e kësaj rryme ishte fakti që mjaft prej fshatrave dhe komunave mbetën me banorë të moshuar ku shumica prej tyre ishin mbi 50 vjeç. Përveç moshimit të popullsisë së qarkut, një shqetësim tjetër që rrodhi nga migrimi ishte largimi i trurit. Burra e gra të reja, të arsimuar ikin drejt qendrave ekonomike si Tirana dhe Durrësi, ose drejt qyteteve kryesore bregdetare si Vlora. Për pasojë, 96% e migrantëve të rinj kanë arsim të mesëm ose të lartë.⁴⁵ Kjo dukuri

41 Raport ecurie i vitit 2003 për zbatimin e SKZHSE, Këshilli i Ministrave, Tiranë 2004.

42 Njësia e sektorit të Zhvillimit Njerëzor: Europa dhe rajoni i Azisë Qendrore, Shqipëri – Vlerësim i varfërisë, Vëll. 1 i 1, Banka Botërore,

nëntor 2003.

43 Migrimi në Shqipëri, INSTAT, 2004.

44 Raport Kombëtar i Zhvillimit Njerëzor, 2004.

45 Migrimi në Shqipëri, INSTAT, 2004.

përmban rreziqe të mëdha sepse, së pari, pakësimi i punës në bujqësi pakëson shumë mundësinë e zhvillimit në ato zona të prekura fshatare. Së dyti, qarkut i janë larguar popullata më e arsimuar, novatore dhe që do të sillte padyshim një efekt të fuqishëm në zhvillimin e ardhshëm ekonomik të qarkut.⁴⁶ Evidencat tregojnë gjithashtu që një mori jomigrantësh e kanë menduar alternativën e migrimit dhe shumë e kanë provuar dhe kanë dështuar, çka të çon në pasoja dramatike. Ekonomitë familjare shpesh janë më keq pas se sa para orvatjeve për migrim dhe përfundojnë në vuajtje të mëdha si rezultat i mbartjes andej-këndej.⁴⁷ Ndaj, ndonëse migrimi dhe ndihma në të holla ka gjasa që do të mbeten të domosdoshme për zhvillimin rural të qarkut, duhet të theksohet fort nevoja e bërjes së strategjive të

përshtatshme më të qëndrueshme për të lehtësuar varfërinë e familjeve fshatare dhe të nxisë rritjen ekonomike të qarkut.


Grafikët vijues japin me hollësi ndryshimet mesatare të popullsisë në qark dhe rrethe. Në nivel qarku, në vitet 1990-2003 ka patur një rritje domethënëse të popullsisë në bashki dhe një ulje të theksuar të saj në komuna. Në rrethet Tepelenë dhe Përmet, për shembull, ka pasur një rritje të popullsisë në bashki por edhe një ulje akoma më të madhe të saj në komuna. Kjo tregon që banorët nuk kanë migruar vetëm në qendrat urbane por kanë shkuar në masë të madhe jashtë qarkut, për shembull në Greqinë fqinje për të rritur përfitimet. Gjithsesi, në rrethin e Gjirokastërës ka patur rritje në popullsinë e bashkive dhe të komunave.

46 Regjistri Statistikor i qarkut, Këshilli i Qarkut, 2003.

47 Njësia e sektorit të Zhvillimit Njerëzor: Europë dhe rajoni i Azisë


qendrore, Shqipëri – Vlerësimi i Varfërisë, Vëll. 1 nga 1, Banka Botërore, nëntor 2003.

Shpërndarja e popullsisë sipas gjinisë




INSTAT: REPOBA, 2001


Ndryshimi i Popullsisë në qark⁴⁸




Ndryshimi i Popullsisë në rrethin e Tepelenës⁴⁹



Ndryshimi i Popullsisë në rrethin e Përmetit⁵⁰



Ndryshimi i Popullsisë në rrethin e Gjirokastrës⁵¹



Dendësia

Pasqyrat tregojnë që migrimi ka shkaktuar ndryshime në dendësinë e rajonit në të gjithë vendin. Tabela më poshtë tregon prirjen kombëtare drejt urbanizimit gjatë periudhës së tranzicionit. Për shembull, është e dukshme që qendrat urbane të Tiranës dhe Durrësit kanë kaluar nëpër një rritje të shpejtë të madhe.

Urbanizimi është shkaktuar nga lëvizja e njerëzve për arsye, sidomos, të gjetjes së mundësive ekonomike dhe përmirësimit të jetës së tyre dhe të familjeve të tyre. Kjo prirje është e dukshme edhe në qarkun e Gjirokastrës nga mungesa e mundësive për punësim për banorët.

48 Regjistri Vjetor i qarkut, Këshilli i qarkut, 2003.

49 Regjistri vjetor i rrethëve, Këshilli i qarkut, 2003.

50 Regjistri vjetor i rrethëve, Këshilli i qarkut, 2003.

51 Regjistri vjetor i rrethëve, Këshilli i qarkut, 2003.

Dendësia sipas qarqeve⁵²

Qarku	Sipërfaqja në Km ²	1989	2001	Diferenca në dendësi
Shqipëria	28,749.01	110.70	106.76	-6.94
Tiranë	1,653.71	271.65	361.55	+89.90
Durrës	765.93	285.31	320.09	+34.87
Fier	1,890.69	200.64	202.33	+1.69
Elbasan	3,199.08	111.75	113.39	+1.64
Lezhë	1,619.79	102.02	98.27	-3.75
Shkodër	3,561.25	80.10	72.02	-8.08
Korçë	3,710.32	83.94	71.47	-12.47
Dibër	2,586.35	87.51	73.42	-14.09
Kukës	2,373.48	61.55	46.93	-14.62
Gjirokastrë	2,884.26	54.09	39.12	-14.97
Berat	1,798.11	123.96	107.35	-16.61
Vlorë	2,706.04	97.76	71.32	-26.44

Struktura Moshore

Shqipëria ka një popullësi të re ku mosha mesatare është 29 vjeç. Në krahasim me pjesën e popullsisë që është mbi 60 vjeç, që përbën 11%, grup mosha 0-19 vjeç përfaqëson 42% të popullsisë.⁵³ Sipas hartës, dhe kësaj karakteristike rinore të vendit, qarku i Gjirokastrës ka pjesën më të madhe të popullsisë

midis 16-30 vjeç dhe 31-45 vjeç. Po ashtu, grupmosha 0-15 vjeç është e konsiderueshme. Numri i banorëve të grupmoshës 46-60 vjeç dhe mbi 60 vjeç është më i paktë. Statistikat në tabelë, që janë pak më specifike, tregojnë qartë mbështetjen e përfundimeve të shprehura në hartë.

Mosha sipas bashkive⁵⁴

Bashkia	Grupmosha			Gjithsej
	0-14	15-64	65+	
Tepelenë				
Përmet				
Gjirokastrë				

Gjendja Civile

Tranzicioni ka sjellë ndryshime thelbësore në shoqërinë shqiptare. Mundësitë për të ndjekur arsimin e lartë, migrimi, vështirësitë që hasin të rinjtë në përballjen për të hyrë në tregun e punës kanë çuar në martesë të vonuara. Si rezultat, gjatë dekadës së fundit, mosha mesatare e femrave që tentojnë të martohen është rritur nga 22.6 në 24.1 vjeç, ndërsa për meshkujt është rritur nga 27.2 në 29.3 vjeç. Kërkimet tregojnë se nënat e reja kanë fare pak apo

aspak fuqi vendimmarrëse në shtëpi, dhe burrat ose prindërit vendosin martesën për to. Si rrjedhim, ndërsa mosha martesore rritet tek femra, pabarazia për sa i takon marrëdhëniet të pushtetit në çift zvogëlohet, duke ndikuar pozitivisht në autonominë e gruas dhe në vetëpërbushjen e saj. Për shkak të ndryshimeve të normave dhe qëndrimeve sociale, numri i zgjidhjeve të martesës ka patur rritje nga 8.7 në 9.6 për 100 martesë.⁵⁵


⁵² INSTAT: REPOBA, 2001.

⁵³ Raport ecurie 2003 mbi zbatimin e SKZHSE, Këshilli i Ministrave, Tiranë 2004.

⁵⁴ INSTAT: REPOBA, 2001.

⁵⁵ Raport ecurie 2003 mbi zbatimin e SKZHSE, Këshilli i Ministrave, Tiranë 2004.

Femrat me lindje të gjalla sipas moshave



INSTAT: REPOBA, 2001

Gjendja Civile sipas Gjinitisë⁵⁶

Bashkia	Gjendja Civile Mashkull				Gjendja Civile Femër			
	Beqar	Martuar	I ve	Ndarë	Beqar	Martuar	E ve	Ndarë
Tepelenë	8,535	7,571	214	45	7,111	7,697	1,179	52
Përmet	6,333	6,463	202	25	5,177	6,619	916	45
Gjirokastrë	13,250	13,741	395	91	11,021	13,917	2,089	143
Gjithsej	28,118	27,775	811	161	23,309	28,233	4,184	240

Në qarkun e Gjirokastrës, rreth 49.6% e popullsisë është martuar dhe afërsisht 45.6% është beqare. Vejanët përbëjnë 4.4%, ndërsa të divorcuarit 0.4% të popullsisë. Duhet të theksohet niveli i ulët i divorceve. Në shoqëritë tradicionale fshatare rrallë ndodh që gratë të kërkojnë zgjidhje martesë për shkak të njollës që u vihet grave të ndara. Gratë janë të vetmet që fajësohen për dështimin e martesës dhe shpeshherë veçohen brenda familjes dhe komunitetit. Varësia ekonomike nga burrat mund të jetë një faktor tjetër për të mos kërkuar zgjidhje martesë. Veç kësaj, sistemi ligjor pengues dhe i vjetëruar për zgjidhjen e martesës vepron si frenues. Gratë e divorcuara në qark janë në numër më të madh sesa meshkujt në çdo rreth dhe vlen të theksohet që edhe gratë e veja ua kalojnë burrave të ve me një shifër befasuese prej 3,373 (nga popullsia e ve 16.2% janë meshkuj, ndërsa 83.8% janë gra). Kjo statistikë thekson edhe njëherë faktin që gjinia është përcaktuesi parësor i cënueshmërisë pasi nëse një grua bëhet kryefamiljar dhe kryesigures i të hollave ka më shumë të ngjarë të vuajë nga varfëria e thellë sesa nëse këtë rol do ta kishte një burrë. Për më tepër, duke qënë se gratë shihen me sy të keq për divorcin krahasuar me burrat, ndodh shumë rrallë që gratë e ndara të rimartohen, ndërsa burrat më shpesh.

Jetëgjatësia

Jetëgjatësia mesatare në Shqipëri është 69 vjeç për

burrat dhe 75 për gratë me një mesatare prej 72 vjeç. Kjo mesatare është vetëm pak më e ulët sesa ajo e Europës Perëndimore, por në vitet e fundit ka shënuar rënie. Jetëgjatësia mesatare në qarkun e Gjirokastrës është 73.78 vjeç. Në kontekstin mesdhetar dhe europianolindor jetëgjatësia mesatare është 78.2 në Greqi, 70.9 në Bullgari, 70.4 në Turqi, 74.1 në Kosovë, 73.5 në Maqedoni, 74 në Bosnjë dhe 78.7 në Itali. Në SHBA jetëgjatësia mesatare është 77 vjeç.⁵⁷

Romët dhe Demografia

Mungesa e të dhënave demografike bazë për romët e vështirëson trajtimin e kësaj çështjeje. Për shembull, mungesa e statistikave konkrete për diçka kaq themelore sa ç'është numri i popullsisë rome është një e metë shumë e madhe; ndaj dhe rëndësia e problemeve të tyre mbetet e pakapshme. Gjithashtu, interpretimi i të dhënave kaq të pakta paraqet rrezik sepse përgjithësimet e gjera shpesh kanë pasaktësi. Një faktor që e ndërlikon këtë është që romët shpesh ruhen që të identifikojnë vetveten nga frika e turpit nga bashkësia më e gjerë.⁵⁸ Vlerësohet që vetëm në Shqipëri ka të paktën 95,000 romë, çka përbën 2% të popullsisë. Gjithsesi, këto statistika janë të vjetra.

⁵⁶ INSTAT: REPOBA, 2001.

⁵⁷ Raport ecurie 2003 mbi zbatimin e SKZbShE, Këshilli i Ministrave, Tiranë 2004

⁵⁸ Romët në Europën qendrore dhe lindore: Shmangia e kurthit të varësisë – Një raport për Zhvillimin Njerëzor në Rajon, PNUD, dhjetor 2002.

Shpërndarja e popullsisë rome në Europën juglindore, qendrore dhe lindore ndërmjet viteve 1991-1994 (1,000)⁵⁹

Shteti	Popullsia rome	Popullsia gjithsej	% e romëve
Shqipëria	95	3,421	2.0
Bosnja & Herzegovina	45	4,383	1.0
Bullgaria	750	8,459	8.9
Kroacia	35	4,788	0.7
Çekia	275	10,323	2.7
Hungaria	575	10,280	5.6
Maqedonia	240	2,191	10.9
Polonia	45	38,446	0.1
Rumania	2,150	22,761	9.4
Slovakia	480	5,345	9.4
Slovenia	10	1,993	0.4
Jugosllavia	425	10,675	4.0

Një vëzhgim i të dhënave më të fundit që burojnë nga pushteti vendor, shoqata e romëve, departamenti i SHBA, autorë jo shqiptar nga Ballkani (Poulton,

Bugajski, Bruner), nxjerrin në pah që numri i romëve në Shqipëri është 60,000-150,000. Në qarkun e Gjirokastrës ka diçka midis 1,200-2,000.

Popullsia e romëve shqiptar sipas qarqeve⁶⁰


Qarqe	Pushteti vendor	Shoqata rome "Amaro Drom"	Poulton	Bugajski	Departamenti i shtetit SHBA	Brunër
Shkodër	50	600-1,000	n/a	n/a	n/a	n/a
Fushë – Krujë	n/a	1,500-2,000	n/a	n/a	n/a	n/a
Tiranë	n/a	10-12,000	n/a	n/a	n/a	n/a
Elbasan	2,622	9-10,000	n/a	n/a	n/a	n/a
Durrës	n/a	3-4,000	n/a	n/a	n/a	n/a
Korçë	2,383	10-11,000	n/a	n/a	n/a	n/a
Fier	5,323	17-18,000	n/a	n/a	n/a	n/a
Vlorë	1,036	2,000-2,500	n/a	n/a	n/a	n/a
Berat	n/a	3-4,000	n/a	n/a	n/a	n/a
Gjirokastrë	1,200	2,000	n/a	n/a	n/a	n/a
Delvinë	285	2,000	n/a	n/a	n/a	n/a
Gjithsej	n/a	120,000-150,000	10,000	10,000	100,000	60,000

Të dhënat e Këshillit të Qarkut bazohen vetëm në pjesën më jugore të Gjirokastrës në rrugën për Lazarat, ku jetojnë afërsisht 660 romë. Shumica e këtyre familjeve përbëhen nga 10-13 veta, dhe afro 300 prej tyre janë ekonomikisht aktivë ndonëse papunësia mendohet të jetë tepër e ulët. Siç u tha më lart, mjaft romë migrojnë për periudha të shkurtra, psh në Greqi, kur të ardhurat nga tregjet formale dhe informale nuk mund t'u përgjigjen nevojave të tyre jetësore. Megjithatë, ndonëse migrimi

është taktikë e uljes së varfërisë, në të ardhmen e largët normalisht të çon në varfëri të thellë. Meqë shumë migrues nuk mund të sigurojnë vizë për në vendin e synuar ata udhëtojnë ilegalisht. Meqë kostoja e vizave në tregun e zi është e lartë migruesit shkojnë pa to, gjë që i detyron të punojnë në vende pune jo profesionale që ofrojnë rroga të ulta. Dërgesat e të hollave zakonisht shpenzohen për nevojat bazë jetësore dhe për të paguar borxhet tek shitësit lokal. Pasi kanë shlyer kostot e

59 Hermine De Soto, Ilir Gedeshi, Sabine Beddies, & Daniel Perez, Romët dhe Evgjilët në Shqipëri: Nga përjashtimi social në përfshirjen sociale ose Dilema e Monedhës së Artë, Raporti I: Rekomandime dhe Implikime Politike, Banka Botërore, prill 2004.

60 Hermine De Soto, Ilir Gedeshi, Sabine Beddies, & Daniel Perez, Romët dhe evgjilët në Shqipëri: Nga përjashtimi social drejt përfshirjes sociale ose Dilema e Monedhës së Artë, Raporti I: Rekomandime dhe Implikime Politike, Banka Botërore, prill 2004.



Raporti Kombëtar i Zhvillimit Nierëzor. 2002.

udhëtimit dhe shpenzimet e tjera, romët ndonjëherë mbesin me më pak të holla se sa kishin para migrimit.

Migrim do të thotë gjithashtu që fëmijët të mos regjistrohen në shkollë për kohë të gjatë, punëtorët të mos futen në asnjë program pensioni, dhe borxhet të vazhdojnë të rriten duke bërë që shumë veta të vazhdojnë të migrojnë. Gratë martohen ose i martojnë të reja që të bëjnë fëmijë dhe të ndihmojnë me shpenzimet e jetesës. Zakonisht, burrat romë martohen në moshën 18.2 vjeç, kurse femrat romë martohen në moshën 15.5 vjeç dhe madhësia mesatare e familjes është 6.4 veta. Duhet

shënuar që martesat e hershme ka pasojë të dëmshme për vajzat. Ajo çon në mosarsimim pasi vajzat e martuara priren të mos vazhdojnë arsimimin. Kjo shpie edhe në probleme të rënda të shëndetit si shtatzani të parakohshme dhe në rritje të shkallës së vdekshmërisë mëmësore dhe foshnjore. Pavarësisht vështirësive në mbledhjen dhe saktësinë e të dhënave statistikore nevojitet një informacion më specifik demografik për përbërjen gjinore, strukturën moshore, gjendjen civile dhe jetëgjatësinë e romëve. Kjo do të çojë në hartimin e politikave të përshtatshme për të trajtuar çështjet e romëve.

Arsimi

Përveç mungesës së burimeve në arsim, Shqipëria ka jetuar dy periudha gjymtimi gjatë të cilave ndërtesat e arsimit u shkatërruan dhe popullsia lëvizi masivisht; këto sollën kërkesa të reja ekonomike në një sistem akademik që ishte ende i paqëndrueshëm. Trazirat që pasuan fundin e regjimit komunist dhe rënia e skemave piramidale shkaktuan vandalizma mbi pronën publike, të cilave nuk u shpëtuan as ndërtesat e arsimit. Ndërtesat u dëmtuan në atë pikë sa që tashmë duhen investime themelore për t'i rehabilituar plotësisht. Për më tepër migrimi masiv nga qendrat fshatare në ato urbane ushtron trysni të madhe mbi shkollat e qyteteve që ishin të papërgatitura për të pasur një fluks të tillë studentësh nga zonat fshatare. Rrjedhimisht dolën në dritë dy sfida madhore. Së pari, ka një numër mjaft të madh nxënësish që duhen arsimuar dhe shpërndarja e tyre është krejt e çekuilibruar. Së dyti, migruerit rivendosen nga zonat ku nuk ka cilësi në arsim në zonat e qytetit dhe nevojat e këtyre studentëve ndryshojnë nga ato të nxënësve të qytetit dhe duhen trajtuar në mënyrën e duhur.⁶¹

Banorët e qarkut të Gjirokastrës kanë pasur gjithmonë dëshirë për të nxënë, pavarësisht vështirësive me të cilat është përballur populli. Për shkak të ndryshimeve të thella ekonomike, shoqërore dhe politike në vend gjatë dhjetëvjeçarit të shkuar, është bërë prioritet që sistemi arsimor të rigjenerohet dhe të mirëpresë jo vetëm brezin e ri por të gjitha grupet e moshave. Megjithatë, standardet

arsimore kanë pësuar rënie të shpejtë ndër vite, njësoj si shkalla e regjistrimit në nivel kombëtar.⁶² Niveli i ulët arsimor ka qenë një faktor kontribues në përqindjen e lartë të papunësisë.

Një rezultat i drejtpërdrejtë i të rinjve që lanë shkollat në vitet 1990 është fakti që tani ata përfaqësojnë një kontingjent të madh të të papunëve.

Indeksi Arsimor & Indeksi i Arsimit të shpërndarë njësoj⁶³

Indeksi arsimor mat arritjet relative të një vendi në arsimin e të rriturve dhe në shkallën e përgjithshme të regjistrimit në shkollat fillore, të nivelit të dytë dhe të tretë. Indeksi i arsimit të shpërndarë njësoj merr të dhëna të shpërbëra mbi gjininë dhe përdor indeksin arsimor për të matur ndryshimin mes arritjeve relative të meshkujve dhe femrave si në shkollimin deri në moshë të madhe ashtu edhe në shkallën e regjistrimit në shkollat e nivelit të parë, të dytë dhe të tretë.

Përbërja gjinore e grafikut të dytë ilustron pabarazinë gjinore në ndjekjen e shkollave në mjaft qarqe të vendit. Meqë në popullsinë e moshës 6-23 ka më shumë femra se meshkuj, do të duhet të kishte më shumë femra që ndjekin shkollën. Por kjo vlen vetëm për Tiranën. Në të gjitha qarqet e tjera rezultoi kundërta, sepse regjistrimi i meshkujve ia kalon regjistrimit të femrave.

	Studentë në arsimin fillor, dytësor dhe tretësor	Popullsia nga 6-23 vjeç	Shkalla e regjistrimit	Shkalla e analfabetizimit	Shkalla e njohjes shkrim e këndim
Tiranë	70,396	94,120	74.8%	3.3%	96.7%
Bregdet	204,966	319,613	64.1%	5.8%	94.2%
Qendër	286,823	452,854	63.3%	5.7%	94.3%
Malore	83,503	139,060	60.0%	7.2%	92.8%
Gjithsej	645,688	1,005,647	64.2%	5.6%	94.4%

61 Njësia e sektorit të zhvillimit njerëzor: Europë dhe rajoni i Azisë Qendrore, Shqipëri – Vlerësim i varfërisë, Vëll. 1 nga 1, Banka Botërore, nëntor 2003.

62 Përgjigja shqiptare për OZHM-të, Qendra për Nxirjen e Zhvillimit Njerëzor, Tiranë, maj 2002.

63 Raporti kombëtar për Zhvillimin Njerëzor, 2004.

	Studentë në nivelin arsimor të parë, të dytë dhe të tretë		Popullsia 6-23 vjeç		Indeksi i Regjistrimit të përgjithshëm	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
Bregdetare	10,4262	100,704	15,5903	163,710	0.669	0.615
Qendrore	14,5787	141,036	215,268	237,586	0.677	0.594
Malore	43,456	40,047	69,209	69,851	0.628	0.573
Tiranë	32,810	37,586	46,106	48,014	0.712	0.783
Gjithsej	32,6315	319,373	486,486	519,161	0.671	0.615

	Shkalla e analfabetizimit		Shkalla e njohjes shkrim e këndim		Indeksi i regjistrimit të përgjithshëm		Indeksi arsimor		Indeksi i Arsimit të shpërndarë njësoj
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	
Bregdetare	0.044	0.073	0.956	0.927	0.669	0.615	0.861	0.823	0.841
Qendrore	0.040	0.074	0.960	0.926	0.677	0.594	0.866	0.815	0.839
Malore	0.052	0.091	0.948	0.909	0.628	0.573	0.841	0.797	0.818
Tiranë	0.022	0.045	0.978	0.955	0.712	0.783	0.889	0.898	0.894
Gjithsej	0.040	0.072	0.960	0.928	0.671	0.615	0.863	0.823	0.842


Indeksi arsimor për meshkujt për kategorinë gjeografike "qendrore" që përfshin edhe qarkun Gjirokastrë, është 0.866 për meshkujt, ndërkohë që e kalon fare pak mesataren kombëtare për meshkuj prej 0.863. Nga ana tjetër indeksi arsimor për femrat për rajonin qendror, që është 0.815, është nën mesataren kombëtare femërore prej 0.823. Indeksi i arsimit të shpërndarë njësoj në total për zonën qendrore është 0.839. Ai bie nën mesataren kombëtare totale prej 0.842. Duke i përgjithësuar këto rezultate duket qartë që regjistrimi në arsimin e nivelit të I, të II dhe të III dhe shkalla e njohjes së shkrim-këndimit kërkon që në qarkun e Gjirokastrës të bëhen përmirësime në mënyrë që të arrihet dhe të tejkalohet mesatarja kombëtare. Megjithatë, edhe më e rëndësishme është të bëhet progres në regjistrimin e femrave dhe arsimimin e tyre pasi ato janë jo vetëm nën mesataren kombëtare por edhe të mesatares së meshkujve në të gjitha zonat gjeografike të vendit, me përjashtim të Tiranës.

Gjendja Arsimore

Një pamje më specifike e nivelit mesatar akademik

të popullsisë së qarkut mund të shihet në hartën më poshtë që përvijon shpërndarjen e banorëve sipas nivelit arsimor. Në të tre rrethet duket sheshit që shumica e banorëve nuk kanë arritur përtej niveleve 5-8 vjeçar të arsimit fillor. Përveç kësaj, në gjithë qarkun ka një përqindje të madhe individësh arsimit të cilëve nuk kalon përtej 1-4 vjet shkollë. Në Odrie të Gjirokastrës dhe në Çarçovë të Përmetit, zona ku treguesit e varfërisë janë relativisht të lartë, takohet numri më i madh i atyre që nuk kanë marrë arsim përtej klasës së 4-t. Fatmirësisht, ka edhe një numër të konsiderueshëm njerëzish që kanë mbaruar arsimin e nivelit të dytë, veçanërisht në Kurvelesh të Tepelenës, në Përmet të Përmetit si edhe në Gjirokastrë dhe Antigone të rrethit Gjirokastrë. Megjithëse numri i të diplomuarve në universitet është i ulët, numri më i madh i tyre gjendet në qytetet Tepelenë, Përmet dhe Gjirokastrë. Kjo tregon qartë që nivelet e larta të arsimit hasen më shpesh në zonat më të populluara urbane. Një arsye për këtë prirje mund të jetë aksesit dhe afërsisht tek arsimit i lartë. Veç kësaj, rol mund të luajë dhe perceptimi i njerëzve për rëndësinë e arsimit.

Shpërndarja e popullsisë nga arsimimi
(popullsia mbi 18 vjeç)



INSTAT: REPOBA, 2001

Tabelat vijuese tregojnë të dhëna të niveleve të ndryshme të arsimit, të ndjekura duke i krahasuar

meshkujt dhe femrat në fshatra, meshkujt dhe femrat në qytete për të tre rrethet e qarkut Gjirokastrë.

Ndjekja e arsimit nga meshkujt dhe femrat në fshatra sipas rretheve⁶⁴

Rrethi		Ndjekja e arsimit						Gjithsej	Të Shkolluar	
		Pa diplomë	fillore	Profesional i epërm	E mesme e Përgjithshme	Teknike e lartë	Universitet dhe Pas-Universitar		Po	Jo
Tepelenë	Meshkuj	1,520 (43.2%)	6,557 (51%)	199 (66%)	912 (59.2%)	346 (61%)	204 (68.2%)	9,738 (51%)	9,596 (51.5%)	142 (33.2%)
	Femra	1,998 (56.8%)	6,277 (49%)	103 (34%)	629 (40.8%)	221 (39%)	95 (31.8%)	9,323 (49%)	9,037 (48.5%)	286 (66.8%)
	Totali:	3,518	12,834	302	1,541	567	299	19,061	18,633	428
Përmet	Meshkuj	1,049 (55.7%)	4,971 (49.8%)	141 (55.7%)	682 (59.4%)	441 (65%)	203 (79.6%)	7,487 (51%)	7,397 (51%)	90 (39.5%)
	Femra	1,316 (44.3%)	4,995 (50.2%)	112 (44.3%)	465 (40.6%)	236 (35%)	52 (20.4%)	7,176 (49%)	7,038 (49%)	138 (60.5%)
	Totali:	2,365	9,966	253	1,147	677	255	14,633	14,435	228
Gjirokastrë	Meshkuj	2,318 (43.4%)	8,814 (48.8%)	396 (65.2%)	1,479 (58.5%)	999 (63.6%)	399 (68.9%)	14,405 (50.2%)	14,233 (50.4%)	172 (39.4%)
	Femra	3,022 (56.6%)	9,242 (51.2%)	211 (34.8%)	1,050 (41.5%)	572 (36.4%)	180 (31.1%)	14,277 (49.8%)	14,013 (49.6%)	264 (60.6%)
	Totali:	5,340	18,056	607	2,529	1,571	579	28,682	28,246	436

Ndjekja e arsimit nga meshkujt dhe femrat në qytete sipas rretheve⁶⁵

Rrethi		Ndjekja e arsimit						Totali	Të Shkolluar	
		Pa diplomë	fillore	Profesional i epërm	E mesme e Përgjithshme	Teknike e lartë	Universitet dhe Pas-Universitar		Po	Jo
Tepelenë	Meshkuj	594 (45%)	2,313 (47.5%)	155 (53.6%)	1,064 (51.4%)	444 (50.6%)	449 (59%)	5,019 (49.3%)	4,988 (49.4%)	31 (35.6%)
	Femra	725 (55%)	2,560 (52.5%)	134 (46.4%)	1,007 (48.6%)	433 (49.4%)	312 (41%)	5,171 (50.7%)	5,115 (50.6%)	56 (64.4%)
	Totali:	1,319	4,873	289	2,071	877	761	10,190	10,103	87
Përmet	Meshkuj	498 (44%)	1,809 (45.8%)	145 (57.3%)	984 (51.5%)	403 (47.8%)	589 (67.1%)	4,428 (49.4%)	4,395 (49.4%)	33 (42.3%)
	Femra	635 (56%)	2,144 (54.2%)	108 (42.7%)	925 (48.5%)	440 (52.2%)	289 (32.9%)	4,541 (50.6%)	4,496 (50.6%)	45 (57.7%)
	Totali:	1,133	3,953	253	1,909	843	878	8,969	8,891	78
Gjirokastrë	Meshkuj	1,113 (44.7%)	4,519 (48.1%)	283 (50.2%)	1,929 (48.9%)	1,167 (57.2%)	1,442 (57.1%)	10,453 (49.9%)	10,396 (49.9%)	57 (42.9%)
	Femra	1,377 (55.3%)	4,873 (51.9%)	280 (49.8%)	2,018 (51.1%)	874 (42.8%)	1,085 (42.9%)	10,507 (50.1%)	10,431 (50.1%)	76 (57.1%)
	Totali:	2,490	9,392	563	3,947	2,041	2,527	20,960	20,827	133

Duke krahasuar rrethet, Gjirokastra ka numrin më të madh të njerëzve pa diplomë, por ka edhe shifrat më të larta të njerëzve në të gjitha kategoritë e ndjekjes së arsimit, e ndjekur nga Tepelena dhe Përmeti. Kjo ndarje më dysh, me shumë i detyrohet popullsisë relativisht të madhe të rrethit dhe migrimit të popullsisë me dhe pa aftësi nga zonat fshatare në ato qytetëse. Të marrë rrethet së bashku, ka më pak femra me diplomë sesa meshkujt, por femrat i tejkalojnë meshkujt në mbarimin e arsimit fillor në rrethet Përmet dhe Gjirokastrë. Në të gjitha kategoritë e tjera të arsimit më të lartë ndjekja e shkollës nga meshkujt është më e lartë se për femrat.

Kur flasim për dallimin e ndjekjes së shkollës në fshatra dhe qytete, faktorë sundues mbeten ndryshimi i normave dhe mendësisë shoqërore që ndikojnë në këndvështrimin e njerëzve mbi arsimin. Për habi, shumë më tepër burra dhe gra fshatare e kanë mbaruar shkollën fillore dhe arsimin e lartë profesional sesa burrat dhe gratë në qytete, gjë që vihet re në të gjitha rrethet. Pavarësisht këtyre treguesve të lartë me rritjen e nivelit akademik, në të treja rrethet vihet re që ka më shumë meshkuj dhe femra të qyteteve që mbarojnë studimet e mesme të përgjithshme, të larta teknike dhe universitare. Pavarësisht këtyre, kërkohet përmirësim i regjistrimeve në arsimin e nivelit të dytë e më lartë,

64 INSTAT: REPOBA, 2001.

65 INSTAT: REPOBA, 2001.

krahasuar kjo me nivelin bazë. Sërish theksojmë që, arsyet për këto janë komplekse dhe përfshijnë çështje të aksesit, gjendjes familjare dhe kuptimin e dobisë së arsimit në nivele më të larta. P.sh kur fëmijët fshatare rriten, ata përballen me trysinë e familjeve për të sjellë të holla. Duket gjithmonë e më e vështirë që prindërit të gjejnë arsye për të shpenzuar që fëmijët e tyre të shkollohen në qendra urbane të largëta, kur shohin humbjet në të ardhura nga mospërfshirja e fëmijëve në punë që të sjellin të ardhura. Bindja që gratë nuk kanë nevojë për arsim aq sa burrat kontribuon në ndjekje më të ulët të shkollës nga femrat në nivel pasfillor. Veç këtyre, rol mund të luajnë edhe shqetësimet për sigurinë e tyre pasi në zonat fshatare ka distanca të largëta shkollë-shtëpi dhe ka rrezik rrëmbimi apo trafikimi.

Ka një mori faktorësh që përcaktojnë regjistrimin në shkollat e nivelit të dytë, në fshatrat dhe qytetet e Shqipërisë. Në zonat qytetëse kjo përfshin nivelin arsimor të kryefamiljarit, nivelin arsimor të bashkëshortit apo bashkëshortes dhe moshën e fëmijës. Çmimi i fletoreve dhe stilolapsave është një tjetër frenues. Në zonat fshatare, faktorë kryesor janë prania e një shkolle të nivelit të dytë, niveli arsimor i bashkëshortit të

kryefamiljarit, konsumi për frymë dhe pronësia e gjësë së gjallë. Faktorë që ndikojnë negativisht regjistrimin në zonat fshatare janë pasja e kuajve, e deleve dhe prania në shtëpi e fëmijëve më të mëdhenj me shkollë të nivelit të dytë. Pra, familjet që mbajnë gjedh zakonisht kishin një kokë, ndërkohë që familjet me dele apo kuaj kishin në pronësi përafërsisht 14 kokë. Kështoj, familjet që kishin dele dhe kuaj kishin nevojë për më shumë punë sesa familjet që kanë gjedh, duke u kërkuar fëmijëve të qëndronin në shtëpi.⁶⁶

Studentët

Në dhjetëvjeçarin e kaluar ka pasur një rënie të dukshme të numrit të fëmijëve të regjistruar në shkollat fillore, në nivel kombëtar. P.sh gjatë vitit akademik 2000-2001 kishte 19% më pak studentë që ndiqnin shkollën sesa gjatë vitit 1989-1990.⁶⁷ Duke përjashtuar studentët universitar ka rreth 22,474 studentë në qarkun e Gjirokastrës, 13.7% e të cilëve janë në kopshte, 58.9% në shkolla fillore, 23.4% në shkollat e mesme të përgjithshme dhe 4% në shkollat profesionale. Në vitin akademik 2003-2004 në të gjithë qarkun kishte 2,397 studentë universitar.

Fëmijë që ndjekin kopshtin, nxënës që ndjekin arsimin fillor dhe dytësor gjatë 2003-2004⁶⁸

	numri i fëmijëve në kopshte			numri i nxënësve në shkollat 8-vjeçare			numri i studentëve në shkollat e mesme		
	Totali	Nga zonat rurale	Nga zonat qytetase	Totali	Nga zonat rurale	Nga zonat qytetase	Totali	E përgjithshme	Profesionale
Qarku i Gjirokastrës	3,082	1,113 (36%)	1,969 (64%)	13,232	6,596 (49.8%)	6,636 (50.2%)	6,160	5,267 (85.5%)	893 (14.5%)

Shkrim e Këndim

Sipas raportit të vitit 2000 të UNICEF-it, njohja e shkrimit dhe këndimit ishte 87,7%, me afro 85% femra dhe 91% meshkuj. Shkalla e njohjes së shkrim-këndimit për moshat 15-24 vjeç ishte afro 93%.⁶⁹ Sot, më shumë se 90% e popullsisë mbi moshën 14 vjeç mund të lexojë dhe shkruajë pa vështirësi. Afro 5% e të rriturve që nuk dinë të lexojnë e të shkruajnë apo që e bëjnë këtë me vështirësi u përkasin brezave më të vjetër. P.sh. afro 15% e qytetarëve mbi 50% janë analfabet, por ndër të rinjtë shqiptarë 98% njohin mjaft mirë shkrim e këndim.⁷⁰ Megjithatë, analfabetizimi vazhdon të jetë problem në pjesë të veçanta

të vendit për shkak të ndryshimeve ekonomike, demografike dhe shoqërore që solli periudha e tranzicionit.

Siç tregoi tabela e mëparshme për Indeksin Arsimor dhe Indeksin e Arsimit të Shpërndarë njëjloj, shkalla e analfabetizimit në zonën gjeografike qendrore është 5,7%, ndërsa shkalla e arsimit është 94,3%. Nga popullata mashkullore e zonës qendrore, 96% dinë shkrim e këndim, ndërkohë që për femrat kjo shifër është 92,6%. Harta vijuese tregon gjithashtu që analfabetizimi është relativisht i ulët në të gjithë qarkun.

66 Njësia e Sektorit të Zhvillimit Njerëzor: Europa dhe Rajoni i Azisë qendrore, Shqipëri – Vlerësimi i varfërisë, vëll. 1 nga 1, Banka Botërore, nëntor 2003.


67 Përgjigja shqiptare për OZHM-të, Qendra e Ncësjes së Zhvillimit Njerëzor, Tiranë, maj 2002.

68 Treguesit sipas prefekturave: 2002-2003, INSTAT, 2004.

69 Raporti i Vëzhgimit të Treguesve të Shumëfishitë, UNICEF, Tiranë 2000.

70 Njësia e Sektorit të Zhvillimit Njerëzor: Europa dhe Rajoni i Azisë Qendrore, Shqipëria – Vlerësimi i varfërisë, Vëll. 1 i 1, Banka Botërore, nëntor 2003.

Shpërndarja e popullsisë analfabete



INSTAT: REPOBA. 2001

Mjediset shkollore

Strukturat e ndërtesave shkollore janë përkeqësuar së fundi, duke përfshirë këtu edhe furnizimin me energji dhe ngrohjen. Veç kësaj, në 42% të shkollave nuk ka banjò, gjë që ndikon negativisht në shkallën e regjistrimit aty të vajzave adoleshente.⁷¹ Edhe në qendrat më të mëdha urbane shkollat ose nuk kanë pajisje ose kanë pajisje klasash të vjetëruara. Për më tepër, numri mesatar i nxënësve për klasë (klasat shpesh janë të përziera, pra në një klasë ka grupmosha dhe nivele aftësisht të ndryshme) është midis 45-50.⁷² Ndonëse numri i mjediseve shkollore nuk tregon drejtpërdrejt cilësinë e arsimit, ai lidhet me çështjet e aksesit në shkollë nga fëmijët dhe të rinjtë që banojnë në qark. Afërsia dhe aksesit në shkollë janë të nevojshme për ndjekjen e rregullt dhe përfundimin e arsimit. Siç tregon tabela vijuese, në zonat fshatare të qarkut, ku jetojnë shumica e banorëve, ka një numër të konsiderueshëm kopshtesh por një numër tepër të vogël

shkollash të nivelit të dytë. Kjo përbën pengesë serioze për ata që duan të ndjekin arsim më të lartë. Veç këtyre, mjediset shkollore kanë rënë në një gjendje të keqe dhe shumë prej tyre nuk kanë ngrohje, furnizim të vazhdueshëm me energji, dhe nga ana tjetër, dyert dhe muret po rrënohen seriozisht.

Shkalla e regjistrimit në universitetet shqiptare ka kapur shifrën 11% dhe një shkallë regjistrimi neto prej 9%. Kjo shkallë është aq e ulët sa që vendi ka pjesëmarrjen më të vogël nëpër universitete në Europë. Krahasuar me vendet e tjera me ekonomi në tranzicion në Europë dhe Azi qendrore, vetëm Turkmenistani dhe Uzbekistani kanë nivel të ulët regjistrimi.⁷⁴ Qarku i Gjirokastrës ka vetëm një universitet, që do të thotë që regjistrimi dhe ndjekja e tij kërkon nga studentët që të zhvendosen në qytet si mundësia më e mirë e mundshme. Këto përpjekje mund të jenë jo vetëm të papërshtatshme por edhe me kosto të lartë.

Mjediset arsimore⁷³

	Kopshte publike	Kopshte private	Shkolla 8-vjeçare publike	Shkolla 8-vjeçare private	Shkolla të mesme publike	Shkolla të mesme të përgjithshme publike	Shkolla profesionale publike	Shkolla të mesme private
Gjirokastrë	88	2	109	1	27	22	3	2
Qytet	20	2	12	1	12	7	3	2
Fshat	68	-	97	-	15	15	-	-

Braktisja e shkollës

Sipas Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës braktisja e shkollës arriti kulmin në 1991-1992 duke zbritur në 2,3% në vitin 2001. Në qarkun e Gjirokastrës siç e tregon tabela vijuese duket qartë që braktisja ndryshon sipas rretheve. Psh. në rrethin e Gjirokastrës largimet janë të ulta, ndërsa në Përmet relativisht të ulta. Rrethi i Tepelenës ka braktisjen më të lartë në qark si për shkollën e nivelin e parë dhe atë të dytë arsimor. Ky tregues e kalon tre herë nivelin e Përmetit dhe e bën të papërfillshëm treguesin e Gjirokastrës. Varfëria e skajshme në familje është shkaku kryesor i braktisjes së shkollës, pasi ndër të tjera, familjet me të ardhura të pakta e kanë të vështirë të blejnë libra dhe t'u ofrojnë fëmijëve një mjedis të favorshëm për të ndjekur shkollën rregullisht.⁷⁵

Braktisja e shkollës është më e lartë në zonat fshatare gjë që lidhet me nivelet e larta të varfërisë. Sipas rezultateve të nxjerra nga një studim i mbështetur nga UNICEF në 2001, ndonëse meshkujt e braktisin shkollën më pak se femrat numri i meshkujve që e braktisin shkollën për shkaqe

ekonomike është 1,4 herë më i lartë se femrat. Është e qartë që faktorët gjinor kanë të bëjnë me këtë ndryshim. Sipas traditës dhe mendësisë, meshkujt konsiderohen më të aftë të sjellin të ardhurave në familjeve, ndaj ata i largojnë nga shkolla dhe i detyrojnë të ndihmojnë prindërit në veprimtaritë e përditshme ose dërgohen për të punuar jashtë shtetit.

Në mënyrë të ngjashme ndodhin braktisje 'të fshehta' kur studentët nuk largohen zyrtarisht por thjesht nuk përparojnë me studimet. Një raport tregon që numri i fëmijëve që braktisin shkollën është mjaft më i vogël sesa numri i studentëve që largohen fshehurazi. Kështu, në disa zona, niveli i braktisjes së 'fshehtë' mund të jetë afërsisht sa 1/3 e numrit të përgjithshëm të nxënësve që ndjekin shkollën fillore. Çështje të tjera që ndikojnë në nivelin e braktisjes i përkasin kompetencave të kufizuara të qeverisë në zbatimin e ligjit për arsimin e detyrueshëm, migrimin e brendshëm dhe të jashtëm, rigjallërimin e gjakmarrjes në disa zona dhe nivelin e ulët të arsimit dhe rrogat e ulta të mjaft mësuesve.

71 Vlerësimi i përgjithshëm i vendit, Kombet e Bashkuara – Shqipëri, 2004.

72 Përgjigja shqiptare ndaj OZHM, Qendra për Nisajën e Zhvillimit Njerëzor, Tiranë, maj 2002.

73 Treguesit sipas prefekturave: 2002-2003, INSTAT, 2004.

74 Njësia e Sektorit të Zhvillimit Njerëzor: Europa dhe Rajoni i Azisë Qendrore, Shqipëria – Vlerësimi i varfërisë, Vëll. 1 i 1, Banka Botërore, nëntor 2003.

75 Arsimit në Shqipëri: Mendime dhe shpresa në ndryshim, Banka Botërore, Tiranë 2000.

Braktisja e shkollës sipas rretheve për arsimin e nivelit të parë dhe të dytë⁷⁶

Rrethe	Gjithsej braktisje	Numri në nivelin e parë	Numri në nivelin e dytë
Gjirokastër	12	3	9
Përmet	60	7	53
Tepelenë	195	46	149
Gjithsej	267	56	205

Braktisja e shkollës është më e lartë në zonat fshatare gjë që lidhet me nivelet e larta të varfërisë. Sipas rezultateve të nxjerra nga një studim i mbështetur nga UNICEF në 2001, ndonëse meshkujt e braktisin shkollën më pak se femrat numri i meshkujve që e braktisin shkollën për shkaqe ekonomike është 1,4 herë më i lartë se femrat. Është e qartë që faktorët gjinor kanë të bëjnë me këtë ndryshim. Sipas traditës dhe mendësisë, meshkujt konsiderohen më të aftë të sjellin të ardhurave në familjeve, ndaj ata i largojnë nga shkolla dhe i detyrojnë të ndihmojnë prindërit në veprimtaritë e përditshme ose dërgohen për të punuar jashtë shtetit.⁷⁷

Në mënyrë të ngjashme ndodhin braktisje 'të fshehta' kur studentët nuk largohen zyrtarisht por thjesht nuk përparojnë me studimet. Një raport tregon që numri i fëmijëve që braktisin shkollën është mjaft më i vogël sesa numri i studentëve që largohen fshehurazi. Kështu, në disa zona, niveli i braktisjes së 'fshehtë' mund të jetë afërsisht sa 1/3 e numrit të përgjithshëm të nxënësve që ndjekin shkollën fillore.⁷⁸ Çështje të tjera që ndikojnë në nivelin e braktisjes i përkasin kompetencave të kufizuara të qeverisë në zbatimin e ligjit për arsimin e detyrueshëm, migrimin e brendshëm dhe të jashtëm, rigjallërimin e gjakmarrjes në disa zona dhe nivelin e ulët të arsimit dhe rrogat e ulta të mjaft mësuesve.⁷⁹

Mësuesit

Si rezultat i standardeve arsimore përherë në rënie, prindërit kanë zgjedhur që t'i mësojnë fëmijët e tyre privatisht ose fare. Gjithashtu, pabarazia mes aksesit dhe cilësisë së arsimit në zonat fshatare kundrejt atyre qytetare po zgjerohet; familjet fshatare po përballen me vështirësi më të madhe në marrjen e një arsimit të mirë për të rinjtë. Mjaft mësues nuk kanë kualifikimin bazë dhe rrogat e tyre janë mjaft të ulta. Siç tregon tabela vijuese vetëm 25% dhe 28% e mësuesve të shkollës fillore përkatësisht në Tepelenë dhe Përmet, kanë diplomë universitare. Në rrethin e Gjirokastrës, vetëm pak më shumë se gjysma e mësuesve të shkollës fillore kanë diplomë universiteti. Gjithsesi, treguesit e kualifikimeve të mësuesve janë mjaft më të mirë për ata që japin mësim në shkollat e nivelit të dytë. Megjithëkëtë, meqenëse shumica e studentëve janë në shkollat fillore (dhe si shumë të tjerë nuk shkojnë më tej me shkollimin), ka rëndësi që në atë nivel, sikurse në të gjitha nivelet, mësuesit të kenë kredenciale të pranueshme.

Numri i mësuesve dhe kualifikimet e tyre⁸⁰

Rrethet	Numri i përgjithshëm në shkollat e nivelit I dhe II	Numri i mësuesve në nivelin I	Numri me diplomë të shkollës së mesme	numri me diplomë universiteti	Numri që punojnë në shkollë të mesme	Numri me shkollë të mesme	Numri me diplomë universiteti
Tepelenë	449	196	147 (75%)	49 (25%)	253	89 (35%)	164 (65%)
Përmet	356	155	111 (72%)	44 (28%)	201	40 (20%)	161 (80%)
Gjirkokastër	549	225	105 (47%)	120 (53%)	324	52 (16%)	272 (84%)
Qarku	1,354	576	363	213	778	181	597

Romët dhe arsimi

Varfëria, rëndësia e pakët që i jepet arsimit dhe diskriminimi janë faktorët madhorë që pengojnë romët për të vazhduar përtej arsimit fillor.

Raportohet se 64% e romëve në Shqipëri dhe që janë të moshës 7-20 vjeç nuk e kanë ndjekur kurrë shkollën. Për pasojë, 62% e romëve në vend janë

⁷⁶ Vlerësimi i kushteve social ekonomike në rrethet e Shqipërisë, UNICEF, 2000.

⁷⁷ Braktisja e shkollës: Shkaqe, rekomandime, Shoqata për Zhvillimin e Arsimit me mbështetjen e UNICEF, Tiranë, dhjetor 2001.

⁷⁸ Studim për braktisjen e fshehtë, Shoqata Arsimit për të gjithë, Tiranë,

dhjetor 2001.

⁷⁹ Financimi, efektshmëria dhe barazia në arsimin shqiptar, Banka Botërore, Tiranë 2000.

⁸⁰ Vlerësimi i kushteve social ekonomike në rrethet e Shqipërisë, UNICEF, 2000.

analfabetë, gjë që e bën më të vështirë për ta të kërkojnë punë. Në qarkun e Gjirokastrës 36% e romëve nga 7-20 vjeç janë analfabetë; kjo është

shkalla më e lartë e analfabetizmit e romëve në shkallë vendi, sipas qarqeve. Mesatarisht gratë dhe burrat romë kanë mbaruar vetëm 3,56 vite shkollim.

Shkalla e analfabetizmit dhe vitet e shkollimit për romët nga 7-20 vjeç, sipas rajonit⁸¹

Vendi	Analfabetizmi (%)	Numri i viteve shkollë të mbaruara
Shkodër	100	0
Fushë Krujë	97.9	3
Durrës	60.4	4.05
Tiranë	61.9	3.36
Elbasan	86.9	2.18
Fier	66.2	4.67
Vlorë	38.0	5.16
Berat	59.7	3.81
Korçë	41.7	3.78
Gjirokastrë	36.0	3.56
Sarandë/Delvinë	51.6	4.6
Gjithsej	62.2	4.02

Kostoja e librave dhe pajisjeve shkollore mund të jetë e papërballueshme. Më shumë se 67% e familjeve rome as nuk i përballojnë dot, pasi duhet të ushqejnë dhe të veshin fëmijët.⁸² Kujdesi për vëllezërit dhe motrat më të reja apo përfshirja në veprimtari ekonomike mund të kufizojë ndjekjen e shkollës. Edhe kur fëmijët romë shkojnë në shkollë, mjaft prej tyre janë të uritur, gjë që e bën të vështirë nxënien. Gjithashtu, kushtet e këqija familjare mund t'i pengojnë fëmijët në kryerjen e detyrave, dhe fatkeqësisht, mjaft prindër romë të paarsimuar nuk mund të ndihmojnë fëmijët e tyre kur ata u kërkojnë ndihmë.⁸³

Një tjetër pengesë është gjuha. Shumë romë që flasin gjuhën e tyre në shtëpi kanë pengesa të mëdha në të kuptuarit e mësimëve, dhe për shkak të diskriminimit. Vajzat dhe djemtë romë që luftojnë vitet e para shpesh përfundojnë duke hequr dorë nga shkolla. Edhe faktorë si largësia nga mjediset

shkollore ndikojnë tek familjet rome. Ngaqë shumë familje në qark migrojnë në Greqi gjatë stinës bujqësore (maj-tetor), fëmijët i largojnë nga shkolla dhe ata nuk mund të ndjekin shkollën jashtë shtetit, pasi ose janë në punë ose sepse migrimi i tyre është i përkohshëm. Mungesa e brendisë multikulturore të lëndëve mësimore i shtohet problemit të përjashtimit dhe diskriminimit. E vetmja gjë që mësohet është jeta shqiptare duke injoruar dhe neglizhuar si në mësimet edhe në libra çdo lloj historie të kulturave të pakicave. Mesatarisht, mësimi i 'çështjeve të pakicave' që lidhet me marrëdhëniet ndëretnike kufizohet në 2-3 orë mësimi në vit.⁸⁴

Zgjidhjet afatgjata janë të dyfishta. Duhet strategji për të nxitur qëndrimin e familjeve rome që e shohin arsimin si vlerë. Për më tepër, sistemi arsimor duhet t'u përgjigjet nevojave individuale të fëmijëve romë, duke njohur rrethanat ku jetojnë dhe duke përdorur përpjekjet e tyre më të mira për t'u dhënë atyre një dorë.

81 Hermine De Soto, Ilir Gedeshi, Sabine Beddies, & Daniel Perez, *Romët dhe evgjitet në Shqipëri: Nga përjashtimi social drejt përfshirjes sociale ose Dilema e Monedhës së Artë, Raporti I: Rekomandime dhe Implikime Politike, Banka Botërore, prill 2004.*

82 Hermine De Soto, Ilir Gedeshi, Sabine Beddies, & Daniel Perez, *Romët dhe evgjitet në Shqipëri: Nga përjashtimi social drejt përfshirjes sociale ose Dilema e Monedhës së Artë, Raporti I: Rekomandime dhe Implikime Politike, Banka Botërore, prill 2004.*

83 *Romët në Europën Lindore dhe Qendrore: Shmangia nga kurrthi i varësisë – Një Raport Rajonal për Zhvillimin Njerëzor, PNUD, dhjetor 2002.*

84 Hermine De Soto, Ilir Gedeshi, Sabine Beddies, & Daniel Perez, *Romët dhe evgjitet në Shqipëri: Nga përjashtimi social drejt përfshirjes sociale ose Dilema e Monedhës së Artë, Raporti I: Rekomandime dhe Implikime Politike, Banka Botërore, prill 2004.*

Shëndeti dhe Shërbimet Shëndetsore

Sektori i kujdesit shëndetsor në Shqipëri është pronë publike dhe sektori privat kufizohet kryesisht në shpërndarjen dhe tregtimin e barnave dhe në shërbimin dental. Ministria e Shëndetsisë është ofruesi kryesor i shërbimit, duke administruar kujdesin shëndetsor në gjithë qarkun dhe financohet kryesisht nga buxheti.⁸⁵

Objekti i sistemit të kujdesit shëndetsor në Shqipëri është të sigurojë mbulimin e plotë me fokus kryesor në kujdesin parësor shëndetsor. Ndonëse ka patur sukses përse i përket përmirësimit të jetëgjatësisë mesatare dhe pakësimit të nivelit të vdekshmërisë foshnjore dhe të fëmijës, politikat e fundit kanë dështuar në përmirësime të tjera të rëndësishme. Kjo vlen veçanërisht për më të shumtën e vendit që ende nuk kanë as kujdesin themelor.⁸⁶ Ndonëse cilësia dhe aksesin në shërbimet e kujdesit shëndetsor

janë tejet të rëndësishme, afro 80% e të pyeturve në një vëzhgim thanë që shëndeti i tyre ishte mesatarisht i mirë, por 41% besojnë që shëndeti i anëtarëve të familjes është përkeqësuar që nga viti 1990. Përkundër kësaj, vetëm 20% besonin që shëndeti në familje ishte mirësuar.⁸⁷


Shërbimet e kujdesit shëndetsor parësor janë kontakti i parë që banorët kanë me sistemin shëndetsor. Për pasojë, sistemi i kujdesit shëndetsor parësor duhet parë si shërbim social. Veç kësaj, pjesëmarrja e komunitetit është kyçe për përmirësimin e shëndetit dhe bashkëpunimi mes sektorit shëndetsor dhe sektorëve të tjerë që lidhen me të është jetike për të pasur akses në kujdesin shëndetsor për të gjithë njerëzit që jetojnë në qarkun e Gjirokastrës. Gjithsesi, ky themel i politikës, nuk duket në politikat rajonale të sektorit të shëndetit.

⁸⁵ Njësia e sektorit të Zhvillimit Njerëzor: Europa dhe rajoni i Azisë Qendrore, Shqipëria – Vlerësim i varfërisë, Vëll. 1 i 1, Banka Botërore, nëntor 2003.

⁸⁶ Raporti kombëtar i Zhvillimit Njerëzor, 2004.

⁸⁷ Punim Teknik nr. 520, Varfëria në Shqipëri: Vlerësim cilësor, Banka Botërore, 2002.

Numri Doktorëve sipas Qarqeve



WHO Statistika Shëndetsore, 2003 (online).

Specialisti i kujdesit shëndetsor & mjediset e kujdesit shëndetsor

Harta tregon që qarku i Gjirokastrës ka numrin më të vogël të mjekëve të përgjithshëm në vend. Aftësia e qarkut për të tërhequr dhe mbajtur mjekë është gjithnjë e më e vështirë. Mjekët migrojnë në zona ku kanë një numër më të madh pacientësh, infrastrukturë më të mirë dhe rroga më të larta. Përsëri, popullsia fshatare është ajo që vuan më shumë nga kjo rënie e numrit të mjekëve, aksesit dhe afërsia bëhet gjithnjë e më sfiduese.

Siç shihet në tabelë, ndërsa mesatarja për qarkun e Gjirokastrës është e lartë, përveç se për specialistët, krahasuar me pjesët e tjera të vendit, banorët e Gjirokastrës kanë ende nevojë të madhe për një numër më të madh personeli të kujdesit shëndetsor me përvojë në mënyrë që të arrijnë synimet e kujdesit të plotë parësor shëndetësor. Kjo vlen sidomos kur shohim se sa pak qendra shëndetësore dhe spitale ka në qark.

Personeli i Shërbimit Shëndetsor për 1,000 banorë⁸⁸

Rajoni	Rrethi	Specialistë	Infermierë	Dentistë	Farmacistë
Qendror	Berat	0.68	4.37	0.11	0.04
	Elbasan	0.55	3.74	0.11	0.04
	Gjirokastrë	1.14	6.19	0.19	0.07
	Korçë	0.89	4.53	0.15	0.05
	Shkodër	0.68	4.34	0.11	0.05
Bregdetar	Durrës	0.75	3.18	0.16	0.04
	Fier	0.52	2.85	0.10	0.03
	Lezhë	0.56	4.05	0.16	0.04
	Vlorë	1.00	4.62	0.16	0.06
Malor	Dibër	0.56	4.96	0.07	0.05
	Kukës	0.80	5.85	0.12	0.07
Tiranë	Tiranë	1.69	4.09	0.15	0.11

Mjekë, infermierë dhe qendra shëndetsore

Në qarkun e Gjirokastrës ka 58 mjekë, 214 infermiere dhe 42 qendra shëndetsore.⁸⁹ Sa i përket mjedisëve ka mangësi të mëdha. Spitalet, siç tregon harta vijuese, janë vetëm tre për një popullsi prej 166.788 vetash. Ka vetëm një spital për çdo rreth, të vendosur në qytetet e Gjirokastrës, Tepelenës dhe Përmetit. Meqë spitalet janë të vendosur në qendrat urbane ato nuk mund të ofrojnë akses për shumicën e banorëve të qarkut. Në spitalet e qarkut ka më pak se 370 shtretër, që arrin në numrin më të vogël të shtretërve në të

gjithë qarqet e vendit. Për pasojë, banorët duhet t'u drejtohen këtyre qendrave shëndetsore që janë vërtet të papërshtatshme. Ka 42 qendra për të gjithë qarkun dhe shpesh ato janë të papajisura.


Ndonëse gjendja është e tillë ka pasur rritje në sesione trainimi nga specialistë dhe në mjediset e laboratorëve dhe farmacive të spitaleve. Gjithashtu, saje punës së "Doktorë pa kufij", qendrat shëndetsore tashmë kanë njësi frigoriferike

88 Njësia e Sektorit të Zhvillimit Njerëzor: Europë dhe Rajoni i Azisë qendrore, Shqipëri – Vlerësimi i Varfërisë, Vëll. 1 i 1, Banka

Botërore, nëntor 2003.


89 Treguesit sipas Prefekturës: 2002-2003, INSTAT, 2004.

Numri Krevateve Spitalorë sipas Qarqeve



WHO Statistika Shëndetsore, 2003 (online).

Përfshirja e popullsisë në sistemin spitalorë



IINSTAT: REPOBA. 2001 dhe të Dhëna Administrative të LGP-Gjirokatrës

Shpenzimet për kujdes shëndetsor

Shpenzimet për kujdes shëndetsor janë pengesë serioze për mjaft familje në qarkun e Gjirokastrës që të perpiqen të kërkojnë ndihmë mjekësore për sëmundjet e fëmijëve, kujdes për të moshuarit dhe për veten e tyre. Tabela vijuese paraqet që banorët e rajonit qendror shpenzojnë shumën e dytë më të madhe në vend si për trajtim dhe për transportim nga dhe drejt mjedisve të kujdesit shëndetsor. Gjithsesi, barnat mbeten shpenzimi më i madh për njerëzit që kërkojnë kujdes për pacientët jashtë spitaleve. Po ashtu, banorët e qarkut renditen të tretët nga katër zonat gjeografike për sa i përket shumës që paguajnë si "dhuratë" kur përfitojnë kujdes për pacientin e pashtuar në spital; 128.5 USD në muaj për banorët qendrorë është një shumë thuajse katër herë më e lartë se shumata që paguajnë

banorët e Tiranës (që janë të katërtit), që paguajnë mesatarisht 32.2 USD në muaj.

Këto "dhurata" ose pagesa joformale janë pagesa jozyrtare që i bëhen një ofruesi të shërbimit i cili supozohet se i ofrohet pacientit pa pagesë. Ndonëse në disa vende europiane ka një praktikë të njohur sipas të cilës pacienti i ofron mjekut një dhuratë të pakërkuar prej këtij të fundit, ka prova të dukshme që tregojnë që pjesa më e madhe e pagesave janë jovullnetare dhe ose të pritura ose të kërkuara. Pagesat joformale mund të jenë një pengesë për aksesin në shërbimet e kujdesit shëndetsor dhe mund edhe të shformojnë përpjekjet e qeverisë për të përmirësuar barazinë dhe efektshmërinë në sistemin e kujdesit shëndetsor.⁹¹

Shpenzimet për kujdes shëndetsor për të pashtuarit sipas zonave⁹⁰

	Trajtim	Dhurata	Barna	Analiza Laboratori	Transportim	Gjithsej
	Pagesa mesatare mujore					
Bregdetare	263.2	227.1	1645.0	425.3	164.1	2728.7
Qendrore	437.7	128.5	1203.2	212.8	373.0	2353.1
Malore	527.6	200.3	1467.6	256.6	483.6	2928.1
Tiranë	166.0	32.2	970.6	214.0	11.7	1401.2
Gjithsej	360.9	163.2	1368.9	294.0	278.6	2465.8

Shkalla e lindjeve

Ndryshimet madhore politike, ekonomike dhe shoqërore të viteve 1990 ndikuan në nivelin e lindjeve. Për shembull, politikat dhe programet e planifikimit familjar, numri në rritje i aborteve pas legalizimit, shtyrja e moshës së martesës për vajzat (veçanërisht në zonat urbane), vështirësitë në sigurimin e mjeteve të jetesës dhe zgjedhjet njëfarësoj të kufizuara të grave në tregun e punës janë të gjithë faktorë që kontribuojnë në uljen e shkallës së lindjeve.⁹² Shkalla e lindjeve për frymë në qarkun e Gjirokastrës është e gjashta në vend me 19.36 lindje për 1,000 banorë. Ky tregues dëfton që ka një mungesë në qendra këshillimi, gjë që shihet edhe në tabelën vijuese. Ajo tregon për një nevojë për më shumë kujdes shëndetsor që merret veçanërisht me çështje të nënës dhe të fëmijës.

Shëndeti i foshnjës dhe i fëmijës

Mbrojtja dhe rritja e fëmijës është një nga shqetësimet më të

mëdha të qeverisë shqiptare dhe të organeve të pushtetit vendor. Si vajzat dhe djemtë, si qytetarë, gëzojnë jo vetëm të drejta të barabarta sipas kushtetutës shqiptare por edhe të drejta të veçanta të mbrojtura nga shteti. Kjo pasqyrohet qartë në komiza ligjore dhe programe qeveritare që lidhen me të njëjtë.⁹³ Pavarësisht nga këto, shkalla e vdekshmërisë për fëmijët deri në 5 vjeç në Shqipëri vazhdon të mbetet më e larta në Europë. Në vitin 2002, vdekshmëria foshnjore ishte 17.4 për 1,000 lindje ndërsa në vitin 2003 shkalla e vdekshmërisë ishte 16.8 vdekje për 1,000 lindje.⁹⁴

Sipas statistikave më të fundit të qarkut, vdekshmëria për fëmijët deri në 5 vjeç ishte 16,43 për 1.000 në rrethin e Gjirokastrës, 12.96 në Përmet dhe 15.72 në Tepelenë. Gjithsej, vdekshmëria foshnjore për qarkun e Gjirokastrës ishte 14.95⁹⁵ (në krahasim me mesataren kombëtare prej 33 për 1,000 në vitin 2000⁹⁶). Meqë ky informacion është pak i vjetër, është e domosdoshme që qarku të ndërmarrë një raund të ri të mbledhjes së të dhënave. Ministria e

90 Njësia e sektorit të Zhvillimit Njerëzor: *Europa dhe rajoni i Arzisë Qendrore, Shqipëria – Vlerësim i vlefshëm, Vëll. 1 i 1, Banka Botërore, nëntor 2003.*

91 Raporti kombëtar i Zhvillimit Njerëzor, 2004.

92 Punim Teknik nr. 520, *Vlefshëria në Shqipëri: Vlerësim cilësor, Banka Botërore, 2002.*

93 Njësia e Sektorit të Zhvillimit Njerëzor: *Europa dhe Rajoni i Arzisë qendrore,*

Shqipëri – Vlerësimi i Vlefshëm, Vëll. 1 i 1, Banka Botërore, nëntor 2003.

94 Raporti i eamisë 2003 për Vënieën në jetë të Strategjisë kombëtare për zhvillimin Social-ekonomik, Këshilli i Ministrave, Tiranë 2004.

95 Vlerësim i kushteve Socioekonomike në rrethet e Shqipërisë, UNICEF, 2000.

96 Përgjigja Shqiptare për OZHM-fë, Qendra për Fuqizimin e Zhvillimit njerëzor, Tiranë, maj 2002.

Shëndetsisë dhe Instituti i Shëndetit Publik citojnë si arsye kryesore të vdekshmërisë së lartë sëmundjet e frymëmarrjes, anomalitë e lindjes, diarenë dhe sëmundjet infektive. Nga këto, sëmundjet e frymëmarrjes renditen të parat.⁹⁷ Disa nga këto lloj sëmundjesh lidhen drejtpërdrejt me kushtet e vështira të jetesës që kanë si veçori kequshqyerjen, aksesin e keq në shërbime, trajtimet e papërshtatshme dhe mungesën e mjediseve të urgjencës. Produkt i kësaj është që shkalla e lartë e vdekshmërisë së foshnjës dhe fëmijës lidhen ngushtë me tregues të tjerë të varfërisë.

Shkalla e lartë e vdekshmërisë në zonat fshatare varet nga aksesin konkret në shërbime të kujdesit shëndetsor, kushtet e përgjithshme të jetesës, kostoja e kujdesit (që mund të jetë e lartë si pasojë e “dhuratave” ose pagesave joformale), niveli i efektshmërisë së shërbimeve shëndetsore që pasohen me mungesë të pajisjeve mjekësore dhe teknikave të përshtatshme për trajtim mjekësor dhe niveli arsimor i nënave, që pasqyrohet veçanërisht tek kequshqyerja e foshnjës. Në zonat fshatare, niveli i vdekshmërisë foshnjore priret të jetë më i lartë për shkak të mungesës së aksesit në shërbimet e kujdesit intensiv shëndetsor dhe mungesa e informimit të përhapur në popullsi në lidhje me çështje shëndetsore, duke përfshirë shëndetin e riprodhimit, planifikimin familjar dhe kujdesin për fëmijën.⁹⁸

Standardet e shumicës së qendrave shëndetsore në funksionim në qarkun e Gjirokastrës janë të ulta, sidomos për shërbimet për nënën dhe fëmijën. Një krahasim i numrit total të fshatrave në qark tregon që 60% janë pa shërbime këshillimi të kujdesit shëndetsor për nënën dhe fëmijën.⁹⁹ Për më tepër, klinikat pa shtretër, aty ku ekzistojnë, shpesh nuk kanë pajisjet e nevojshme për të administruar siç duhet kujdesin shëndetsor.¹⁰⁰ Mes viteve 1990-2000, afro 61% e gjithë bebeve 3 muajshe në Shqipëri ushqeheshin me gj. Krahasuar me mesataren europiane prej 60.33%, kjo statistikë është vërtet premtuese. Futja, në vitin 1990, e qumështit industrial, ndikoi në numrin e nënave që vendosnin të mos ushqenin me gj. Për të kundërshtuar këtë prije, UNICEF-i mbështeti një program kombëtar për të nxitur ushqyerjen me gj nëpërmjet trainimit të personelit shëndetsor në edukimin e shëndetit mëmësor.¹⁰¹ Në qarkun e

Gjirokastrës, ushqyerja me gj ende sundon mbi qumështin artificial, gjithsesi, rëndësia e vazhdimin të këtyre fushatave nuk mund të mbitheksohet.¹⁰²

Shëndeti i nënës

Ndonëse gratë në Shqipëri janë 50.1% e popullsisë, mjaft aspekte të barazisë gjinore duke përfshirë çështjet shëndetsore mbeten për tu njohur dhe trajtuar. Vdekshmëria e nënës në Shqipëri në vitin 2000 ishte 50% më e ulët se në vitin 1990, por krahasuar me vende të tjera Europiane mbetet e lartë (21.3 vdekje për 100,000 lindje në 2003).¹⁰³ Të dhënat specifike për shkallën e vdekshmërisë së nënës në qarkun e Gjirokastrës janë të pabesueshme dhe kësajsoj nevojitet mbledhje e të dhënave për të bërë një analizë gjithëpërfshirëse. Që nga viti 1990 për shkak të mungesës së statistikave për qarqet në veçanti ndryshimet në vdekshmërinë e nënës ende nuk kanë gjetur shpjegim të saktë. Meqë sistemi shqiptar i raportimit regjistron vetëm vdekje që ndodhin gjatë lindjes dhe abortimit, ka shumë gjasa që aborti, hemorragjia, epilepsia, ndërlikimet nga anestezia dhe infeksionet të mos jenë shkaqet e vetme të vdekshmërisë së nënës.¹⁰⁴

Meqë shkalla e vdekshmërisë së nënës mbetet e lartë megjithë zbritjet e fundit, rreziku më i madh është gjatë shtatëzanisë, gjatë lindjes dhe pas saj. Vitet e fundit kanë treguar akses më të pakët në shërbimet gjinekologjike dhe lindjet e ndihmuara, çka prek negativisht në vdekshmërinë e nënës. Përqindja e vizitave gjatë shtatëzanisë ka rënë me 5.1% për periudhën 1990-2001. Vizitat periodike të grave shtatzana tek personeli i specializuar mjekësor mbeten të ulta. Mesatarisht, vetëm 18% e grave bëjnë vizitën e parë gjatë tremujorit të parë të shtatëzanisë. 45% i bëjnë vizitat në tremujorin e dytë, ndërsa një përqindje e lartë prej 37% vizitohen për së pari gjatë tremujave të fundit.¹⁰⁵

93% e lindjeve bëhen në mjedise të shëndetit, ndërsa 7% në shtëpi. Nga grupi i fundit, personeli i aftë mjekësor e ndjek lindjen gjatë 6.2% të tyre ndërsa 0.8% nuk marrin fare ndihmë mjekësore. Lindja në shtëpi mund t'i atribuohet aksesit të ulët dhe cilësisë së ulët të shërbimeve shëndetsore,

97 Shqyrtim i Shqipërisë në funddekadë, UNICEF, Tiranë 2000.

98 Kultura e familjes: Evolucionit dhe Problemet, Komiteti “Gruaja dhe familja”, Tiranë 2002.

99 Raporti kombëtar i Shqipërisë: Në progres drejt arritjes së OZHM-ve, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Departamenti i SKZbShE-së në Ministrinë e Financave, Shqipëri 2004.

100 Regjistri Statistikor i Rretheve, Këshilli i Qarkut, 2003.

101 Raporti Kombëtar i Shqipërisë: Në progres drejt arritjes së OZHM-ve, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Departamenti i

SKZbShE-së në Ministrinë e Financave, Shqipëri 2004.

102 Regjistri Statistikor i Rretheve, Këshilli i Qarkut, 2003.

103 Raporti Kombëtar i Shqipërisë: Në progres drejt arritjes së OZHM-ve, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Departamenti i SKZbShE-së në Ministrinë e Financave, Shqipëri 2004.

104 Raporti kombëtar i Zhvillimit Njerëzor, 2004.

105 Raporti Kombëtar i Shqipërisë: Në progres drejt arritjes së OZHM-ve, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Departamenti i SKZbShE-së në Ministrinë e Financave, Shqipëri 2004.

mungesave në stafin mjekësor, veçanërisht e mamive në fshatra, dëshirës për të lindur në shtëpi (e ndikuar nga bindjet) dhe infrastruktura e varfër e pavioneve të materniteteve, të cilat kanë mungesa uji, ngrohjeje dhe energjie.¹⁰⁶ Faktorë të tjerë që ndikojnë në vdekshmërinë e nënës janë kushtet e higjienës para shtatzanisë, ndërlikimet gjatë barrës dhe lindjes dhe mungesa e personelit shëndetësor të trajnuar dhe të motivuar sidomos në zonat fshatare. Vlen të përmendet gjithashtu që mbledhja dhe përhapja e informacionit për kujdesin shëndetësor, bashkë me edukimin e grave për të ruajtur shëndetin e tyre dhe të të sapolindurve është minimal ose inekzistent në qark. Ajo që duket në fakt është mungesa e të dhënave të sakta që lidhen me vdekshmërinë e nënës në të treja rrethet.

Abortet

Legalizimi i aborteve u ka dhënë grave shqiptare një mundësi për të rritur kontrollin e tyre mbi trupin dhe jetën. Ashtu sikurse shifrat rajonale mbi vdekshmërinë gjatë lindjes janë të cinguara e njëjta gjë mund të thuhet për abortet. Si pasojë, duhet të ndermerret një fushatë për mbledhjen e të dhënave së bashku me plotësimin e statistikave mbi përdorimin e kontraktivëve dhe përdorimin e metodave të planifikimit familjar. Është më se i njohur fakti, që gratë në nivel kombëtar tentojnë të abortojnë si rezultat i varfërisë, papunësisë dhe arsyeve shëndetsore. Disa gra duan të kufizojnë numrin e fëmijëve dhe si mënyrë të zakonshme të planifikimit familjar ato përdorin abortin.¹⁰⁷ Një tjetër faktor që mund të ndikojë në shkallën e abortit është dhe gjinia e fëmijës që pritet të lindë. Familjet shqiptare historikisht kanë përparësi për meshkuj, kundrejt femrave, pasi mashkulli tejçon emrin e familjes dhe bëhet krahë për familjen në plotësimin e anës financiare. Megjithatë, meqë Ministria e Shëndetësisë nuk ka grumbulluar të dhëna mbi vdekshmërinë foshnjore sipas gjinisë, mbetet enigmë nëse kjo traditë kulturore ka të bëjë me shkallën e lartë të vdekshmërisë foshnjore tek femrat.¹⁰⁸ Reduktimi i aborteve ilegale dhe një rritje e përdorimit të kontraktivëve mund të ndikojë në uljen e shkallës së vdekshmërisë gjatë lindjes. Si pasojë, aborti ka patur një rënie prej 24% ndërmjet viteve 1990-1999,

megjithëse numri i procedurave që kërkohet të kryhen është i lartë. Kërkimet e bëra nga Ministria e Shëndetësisë tregojnë që në 1990 rreth 50% a vdekjeve gjatë lindjes janë shkaktuar si rrjedhojë e aborteve ilegale. Për më tepër, përdorimi i kontraktivëve ka një varësi të drejtëpërdrejtë pozitive me uljen e rasteve të vdekshmërisë gjatë lindjes në Shqipëri.¹⁰⁹

Imunizimi

Qeveria Shqiptare ka bërë përpjekje të mëdha për të përmirësuar vaksinimin e fëmijëve në të gjithë vendin. Programi i Imunizimit, i shtrirë në vite, ka rezultuar i suksesshëm për përballimin dhe menaxhimin e strategjisë së vaksinimit. Së fundi janë futur si të detyrueshme imunizimi ndaj Fruthit, Diftentit, Tetanozit, Tuberkulozit, Poliomyelitit, Hepatitit B dhe Rubeolës. Si pasojë, ka një nivel të lartë imunizimi në vend, duke kapur shifrën mbi 95%, gjë që ka kontribuar mjaft në uljen e vdekshmërisë foshnjore të shkaktuar nga sëmundje të ndryshme infektive. Pavarësisht këtyre, statistikave mbi shkallën e imunizimit në qarkun e Gjirokastrës mbeten jo të besueshme, dhe si të tilla duhet të bëhen përpjekje për regjistrimin e këtyre shifrave në interes të promovimit të shëndetit.¹¹⁰

Shërbimi Dentar

Shërbimi dentar shpesh përbën një aspekt të shëndetit që neglizhohet, duke rezultuar në një higjenë të ulët të gojës, prishje të gradëve të rënda, rënie dhëmbësh dhe sëmundje. Tepër e rëndësishme është nxitja e prindërve për të përçuar kujdesin e gojës tek fëmijët e tyre dhe t'i mësojnë ata për rëndësinë e mirëmbajtjes së dhëmbëve. Kjo gjithësesi, nuk do të jetë kurrë prioritet nëse aksesimi për shërbim dentar është i paarrtshëm për shumicën e banorëve. Qarku i Gjirokastrës ka tepër nevojë për dentistë dhe higjienistë dentar specialistë pranë qendrave të banuara. Në qytetin e Gjirokastrës ka rreth 4 dentistë shtetëror dhe 6 dentistë privat. Gjithashtu ka 2 dentistë në Dropullin e poshtëm. Të 12 dentistët për qarkun e Gjirokastrës ndodhen në rrethin e Gjirokastrës dhe shumë larg nga zonat fshatare apo rrethet e tjera si Tepelena dhe Përmeti.

106 Raporti i ecurisë 2003 për Vënie në Jetë të Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin Social-ekonomik, Këshilli i Ministrave, Tiranë 2004.

107 Raporti Kombëtar i Zhvillimit Njerëzor, 2004.

108 Përgjigja shqiptare për OZHM-të, Qendra për Forcimin e Zhvillimit Njerëzor, Tiranë, maj 2002.

109 Raporti Kombëtar i Shqipërisë: Në progres drejt arritjes së OZHM-ve, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Departamenti i SKZbShE-së në Ministrinë e Financave, Shqipëri 2004.

110 Përgjigja shqiptare për OZHM-të, Qendra për Forcimin e Zhvillimit Njerëzor, Tiranë, maj 2002.

HIV/SIDA

Ndërsa në nivel qarku nuk ka të dhëna mbi përhapjen e HIV/AIDS, në nivel vendi njihen së paku 72 raste të infektuar me HIV dhe 15 raste me SIDA. Në tërësi, rreth 90% e popullsisë së prekur është e moshës 20-35 vjeç. Meqenëse përqindja e të infektuarve është më

pak se 0,1% e popullsisë, Shqipëria ende renditet ndër vendet me nivel tepër të ulët të HIV/SIDA. Gjithsesi, vihen re rritje të shkallës së të infektuarve pasi në vitin 2001 kishte 5 herë më shumë të infektuar sesa të dhënat e raportuara në 1999.¹¹¹

Përhapja e HIV/SIDA¹¹²

	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999	2000	2001	Gjithsej
HIV	-	2	9	12	7	3	5	4	10	20	72
SIDA	-	-	1	4	3	2	1	-	4	-	15

Kështu, megjithëse rastet e dokumentuara të sëmundjeve seksualisht të transmetueshme janë të ulta, vendi konsiderohet me shumë risk për këto infeksione për shkak të numrit të madh të popullatës së re rritjes së migrimit dhe të niveleve të emigracionit, përshkallëzimit të prostitucionit dhe mungesës së shpërndarjes së informacionit për HIV/SIDA. Për sa i takon, transmetimit, mënyra më e përhapur, në 90% të rasteve, është ajo me anë të marrëdhënieve seksuale (heteroseksuale dhe homoseksuale). Po ashtu, HIV/SIDA po zhvillohet me shpejtësi në pjesën e lëvizshme të popullsisë, ku 80% e tyre e kanë marrë virusin jashtë vendit si emigrantë.¹¹³ Partnerët apo gratë e punëtorëve migrantë janë të riskuar të infektuar për shkak të mungesës së ndërgjegjësimit midis punëtorëve migrant mbi sëmundjet seksualisht të transmetueshme dhe metodave moderne të kontraceptivëve. Gjithsesi, për shkak të çekuilibrimit tradicional të marrëdhënieve mashkull-femër ka ende një paaftësi të partnereve apo grave për të negociuar për seks të sigurtë.

HIV/SIDA nuk është vetëm një problem shëndetsor por edhe çështje gjinore. Studimet tregojnë që gratë dhe vajzat preken në mënyrë jo të barabartë, pasi ato janë shumë më të ndjeshme ndaj epidemive biologjike, sociale dhe ekonomike. Po ashtu vihet re një feminizim i epidemisë në Shqipëri pasi gratë përfaqësojnë 24% të rasteve të HIV/SIDA në 2003 krahasuar me 19% në vitin 2002.¹¹⁴ Vajzat dhe gratë janë sidomos të ndjeshme ndaj sëmundjeve seksualisht të transmetueshme përfshirë infektimin me HIV për shkak të pabarazisë gjinore në shoqërinë shqiptare që e bën më të vështirë për to të refuzojnë seksin e

padëshiruar dhe jo të sigurtë. Faktorë ndihmës për shqiptarët në gjendje 'vështirësie', përfshijnë një kuadër rregullues jo të efektshëm për ta parandaluar dhe trajtuar, metoda të varfra të mbledhjes së informacionit dhe fakti që lehtësitë e kujdesit shëndetsor për të trajtuar këto tipe infeksionesh janë të pakta. Për pasojë, burrat dhe gratë në qarkun e Gjirokastrës janë veçanërisht riskuar për shkak migrimeve që zakonisht përfshijnë udhëtimet jashtë për qëllime punësimi.

Dhuna ndaj grave

Një dukuri jo e pëlqyeshme dhe e pamëshirshme e hasur shpesh në shoqërinë shqiptare është dhuna me bazë gjinore. Dhuna gjinore përfshin abuzim fizik, psikologjik ose emocional si, fyerje dhe përdorim i gjuhës fyese, dhunë seksuale, izolim social i detyruar dhe abuzim ekonomik kur abuzuesi kontrollon burimet e viktimit. Dhuna në familje është problem shoqëror dhe kur ndodh brenda familjes mund të analizohet në pikëvështrime: faktorët botërorë dhe faktorët e brendshëm rrethorë. Për shembull, në kontekstin shqiptar, varfëria, papunësia, pabarazia gjinore dhe abuzimi me alkolin priren të rëndojnë dhunën familjare. Në shumicën e rasteve, format e ndryshme të dhunës shkaktohen njëherësh duke e bërë kështu gjendjen e viktimave më brutale. Disa nga këta faktorë përfshijnë traditën dhe mendësinë kulturore që e vendosin gruan në pozita mjaft inferiore. Po ashtu kuadri ligjor ka mjaft të meta serioze në mbrojtjen e gruas brenda shtëpisë dhe të grave pa shtëpi, si dhe probleme të rënda me zbatimin e ligjit ekzistues. Kushtet e vështira ekonomike dhe sociale të familjeve shqiptare, dhe veçanërisht të gruas, që i shtohen periudhës së vështirë të tranzicionit ka shkaktuar mungesë dëshire dhe

¹¹¹ Raporti Kombëtar i Shqipërisë: Në progres drejt arritjes së OZHM-ve, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Departamenti i SKZhSbE-së së Ministrisë së Financave, Shqipëri 2004.

¹¹² Përgjigjia shqiptare për OZHM-të, Qendra për Forcimin e

Zhvillimit Njerëzor, Tiranë, maj 2002.

¹¹³ Përgjigjia shqiptare për OZHM-të, Qendra për Forcimin e

Zhvillimit Njerëzor, Tiranë, maj 2002.

¹¹⁴ Instituti i Shëndetit Publik, Tiranë, 2004.

stresi i lartë acarojnë dhunën gjinore. Edhe mënyra e ndryshme e socializimit të meshkujve dhe femrave dhe imazhi stereotip i gruas i përforcuar nga media luan një rol në përshkallëzimin e dhunës ndaj gruas.¹¹⁵

Megjithëse vitet e fundit nuk ka statistika mbi raste të dhunës në familje, ka një sërë rastesh që flasin për prani të dhunës në familje dhe faktorët shkakësor specifik. Për shembull, në një studim të UNICEF-it, 19 gra nga 55 të pyetura (33%) ishin objekt si i dhunës fizike edhe seksuale.¹¹⁶ Gjithashtu, shqyrtimi i statistikave penale për kohën 1990-1998 nxjerr në pah që mjaft vepra të rënda penale kishin akte dhune fizike të ushtruara ndaj grave dhe që mund të shkaktonin, ose shkaktuan humbjen e jetës.¹¹⁷ Dhuna ekonomike është një formë tjetër abuzimi ku gratë janë viktimat kryesore. Tradicionalisht burrat kanë kontrolluar të ardhurat financiare familjare dhe kanë sunduar në vendimmarrjen financiare. Praktika të tilla në mjaft raste krijojnë mendësinë që pasuria u takon burrave dhe që gratë nuk mund të gëzojnë të njëjtën të drejtë mbi pronësinë pavarësisht se ajo njihet me ligj. Kjo i vë të drejtat themelore të grave në rrezik pasi në zona fshatare kjo mendësi u mohon grave të drejtën e pronësisë.¹¹⁸ Dhuna kundër grave mund të ndodhë edhe në vendet e punës dhe ndonëse shpesh herë nuk raportohet ajo ekziston në të gjitha format. Mosveprimi i grave dhe vajzave për të denoncuar këtë lloj dhune rrjedh drejtpërdrejt nga frika e humbjes së punës.¹¹⁹ Dhuna ndaj grave zakonisht kryhet në mjedisë familjare, veçanërisht në vetë shtëpinë e të abuzuarit. Abuzuesit janë përgjithësisht njerëz që i njohin viktimat ose që jetojnë nën një kulm me to. Baballarët dhe vëllezërit janë dhe dhunuesit më të këqinj pasi ata ushtrojnë masën më të madhe të dhunës ndaj anëtarëve të familjes.¹²⁰

Romët dhe shëndeti

Monitorimi i gjendjes shëndetësore të romëve është një tjetër fushë që preket negativisht nga mungesa e statistikave. Pavarësisht kësaj, nuk gabojmë kur themi që fëmijët romë përbëjnë një grup mjaft në rrezik. Shëndeti i grave është një tjetër pikë shqetësuese pasi ky problem pasqyron si faktorët shoqëror ekonomik (varfëria, ushqyerja e papërshtatshme, mungesë aksesi në shërbimet shëndetësore) ashtu edhe

çështjet kulturore (arsim i pakët, martesat e hershme, lindje në moshtë të re).¹²⁰ Vetëvlerësimet konfirmojnë që romët vuajnë nga shëndeti në përkeqësim dhe që rreth 25% e tyre nuk kanë mjete për të përballuar barna ose për të paguar trajtimin jashtë spitalor. Mungesa e shërbimeve shëndetësore në zonat fshatare e rrit cënueshmërinë e tyre qyshse mjaft romë jetojnë në zona të largëta. Gjithsesi, shpesh diskriminimi nga stafi mjekësor tregohet si shkak kryesor për mungesën e aksesit në këtë shërbim pasi specialistët priren të kërkojnë me ngulm të holla ekstra për këshillimet. Një çështje tjetër po aq serioze për shëndetin e romëve ka të bëjë me moskërkimin e trajtimit që rrjedh nga mungesa e vetëdijes që disa kushte mjekësore kërkojnë trajtim.

Në lidhje me gjininë, traditat rome e shohin femrën si nënë dhe grua, gjë që çon drejt martesave dhe lindjeve të hershme. Shumë pak gra marrin training mbi planifikimin familjar dhe kështu kontrolli i lindjeve është një gjë tepër e rallë (vetëm 10% e tyre). Mosbesimi i përgjithshëm, mungesa e njohurive për metodat dhe refuzimi i përgjithshëm i burrave për të përdorur kontrceptivë janë arsye të përsëritshme praktikave të kontrollit të lindjeve përdoren mjaft pak. Në mënyrë të ngjashme gratë duhet të luajnë rolin e tyre në ndërprerjen e shtatzanive të padëshiruara nëpërmjet abortit. Shkalla e abortit në popullsinë rome është mjaft e lartë. Vetëvlerësimet nxjerrin në pah që 56% e grave rome kanë abortuar 1 herë dhe 77% dy ose më shumë. Befasuesë është gjetja që, megjithëse doktorët ndjekin shumicën e aborteve rreth 17% e romëve e bëjnë vetë abortin.¹²² Për më tepër, për shkak të rrethanave të vështira social-ekonomike, romët janë të ekspozuar ndaj hepatit B dhe C, sëmundjeve seksualisht të transmetueshme dhe HIV/SIDA. Varfëria dhe diskriminimi i shtynë romët të kërkojnë mundësi për gjenim parash në ekonominë e zezë, ku një numër në rritje i grave dhe burrave romë (ose me dëshirë apo të shtyrë nga shfrytëzimi) i hyjnë bizneseve dhe aktiviteteve të rrezikshme të HIV/SIDA, duke përfshirë trafikim dhe përdorim droge, dhe seks me pagesë. Ndërsa të dhënat e pamjaftueshme për çështjet shëndetësore e kufizojnë daljen në përfundime të sakta, mbetet e qartë që gjendja shëndetësore e romëve është mjaft më e rëndë se ajo e shumicës së popullsisë.¹²³

115 Studim për kontributin e shkruar të lëvizjes së grave në Shqipëri: 1990 – 1998, Qendra e Gruas, Tiranë 2000.

116 Raporti kombëtar i Zhvillimit Njerëzor, 2004.

117 Mbi dhunën e ushtruar ndaj grave, Shoqata e grave juriste, Ambasada Amerikane në Shqipëri, Tiranë 2000.

118 Mbi dhunën e ushtruar ndaj grave, Shoqata e grave juriste, Ambasada Amerikane në Shqipëri, Tiranë 2000.

119 Raporti Kombëtar i Zhvillimit Njerëzor, 2004.

120 Raporti Kombëtar i Zhvillimit Njerëzor, 2004.

121 Romët në Europën qendrore dhe lindore: Shmangia e kurrthit të varësisë – Raport rajonal i zhvillimit njerëzor, PNUD, dhjetor 2002.

122 Hermine De Soto, Ilir Gedeshi, Sabine Beddies, & Daniel Perez: Romët dhe evgjitet në Shqipëri: Nga përjashtimi në përfshirjen sociale ose Dilema e Monedhës së Artë, Raporti I: Rekomandime dhe Implikime Politike, Banka Botërore, prill 2004.

123 Romët në Europën qendrore dhe lindore: Shmangia e kurrthit të varësisë – Raport rajonal i zhvillimit njerëzor, PNUD, dhjetor 2002.

Bujqësia

Bujqësia është sektori më i madh i ekonomisë së Shqipërisë dhe zë një raport shumë të madh të fuqisë prodhuese të Shqipërisë, duke prodhuar 50-55% të GDP kombëtare. Pavarësisht nga pjesa aktuale e GDP që zë, toka është një rrjet shumë i rëndësishëm sigurie për vetë faktin se pronarët e tokave të cilët nuk kanë burime të konsiderueshme të ardhurash varen nga prodhimi bujqësor për të plotësuar nevojat e tyre të ekzistencës.¹²⁴ Ka pasur një rënie masive të prodhimit si rrjedhojë e trazirave të viteve të pas-komunizmit. Kontrolli dhe subvencionet e shtetit u pakësuan dhe ka pasur një braktisje dhe shkatërrim masiv të sistemeve të ujitjes, zvogëlim të sasisë së lëndëve të para, dhe një disintegrim virtual të marketingut dhe industrisë së përpunimit bujqësor. Politikat e bazuara në liberalizim shkaktuan shkatërrimin e 550 fermave shtetërore dhe kolektive, dhe deri në vitin 1994 u privatizua 94% e tokës bujqësore. Ndërsa ky sistem mund të ketë penguar ndonjë rritje të mundshme të prodhimit, dhënia e parcelave të vogla të tokës shërbeu për t'i siguruar popullsisë fshatare një formë të rëndësishme të sigurisë sociale.¹²⁵ Së fundmi, ka pasur një zgjerim të sektorit bujqësor, megjithatë, pothuajse gjysma e pronarëve të tokave nuk e shesin prodhimin në treg dhe shumë prej tyre i përdorin fermat e tyre për jetesë, që siguron një burim të konsiderueshëm të sigurimit të ushqimit ditor të familjeve rurale. Shumica a tyre nuk kanë tokë të mjaftueshme për të siguruar ushqim të mjaftueshëm ose varietet dhe pjesa më e madhe përdorin një seri në sasi të vogëla të të lashtave dhe produkteve kryesore si vakte të tyre. Në mënyrë të ngjashme parcelat e tokës që familjet fermere kanë në pronësi, janë zakonisht shumë pak hektarë për të prodhuar për konsum familjar dhe për më tepër për të siguruar mbiprodhim për ta shitur në treg. Fatkeqësisht, disa pronarë tokash

thjesht e kanë lënë tokën e tyre djerr.¹²⁶

Bujqësia është një sektor kyç në ekonominë shqiptare, ku gratë luajnë një rol kryesor. Zhdukja e kooperativave çoi në rritje të papunësisë femërore në zonat rurale. Si rrjedhojë, gratë e zonave rurale iu kthyen sferës së punëve shtëpiake dhe u kthyen në marrëse pasive të parave të dërguara, që përforcon nocionet kulturalisht të përcaktuara të roleve të mashkullit dhe femrës.¹²⁷ Në programet bujqësore roli produktiv i grave nuk duhet të anashkalohet. Është e rëndësishme t'i kushtohet vëmendje perspektivave të gjinive për të identifikuar rolet e grave dhe burrave, dhe për të fituar një kuptim më të mirë të përdorimit të burimeve bujqësore si nga gratë ashtu edhe nga burrat. Për të nxitur zhvillimin e barabartë dhe të qëndrueshëm në bujqësi, një përafrim i balancuar i gjinive është kritik për të siguruar akses të barabartë tek toka, veglat dhe krediti.

Qarku i Gjirokastrës përfaqëson një shembull për të ardhur keq të nënpërdorimit dhe menaxhimit të gabuar të burimeve bujqësore. Për më tepër, progresi i bujqësisë në qark është lënduar nga pengesa të panumërta, të cilat të llogaritura së bashku kanë shkaktuar mungesa serioze të zhvillimit të këtij sektori vital. Disa prej këtyre pengesave përfshijnë:

- infrastrukturën e varfër, veçanërisht transporti, rrjeti i kullimit dhe vaditjes;
- organizimin minimal të tregut bujqësor;
- ndarjen e tokës bujqësore në ndarje ekstremisht të vogla dhe inefficente;
- mungesën e makinerive bujqësore;
- kostot e larta të prokurimit, duke përfshirë farat, plehërat dhe pesticidet;

124 Dokument Teknik Nr. 520, *Varfëria në Shqipëri: Një Vlerësim Cilësor*, Banka Botërore, 2002.

125 *Raport i Zhvillimit Kombëtar Njerëzor*, 2004.

126 *Njësia e Sektorit të Zhvillimit të Njerëzimit: Rajoni i Europës dhe*

Azissë Qendrore, Shqipëri – Vlerësimi i Varfërisë, Vol. 1 nga 1, Banka Botërore, Nëntor 2003.

127 *Gjermani e, Perci Z., etj., Raport mbi Gjininë dhe Bujqësinë, 2003.*

- teknologjinë përpunuese të vjetëruar;
- skemat nominale të kreditimit; dhe
- pasigune sociale të viteve parardhëse

Toka

Shpërndarja relativisht e barabartë e tokës familjeve fshatare në vitet 1990 rezultoi në një fragmentim të pronave. Sikurse është vënë re, ngastrat e tokës janë zakonisht shumë të vogla dhe shpesh shumë larg nga shtëpitë. Disa ngastrat janë të një cilësie të ulët për qëllime bujqësore dhe të tjera janë braktisur prej familjeve të cilat kanë emigruar. Aktualisht, po ndodh, por shumë ngadalë, procesi i konsolidimit të ngastrave të tokës të vogla, të veçuara në fusha bujqësore më produktive. Nëse ky proces nuk stimulohet dhe inkurajohet më plotësisht, dimensionet mesatare të këtyre ngastrave (1.26 hektarë për familje në qark) tregojnë se ka për të pasur shumë pak hapësirë për zgjerimin e operacioneve bujqësore.¹²⁸

Përsa i përket reformave të tokës, qarku ka parë një progres të vogël në plotësimin e regjistrimit të tokës apo në marrjen e vendimeve të plota dhe finale për ndarje të tokës siç duhet. Kjo është provuar pjesërisht nga numri më i vogël i certifikatave të pronësisë të lëshuara nga qarku në krahasim me numrin më të madh të familjeve të cilave u ishin dhënë parcela toke në të treja krahinat (shiko tabelën poshtë). Domethënia e këtij deficiti nuk mund të mbivlerësohet sepse individët mund ta përdorin tokën si një aset vetëm pasi të ketë mbaruar regjistrimi i tokës. Për shembull, një pronar toke,

duke ndjekur procedurat e duhura të regjistrimit të tokës do të jenë në gjendje të japin me qera pjesën e tij apo të saj të pronës dhe si rrjedhim të rrisin aktivitetin ekonomik me të cilin merren me qëllim që të gjenerojnë fitim. Meqë toka është mjete themelor i prodhimit për qarkun, zgjidhja e konflikteve të pronësisë së tokës është faza e parë në procesin e modernizimit të sektorit të bujqësisë.

Koordinimi i një projekti të regjistrimit të tokës i ndarë sipas bashkive, do të vepronte si një hap thelbësor për zgjidhjen e këtyre konflikteve në komuna dhe do të çonte në çlirimin e tokës së punëshme që për momentin është lënë djerrë ose nuk është përdorur plotësisht. Vezhgimi dhe plotësimi i regjistrimit të tokës do t'i jepte fermerëve garancinë që u duhet për të rritur aktivitetin e tyre ekonomik, rritur të ardhurat e familjes, dhe për të rritur standartet e jetesës, në të njëjtën kohë u jep sigurinë dhe garancinë e të drejtave të pronave dhe të drejtën në të ardhmen.

Përsa i përket shpërndarjes së tokës brenda qarkut, lidhur me ndarjen ndërmejt bashkive, Gjirokastra ka shumicën e hektarëve, e ndjekur nga Përmeti, dhe pas saj nga Tepelena. Në përfundim të ndarjes së tokës nga shteti, përmasat e popullsisë rurale imponuan që banorët e Gjirokastrës të merrnin shumicën e tokës, ndjekur nga Tepelena dhe pas saj Përmeti. Mesatarisht familjet rurale përfituan 1.26 hektarë toke secila, por familjet e të dyja bashkive, Gjirokastrës dhe Përmetit, morën ngastrat më të mëdha se sa familjet në Tepelenë.


Përbërja Territoriale¹²⁹

Bashkia	Hektarë Toke	Hektarë Toke Bujqësore	Hektarë të Tokës së Ndarë	Numri i Familjeve që Morën Tokë	Mesatarja e Hektarëve për Familje	# i Tapive të Tokë të Lëshuara
Gjirokastra	113,734 (39.4%)	17,693 (39%)	15,354 (48%)	10,050 (45.6%)	1.45	9,632
Tepelena	81,734 (28.3%)	13,055 (28.8%)	7,375 (23%)	7,160 (30.3%)	0.99	6,200
Përmeti	93,000 (32.2%)	14,600 (32.2%)	9,261 (29%)	6,390 (27.1%)	1.43	5,500
Total	288,468	45,348	31,990	23,600	1.26	21,332

128 Dokument Teknik Nr. 520, Varfëria në Shqipëri: Një Vlerësim Cilësor, Banka Botërore, 2002.


129 Regjistri Statistikor i Bashkive, Kwshilli I Qarkut, 2003.

Klasifikimi tokës



INSTAT: Regjistrimi Bujqësisë, 1998.

Shpërndarja e pronësisë tokës



INSTAT: Regjistrimi Bujqësisë, 1998.

Sipas hartës, e cila bazohet në klasifikimin e tokës, në të tre bashkitë pjesa më e madhe e tokës bujqësore ka pronarë, në krahasim me tokën e dhënë me qera apo atë që pothuajse nuk përdoret. Në një shtrirje më të vogël, në Tepelenë dhe Luftinjë në bashkinë e Tepelenës, ka gjithashtu një numër të konsiderueshëm të popullsisë që i është dhënë tokë, por që as nuk e kanë në pronësi dhe as nuk paguajnë qera për ta kultivuar atë. Një pronar mund t'i japë tokë një familjeje tjetër për ta përdorur (pa ia kaluar në pronësi apo pa marrë qera) me qëllim që të sigurojë se toka do të shkojë dëm dhe nuk do të bëhet joproduktive. Gjithashtu, në Odrie dhe Dropull i Poshtëm, në bashkinë e Gjirokastrës, ekziston një pjesë të vogël të banorëve që marrin tokë me qera për ta përdorur.

Në hartën që përshkruan kategoritë e përdorimit të tokës në qark, është evidente se pjesa më e madhe e tokës përdoret për qëllime bujqësore, e shoqëruar kudo me shkallë të ndryshme të moszhvillimit. Për shembull, në Kurvelesh, dhe veçanërisht në Lopes, në bashkinë e Tepelenës, Çarçovë (dhe në një shkallë më të vogël zonat e tjera) në bashkinë e Përmetit dhe Lunxhëri, Pogon dhe Dropull i Sipërm në bashkinë e Gjirokastrës, një pjesë e konsiderueshme e tokës bujqësore nuk shfrytëzohet plotësisht dhe si rrjedhojë keqmenaxhohet. Këto porcione të mëdha të tokës bujqësore të papërdorura nëse do shfrytëzohen siç duhet, mund të sjellin rritje të menjëhershme të të ardhurave për llogari të familjeve dhe në një periudhë afat-gjatë mund të kthehen në një pasuri me vlerë.

Prodhimet bujqësore

Problemeve në sektorin e prodhimit të bujqësore në qark kanë pjesërisht faj se ndikojnë negativisht rritjen e të ardhurave. Dhe pikërisht, kërkesa e ulët e tregut ka shkaktuar pakësimin e prodhimeve bujqësore, veçanërisht të misrit. Për shembull, në vitin 2002 prodhimi nga të korrat ishte 24.4 kuintalë për hektarë, ndërsa në nivel kombëtar ky prodhim ishte 32.9 kuintalë për hektarë.¹³⁰ Kjo ulje e kërkesës, u ka shkaktuar fermerëve një rritje të kostos totale prodhimit. Në mënyrë të ngjashme, fermerët shpesh e vendosin veten në një disavantazh duke përdorur në mënyrë joefikase burimet dhe mundësitë që kanë

në dispozicion të tyre. Për shembull, rritja e drithërave dhe të lashtave që janë thelbësore për prodhimin e bukës shpesh herë ndërmerret në zona ku toka nuk ka mundësi të japë prodhimtari të lartë. Në mënyrë të pashmangshme, kjo shkakton humbje për fermerët si dhe efekte negative për standardet e jetesës së familjeve.

Prandaj fermerët mund të përfitojnë shumë nga planifikimi dhe zbatimi i projektit të diversifikimit të fermës. Diversifikimi i fermës është një degëzim i aktiviteteve tradicionale të fermës, që merr përsipër ndërmarrjet e reja fitim-prurëse. Llojet e këtyre ndërmarrjeve mund të ndryshojnë gjerësisht, meqë ndërkohë mund të krijohen biznese të reja në aktivitete të lidhura me turizëmin dhe zbavitjen, në blegtorisë dhe prodhimeve bujqësore të specializuara, në sektorët e shërbimeve apo përpunimit, si edhe në ndërmarrje të rrezikshme të shtimit të vlerës. Të gjithë fermerët dhe anëtarët e familjeve fermere mund të përfshihen në projektet e diversifikimit, duke përfituar në këtë mënyrë nga suksesi personal dhe familjar në rritje, nga financat e përmirësuara, nga rendimenti më i mirë i tokës, dhe nga përdorimi i tokës jo të punueshme ose i ndërtesave të tepërta apo të papërdorura. Për më tepër, diversifikimi ka kuptimin që fermerët mund të rrisin të ardhurat e fermës, të trajtojnë kushtet e ndryshimit, të shfrytëzojnë një mundësi apo një hapje të tregut, të krijojnë punësim shtese në fermë, të krijojnë plane për pension, madje dhe sigurojnë një pasardhës.¹³¹


Përsa i përket vjeljes së duhanit, megjithëse ai tradicionalisht ka qenë një prodhim kryesor i qarkut dhe të ardhurat në të shkuarën kanë qenë të larta, mungesa e makinerive moderne dhe e fuqisë punëtore (të rinj dhe të reja të fshatit të aftë për punë) ka rezultuar në braktisje totale të prodhimit të duhanit. Hektarë toke dhe faqe kodrash pjellore të përdorura për prodhimin e duhanit, nuk janë mbjellë, sidomos në zonat që do të jepnin prodhim më të mëdha. Këto zona përfshijnë Lunxhërinë në bashkinë e Gjirokastrës, Krahës në bashkinë e Tepelenës, dhe të gjitha zonat në bashkinë e Përmetit. Kjo humbje përfaqëson humbjen e një mundësie të madhe për të përmirësuar kushtet e jetesës së shumë familjeve rurale.

¹³⁰ Rregjistri Statistikor I Bashkive, Këshilli i Qarkut, 2003.

¹³¹ Irlanda Veriore Rurale: Sektori I Diversifikimit të Fermave,


Departamenti I Zhvillimit Rural të Qeverisë të Mbretërisë së Bashkuar, 2001 (në internet).

Shpërndarja e pemëve frutorë si ullinjë, portokalle dhe rrushë



INSTAT: Regjistrimi Bujqësisë, 1998.

Shpërndarja e pemëve frutorë



INSTAT: Regjistrimi Bujqësisë, 1998.

Nga ana tjetër prodhimi i hardhive është rritur në mënyrë konstante në 2-3 vitet e fundit. Pavarësisht rënies që hardhitë pësuan gjatë viteve të tranzicionit, tashmë ai po e merr veten dhe me shpejtësi po kthehet në një prodhim kryesor për fermerët. Kjo është e vërtete edhe për komunat në të cilat kjo traditë nuk ishte tipike. Popullariteti i tij në rritje bazohet në kërkesën e tregut për rrush, si edhe në rritjen e kërkesës për prodhimet që përdorin rrushin si një përbërës vital, të tilla si vera. Në vitin 2003, qarku i Gjirokastrës ishte shtëpia e 499 hektarëve vreshta. Sikurse tregon dhe harta e mësipërme, shumica e bashkive si Përmeti dhe Gjirokastra kanë vreshta me shumicë, veçanërisht në zonat rurale dhe të thella ku mund të merreshin edhe përfitimet më të mëdha. Megjithatë përfitimet nga prodhimi i hardhive nuk janë shfrytëzuar në zonat e varfra, por potencialisht të suksesshme, si Odrje dhe Lunxhëri në bashkinë e Gjirokastrës, Buz, Memaliaj dhe Luftinjë në bashkinë e Tepelenës, dhe Sukë dhe Ballaban në bashkinë e Përmetit. Megjithatë, një ringjallje e suksesshme e prodhimit të rrushit në qark do të jetë i mundur vetëm nëse zëvendësohet teknologjia e vjetëruar e procesimit bujqësor, dhe nëse kompletohet restaurimi i nevojshëm i fabrikave më të vogla dhe më të vjetra. Për këtë qëllim, një projekt strategjik i prodhimit të verës mund të vepronte si katalizator për rritjen ekonomike afat-shkurtër si dhe afat-gjatë në qark duke krijuar mundësi për ekspansion në të ardhmen. Ky tip ndërmarrjeje do të kërkonte organizimin e fermerëve dhe koordinimin e punës, sikurse edhe asistencën e qeverisë vendore dhe organizatave joqeveritare. Investimet e donatorëve për

materiale prodhimi dhe trainime specifike për fermerët mund të rezultojnë në të ardhura të mëdha për një kooperativë fermerësh nëse ata do të ishin në gjendje të mbanin një prodhim të mjaftueshëm dhe nëse do ta marketonin efektivisht prodhimin e tyre. Për shembull, mund të arrihet sukses duke marketuar verën në tregun e brendshëm si një specialitet origjinal dhe unik i qarkut nën një markë të regjistruar ligjërisht. Në një periudhë afat-gjatë, kjo ndërmarrje mund të çonte gjithashtu në shitjen aktuale të markës së verës së cilësisë së eksportit në tregun e huaj dhe të vepronte si një tjetër faktor për tërheqjen e turizmit, si p.sh. përmes tureve në vreshta dhe tureve të shijimit të verës në qark.

Harta e mësipërme paraqet gjithashtu mbizotërimin e pemëve të ullinjve në Përmet në bashkinë e Përmetit, prezencën e tyre përmes bashkisë së Tepelenës dhe në një shtirje më të vogël ekzistencën e tyre në disa zona të bashkisë së Gjirokastrës. Vjelja e ullinjve mund të krijonte mundësi të mrekullueshme për rritjen ekonomike. Në mënyrë të ngjashme, prodhimi i portokalleve në Odrje dhe Qendër Libohovë në bashkinë e Gjirokastrës, dhe Përmet në bashkinë e Përmetit, është gjithashtu një burim potencial i të ardhurave nëse bëhet investimi i duhur. Përveç hardhive, ullinjve dhe portokalleve, qarku është i pasur me fruta, të tilla si qershitë, kajsitë, mollët, dardhat, kumbullat, fiqet, si dhe varietete të arrave. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet këtyre produkteve, meqë ato mund të sjellin prosperitet me shifra të larta, si dhe shpërndarjes së tyre. Veçanërisht dardhët, kumbullat dhe arrat janë të shpërndara gjerësisht në të gjithë qarkun, në të tre bashkitë.

Prodhimi Bujqësor për Vitin 2003 (1,000 hektarë)¹³²

	Tokë Bari	Vreshta	Ullinj	Grurë	Thekër	Elb	Misër	Patate	Ugar
Qarku Gjirokastrër	98.9	0.6	0.3	3.6	0.0	0.1	1.0	0.5	0.3

Blegtoria

Të një rëndësie të madhe për qarkun e Gjirokastrës janë të ardhurat e nxjerra nga blegtoria, përmes shitjes së mishit, qumështit dhe nënprodukteve të qumështit, të cilat mbeten ushqimet bazë për shumicën e familjeve. Megjithatë, duhet mbajtur

mend se vetëm banorët që jetojnë në afërsi të qendrave urbane dhe kanë akses në njësitë frigoriferike janë në gjendje të shesin qumështin apo mishin, pasi transporti i shpejtë është një domosdoshmëri për të ruajtur produktet nga prishja.

Prodhimi i Blegtorisë për Vitin 2003¹³³

	Qumësht Lope	Qumësht Dele	Qumësht Dhie	Vezë	Lesh Dele
	Mijë Ton			Milion	Ton
Qarku Gjirokastrër	30	11	12	16	337

132 Treguesit sipas Perfekturave: 2002-2003, INSTAT, 2004.

133 Treguesit sipas Perfekturave: 2002-2003, INSTAT, 2004

Mbarështimi i bagëtisë, lopëve, deleve, dhe dhive, ka shumë mundësi të jetë një nga mjetet primare të zhvillimit ekonomik të qarkut, veçanërisht meqë numri i kokëve të bagëtisë është rritur gjatë këtyre pak viteve të fundit. Transferimi i kohëve të fundit i ngastrave të

mëdha të tokës bujqësore për t'i kthyer në kullota ka shoqëruar këtë rritje. Megjithatë si rezultat i kapacitetit të ulët prodhues, mbarështimi i bagëtisë nuk është bërë në potencialin e tij të plotë dhe situata ekonomike e shumë mbarështuesve ka mbetur pezull.

Bagëtia për Vitin 2003 (1,000 kokë)¹³⁴

	Lopë	Dele	Dhi	Derra	Pula
Qarku Gjirokastër	25.6	307.2	173	2.3	300.3

Mbarështimet e pafavorshme, të zakonshme për qarkun janë quajtur si një faktor vital që ka kufizuar rritjen e të ardhurës neto të mbarështuesve. Si rrjedhojë një program për përmirësimin e racës, me mbështetjen e Projektit Ndërkombëtar të Lopëve dhe Qeverisë së Shqipërisë, mund të kishte një përfitim të pamatshëm për rritjen e fitimeve të shumë prej mbarështuesve në qark, të cilët janë duke përjetuar vështirësi si rezultat i një problemi që nëse ndreqej do të ndryshonte përfundimisht faqen e industrisë së gjëse së gjallë në qark. Gjithashtu banorët kanë përjetuar një nevojë për të pasur një ushqim më të mirë, për të investuar në reklama, dhe për të përmirësuar teknologjinë e përpunimit të mbetjeve. Për më tepër, mbarështuesit e bagëtisë janë shumë të shpërndarë dhe mund të vilnin përfitimet e bashkimit të tyre në një organizatë të vetme.

Bimët Medicinale

Ka pothuajse 120 varietete të bimëve medicinale dhe tradicionale të gjetura në qark, të tilla si gjethe dafine, çaj mali, sherebelë, rigon i egër dhe barëra të këqija të shkëmbinjve. Rritja e të ardhurave mund të realizohet përmes mbjelljes dhe korrjes së bimëve tradicionale si bimë medicinale. Në veçanti, popullsia nga zonat malore, të tilla si Frashëri në bashkinë e Përmetit, Buzi në bashkinë e Tepelenës, dhe Zagoria dhe Pogoni në bashkinë e Gjirokastrës, të cilat kanë një popullsi më të vogël, mund të garantojnë siguri financiare më të mirë duke i mbledhë këto lloje bimësh për shitje të brendshme. Nëse një propozim strategjik do të ishte në gjendje të siguronte investimet e nevojshme, dhe në të njëjtën kohë hapësirën e magazinimit dhe mjetet paketuuese për produktet, dhe marketimin e bazuar në kërkime të tregut, atëherë një kooperativë vjelësish mund të

krijonte potencialisht një vend në tregun e brendshëm dhe të rriste ndjeshëm të adhurat personale.

Mbrojtja e Bimëve

Me qëllim që të mbrohen bimët me vlerë për industrinë bujqësore, ka pasur një rritje të përdorimit të pesticideve nëpër prona për të kundërsulmuar shpërthimin e insekteve, që çon në ulje të prodhimit. Megjithatë, qarku ka mangësi në zbatimin e një sistemi për liçensimin e pesticideve dhe për udhëzimin e fermerëve se si t'i përdorin pesticidet dhe insekticidet me qëllim që të reduktojnë rrezikun e dëmtimit të burimeve ujore, bimëve, gjallesave, banorëve lokalë dhe vetes së tyre. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për faktin se të moshuarit, fëmijët e vegjël dhe ekosistemet e brishta janë të zbuluar në mënyrë akute ndaj efekteve dëmtuese të këtyre lëndëve helmuese.

Vëmendje duhet t'i kushtohet formulimit të një programi të integruar për menaxhimin e dëmtuesve (MP), i cili konsiston në kërkime shkencore, ndryshim të politikave, dhe programe të trainimit me pjesëmarrje për fermerët, si një mënyrë alternative për mbrojtjen e bimëve përmes përdorimit të pesticideve. Në këtë mënyrë fermerët kanë përgjegjësi për diagnostikimin e problemeve të shkaktuara nga dëmtuesit dhe për pjesëmarrjen në hartimin e zgjidhjeve, dhe si rrjedhojë ekspertiza e tyre pranohet dhe rritet. Një përafrim IPM do të përfshinte në mënyrë të domosdoshme personelin e terrenit nga departamentet e qeverisjes lokale dhe kombëtare dhe nga organizatat joqeveritare, dhe do të shërbente për të rritur ndërgjegjësimin ekologjik, vendim-marrjen dhe aftësitë e tjera të biznesit, në të njëjtën kohë që do

134 Treguesit sipas Perfekturave: 2002-2003, INSTAT, 2004.

të rriste besimin e fermerëve. Si rrjedhojë përfitimet ekonomiko-shoqërore do të tejkalonin objektivin fillestar të mbrojtjes së bimëve. Për shembull, investimi në një shkollë në terren për fermerët (FFS), sikurse është ndërmarrë së fundmi në pjesë të Azisë, me një grup fermerësh të cilët janë dakort të takohen një herë në javë gjatë një sezoni të plotë prodhimi, është një pikënisje potenciale. Kjo do të thotë 12-16 mbledhje, secila të paktën një gjysëm dite. Fermerët do të ndaheshin në pesë skuadra të vogla në terren dhe do të shpenzonin një deri në dy orë në fushë, duke bërë vëzhgime, duke llogaritur dendësitë e popullimit të specieve të ndryshme, duke vlerësuar kushtet fiziologjike të prodhimit dhe duke shënuar vëzhgimet. Më pas secila nga skuadrat do të rimblidhen jashtë fushës dhe do të diskutojnë, analizojnë dhe interpretojnë të dhënat e tyre. Vëzhgimet e dorës së parë të fermerëve konfirmojnë vlefshmërinë e konceptit të balancimit të natyrës dhe rregullimit të popullsisë. Skuadrat individuale diskutojnë vëzhgimet e tyre me skuadrat e tjera dhe arrijnë në vendime mbi kontrollin e dëmtuesve dhe mbi nevojën për praktika të tjera bujqësore. Kuptimi i fermerëve mund të çohet më tej nëpërmjet eksperimentimeve të tilla si studimeve të efekteve të pesticideve mbi armiqtë natyralë dhe simulimin artificial të dëmtimit nga insektet, për të treguar se një bimë mund t'i qëndrojë disa dëmtimeve prej insekteve pa u sëmurrur. Për më tej, ndërsa fermerët e qarkut kanë një bagazh njohurish tradicionale përsa i përket kujdesit të hortikulturës, ekzistojë edhe metoda të reja për rritjen e rendimentit, nga të cilat fermerët mund të

përfitojnë duke i përfshirë më pas në praktikatat e tyre personale.¹³⁵

Drenazhimi dhe Ujitja

Mungesa e ujitjes kufizon në mënyrë domethënëse prodhimin bujqësor dhe shkakton dobësimin në tërësi të ekonomive rurale. Zonat e thella dhe rurale vuajnë më shumë, sepse terreni i ashpër apo i pjerrët bëjnë që instalimi i veprave të ujitjes të jetë i vështirë dhe i kushtueshëm. Madje edhe në disa raste ku veprat e ujitjes funksionojnë ato janë shpesh të mbingarkuara nga kërkesa dhe nuk mund t'i ofrojnë shërbim të mjaftueshëm fermerëve. Përveç kësaj, ujitja mund të jetë shumë e shtrenjtë për shumë fermerë për t'u përdorur, madje edhe kur ata kanë aq fat sa të kenë akses në të.¹³⁶

70-80% e infrastrukturës ujitëse, duke përfshirë barrierat, kanalet e drenazhimit dhe stacionet e pompimit, në qarkun e Gjirokastrës kanë nevojë për riparim. Si rrjedhojë, sipërfaqja e tokës së ujitur dhe të drenazhuar në qark është ulur ndjeshëm në vitet e fundit. Për shembull, sipërfaqja e tokës së ujitur ka pasur rënie nga 23,875 ha në vitin 1990, në 5,375 ha në vitin 2000. Në mënyrë të ngjashme, pothuajse 14,300 ha tokë u drenazhua në vitin 1990, por vetëm 5,412 ha tokë u drenazhuan në vitin 2000. Fatkeqësisht, legjislacioni aktual nuk adreson mjaftueshëm mbrojtjen e veprave të ujit ose nuk diskuton masat për të luftuar erozionin që acaron situatën ndërkohë serioze në qark.

Skemat e Ujitjes dhe Drenazhimit për t'u Zbatuar¹³⁷

Bashkia	# total i Skemave të Ujitjes	Hektarë Tokë për Ujitje	# total i Skemave të Drenazhimit	Hektarë Tokë për Drenazhim
Gjirokastra	24	12,730	7	9,400
Tepelene	22	5,598	8	1,752
Permet	9	3,948	5	3,110
Total	55	22,276	20	12,262

Si rezultat i këtij degjenerimi, me asistencën e Ministrisë së Bujqësisë dhe Bankës Botërore, të cilat veprojnë si kreditorë, tashmë janë identifikuar dhe planifikuar një numër skemash për restaurim. Në bashkinë e Gjirokastrës janë planifikuar 5 skema për ujitje të mëdha dhe 19 skema për ujitje të vogla që do të mbulojnë një sipërfaqe toke prej 12,730 hektarësh. Këto skema ujitjeje përfshijnë si rezervuarët ahtu edhe stacionet e

pompimit, specifkisht në zonat e Dropullit të Poshtëm, Dropullit të Sipërm, Fushë e Suhës, Lunxhëri dhe Odrie të kombinuara sëbashku, dhe Cepune dhe Mashkullorë të kombinuara së bashku. Gjithashtu do të nxitet edhe ndërtimi i një serie prej 7 skemash drenazhimi. Në bashkinë e Tepelenës janë planifikuar 9 skema ujitjeje të mëdha dhe 13 skema ujitjeje të vogla që do të mbulojnë një sipërfaqe toke prej 5,598 hektarë.

¹³⁵ Divizioni i Prodhimit dhe Mbrojtjes së Bimëve i Organizatës së Ushqimit dhe Bujqësisë i Kombeve të Bashkuara (FAO), 2004 (në internet).
¹³⁶ Dokument Teknik Nr. 520, Vërfëria në Shqipëri: Një Vlerësim

Cilësor, Banka Botërore, 2002.

¹³⁷ Rregjistri Statistikor i Bashkive, Këshilli i Qarkut, 2003.

Këto skema përfshijnë gjithashtu edhe rezervuarët dhe stacionet e pompimit, specifikisht në zonat Krahës dhe Toç të kombinuara së bashku, Kalivaç, Qesarat, Vasjar Mogila, Dukaj, Luftinjë Lopës, Kurvelesh dhe Buz. Përveç këtyre, pritet që të realizohen edhe 8 skema drenazhimi. Nga 9 skema ujitjeje në Përmet, 1 është e madhe dhe 8 janë të vogla, dhe shtrihen përmes 3,948 hektarëve tokë. Zonat që do të ndikohen përfshijnë tokat nga Bubsj në Këlcyrë, Ranakosh, Keraj, Gjon Kuç, Bubes, Xhanaj, Topojan, Shelq, dhe Goricë duke u lidhur me lumin e Vjosës. Gjithashtu do të ndërtohen edhe 5 skema drenazhimi.

Infrastruktura

Ndërsa varfëria në të ardhura në Shqipëri është e lartë, statusi i varfërisë që lidhet me kushtet fizike të infrastrukturës dhe sigurimit të shërbimeve është akoma më keq. Konform me këtë perspektivë kombëtare, infrastruktura e qarkut të Gjirokastrës ka përjetuar një rënie serioze. Në mbarë qarkun, familjet kanë mungesa të shërbimeve bazë dhe pabarazitë në ofrimin e tyre janë bërë edhe më të thella. Anketa e Bankës Botërore mbi varfërinë në Shqipëri ilustron se pas papunësisë dhe të ardhurave, shumë shqiptarë ndihen se problemet e infrastrukturës janë shkak kryesor i vështirësive të tyre dhe i standartit të ulët të jetesës. Të anketuarit kanë renditur ujin, dhe kanalizimet, elektricitetin dhe rrugët si një prej prioriteteve të tyre, më urgjente se sa strehimi, kujdesi për fëmijët dhe të moshuarit, dhe asistencë ekonomike. Gjithashtu është gjetur se problemet e lidhura me infrastrukturën janë një shkak kryesor se përse emigrantët vendosën të ikin. Infrastruktura e dobët gjithashtu lëndon si investimet për komunitetin si të brendshmet ashtu edhe ato të huaja.¹³⁸

Infrastruktura fizike e pamjaftueshme renditet si një prej pengesave më të rëndësishme të rritjes së ardhme ekonomike; një faktor kryesor në kufizimin e zhvillimit të komunave më të varfra të qarkut të Gjirokastrës dhe një pengesë gjithnjë e më domethënëse në përpjekjet për të arritur zhvillimin e qëndrueshëm. Është e qartë se qarku nuk mund të plotësojë të gjitha kërkesat për shërbime me burimet e tij të limitizuara, me të ardhurat kombëtare apo edhe me donacionet. Megjithatë, eksperiencia ndërkombëtare demonstroi se shumë

aktivitete të shërbimeve publike janë më efektive nëse ato mbështeten nga sektori privat dhe investimet e tij.

Rrjetet e Rrugëve Urbane dhe Rurale

Investimet fillestare në sistemin e rrugëve u përqëndruan në rrjetin kryesor që mbante peshën më të madhe të trafikut, megjithatë, rrugët dytësore dhe tretësore që lidhin fshatrat rurale me rrugët kryesore janë ende në një masë të madhe të papërshtatshme. Banorët e zonave rurale pohojnë se sistemi rrugor i pamjaftueshëm mban peng rritjen ekonomike, sepse për shembull, fermerët kanë vështirësi në arritjen e tregjeve lokale, duke penguar shitjen e produkteve dhe bagëtisë së tyre, ose bëjnë që ato të shiten më shtrenjte. Përmirësimet domethënëse të transportit janë në gjendje të rrisin aksesin ndaj prodhimeve të fermës, duke zgjeruar potencialin e përpunimit bujqësor dhe duke zvogëluar izolimin e zonave rurale. Për më tepër, duke marrë në konsideratë faktin se rritja e sektorit të përpunimit është thelbësore për zhvillimin ekonomik dhe, meqë investimet në industri parashikohen bazuar në lidhje të besueshme transporti, për lëvizjen e lëndës së parë dhe të produkteve të përpunuara (jashtë kufijve dhe brenda vendit), forcimi i infrastrukturës rrugore është një domosdoshmëri absolute.¹³⁹

Rrugët e vështira dhe shpesh të pakalueshme, kombinuar me mungesat e tjera të infrastrukturës janë një shkak kryesor i emigrimit. Për më tepër ato ndikojnë negativisht në përhapjen e arsimit dhe shërbimeve të kujdesit për shëndetin. Meqë rreth 88% e studentëve në Shqipëri shkojnë në shkollë në këmbë, është e pritshme që distanca nga shtëpitë në ndërtesat e shkollave në disa zona të shkaktojë pjesëmarrje të vogël. Gjithashtu njerëzit në zonat rurale dhe të thella që kanë nevojë për shërbim mjekësor urgjent, përballohen me kushtet ekstremisht të këqija të rrugëve që bëhen edhe më keq kur moti është i keq.¹⁴⁰

Rrjeti i rrugëve në qarkun e Gjirokastrës është pothuajse 651 kilometra i gjatë, nga të cilat rreth 270 kilometra janë rrugë nacionale dhe rreth 381 janë rrugë rurale.¹⁴¹ Rrjeti i rrugëve nacionale në qark ndahen si më poshtë:

¹³⁸ Dokument Teknik Nr. 520, Varfëria në Shqipëri: Një Vlerësim Cilësor, Banka Botërore, 2002.

¹³⁹ Njësia e Sektorit të Zhvillimit të Njerëzimit: Rajoni i Europës dhe Azisë Qendrore, Shqipëri – Vlerësimi i Varfërisë, Vol. 1 nga 1,

Banka Botërore, Nëntor 2003.

¹⁴⁰ Dokument Teknik Nr. 520, Varfëria në Shqipëri: Një Vlerësim Cilësor, Banka Botërore, 2002.

¹⁴¹ Rregjistri Statistikor i Bashkëve, Kështilli i Qarkut, 2003.

TEPELENA

● Kufi Mallakastër deri në kufi Gjirokastër	48 kilometer
● Ura e Leklit deri në kufi të Përmetit	12 kilometer
● Qafa e Këçokut deri në Qafë Gllavë	21 kilometer
● Telepene deri në kufi të Vlorës	35 kilometer

PERMET

● Permet deri në kufi të Tepelenës	25 kilometer
● Permet deri në kufi të Leskovikut	33 kilometer
● Kolonjë deri në Ballaban deri në kufi të Tepelenës	21 kilometer
● Carçove deri te Tre Urat	10 kilometer

GJIROKASTRA

● Kufi i Tepelenës deri në Kakavijë	51 kilometer
● Jergucat deri në kufi të Sarandës	6 kilometer
● Kthesa Dhuvjan deri në Libohovë	8 kilometer

I një rëndësie të veçantë është sistemi i rrugëve që përbëjnë rrjetin Kakavijë-Gjirokastër-Tepelenë, të cilat jo vetëm lidhin veriun dhe jugun, por gjithashtu krijojnë lidhje me Greqinë dhe Malin e Zi. Në vitin 2003, numri i automjeteve që transportonin pasagjerë në rrugën Kakavijë-Gjirokastër-Tepelenë arriti në total në rreth 7,614, nga të cilat 6,577 ishin makina, 991 ishin autobuzë dhe mikrobusë, dhe 46 ishin motoçikleta. Numri i automjeteve rrugore që transportonin mallra në vitin 2003 arriti në total 3,329, nga të cilat 2,327 ishin kamionë transportues, 122 ishin traktorë dhe 880 ishin rimorkio. Ky është i njëjti rrjet rrugor në të cilin në vitin 2003 ndodhën të paktën 33 aksidente rrugore, të cilat shkaktuan 15 vdekje dhe 18 plagosje serioze. Meqë numri i automjeteve transportuese, që transportojnë si mallra ashtu edhe udhëtarë, rritet çdo vit, riparimi dhe

mirëmbajtja e rrjetit rrugor është një nevojë e ngutshme.¹⁴²

Rrjeti i rrugëve rurale përbëhet nga 342 kilometra rrugë që lidhin komunat me rrugët nacionale dhe fshatrat. Ndonëse mirëmbajtja e këtij rrjeti është përgjegjësi e Ndërmarrjeve të Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale të bashkive të Gjirokastrës, Tepelenës dhe Përmetit, vetëm rreth 43 kilometra janë të shtruar dhe kushtet mbeten të këqija gjithandej. Nga harta është e dukshme se jashtë rrugëve nacionale të asfaltuara ka vetëm pak rrugë të mirëmbajtura. Me përjashtim të një pakice rrugësh të mirëmbajtura, në të tre bashkitë e qarkut ka shumë rrugë fshati dhe rrugë stinore. Këto rrugë fshati dhe rrugë stinore nuk janë as të asfaltuara e as të mirëmbajtura, dhe gjatë ditëve me shi dhe me lagështi mund të jetë e pamundur dhe e rrezikshme për t'i përdorur.


Rrjeti i Rrugëve Rurale sipas Bashkive¹⁴³

Bashkia	Komuna	Rrjeti Rrugur	Gjatësia (km)	
			Total	E Shtruar
Gjirokastër	Qendër Libohovë	K/Suhes-Labovë E Sipërme	8	-
		K/Goranxi-Bulo	3	-
	Cepo	K/Mashkullore- Mashkullore	5	5
		K/ Ura Kardhiq- Fushbardhe	26	-
	Picar	K/Votuc-Golem- Guri i Shpuar	20	-
	Lunxhëri	Ura e Drinos- Erind-Çajup	22	6
		Dhoksat-Qestorat	3	-
		Erinde-Dhoksat	5	-
	Antigone	Ura e Drinos- Sarqinisht	14	-
	Lazarat	K/Lazarat-Lazarat	3	1
	Odie	Ura e Subashit - Labov	9	-
		Ura e Subashit Andon Poci	6	-
	Pogon	Polocan-Sopik	12	-
		Stacioni Pyjor-Çatister	14	-

142 Treguesit sipas Prefekturave: 2002-2003, INSTAT, 2004.

143 Rregjistri Statistikor I Bashkive, Kësbilli i Qarkut, 2003.

	Dropull I Sipërm	K/Bularat-Bularat	4	4
		K/Koshovic-koshovic	6	-
		K/Bularat-Bodrishte	4	4
	Dropull I Poshtëm	Hyrjet në fshatrat e Dropullit	3	
		K/Glinës-Glin	4	4
		Fabrika Glinës-Glinë	1	-
	Zagori	K/Libohovës-Hoshtev	38	-
Tepelenë	Qendër	Tepelene-Progonat-Nivicë	31	-
		Kufi Salari-Salari	4	-
		Kufi Salari-Salari Nivic	20	-
		Subash-Qender- Hormov	9	-
		Ura e Dragotit-Sektori N.B.	5	-
	Kurvelesh	Kufi Gusmar-Gusmar	2	-
		Varrezat e Progonat-Kufi Gjiro	3	-
	Buz	Kufi Gllav-Reperditori	2	-
	Luftinjë	Luftinje-Sektori 4	2	2
		Agjensi- Luftinje-Ivory	17	17
Përmet	Ballaban	Kiçok-Malas	10	-
	Dishnicë	Kthesa Katundisht- Katundisht	4	-
		Baduqas-Tolar	4	-
		Degëzim-Luarë	5	-
	Sukë	Sukë-Kthesa Zhepovë	2	-
	Petran	Petran-Benja	7	-
		Degëzim-Boder	5	-
		Përmet-Badelonjë	3	-
	Qendër	Degëzim-Kosinë	1	-
		Piskovë-Frashër	31	43



INSTAT: REPOBA, 2001

Furnizimi me Energji Elektrike

Kriza e sektorit energjistik ka ngadalësuar rritjen e prodhimit në Shqipëri. Ajo ka vepruar gjithashtu si një frenues domethënës për investimet e reja në industri dhe pengon turizmin. Kërkesa është në arritje, por nuk ka burime të mjaftueshme për ta përmbushur atë dhe burimet ekzistuese nuk janë menaxhuar siç duhet. Në disa raste, rrjetet e transmetimit kanë degraduar si rezultat i mbingarkesës që shkakton qarqe të shkurtra të transformatorëve si dhe një kompromentim të sistemit në tërësi. Që prej viteve 1990-të, mesatarisht 85.7% e familjeve kanë vuajtur nga ndërprerje ditore të energjisë elektrike, që zgjasin 8 orë. Kjo situatë e ka kthyer çështjen e furnizimit me energji elektrike në një nga problemet më akute që shoqëria shqiptare është duke përballuar sot.¹⁴⁴

Banka Botërore raporton se elektriciteti ndjek nga shumë afër, si një prioritet urgjent i banorëve, ujin dhe rregullimin e sistemeve të kanalizimeve. 36% thonë se ai renditet si një nga dy prioritetet kryesore dhe pothuajse 75% e ndejnë se ai është një nga katër

prioritetet, duke lënë prapa strehimin, ushqimin dhe ndihmën ekonomike, kujdesin për fëmijët dhe të moshuarit, dhe shkollat.¹⁴⁵ Problemet ekzistojnë në të gjitha rrjetet e prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike në varësi nga lokaliteti i qarkut. Sikurse përvijëzon tabela e mëposhtme, familjet janë konsumatorët më të mëdhenj të energjisë elektrike. Megjithatë, njerëzit jo vetëm që përjetojnë ndërprerje të tejzgjatura të energjisë, por edhe kur ka energji, tensioni është shpesh shumë i ulët për të ndezur kompjuterat e shkollave apo edhe pajisjet shtëpiake. Një tjetër problem përfshin faktin se shumë njerëz thjesht nuk janë në gjendje të përballojnë energjinë elektrike. Për shembull, nëse energjia elektrike kushton 45 lekë për një kilovat-orë (sikurse është vendosur nga Banka Botërore dhe që është nën koston e prodhimit), por familja merr vetëm 2,000 lekë me të cilat i duhet të jetojë, ajo nuk është në gjendje të paguajë një faturë prej 1,500 lekësh për çdo muaj.¹⁴⁶ Në të vërtetë, lidhjet ilegale gjithashtu intensifikojnë ngarkesën në rrjetin që është ndërkohë i mbingarkuar.

Konsumi i Energjisë Elektrike (MWh)¹⁴⁷

	Familjet	Industria	Bujqësia	Tregu më Pakicë	Të Tjerë	Total
Qarku Gjirokastrë	65,572 (69.1%)	5,666 (6%)	286 (0.3%)	10,186 (10.7%)	13,248 (14%)	94,958

Me përjashtim të minierës së Memaliajt dhe disa stacioneve hidroenergjitike të vogla që mezi funksionojnë, qarku i Gjirokastrës aktualisht nuk ka një hidrocentral funksional. Megjithatë, studimet në dekada të vjetra nxjerrin në pah se qarku përmban burime të konsiderueshme, duke përfshirë lumin e Vjosës dhe degë të ndryshme të lumit të pashfrytëzuar. Si rrjedhojë fillimi i punimeve në Kalivaç, Sukë dhe Këlcyrë në bashkinë e Përmetit, do t'i hapnin dyert zhvillimit përgjatë lumit Vjosë dhe gjithashtu do të ofronin mundësi punësimi për periudhën afat-gjatë. Për më tej, ka gjithashtu projekte të propozuara që synojnë ndërtimin e një hidrocentrali në grykën e Selckës që do të eksploroheshin me maturi.

Rikonstruksioni i Aeroportit

Rikonstruksioni i aeroportit në qytetin e Gjirokastrës do

të sillte avantazh për qarkun në shumë drejtime. Ai do të thoshte akses më i mirë në një treg më të madh për produktet bujqësore dhe për produktet e tjera rajonale. Do të sillte një rritje të lëvizjes së banorëve të qarkut dhe një mënyrë më të shpejtë dhe më të sigurt vizite për shqiptarët dhe të huajt, duke nxitur në këtë mënyrë turizmin dhe një investim të huaj më të madh. Edhe një periudhë afat-shkurtër, një ndërmarrje e madhe e tillë si kjo, do të krijonte shumë vende pune në fazën e ndërtimit, dhe do të çonte në pozicione të shumta punësimi të përhershme në një shumicë fushash.

Telekomunikacioni dhe Interneti

Në sektorin e telekomunikacionit shqiptar ka ndodhur një progres i shpejtë, duke përfshirë shërbimet e telefonisë fikse, komunikimin celular, dhe sigurimin e lidhjes në internet. Përveç Albtelekom-it, në zonat

¹⁴⁴ Raport për Zhvillimin Kombëtar Njerëzor, 2004.

¹⁴⁵ Dokument Teknik Nr. 520, Varsëria në Shqipëri: Një Vlerësim Cilësor, Banka Botërore, 2002.

¹⁴⁶ Dokument Teknik Nr. 520, Varsëria në Shqipëri: Një Vlerësim Cilësor, Banka Botërore, 2002.

¹⁴⁷ Tregues sipas Prefekturave: 2002-2003, INSTAT, 2004.

rurale janë lëshuar liçenca për 45 operatorë telefonie, me një numër në rritje përdoruesish. Në vitin 2003, zgjertimi në treg përfshiu fushën e komunikimit celular. Në qershor të vitit 2003 numëroheshin 996,288 përdorues të telefonisë celulare, nga vetëm rreth 800,000 në fund të vitit 2002.¹⁴⁸ Në Qarkun e Gjirokastrës janë ndërmarrë përmirësime të rëndësishme nga Albtelekom-i për të shtrirë linjat e tyre dhe për zëvendësimin e pajisjeve të vjetra me teknologji moderne. Në vitin 1996, në qytetin e Gjirokastrës u instalua një stacion i ri dixhital me kapacitet prej 2,000 numrash. Ky numër u rrit në vitin 1998 duke shtuar edhe 3,000 numra të tjerë. Në vitin 2001 Albtelekom-i instaloi edhe 2,500 numra, duke arritur një kapacitet prej 7,500 numrash (1,000 numra u instaluan në Libohovë të bashkisë së Gjirokastrës, 2,000 në Tepelenë dhe 1,500 në Memaliaj të bashkisë së Tepelenës, dhe 2,000 në Përmet dhe 1,000 në Këlcyrë të bashkisë së Përmetit). Pas instalimit të radio-transmetueseve dixhitale, sistemet e transmetimit u përmirësuan në të gjitha qytetet e qarkut. Në vitet 2003-2004 në çdo qytet të qarkut u instaluan eventualisht rrjete të telefonisë kabllore. Në zonat rurale, në zyrat e postës të komunave, u instaluan radio me katër kanale. Statistikat tregojnë se numri i abonentëve telefonikë në qark në vitin 2002 ishte 6,236. Shumica ishin abonentë familjarë (5,894), dhe pjesa e mbetur ishin zyra (342).¹⁴⁹ Pas aprovimit të liçencës së tretë të telefonisë celulare nga Albtelekom, shërbimet telefonike për qarkun e Gjirokastrës duhet të kompletohen në vitin 2005. Përsa i përket internetit, gjatë viteve 2003-2004, secili qytet i qarkut ishte në gjendje të lidhej me web-in mbarëbotëror. Një objektiv i pritshëm dhe thelbësor i Albtelekom-it është nxitja e procedurave teknikisht më preçize të faturimit.

Shërbimi Postar

Shërbimi postar në qark ka filluar të bëhet më i

organizuar dhe tani shtrihet në të gjitha pjesët e qarkut. Përveç shërbimeve të tij tradicionale, zyrat postare tani shpërndajnë pensione dhe mbledhin faturat e energjisë elektrike dhe të ujit. Këtu gjithashtu, besueshmëria dhe shpejtësia e shërbimit varet shumë nga cilësia e rrjetit të rrugëve, veçanërisht në zonat e thella dhe rurale të qarkut të Gjirokastrës.

Komunitetet Rome dhe Infrastruktura

Të dhënat statistikore mbi kushtet e infrastrukturës së komuniteteve Rome janë virtualisht inekzistente, sidomos në rang qarku. Ajo çfarë mund të themi është se po të krahasojmë infrastrukturën në lagjet brenda për brenda qytetit të Gjirokastrës, furnizimin konstant me ujë të pijshëm, shërbimin e besueshëm të furnizimit me energji elektrike, kushtet e rrugëve, dhe telekomunikacionet, ato janë shumë më të këqija në komunitetin Rom. Si rezultat, shumica e Romëve jetojnë në kushte ekstremisht të varfra, me një infrastrukturë që mungon plotësisht apo me kufizime për t'u aksesuar. Për shembull, vetëm 7% e romëve kanë një telefon në shtëpinë e tyre, dhe përafërsisht gjysma e tyre nuk mund të përballojë pagesën e faturave të tyre të energjisë elektrike. Meqë romët tentojnë të struken në lagjet periferike, ata shpesh nuk janë të lishur me shërbimet publike, me rrjetin elektrik, dhe kanë mungesë të alternativave të transportit. Duke jetuar në këto lloj kushtesh, përkrah mungesës së përgjithshme të kujdesit shëndetësor të përballueshëm, në mënyrë tipike, ata jetojnë 10-15 vjet më pak se popullsia jo-rome. Në qarkun e Gjirokastrës, akoma më shumë romë jetojnë në zonat rurale, gjë që i ekspozon ata ndaj rreziqeve më të mëdha për t'u privuar nga infrastruktura se sa ata që jetojnë në qendrat urbane.¹⁵⁰

148 Raporti i Progresit 2003 mbi Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim Ekonomik-Shoqëror, Këshilli I Ministrave, Tiranë 2004.

149 Rregjistri Statistikor i Bashkive, Këshilli I Qarkut, 2003.

150 Hermine De Soto, Ilir Gedeshi, Sabine Beddies, & Daniel

Perez, Romët dhe Jevgjit në Shqipëri: Nga Prjashtëmi Shoqëror në Përfshirjen Shoqërore apo Dilemma e Monedhës së Artë, Raport I: Rekomandime dhe Implikime Politike, Banka Botërore, Prill 2004.

Mjedisi

Degradimi i mjedisit është një shqetësim serioz në të gjitha zonat e Shqipërisë, sepse në rrjedhën e katër dekadave politikave ekonomike u fokusuan vetëm në plotësimin e objektivave të prodhimit pa marrë në konsideratë impaktin mjedisor. Rrjedhimisht, burimet natyrore u përdorën në mënyrë diskriminuuese, pa i vënë rendësi kufizimeve të tyre.¹⁵¹ Në vitet e fundit politikave të fokusuar në mbrojtjen e mjedisit dhe prodhimin e qëndrueshëm janë bërë prioritare. Këto aspekte janë thelbësore për rritjen afat-gjatë sepse vetëm duke përmirësuar cilësinë e jetës në të gjitha mjediset, mund të arrihet reduktimi i varfërisë. Në këtë kontekst ulja e varfërisë do të thotë jo vetëm nevojat bazë të zonave rurale (ujë i pastër, standarte të shëndetit publik, eliminim i mbetjeve), por në zonat urbane ku ka lloje të ndryshme të keqësimeve mjedisore.¹⁵²

Në vitin 1991, u krijua një Komitet i Mbrojtjes së Mjedisit (CEP) për të vepruar si një aparat rregullator, dhe në vitin 1993 u krijua një rrjet i përbërë nga 12 Agjensish Mjedisore Rajonale. Një Agjensi Rajonale Mjedisore u vendos në qarkun e Gjirokastrës dhe përgjegjësia e saj ishte të kryente vlerësime të impaktit mjedisor. Në vitin 1998, CEP u transformua në Agjensinë Kombëtare Mjedisore. Në vijim, qeveria krijoi të parën Ministri të Mjedisit në vend, në vitin 2001. Megjithatë, rolet dhe përgjegjësitë e Ministrisë vazhdojnë të jenë kaq ambiciozë sa ajo vazhdon të marrë vendime kyçe për mjedisin, kur kooperimi mes institucioneve të tjera qeveritare mungon. Në një nivel rajonal, Agjensitë Rajonale Mjedisore zotërojnë autoritet minimal legjislativ dhe burime të pamjaftueshme.

Përsa i përket sipërfaqes së tokës kombëtare, Shqipëria mbulon një sipërfaqe prej 28,748 kilometrash katrore, nga të cilat përafërsisht 37% janë të mbuluara nga pyjet, 25% nga toka bujqësore, 15% nga kullota dhe livadhe, dhe 23% nga zonat urbane, tokat e papërdorura malore dhe shkëmbore, dhe liqenet dhe rrugët ujore.¹⁵³ Në vitin 2000, pyjet produktive përfaqësonin 82.86% të zonës pyjore totale, krahasuar

me 87.28% në vitin 1993. Pyjet e vendeve malore që karakterizojnë rreth 80% të materialit duror në pozicion vertikal, në mënyrë tipike menaxhohen me metoda tradicionale të hollimit dhe prerjes së pastër. Rigjenerimi arrihet në mënyrë natyrale duke lënë pemët me farë, apo nëpërmjet përpjekjeve të rimbjelljes.¹⁵⁴ Në rajonin e Gjirokastrës ka në total 332,677 hektarë tokë. Megjithatë, gjatë dekadës së fundit ka pasur një pakësim të sipërfaqes së gjelbër për frymë. Kjo tendencë ka qenë më e dukshme në qytete si Gjirokastra ku shifrat kanë rënë nga 12 m² në 3 m² për frymë. Fatkeqësisht, gjithashtu ka pasur rënie masive në numrin e pemëve që janë mbjellë ndërmjet viteve 1990-2003.¹⁵⁵

Pyjet

Sipërfaqja totale e pyjeve në vitin 2000 ishte 0.991 hektarë ose afërsisht 37%, krahasuar me përafërsisht 1.07 milion hektarë në vitin 1990.¹⁵⁶ Kjo përfaqëson një ndryshim të sipërfaqes së mbuluar me pyje me rreth 8% krahasuar kjo me rritjen e raportuar prej përafërsisht 4% në vitet 1980-1990.¹⁵⁷ Vitet paraardhëse kanë parë pyje që janë tejpendorur dhe burime financiare për menaxhim që janë të tendosura. Ka pasur një mungesë kontrolli mbi aktivitetet ilegale të tilla si prerja diskriminuuese e drurëve, lejimi i kullotjes së bagëtisë, dhe zënia e tokave pyjore dhe kullotave. Përgjegjësia për rastet e përhapura të prerjeve ilegale të drurëve bie fillimisht mbi palët tregëtare dhe të varfërit e zonave rurale. Pyjet dhe kullotat, të kombinuara së bashku mbulojnë 64% të tokës në qarkun e Gjirokastrës. Ato strehojnë një shumëllojshmëri të faunës, si lepuj, ujç, derra dhe zogj, si thëllënza dhe zogj të zinj. Kullotat janë të paqumeshme si një burim ushqimi për blegtorinë dhe gjithashtu për rreth 120 llojet e bimëve medicinale të qarkut. Shumica e zonës pyjore gjendet në bashkinë e Përmetit, që përmban edhe pjesëm më të madhe të pyjeve malore dhe tokës së mbuluar me ferra të gjithë qarkut, i ndjekur nga Bashkia e Gjirokastrës. Bashkia e Gjirokastrës ka shumicën e pyjeve të tokave të ulëta, i ndjekur nga Bashkia e Përmetit.

151 Përgjigja Shqiptare ndaj Synimeve të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, Qendra e Promovimit të Zhvillimit Njerëzor, Tiranë, Maj 2002.

152 Raporti I Zhvillimit Kombëtar të Njerëzimit, 2004.

153 Përgatitja e një Harte Pyjore dhe e një Inventari Topografik I Pyjeve të Shqipërisë. Shogata Ndërkombëtare e Zhvillimit, Maj 1995.

154 Përgjigja Shqiptare ndaj Synimeve të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, Qendra e Promovimit të Zhvillimit Njerëzor, Tiranë, Maj 2002.

155 Rregjistri Statistikor I Bashkive, Këshilli I Qarkut, 2003.

156 Vlerësim Global I Burimeve Pyjore, EAO, Romë 2001.

157 Vjetari Statistikor I Shqipërisë, INSTAT, Tirana 1991.

Përbërja e Pyjeve të Qarkut sipas Rrehteve (Ha)¹⁵⁸

Bashkia	Totali	Pyje Malore	Pyje të tokave të ulëta	Tokë shkurre
Gjirokastra	30,471 (35.5%)	4,680 (33%)	13,920 (44.4%)	11,871 (29.5%)
Tepelene	17,284 (20.2%)	2,190 (15.5%)	5,194 (16.6%)	9,900 (24.6%)
Permet	38,000 (44.3%)	7,300 (51.5%)	12,230 (39%)	18,470 (45.9%)
Total	85,755	14,170	31,344	40,241

Sipas krahasimit, Bashkia e Tepelenës, në mënyrë domethënëse, në gjithë qarkun ka më pak pyje malore, pyje fushore dhe tokë shkurre. Siç është vënë re, druri është një burim predominues zjarri për familjet, dhe mbulon përafërsisht 68% të nevojave të familjeve rurale për ngrohje dhe gatim gjatë dimrit, dhe përafërsisht 53% të nevojave të familjeve rurale për energji gjatë verës. Gjithashtu drutë e zjarrit përmbushin 78% të nevojave totale të familjeve rurale për ngrohje.¹⁵⁹ Prandaj, arrihet në përfundimin e arsyeshem se shumë familje në bashkinë e Tepelenës jetojnë pa asnjë lloj burimi ngrohjeje sepse kjo bashki ka gjithashtu sasinë më të vogël të pyjeve me të cilat mund të ngrohni shtëpitë e tyre (megjithëse praktika e prerjes së druve është ilegale).

Gjatë periudhës së tranzicionit pati prerje diskriminuese të pyjeve dhe djegie masive. Degradimi i pyjeve të qarkut është i ashpër, veçanërisht në bashkinë e Përmetit dhe në zonat e Hillomose dhe Kardhiqit. Prandaj përpjekjet e koordinuara për pyllëzimin duhet të fokusohen në zonat më të prekura të qarkut. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet ruajtjes së tokës shtetërore, përmes mbjelljes së pishave dhe drurëve të tjerë me vlerë. Gjithashtu duhet të merret në konsideratë edhe mbjellja e pemëve që do të intensifikonin aktivitetin ekonomik të qarkut, veçanërisht në zonat e varfra. Mbjellja e bimëve medicinale e aromatike dhe e bimëve të tjera potencialisht me vlera ekonomike, do të ishte një mënyrë e shkëlqyer nëpërmjet të cilës do shtoheshin të ardhurat rurale.

Prodhimet Dytësore të Pyjeve

Bollëku i bimëve ekzistuese, bimëve medicinale dhe aromatike, rrëshirave të pemëve, frutave, perimeve, dhe farave të tjera mund të jenë produkte dytësore të rëndësishme për shitje brenda vendit dhe për eksport. Për shkak të mungesës së mjeteve përpunuese, para vitit 1990 shumë prej këtyre burimeve eksportoheshin si lëndë të para. Gjithashtu, gjatë dekadës paraardhëse u bë

privatizim, mbledhje dhe korrije masive, të pakontrolluara, e këtyre produkteve, gjë që shkaktoi degradim serioz. Tashmë, Drejtorja e Pyjeve dhe Kullotave është përgjegjëse për liçensimin e bizneseve private dhe për zbatimin e rregullave, por megjithatë, mbledhja ilegale e këtyre produkteve është ende e papërmbyshme, duke rënduar në këtë mënyrë një situatë tashmë delikate.

Kullotat

Kullotat përbëjnë përafërsisht 98,823 hektarë nga 288,468 hektarë toke totale në qark. Bashkia e Gjirokastrës ka rreth 45,809 hektarë kullota, Bashkia e Tepelenës ka rreth 30,014 hektarë dhe 23,000 hektarë kullota i takojnë bashkisë së Përmetit. Trazirat ekonomike të viteve 1990 rezultuan në një rritje të konsiderueshme të kërkesës për produktet e blegtorisë, duke ndikuar drejtpërdrejtë tek sipërfaqet e kullotave dhe duke shkaktuar një stres të pamasë mbi disponueshmërinë e këtij burimi të kufizuar. Madje edhe sot, kur pritet që mbarështimi i bagëtisë të bëhet shumë shpejt një burim parësor i zhvillimit ekonomik të qarkut, do të jetë themelore të sigurohet qëndrueshmëria e tokave të kullotave ekzistuese. Sikurse u përmend më parë, numri i bagëtisë ka pësuar rritje gjatë pak viteve të fundit, dhe, ndërsa ngastratë mëdha toke bujqësore janë kthyer në kullota, fuqia frytdhënëse e këtyre tokave do të përcaktojë suksesin e çdo projekti mbarështimi që do të ndërmerret në qark.

Toka e Mbrojtur për Shumëllojshmërinë Biologjike

Në proporcion më madhësinë e saj, Shqipëria është e pasur në shumëllojshmërinë biologjike, duke strehuar 30% të specieve europiane të bimëve dhe 42% të gjitarëve europianë.¹⁶⁰ Ajo përfiton gjithashtu edhe nga një larmi tokash ujore, laguna, dhe liqenjtë të mëdhenj që sigurojnë një banesë dimri për shumë zogj shtegëtues. Në vitin 1992, në përputhje me Bashkimin Ndërkombëtar të

158 Rregjistri Statistikor I Bashkive, Kështilli I Qarkut, 2003.

159 Përgjigja Shqiptare ndaj Synimeve të Zhvillimit të Mjësjeçarit, Qendra e Promovimit të Zhvillimit Njerëzor,

Tiranë, Maj 2002.

160 Vlerësim Mjedisor Post-Konfliktual i Shqipërisë, UNEP, Geneva, Nëntor 2000.

Ruajtjes së Natyrës, u krijua një rrjet i zonave të mbrojtura, dhe si rezultat sipërfaqja e përgjithshme e zonave të mbrojtura u rrit nga 3.79% që zinte në vitin 1998 në 5.8% në vitin 2000. Pavarësisht se është bërë progres, madhësia e zonave aktuale të mbrojtura mbetet e pamjaftueshme për të siguruar ruajtjen efektive të shumëllojshmërisë biologjike të vendit. Kjo është veçanërisht e vërtetë nën

dritën e faktit që aktivitetet e monitorimit dhe shtërngimit janë të pamjaftueshme, dhe ende duhet të hartohen plane menaxhimi të përgjithshme.¹⁶¹ Tabela e mëposhtme jep në detaje zonat e mbrojtura të qarkut, ato ekzistuese dhe ato të propozuara. Dukshëm, ekzistojnë vetëm tre zona të mbrojtura në gjithë qarkun, dhe ato ndodhen në bashkinë e Gjirokastrës.

Zonat e Mbrojtura Ekzistuese dhe të Propozuara (ZM) të Qarkut të Gjirokastrës¹⁶²

Emri i ZM	Madhësia e ZM	Statusi Ekzistues	Statusi i Propozuar	Bashkitë
Gryka e Këlcyrës – Uji i Ftohtë (Tepelenë) – Subash	50 km gjatësi e lumenjve Vjosë dhe Drino	Asnjë	Peizash Zonë e Mbrojtur	Bashkitë e Permetit, Tepelenës, dhe Gjirokastrës
Zheji	1500 ha	Monument Natyral	Rezervë Shkencore e Natyrës	Bashkia e Gjirokastrës
Kardhiqi	1800 ha	Rezervë Shkencore	Rezervë Shkencore	Bashkia e Gjirokastrës
Bredhi i Sotirës	1740 ha	Monument Natyral	Rezervë Shkencore e Natyrës	Bashkia e Gjirokastrës

Për më tepër, Banka Botërore ka zhvilluar një projekt afat-gjatë për investimin dhe menaxhimin e pyjeve, i titulluar, “Mbi Zhvillimin e Integruar të Pyjeve”. Në të mund të gjenden dy projekte pilot që synojnë të investojnë në ekosistemet pjellore të Bredhit të Hotovës dhe Bredhit të Sotirës, në qarkun e Gjirokastrës. Projektit të parë do t’i jepet një sipërfaqe prej 1,200 hektarësh park kombëtar, dhe i dyti do të kthehet në një park kombëtar prej 1,000 hektarësh. Për më tepër, zonat e tjera, të identifikuar se garantojnë mbrojtjen, përfshijnë luginën e Bënçës, Grykën e Këlcyrës, Ujin e Ftohtë, Rrepet e Prongjisë, Fushën e Çajupit, dhe Llufe në Nivicë të Kurveleshit, që mund të shndërrohet në rezerva që përmbajnë një larmi flore dhe faune.

Faunës

Varietetet e faunës në Gjirokastrë janë po aq të shumta sa edhe ekzotike. Pothuajse gjysma e gjitarëve mund të gjenden në rajon (31 nga 65), si dhe një numër i llojeve të lakuriqëve të natës që strehohen në shpella. Për sa i përket zogjve, 93 nga 320 specje që ka vendi, dihet se banojnë në qark. Lujina e lumit Drinos dhe lumi Vjosës veprojnë si një rrugë e rëndësishme migrimi, veçanërisht për

specjet globalisht të kërcënuara të quajtura Sokoli i kuqërrëmtë. Ky qark strehon gjithashtu 18 nga 37 specjet e zvarranikëve të Shqipërisë, dhe 10 nga 15 specje të amfibëve të vendit. Përsa i përket 60 specjeve të peshkut të ujërave të ëmbla, qarku numëron rreth 11 specje nga të cilat 5 po humbasin.

Gjuetia

Para vitit 1990, gjuetia ishte rreptësisht e kontrolluar dhe e rrallë. Vetëm personat që i përkisnin shoqatës shtetërore të gjahut ishin të lejuar të mbanin armë. Pas vitin 1990, gjuetia ilegale ka qenë plotësisht e pakontrolluar, duke pakësuar dhjetë herë numrin e kafshëve të egra. Një kuadër rregullator për të monitoruar situatën është i domosdoshme që të sigurojë që kafshët e egra nuk po zbrazen. Varfëria është pjesërisht fajtorë për gjuetinë ilegale, dhe si e tillë, përkrah teknikave rregulluese efektive, duhet të parashtrihen alternativa për ata që mbështeten tek mënyrat ilegale. Gjithashtu duhet konsideruar krijimi i rezervateve të specifikuar të gjahut si një mënyrë për rivitalizimin e zonave të caktuara rurale dhe për tërheqjen e turizmit. Zonat e identifikuar si potencialisht të favorshme për këtë qëllim, përfshijnë Çarçovën, Bredhi i Hotovës, Izvore-Rabies dhe

¹⁶¹ Përgjigja Shqiptare ndaj Synimeve të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, Qendra e Promovimit të Zhvillimit Njerëzor, Tiranë, Maj 2002.

¹⁶² Strategjia e Shumëllojshmërisë dhe Plani I Veprimt – Shqipëri, NEA, 1999.

Radat-Çatiste për gjuetinë e lepurit dhe drerit, dhe Sinanaj-Salari për gjuetinë e thëllënzës.

Ndotja e Atmosferës

Ndotja e mjedisit është një problem serioz në Shqipëri sepse për afro një gjysëm shekulli politikat ekonomike u fokusuan tek prodhimi pa i vënë rëndësi efekteve të tij negative. Përbërës i problemit është fakti se ndotja atmosferike në ajrin e Shqipërisë nuk monitorohet gjerësisht dhe nuk ekzistojnë statistika në nivel qarku. Konsensusi i përgjithshëm është se ndotja atmosferike, veçanërisht në qendrat urbane është një problem në rritje.

Burimet kryesore të cilësisë së ulët të ajrit përfshijnë nxjerrjen dhe përpunimin e naftës, ngrahjen shtëpiake, prodhimin e çimentos, dhe djegien e plehërave. Gjithashtu, gjatë dekadës së fundit ka pasur një rritje të shpejtë të numrit të automjeteve, 78% e të cilave konsumojnë diesel.¹⁶³ Sikurse është llogaritur në vitin 1999, gazi kryesor i serrave që çlirohet në Shqipëri është gazi karbonik, që rezulton në masë të madhe nga sektori i transportit dhe ai energjistik. Meqë Shqipëria çliron sasira kaq të vogla të gazit karbonik, nuk është e detyruar të marrë masa për reduktimin e tyre. Megjithatë Ministria e Mjedisit ka rekomanduar masa për periudhën 2002-2020 me qëllim që të parandalojë këtë problem gjithnjë në rritje.¹⁶⁴

¹⁶³ Përgjigja Shqiptare ndaj Synimeve të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, Qendra e Promovimit të Zhvillimit Njerëzor, Tiranë, Maj 2002.

¹⁶⁴ Përgjigja Shqiptare ndaj Synimeve të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, Qendra e Promovimit të Zhvillimit Njerëzor, Tiranë, Maj 2002.

Pjesa II

**Platforma e Programit: Duke
Vështruar përpara drejt 2015**

Objektivi 1: Zvogëlimi i Varfërisë dhe Pasigurisë së të Ardhurave

Prioritetet Strategjike të Parashtruara

SKZHES dhe Kornizat Kombëtare ¹⁶⁵	OZHM	KE ¹⁶⁶	Qarku i Gjirokastrës
1) Reduktimi i nivelit aktual të varfërisë në më shumë se 50% dhe eliminimi i varfërisë ekstreme; 2) Dyfishimi i rritjes së GDP për frymë në 2015; 3) Adresimi i nevojave të grave në varfëri; 4) U siguroi grave akses në institucionet kreditore; 5) Rritja e mundësitë e punësimit për gratë; dhe 6) Rritja e respektimit të të drejtave të minoriteteve duke përmirësuar kuadrin ligjor për minoritetet dhe zbatimin e një "Strategjie kombëtare për Romët" për të përmirësuar kushtet e jetesës. ¹⁶⁷	1) 50% reduktim në raportin e njerëzve që jetojnë me më pak se 1 dollarë në ditë dhe atyre që vuajnë nga uria; dhe 2) Investim në zhvillimin njerëzor – ushqim, shëndet (duke përfshirë shëndetin riprodhues), arsimimin, ujin dhe kanalizimet – për të nxitur një fuqi punëtore produktive që mund të marrë pjesë efektivisht në ekonominë botërore. ¹⁶⁸	1) Zhvillimi i sektorit privat përmes sektorëve të ndërmarrjeve konkurruese dhe të integruara në Shqipëri, q për të qenë në gjendje të tërheqë investimet e huaja direkte; 2) Krijimi i një mjedisi të sigurt për biznesin dhe një kornizë ligjore të përmirësuar, dhe rregjimeve fiskale në linjë me kërkesat e KE dhe OBT; 3) Adoptimi i një strategjie për të nxitur eksportin e prodhimeve bujqësore; dhe 4) Institute rregullatore të fuqizuara në fushën e sigurimit të ushqimit.	1) Reduktimi i nivelit të varfërisë me 50% dhe eliminimi i varfërisë ekstreme; 2) Rritja e zhvillimit industrial tregtar dhe krijimi i markave rajonale konkurruese; 3) Intensifikimi i planifikimit territorial dhe zhvillimi i infrastrukturës; dhe 4) Përcaktimi i nevojave të varfërisë specifike për gratë dhe përqëndrimi i përpjekjeve në problemet e Romëve.

Përshkrim

Pavarësisht burimeve të tij të pasura natyrore dhe vendndodhjes së favorshme gjeografike, qarku i Gjirokastrës po përballon probleme serioze me varfërinë. Megjithëse qarku ka një nivel mesatar HDI, niveli i tij i varfërisë mbetet shumë i lartë. 21% e popullsisë së Gjirokastrës jeton nën nivelin e varfërisë dhe pothuajse 10% konsiderohen shumë të varfër. Për më tepër, HDI për qarkun e Gjirokastrës është shumë më i ulët se sa fqinji i tij Greqia, e cila qëndron në nivelin 0.902. Megjithëse varfëria është një fenomen shumë dimensional, shkalla e lartë e varfërisë së të ardhurave është kryesisht i shoqëruar me sektorët e pazhvilluar industrialë, bujqësor dhe atë të turizmit, si edhe me zhvillimin e pamjaftueshëm të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Zhvillimi i ulët i aktiviteteve ekonomike rezulton në papunësi të lartë, që është një shkak kryesor i varfërisë të

të ardhurave në zonat urbane. Si rezultat, shkalla e papunësisë për qarkun e Gjirokastrës prej 21%, ndonëse paksa më e ulët se mesatarja në shkallë vendi prej 22.7%¹⁶⁹, është ende shumë e lartë.

Ndërsa si zonat urbane edhe ato rurale përballen me nivele të larta të varfërisë, shkalla e varfërisë në zonat rurale mbetet paksa më e lartë.¹⁷⁰ Së bashku, si zonat urbane edhe ato rurale që përballen me burime të kufizuara janë të ekspozuara ndaj pasigurisë së lartë të të ardhurave. Pikërisht, situata e varfërisë tenton të jetë më e ashpër në zonat urbane dhe veçanërisht ato rurale që nuk kanë burime të mjaftueshme bujqësore. Zonat rurale në qarkun e Gjirokastrës po përballen me probleme të tmerrshme. Niveli i lartë i emigracionit nga zonat rurale në ato urbane, dhe nga zonat e thella në ato në afërsi të

165 Prioritetet që i takojnë gjinisë janë marrë nga "Platforma Kombëtare e Veprimit për Përmirësimin e Statusit të Grave në Shqipëri"

166 Informacioni për këto prioritetë është marrë nga "Programi CARDS I Komunitetit Europian: Dokument i Strategjisë së Vendit, Shqipëria 2002-2006" botuar nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë për Ballkanin Perëndimor, KE.

167 Prioritetet që lidhen me minoritetet, veçanërisht atë Rom, janë marrë nga "Plani Veprues për Zbatimin e Prioriteteve Europiane për

Partnership", Shtator 2004.

168 Ky prioritet cilësohet në Kompaktin e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (botuar në 2003 si pjesë e Raportit të Zhvillimit Njerëzor). Ky është më shumë një deklaratë e natyrës shumëdimensionale të varfërisë se sa një prioritet.

169 INSTAT: REPOBA, 2001.

170 20.9% versus 20.4%.

qyteteve ka lënë prapa një popullsi të vjetër dhe braktisjen e disa fshatrave. Për më tepër qarku i Gjirokastrës vuan nga mungesa e tokës dhe nga madhësia shumë e vogël dhe shpërndarja e madhe e fermave. Pavarësisht këtyre mungesave të tokës, shkalla e madhe e emigrimit e çiftëzuar me nivelin e ulët të teknologjisë, do të thotë se ka një shfrytëzim nën kapacitet të tokës së disponueshme. Një analizë më e thellë nxjerr në pah se sektori bujqësor në qarkun e Gjirokastrës ka një natyrë të dyfishtë. Në njërin anë ka një shumicë të fermerëve të nivelit minimal të jetesës që prodhojnë për konsumin e tyre personal dhe që shesin vetëm mbiprodhimin mbi nevojat e tyre për ushqim. Nga ana tjetër ka një shtresë fermerësh tregtarë që sapo po lind me një numër të kufizuar, por që po rritet me shpejtësi, të cilët prodhojnë për treg. Problemet e përbaluara nga fermerët që sigurojnë ushqimin përfshijnë cilësinë e farave, mbarështrimet e pamjaftueshme të deleve dhe dhive, kujdesin e pamjaftueshëm shëndetësor për kafshët, çmimet e larta për makineritë bujqësore, sistemet e meta të ujitjes, dhe infrastrukturën e keqe të rrugëve për të transportuar mbiprodhimin në tregjet e qytetit. Fermerët tregtarë, përveç këtyre problemeve, përballohen gjithashtu me pasigurinë e pronës, padisponueshmërinë e kredisë për shkak të mungesës së kolateralit, tregëtimit të keq, informacionit minimal mbi tregun, infrastrukturën e keqe të tregut të shumicës, dhe konkurrimit jo të drejtë. Megjithatë shumë prej shqetësimeve të fermerëve që sigurojnë ushqimin janë duke u adresuar nëpërmjet projekteve të politikave publike të implementuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Departamenti i Bujqësisë në rrethe. Këto përfshijnë programet për regjistrimin e tokës, mbarështrimin e deleve dhe dhive, rehabilitimin e kullotave, dhe ndërtimin e sistemeve të ujit dhe infrastrukturës së rrugëve rurale. Duke pranuar këtë, mbetet një nevojë për të hartuar mekanizma më formale monitorimi, vlerësimi dhe përgjegjshmëri për institucionet bujqësore në nivel qarku, me qëllim që të përmirësohet në mënyrë radikale impakti i këtyre ndërhyrjeve. Gjithashtu, është e nevojshme të hartohen projekte të reja me qëllim që të mbështesin fermerët që sigurojnë nivelin minimal të jetesës, për shmangien e varfërisë, apo që të ndihmohen në synimet e tyre për t'u bërë fermere tregtarë. Fokusi për projekte potenciale mund të përfshijë përmirësimin e cilësisë së farërave, krijimin e kooperativave më makineri bujqësore, dhe përmirësimin e marrjes së informacionit mbi tregun. Ndërsa nevojat e fermerëve që sigurojnë ushqimin mbeten më shumë në problemet e shërbimeve publike, fermerët tregtarë kërkojnë shërbime tregtare, menjëherë sapo kërkesat bazë si siguria e tokës, ujitja dhe rrugët të plotësohen. Shërbimet tregtare përfshijnë marrjen e

informacioneve mbi tregun, përmirësimet e teknologjisë dhe marketimit, dhe skemat e kredisë tregtare nëpërmjet kooperativave. Fermerët tregtarë kanë nevojë për atë lloj informacioni profesional dhe të dhënë në kohën e duhur, të cilin shërbimi publik nuk mund ta sigurojë pasi i mungojnë kapacitetet, motivimi dhe burimet. Në këtë mënyrë, zhvillimi dhe zbatimi i një programi konsulence është i një domosdoshmërie reale. Problemet brenda sektorit bujqësor, në perspektivën afat-mesme dhe në afat-gjatë, mund të zgjidhen vetëm përmes një strategjie të integruar të zhvillimit rural. Kjo strategji, ndërmjet të tjerash, duhet të adresojë problemet e varfërisë që rrethojnë zhvillimin e biznesit, politikat sociale, problemet e mjedisit, dhe emigracionin. Plakja dhe braktisja e disa zonave të thella rurale e shoqëruar me migrim dhe emigrim gjithashtu meriton t'i kushtohet vëmendje. Përsa i përket prioriteteve sektoriale, qarku i Gjirokastrës ka një potencial të madh në zhvillimin e industrive të bulmetrave, djathit, një shumëllojshmëri perimesh, dhe pijeve alkoolike të tilla si vera dhe rakia. Djathi i Gjirokastrës është veçanërisht i njohur si djathi më i mirë në Shqipëri, sikurse dhe evidentohet nga kërkesa e madhe vendase. Megjithëse rajoni është i pasur me kullota për mbarështrimin e deleve, të nevojshme për rritjen e prodhimit të djathit, cilësia e produktit, siguria dhe metodat e tregëtimit janë shumë larg nga plotësimi i kushteve të kërkesës për eksport. Duke pasur parasysh potencialin për zhvillimin e industrisë së djathit, investimi për të krijuar një markë “Djath Gjirokastrë” është një prioritet i qartë. Rrjedhimisht, hulumtimi i tregut për të caktuar kërkesën vendase dhe të huaj, dhe kushtet e produktit, duhet të paraprijnë një projekt pilot të planifikuar me kujdes. Gjithashtu është e qartë se qarku i Gjirokastrës demonstroi një potencial të madh për zhvillimin e sektorit të vreshtarisë, i cili përfshin prodhimin e rakisë dhe të verës. Megjithatë, krijimi dhe organizimi i vreshtave është një kërkesë paraprake për zhvillimin e kësaj industrie. Krijimi i një marke të regjistruar legalisht, si p.sh. “Raki Përmeti”, gjithashtu ia vlen të avancohet nëpërmjet një projekti pilot. Në mënyrë të ngjashme me industrinë e djathit, një hulumtim i tregut për kërkesën e vendase dhe të huaj dhe për kushtet e produktit duhet të paraprijë një projekt pilot strategjik. Sikurse u përmend më sipër, një nga shkaqet kryesore të varfërisë në qarkun e Gjirokastrës është shkalla e lartë e papunësisë. Në vitin 2003, shkalla e panunësisë ra me një vlerë shokuese prej 14% nga ajo e vitit 1997. Kjo ndodhi pjesërisht për shkak të mbylljes së disa kompanive të mëdha si p.sh. Minierës së Memaliajt, fabrikës së prodhimit të këpucëve “Recor Albania”, Uzines Metalike në Gjirokastrë dhe kompanive të tjera eksportuese. Pas krizës së vitit 1997, të shkaktuar nga rënia e skemave

piramidale në mbarë kombin, disa kompani të mëdha dhe shumë ndërmarrje të vogla dhe të mesme ose u mbyllën ose u larguan nga qarku. Gjithashtu gjatë dekadës së fundit, papunësia e femrave është rritur më shumë se papunësia e meshkujve, kryesisht për shkak të mbylljes së disa kompanive të mëdha shtetërore që punësonin gra. Kjo ka shënuar një regres sepse shumë punëtore femra në zonat rurale i janë kthyer roleve tradicionale, gjë që u lejon atyre vetëm një pozitive shumë të kufizuar jashtë shtëpisë.

Biznesi jo bujqësor ka gjithashtu një natyrë të dyfishtë. Kompani të mëdha që operojnë në qark përfshijmë Alpha Glina, Anonime Kakavi, Harri Lena Fresh Company. Megjithatë, ka një moszhvillim serioz të sektorit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, nga ku shumica e atyre që ekzistojnë funksionojnë më tepër në tregëti dhe shërbime, se sa në sektorin industrial (më pak se 6% në vitin 2003). Në mënyrë të rëndësishme, ndërsa kompanitë e mëdha kanë relativisht imunitet ndaj problemit të burimeve, mbështetja e dhënë nga autoritetet publike, duke përfshirë ato të qarkut dhe bashkisë, ndaj ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme që po kalojnë probleme me burimet, kthehet në një çështje mbijetese. Shkalla e fillimit për bizneset e vogla dhe të mesme është e lartë (17% në vitin 2003), por problemet me të cilat ata përballen mund të jenë të pakapërcyeshme. Ka një mungesë të një fushe loje të niveluar, e shkaktuar nga mungesa e zbatimit të ligjit zbatimi selektiv i ligjislacionit, kryesisht përsa i përket taksimit dhe prokurimit publik, mundësia e marrjes kredi për shkak të problemeve kolaterale, cilësia e planeve të biznesit, dhe njohuritë minimale manaxheriale dhe informacioni mbi tregun. Në mënyrë kritike, këto probleme duhet të adresohen si një prioritet nëse duam të zhvillohet ky sektor dhe mundësitë përkatëse të punësimmit të burrave dhe grave së bashku.

Qarku ka gjithashtu burime të bollshme natyrore si gurët, lumenjtë dhe ujrat termale. Këto rezerva përmbajnë potencial për prodhimin e energjisë hidroelektrike, por ato gjithashtu mbeten të pashfrytëzuara për shkak të teknologjisë së dalë jashtë përdorimit dhe mungesës së investimeve. Tërheqja e investimeve direkte vendase dhe të huaja për të shfrytëzuar këto burime është prioritet i tillë sa që, në një përpjekje për të thithur investime të reja, duhet të futen kontratat me konçesion. Një partneritet midis qeverisë vendore, qeverisë qendrore dhe parlamentit është i domosdoshëm për të përfutur nga burimet rajonale që duhet të menaxhohen në nivel kombëtar.

Perspektiva e turizmit për qarkun e Gjirokastrës është i pamasë nëse do hartohej dhe zbatohet një program serioz për rehabilitim dhe restaurim. Atraksionet

përfshijnë Kështjellën e Gjirokastrës, disa shtëpi të vjetra qytetare me karakteristika unike, qendra arkeologjike në Luginën e Drinos, dhe një numër të madh të kishave antike, manastireve dhe xhamive. Për më tepër, peisazhi malor i qarkut të Gjirokastrës është i pjekur për zhvillimin e sporteve dhe ekoturizmit. Bazuar në gjetjet e një studimi të realizueshëm, nxitja e këtyre vendeve për zhvillimin e turizmit duhet të konsiderohet një prioritet.

Së fundmi, qarku i Gjirokastrës ka mungesë të infrastrukturës funksionale. Zhvillimi dhe përmirësimi i rrugëve, si atyre rurale edhe atyre kombëtare, një aeroporti, sistemit të ujësjellës-kanalizimeve, fuqisë hidroelektrike, komunikacionit, dhe mbledhjes dhe eliminimit të mbetjeve të ngurta, do të jenë themelet për një stabilitet dhe rritje ekonomike në qarkun e Gjirokastrës. Për të arritur këtë pikë përfundimtare, një planifikim territorial urban i bazuar në një studim GIS duhet të përbëjë bazat për zhvillimin e infrastrukturës. Këshilli i Qarkut është i ndërgjegjshëm se nuk ka ndonjë bar çudibërës për zhvillim, por nëpërmjet kësaj strategjie të zhvillimit rajonal ata synojnë të fokusohen në infrastrukturën, ndërtimin e institucioneve, dhe në nxitjen e investimeve në produktet dhe sektorët ku Gjirokastra tashmë e ka konfirmuar forcën për rritje dhe mundësinë. Në të njëjtën kohë, është kritike të gjendet një balancë efektive ndërmjet tregut dhe ndërhyrjeve të qeverisë me qëllim që kjo strategji të ketë sukses.

Synimet

- 1.1. Përgjysmimi i numrit të njerëzve që jetojnë me më pak se 2 dollarë në ditë, deri në vitin 2006, përmes nxitjes së prodhimit të fermave të vogla, duke përfshirë gratë, dhe duke mbështetur aktivitetet intensive, të orientuara drejt tregut, të ndërmarrja nga fermerët tregtarë, burra dhe gra.
- 1.2. Përgjysmimi i numrit të njerëzve që jetojnë me më pak se 3 dollarë në ditë deri në vitin 2010 dhe zvogëlimi i pasigurisë financiare përmes krijimit të punës. Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, duke mbështetur dhe inicjuar aktivitete të generimit të të ardhurave për gratë përmes mundësisë së marrjes së kredisë së vogël, trainimeve dhe mbështetjes teknike, kultivimit të burimeve të pasura natyrore dhe kulturore dhe zhvillimit të konkurrencës ndërmjet markave gjirokastrite, janë çelësi i zhvillimit afat-gjatë të qëndrueshëm dhe të balancuar në gjini.
- 1.3. Zhvillimi i infrastrukturës i bazuar në planifikimin e integruar rajonal territorial.

Treguesit

A). Shkalla e Papunësisë: Sipas Eurostat, shkalla e papunësisë në KE aktualisht është 8.1% (kjo kapasur një

ritje gjatë vitit të fundit nga 7.7%). Eurostat jep gjithashtu informacionin se rritja e punësimit ka qenë mesatarisht 1.5% në vitet parardhëse (nuk ka të dhëna të disponueshme për vitet 2002-2003). Sipas statistikave të INSTAT për vitin 2002, mesatarja e shkallës së papunësisë për Shqipërinë gjatë viteve 1992-2001 ishte 18.79% (kjo shkallë ndryshoi konsiderueshëm çdo vit – disa herë duke u rritur e herë të tjera duke u zvogëluar). Gjatë kësaj kohe, janë përdorur metodologji të ndryshme për llogaritjen e shkallës së papunësisë, e si rrjedhim shifrat mund të na gabojnë. Nga 1999-2001 shifrat janë më të sakta dhe reflektojnë një zvogëlim mesatar të papunësisë prej 2% në vit. Të dhënat e fundit të INSTAT konfirmojnë se shkalla e papunësisë është 15%. Treguesi i mëposhtëm është vendosur në bazë të zvogëlimit të parashikueshëm të papunësisë më 1% në vit. Kur konsiderojmë shkallën aktuale të papunësisë për qarkun e Gjirokastrës prej 12.7% është e mundur që deri në vitin 2015, qarku të arrijë normat e KE për papunësinë. Kanje mungesë të të dhënave të pranueshme mbi gratë, megjithëse të dhënat e disponueshme tregojnë se papunësia e grave predominon kundrejt tërësisë së popullsisë së papunë. Ekzistojnë shifra të larta të fshehura si për burrat edhe për gratë meqë fermerët nuk janë regjistruar si të papunë dhe meqë shumë gra nuk regjistrohen si të papuna në zyrat e papunësisë.

B). Përqindja e Familjeve që Përfitojnë Ndhimë

Ekonomike: Brenda shteteve anëtare të BE ekzistojnë skema të shumta të ndryshme të ndihmës ekonomike. Si rrjedhojë, është pothuajse e pamundur të formulohet

një përkufizim se çfarë është ndihma ekonomike, dhe prandaj, nuk ka tregues të qartë për këtë subjekt. Vëzhgimi i statistikave të mëparshme për përfitimin e ndihmës në para në vendet e BE, për vitin 1992 (të dhëna të Eurostat-it) tregojnë se 15.35% e popullsisë së Britanisë së Madhe morri një formë ndihme, krahasuar me Greqinë në nivelin 0.7%. Marrja mesatare e ndihmës në para (bazuar në nivelet e 12 nga 15 vendet e BE) ishte 5.97%. Nuk është e pritshme që qarku i Gjirokastrës të jetë në gjendje ta arrijë këtë mesatare në vitin 2015 dhe si i tillë, treguesi i parashikuar është vendosur arbitrarisht.

C). Shkalla e Vdekjes Foshnjore: Të dhënat e Eurostat-it tregojnë se nivelet e vdekjes foshnjore në BE vazhduan të bien deri në 4.5 vdekje për çdo 1000 lindje në vitin 2002, krahasuar me 4.7 në vitin 2001. Nivelet më të ulëta u shënuan në Suedi (2.8) dhe vlerat më të larta u gjenden në Greqi (5.9). Nivelet më të ulëta nga vendet hyrëse u shënuan në Slloveni (3.9) dhe niveli më i lartë në Letoni (9.8). Duke konsideruar mesataren e BE prej 4.5 dhe mesataren aktuale të qarkut të Gjirokastrës prej 14.95 (kjo shifër është më e ulët se mesatarja kombëtare prej 20.5), është e mundur që shkalla e vdekjes foshnjore deri në vitin 2015 të ulet në normat e BE. Një shqetësim special përbën numri i lartë i vdekjes foshnjore te vajzat dhe preferencës ndaj dhënies së kujdesit shëndetësor intensiv dhe ushqimit të djemve. Ky tregues konsiderohet “indirekt”, pasi ai përfaqëson përmirësimin tërësor të situatës së shëndetit si një rezultat i uljes së varfërisë.

Treguesit Aktualë dhe të Parashikuar:

OBJEKTIVI 1: Eliminimi i Varfërisë Ekstreme dhe Urisë								
Synimi	Treguesi	Mesatarja Kombëtare e Shqipërisë	Niveli Bazë për Qarkun e Gjirokastrës	2006	2009	2012	2015	Mesatarja e BE (Të dhëna nga Eurostat)
1.1.-1.2.	1. Shkalla e Papunësisë (%)	15% (INSTAT, 2003)	12.7 (INSTAT, 2003)	11	10	9	8	8% (mesatarja e BE 2003)
1.1.-1.2.	2. % e Familjeve që përfitojnë nga Ndhimë Ekonomike	22.06% (INSTAT, 2002)	10.20% (2001, 2003, Rregjistri Statistikor i Bashkive/ Këshilli i Qarkut)	9	8	7	6	5.97% (1992, bazuar në mesataren e 12 nga 15 vendeve të BEs)
1.1.-1.3.	3. Shkalla e Vdekjes Foshnjore për 1,000 Lindje	20.5 (2000, MoH)	14.95 (2000, Vlerësimi i Kushteve Socio-Ekonomike të bashkive të Shqipërisë – UNICEF)	13	10	7	4.5	4.5 (2002)

Programi i Zhvillimit¹⁷¹

Synimi 1.1.: Përgjysmimi i përqindjes së njerezve me të ardhura më pak se dy dollarë në ditë deri në vitin 2006 nëpërmjet nxitjes së prodhimit të fermerëve të vegjël, duke përfshirë gratë fermere, dhe duke mbështetur veprimtarinë intensive me orientim tregu të fermerëve tregëtarë meshkuj dhe femra.

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Periudha Kohore	Partnerët Potencialë	Kosto në Euro	Efekti
Mungesa e një pakete koherente politikash në nivel qarku që adreson problemet rurale.	Strategjia për zhvillim rural të integruar	Strategjia do të identifikojë shqetësimet ekonomike, sociale, gjinore dhe të mjedisit në zonat rurale dhe do të propozojë masat për t'i menaxhuar ato.	2005	Organizatat e Shoqërisë Civile, donatorët	50,000	Një strategji lejon një përdorim eficient të burimeve ekzistuese (financiare dhe të personelit) në shërbim të rritjes së sektorëve. Rezultatet e strategjisë do të ndikojnë pozitivisht mbi të gjithë treguesit.
Përdorim jo efikas i tokës për shkak të tokës së papunuar, pasigurisë së tokës, përmasës së vogël së ngastrave, dhe fermave të shpërhapura.	Programi i përmirësimit të përdorimit të tokës	Finalizimi i regjistrimit të tokës	2005	Projekti i regjistrimit të tokës, USAID, BE	150,000	Regjistrimi i tokës do të lejojë zgjerimin e huave me bazë-garancie për ndërmarrjet e vogla/të mesme, duke ulur kështu varfërinë dhe duke ndikuar pozitivisht të gjithë treguesit.
		Projekti pilot i konsolidimit të tokës në një nga komunat e ndodhura në zonën e ulët. Projekti do të numërojë dhe do të konvertojë të gjitha parcelat në një zonë, duke ndjekur shembullin Turk.	2005-2006	Universiteti Bujqësor i Tiranës, Ambasada Turke, donatorët	70,000	
Teknologjia e pamjaftueshme dhe çmimet e larta për makineri të reja	Projekt pilot për përdorim të përbashkët të makinerive bujqësore në një komunë të ndodhur në zonat e ulëta	Identifikimi i një grupi burrash dhe grash që dëshirojnë të bashkëpunojnë për një trainim mbi menaxhimin e shoqatave, një turne studimi, dhe dhënie e kredisë për makineri bujqësore.	2005-2007	Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, projekti 2KR (Japonez), donatorë të tjerë	150,000	Demonstrimi i përdorimit të pajisjeve dhe teknikave moderne mund të udhëheqë drejt një zgjerimi të këtij përdorimi në gjithë sektorin, duke çuar në rritjen e të ardhurave, uljen e papunësisë dhe duke ndikuar pozitivisht të gjithë treguesit.
Infrastrukturë e varfër ujitjeje dhe kullimi	Programi i rehabilitimit të infrastrukturës ujore	Rehabilitimi i ujitjes dhe kullimit në të gjithë tokën e përdorur për bujqësi.	2005-2010	MBU, Banka Botërore, IFAD 3	1,000,000	Zhvillimi bujqësor në rritje çon drejt uljes në tërësi të niveleve të papunësisë dhe varfërisë, duke ndikuar kështu pozitivisht të gjithë treguesit.
Cilësi e dobët e ushqimit për delet dhe gjedhët	Studim fizibiliteti për përmirësimin e ushqimit të gjësë së gjallë	Analizimi i llojeve më cilësore të ushqimit dhe zonave më të mira të rritjes, për të rritur prodhimin e bagëtisë dhe për një përdorim efikas të tokës.	2005-2006	Qeveria e Shqipërisë, Insituti i Forgjereve	80,000	Përmirësimi i zonave të mbarështimit dhe ushqimit do të çojë drejt një rritjeje të të ardhurave, uljes së papunësisë dhe një ndikimi pozitiv në tërësi mbi të gjithë treguesit.
Racat e papërshtashme të dhive dhe deleve	Projekti i përmirësimit të racës	Identifikimi i zonave të veçanta në të cilat racat kanë nevojë për përmirësim dhe cilat prej tyre do të prodhojnë produkte të cilësisë më të lartë, të ndjekura nga një integrim i koordinuar i racave të favorshme.	2005-2007	QSH, Projekti Ndërkombëtar i Lopës	350,000	Racat e përmirësuara të bagëtisë do të çojnë drejt një prodhimtarie më të lartë të qumështit dhe mishit, dhe kështu do të kontribuojnë në një rritje në të ardhura, ulje në papunësi dhe ndikim pozitiv mbi të gjithë treguesit.
Pamjaftueshmëri në kërkim tregu, mbrojtjen e bimëve, marketing (pas-korje, përcaktim cilësie, paketim) dhe shërbime të tjera për fermerët tregëtarë meshkuj dhe femra	Projekti i zhvillimit të konsulencës	Identifikimi dhe trainimi i një grupi konsulentësh tregëtarë që do të ndihmojnë fermerët tregëtarë meshkuj dhe femra në përmirësimin e teknologjisë së tyre dhe teknikave marketingut.	2005-2006	MBU, Projekti i Shërbimeve Bujqësore i Bankës Botërore, SNV, donatorë të tjerë	50,000	Aftësitë e konsulentëve tregëtarë do të ndikojnë indirekt te gjithë treguesit nëpërmjet dhënies së njohurive të tyre për përmirësimin e të gjithë sektorëve të bujqësisë.
Infrastrukturë e varfër tregu, akses i kufizuar në informacionin mbi tregun, dhe konkurrencë jo e pastër	Ndërtimi i tregjeve të shumicës në zonat më të mëdha urbane	Rehabilitimi dhe/ose ndërtimi i një serie vendesh tregëtimi me qëllim nxitjen e tregëtisë dhe të zhvillimit ekonomik lokal.	2005-2006	MBU, Drejtoritë Bujqësore, Bashkitë dhe Komunitat në Qarkun e Gjirokastrës	90,000	Vendet e tregëtimit do të ndikojnë indirekt shkallën e papunësisë në qark nëpërmjet një rritjeje të shitjeve të prodhimeve bujqësore.
	Projekt pilot për krijimin e	Identifikimi i një grupi fermerësh që dëshirojnë të bashkëpunojnë.	2005	Universiteti Bujqësor i	100,000	Nëse do të jenë të sukseshme, bashkësitë do

171 Shiko shenimin metodologjik, Aneksi 1.

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TE QARKUT GJIROKASTER 2005

	bashkësive të marketingut në një zonë, për të luftuar monopolin e shitësve të shumicës.	Trainim mbi menaxhimin e përbashkët.	2005	Tiranës, QSH, Qeveria Japoneze		të ofrojnë mundësi më të mëdha për të hyrë në tregje dhe do të ndihmojnë në uljen e shkallës së papunësisë nëpërmjet marketingut të mallrave bujqësore.
		Ofrimi i kredive për bashkësitë.	2006			
	Krijimi i njësive të informacionit mbi tregun dhe inteligjencës së tregut në Drejtoritë Bujqësore të qarqeve.	Mbështetje në ndryshimin e përshkrimit të punës së Drejtorive Bujqësore. Trainimi i njësive mbi inteligjencën dhe informacionin e tregut. Përhapja e informacionit nëpërmjet media-s, për shembull radio.			MBU, Drejtoritë Bujqësore	85,000 75,000 65,000
Pamundësia e kredisë për fermerët tregëtarë	Krijimi i Shoqatave të Kursimeve dhe Kredisë në 7 komuna	Kryerja e studimit të fisibilitetit për të vlerësuar potencialin e duhur për krijimin e Shoqatave të Kursimeve dhe Kredisë	2005	Bashkimi i Shoqatave të Kursimeve dhe Kredisë, Shoqëria Civile, donatorët	30,000	Rritja e mundësisë për të marrë kredi (dhe trainimi i nevojshëm mbi biznesin) do të ndikojë në mënyrë direkte shkallën e papunësisë, nëpërmjet krijimit të mikro-bizneseve të reja dhe përmirësimit të bizneseve ekzistuese.
		Bashkimi i Shoqatave të Kursimeve dhe Kredisë ndihmon në krijimin e shoqatave, duke u bazuar asistencën teknike për 3 vitet e para.	2005-2008	KQ, BSHKK, donatorët	350,000	
Zhvillim i pamjaftueshëm i sektorit të frutave dhe perimeve	Mbështetja e krijimit të biznesit tregëtar të frutave dhe perimeve në Përmet	Projekti do të përfshijë infrastrukturën, inputet dhe trainimin.	2005-2006	Projekti Shqiptaro-Holandez i lidhjeve të biznesit - PCO, kompania private "Agroblend"	150,000	Një sektor i përmirësuar frutash dhe perimesh i bazuar në kërkesat e tregut do të çojë drejt një të ardhme të përmirësuar për njerëzit e përfshirë në aktivitete të tilla, si rrjedhojë të ardhura të rritura.
	Projekti i demonstrimit të teknologjisë së frutave dhe perimeve, "Zona e Intesifikimit të Prioritetit"	Zbatimi i teknologjisë së frutave dhe perimeve dhe trainim për fermerët e interesuar.	2006-2008	QSH, Banka Botërore (projekti i shërbimeve bujqësore), donatorë të tjerë	100,000	papunësi e ulur dhe ndikim pozitiv mbi të gjithë treguesit.
Nivel i ulët i prodhimit bujqësor duke përfshirë këtu prodhimin e dobët të bagëtisë dhe të korrave, përdorim i teknologjive të vjetëruara të prodhimit, dhe njohuri të vjetëruara të grave fermere.	Fillimi dhe mbështetja e trainimeve, njohja me teknologjinë e sotme, si dhe njohuri të reja për gra fermere	Dhënie trainimesh mbi prodhimin modern bujqësor.	2005-2010	MBU, donatorët, OJQ-të e Grave, Drejtoritë Bujqësore, Bashkitë dhe Komunitat në Qarkun e Gjirokastrës	60,000	Prodhimi i lartë bujqësor, të ardhurat e rritura për gratë, shëndeti familjar i përmirësuar dhe fuqizimi i grave fermere nëpërmjet përmirësimit të statusit të tyre, do të ndikojnë pozitivisht të gjithë treguesit.
		Lehtësimi i partneriteteve trainuese ndërmjet grave fermere në prefekturë dhe në shkallë kombëtare/ndërkombëtare duke organizuar udhëtime studimore për të shkëmbyer eksperiencat dhe për të mësuar rreth teknologjive.	2005-2007	MBU, Donatorët, OJQ-të e Grave, Drejtoritë Bujqësore, Bashkitë dhe Komunitat në Qarkun e Gjirokastrës.	75,000	
		Krijimi dhe fuqizimi i grupeve të pavarura të grave fermere për të shkëmbyer eksperiencat e mira (kjo mund të jetë një pikënisje për aktivitete të tjera, si p.sh. informim mbi shëndetin riprodhues, planifikimin familjar, çështjet gjinore).	2005-2009	MBU, Donatorët, OJQ-të e Grave, Drejtoritë Bujqësore, Bashkitë dhe Komunitat në Qarkun e Gjirokastrës	250,000	
		Dhënie aksesit në teknologjinë moderne të prodhimit nëpërmjet kredisë, dhurimeve në natyrë.	2006-2010	MBU, donatorët, OJQ-të e Grave, Drejtoritë Bujqësore, Bashkitë dhe Komunitat në Qarkun e Gjirokastrës.	500,000	

Synimi 1.2.: Përgjysmimi i përqindjes së njerëzve me të ardhura më pak se tre dollarë në ditë deri në 2010 dhe ulja e pasigurisë financiare nëpërmjet krijimit të punës. Zhvillimi i ndërmarjeve me përmasa të vogla dhe të mesme, fillimi dhe mbështetja e aktiviteteve që gjenerojnë të ardhura për gratë, nëpërmjet aksesit drejt kredisë, trainimi dhe mbështetja teknike, kultivimi i burimeve të pasura natyrore dhe kulturore, dhe zhvillimi i konkurrencës ndërmjet degëve të Gjirokastres, janë çelësi drejt zhvillimit të qëndrueshëm afatgjatë dhe të barabartë gjinor

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Periudha Kohore	Partnerët Potencialë	Kosto në Euro	Efekti
Mungesa e një fushe të qëndrueshme veprimi për zhvillimin e ndërmarjeve të vogla dhe të mesme	Krijimi i një këshilli këshillimor rajonal biznesi	Këshilli do të veprojë si një forum në të cilin mund të diskutohen shqetësimet e biznesit, i udhëhequr nga Dhoma e Tregëtisë nëpërmjet Kryetarit të Këshillit të Qarkut.	2005	Dhoma e Tregëtisë, zyrat e Tatim-Taksave, zyrat e Prokurimit Publik, Shoqëria Civile	10,000	Partneriteti i përmirësuar do të lehtësojë zgjidhjen e problemit dhe do të nxisë një zhvillim të gjerë ekonomik, duke ndikuar kështu indirekt treguesin e papunësisë. Investimi i huaj i rritur, ndërgjegjësimi mbi marrëveshjet e lira tregëtare, dhe të tjera çështje specifike ekonomike rajonale do të jenë fokusi i këtij grupi.
Marrje me vështirësi e kredisë për ndërmarjet e vogla dhe të mesme	Krijimi i një fondi lokal të garancisë së huasë	Përgatitje metodologjike, shpërndarja fillestare e fondit, dhe një numër i kufizuar huash afatgjata.	2005-2006	UNOPS, SEED, BESA, MADA dhe të tjera banka tregëtare	1,000,000	Një numër i rritur huash do të ofrojë kapital më të madh për bizneset e reja dhe zgjerim të ndërmarjeve ekzistuese, duke ndikuar kështu pozitivisht treguesin e papunësisë.
Informacion i	Krijimi i një	Sigurimi i hardware dhe software të	2005-2006	Dhoma	10,000	Marketingu i përmirësuar do
pamjaftueshëm mbi tregun	qendre informacioni mbi tregun në Dhomën e Tregëtisë	nevojshëm, lidhjes me internetin, dhe trainim për 1 vit, pas të cilit kjo qendër do të bëhet e pavarur.		Amerikane e Tregëtisë (AmCham), agjensia SME, Organizatat e Shoqërisë Civile, ARZH		të japë një rritje të të ardhurave të biznesit, dhe si rrjedhojë do të nxisë rritjen e bizneseve. Kështu, kjo iniciative ndikon në mënyrë indirekte treguesin e shkallës së papunësisë.
Teknologjia e vjetëruar e përpunimit të qumështit dhe marketingu i dobët	Projekti i fabrikës së ambalazhimit të qumështit të lopës	Ndërtimi i një fabrike për ambalazhim, në një vend strategjik, me një teknologji të konsoliduar dhe e shoqëruar me teknika të përparuara marketingu.	2005	QSH, Land O'Lakes, grant Japonez	140,000	Përmirësimi i higjenes së ambalazhimit të qumështit duhet të çojë drejt përfitimeve më të mëdha të bizneseve, duke nxitur kështu rritjen e biznesit dhe të nivelit të punësimit.
	Projekti pilot për markën "Djath Gjirokastre"	Duke ndjekur kërkimin mbi tregun për të identifikuar kërkesat e brendshme dhe të jashtme, projekti do të zbatohet nga 1 biznes i prodhimit të djathit me anë të një teknologjie të re prodhimi, sigurie më të madhe (nëpërmjet HACCP), teknikave moderne të marketingut, dhe zotërimit të certifikatës së origjinës.	2005-2007	QSH, Land O'Lakes, granti Japonez, BE/PNUD, Projekti i Tregëtisë dhe i Investimeve të Huaja Direkte	185,000	Të rritet vlera e tregut të "Djathit Gjirokastre" dhe më në fund të shitet si një eksport, të zhvillohet industria dhe të rriten të ardhurat.
Teknologjia e vjetëruar e përpunimit të rrushit dhe marketingu i dobët	Projekti pilot i markës "Raki Përmeti"	Duke ndjekur kërkimin mbi tregun për të identifikuar kërkesat e brendshme dhe të jashtme, projekti do të zbatohet nga 1 komunë me anë të një teknologjie të re prodhimi, sigurie më të madhe (nëpërmjet HACCP), teknikave moderne të marketingut, dhe zotërimit të certifikatës së origjinës. Projekti mund të mbështetë shoqatat e prodhuesve të rrushit ose të mbetet me bazë në komunë.	2005-2007	QSH, Land O'Lakes, granti Japonez, BE/PNUD, Projekti i Tregëtisë dhe i Investimeve të Huaja Direkte	200,000	Një projekt pilot i sukseshëm do të çojë drejt përhapjes së aktiviteteve të tilla nëpër gjithë qarkun, duke rritur kështu punësimin nëpërmjet formimit të ndërmarjeve të reja dhe duke ndikuar pozitivisht treguesin e papunësisë.
	Keqpërdorimi i burimeve të gurëve dhe lumenjve	Ndërtimi i hidrocentraleve e për Kalivacin (Vjosa), Suhën, Këlcyrën, Selckën	Të ofrohen Kontrata Konçensionale për të nxitur investimin në infrastrukturë dhe për të siguruar një burim të qëndrueshëm përfitimi për kompaninë investuese.	2005-2010	KESH, kompanitë italiane, donatorët, QSH	150,000,000
Minierat e gurit në Dropull, Zagori, Përmet dhe Memallaj		Të ofrohen Kontrata Konçensionale për të nxitur investimin në infrastrukturë dhe për të siguruar një burim të qëndrueshëm përfitimi për kompaninë investuese.	2005-2010	Donatorët, QSH	10,000,000	
Rehabilitimi i zonës së urrave termale në Bënja		Të ofrohen Kontrata Konçensionale për të nxitur investimin në infrastrukturë dhe për të siguruar një burim të qëndrueshëm përfitimi për kompaninë investuese.	2005-2008	Donatoret, QSH	500,000	

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TE QARKUT GJIROKASTER 2005

Përdorimi jo i mjaftueshëm i prodhimeve pyjore dytësore si bimët mjeksore dhe aromatike	Përdorimi i prodhimeve pyjore dytësore nga gratë fermere, të cilat duhet të shtojnë të ardhurat e tyre	Kërkim tregu dhe studim fizibiliteti, duke blerë pajisje, duke zotëruar teknologji përfshirë këtu përpunimin dhe paketimin, dhe duke krijuar rrjete shpërndarjeje.	2005-2010	MBU, Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave, donatorët, komuniteti, OJQ-të e grave, sektori privat	80,000	Rritja e përdorimit dhe marketing-u i këtyre prodhimeve do të ndikojnë drejtpërdrejt dhe pozitivisht shkallën e papunësisë.
Kushtet e këqija të vendeve arkeologjike dhe kulturore të qarkut të Gjirokastrës	Programi i mirëmbajtjes dhe rehabilitimit kulturor e arkeologjik	Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e disa shtëpive të varfra në qytetin e Gjirokastrës.	2005-2010	BE (Koperimi Përmes Kufijve), UNESCO, donatorë të tjerë	1,400,000	Rehabilitimi dhe mirëmbajtja do ta bëjë Gjiroakstrën me tërheqëse për turizmin e brendshëm dhe të jashtëm dhe do të rrisë zhvillimin e biznesit, duke prekur kështu pozitivisht treguesit e papunësisë dhe asistencës sociale.
		Riparimi i Kështjellës së Gjirokastrës.				
		Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e pasurisë arkeologjike në Luginën e Drinos.				
		Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e kishave, manastireve dhe xhamive të lashta.				
Niveli i ulët i shërbimeve të turizmit në zonat me potencial turistik	Promovimi i programit të eko-turizmit dhe sportit	Kryerja e një studimi fizibiliteti për të përcaktuar destinacionet potenciale turistike, strategjitë e marketingut (duke përfshirë guidat turistike), identifikimi i problemeve (infrastrukturë e keqe, mbrojtja e vendeve arkeologjike, nevojat për trainim) dhe strategjitë e pjesëmarrjes së komunitetit.	2005	Ministria e Turizmit, pushtetet në nivel bashkie dhe komune, donatorët, qytetarët e Qarkut të Gjirokastrës	70,000	Turizmi është gjenerues i njohur punësimi, si rrjedhojë këto iniciativa do të ulin shkallën e papunësisë dhe numrin e qytetarëve që varen nga asistencën sociale.
		Zabtimet e projektit pilot, sic është identifikuar nga studimi i fizibilitetit.	2005-2008		700,000	
		Zgjerimi i iniciativave të turizmit nëpërmjet ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.	2005-2010		1,000,000	
Braktisja e inustrisë së vogël artizane të punës së dorës	Ringjallja e industrisë tradicionale artizane për të mbështetur punësimin e grave	Kërkim tregu dhe studim fizibiliteti, duke blerë ose ribërë teknologji / vegla, krijimi i shoqatave artizane, dhe krijimi i rrjeteve të shpërndarjes.	2005-2010	Bankat, sektori privat, Dhoma e Tregëtisë, OJQ-të e Grave, Donatorët, Komuniteti	50,000	Status i përmirësuar ekonomik i grave dhe shkallë më e ulët papunësie nëpërmjet mundësive të më të shumta për punë.
Shkallë e lartë papunësie në komunitetin Rom	Mbështetje në ndërtimin e një fabrike shelgu dhe gjineshtre	Kërkim mbi tregun e eksportimit të shelgut dhe gjineshtres.	2005	Pushtetet në nivel komune dhe bashkie, donatorët, qytetarët e Qarkut të Gjirokastrës	20,000	Dhënia e mundësive për punësim do të ulë shkallën e papunësisë në popullsinë Romë si dhe numrin e njëzve të varur nga asistencën sociale.
		Mundësimin e marrjes së kredisë nga bizneset.	2005-2007		50,000	
Shkallë e lartë papunësie mes grave dhe mundësive për të gjeneruar të ardhura për gratë	Gra të fuqizuara duke filluar dhe mbështetur aktivitete që gjenerojnë të ardhura nëpërmjet NVM-ve	Kërkim tregu dhe studim fizibiliteti për të identifikuar hendeqet dhe kthinat në ekonominë lokale, që mund të jepen nga NVM-të funksionuese të grave.	2005-2006	Bankat, sektori privat, Dhoma e Tregëtisë, OJQ-të e Grave, Komuniteti i Donatorëve	50,000	Status i përmirësuar ekonomik i grave dhe shkallë më e ulët papunësie nëpërmjet mundësive të rritura për punë.
		Lehtësimi i aksesit për kredi për gratë dhe nxitja e mbledhje dhe mobilizimit të kursimeve të grupit dhe komunitetit.	2006-2009		100,000	
		Dhënie e asistencës teknike dhe trainimeve periodike për gratë për të ngritur dhe menaxhuar NVM-të.	2006-2010		250,000	

Synimi 1.3.: Zhvillimi i infrastrukturës duke u bazuar në planifikimin rajonal territorial të integruar

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Periudha Kohore	Partnerët Potenciale	Kosto në Euro	Efekti
Mungesë e planifikimit territorial rural dhe urban	GIS	Caktimi i burimeve natyrore duke përfshirë burimet njerëzore, tokësore, infrastrukturën dhe habitat-in.	2005-2006	Pushtetet në nivel komune dhe bashkie, donatorët, qytetarët e Qarkut të Gjirokastrës	500,000	Planifikimi më i gjerë do të çojë drejt një përdorimi më të mirë e të qëndrueshëm të burimeve dhe një zhvillimi tregëtar më efektiv. Këto iniciativa do të ndikojnë indirekt dhe pozitivisht treguesit e papunësisë dhe asistencës sociale.
	Zhvillimi i planit rajonal	Plani do të adresojë, ndërmjet gjërave të tjera, çështjet e infrastrukturës, mjedisit dhe zonave industriale.	2006		65,000	
	Të zhvillohet një plan zonë për zonat urbane	Plani i zonave urbane do të adresojë çështjet e infrastrukturës, si rrugët urbane, sistemet e ujrave të zeza, habitat-in, zonat industriale dhe infrastrukturën sociale.	2005		80,000	
Infrastrukturë e keqe e rrugëve rurale	Programi i rehabilitimit të rrugëve rurale	Mbështetje për dizajnimin dhe ndërtimin e rrugëve të reja dhe rehabilitimi i rrugëve të vjetra.	2005-2010		470,000	Rrugët e mirëmbajtura të transportit do të rrisin të

Infrastrukturë e keqe e rrugëve nacionale	Programi i rehabilitimit të rrugëve nacionale, duke përfshirë dhe pikat e doganës	Rruga Kakavijë-Gjirokastrë-Tepelenë.	2005-2010	KQ, Donatorët, QSH, ADF	1,000,000	ardhurat nëpërmjet tregëtisë së rritur dhe koston më të ulët të eksport/importit, duke prekur kështu pozitivisht tregësitë e papunësisë dhe asistencës sociale.
		Rruga Ura e Lekelit- Tri Urat.			600,000	
Mungesë e infrastrukturës së transportit ajror	Projekti i aeroportit të Gjirokastrës	Të kryera në bazë të kontratave konçensionale, duke përdorur hapësirat ekzistuese.	2005-2012	KQ, Donatorët, QSH,	Kosto të përcaktuara mbas studimeve të fisibilitetit	Një aeroport do të ishte një qëndër e dobishme ekonomike për qarkun e Gjirokastrës dhe do të ndihmonte në uljen e papunësisë.
Furnizim i pamjaftueshëm më ujë për shkak të infrastrukturës dhe menaxhimit të varfër të ujit dhe kanalizimit të ujërave të zeza	Rehabilitimi dhe zgjerimi i programit për sistemin e ujit dhe kanalizimit të ujërave të zeza	Projekt i ri për furnizimin me ujë të Gjirokastrës.	2005	KQ, Donator, QSH, ADF, Pushtetet në nivele bashkie dhe komune	35,000	Menaxhimi i përmirësuar i ujit dhe ujërave të zeza do të mbështesë zhvillimin e biznesit (në këtë mënyrë do të ndikojë indirekt në tregësitë e asistencës sociale dhe të papunësisë) duke siguruar në të njëjtën kohë pastrimin e ujit të pishëm dhe si rrjedhim reduktimin e shkallës së vdekshmërisë foshnjore.
		Zgjerim i rrjetit të tubacioneve të ujit për qytetin e Këlcyrës.	2005		35,000	
		Ndërtimi i një rrjeti për furnizimin me ujë për qytetin e Përmetit – zona SMT.	2005-2005		30,000	
		Rindërtimi i rrjetit për furnizimin me ujë në Tepelenë dhe Memaliaj.	2005-2006		750,000	
		Ndërtimi i rrjetit për furnizimin me ujë ndërmjet Lekel dhe Tepelenë.	2005-2006		1,000,000	
	Asistence teknike për pushtetet vendore dhe të sistemit ujor	Trainim mbi menaxhimin i stafit të kompanisë së sistemit ujor.			KQ, Donatorë, QSH, ADF, Pushtetet në nivele bashkie dhe komune	80,000
Mungesë e sistemit për grumbullimin dhe hedhjen e plehrave të ngurta	Projekti “Gjirokastra e pastër dhe e gjelbër”	Asistencë teknike mbi menaxhimin e plehrave të ngurta e ofruar nga Bashkia e Tiranës, duke përfshirë një udhëtim studimor qytetit Catawba, SHBA.	2005	SHC, USAID, Qyteti Catawba, SHBA	150,000	Rrugët e pastra dhe plehra të riciklueshme do të çojnë drejt një furnizimi me ujë më të pastër, duke ndikuar kështu pozitivisht mbi tregësinë e vdekjes foshnjore. Kompania e grumbullimit/reciklimit të plehrave do të gjenerojë gjithashtu të ardhura, duke ndikuar në këtë mënyrë në tregësitë e asistencës sociale dhe të papunësisë.
		Zhvillimi i sistemit privat për grumbullimin e plehrave të ngurta.	2005-2007	SHC, USAID, Qyteti Catawba, SHBA	1,500,000	
		Aktivitetet e pastrimit të komunitetit dhe shoqërisë civile dhe krijimi i një politike ricikluese.	2005-2007	SHC, USAID, Qyteti Catawba, SHBA	1,200,000	
		Instalimi i njësie ricikluese të plehrave.	2007	SHC, USAID, Qyteti Catawba, SHBA	1,700,000	
Ndërprerja e energjisë elektrike dhe tensioni i ulët	Rehabilitimi dhe zhvillimi i rrjetit elektrik	Ndërtimi i nënstacioneve elektrike në Gjirokastrë.	2005-2007	KESH, Kompani gjermane	2,300,000	Përmirësimi i furnizimit me energji elektrike do të ndikojë në të gjithë tregësitë nëpërmjet sigurimit të energjisë për ndërmarrjet, spitalet, klinikat, qëndrat e pompave dhe pastrimit të ujit.
		Ndërtimi i nënstacioneve elektrike në Përmet.	2005-2007	KESH, Kompani gjermane	1,800,000	
		Rehabilitimi i rrjetit energjiek për hapësirat rurale.	2005-2006	KESH	2,200,000	
Ndricim i keq urban	Projekti i ndriçimit urban	Ndërtimi i shtyllave në vende strategjike për të rritur trafikun dhe sigurinë e këmbësorëve, dhe nxitjen e tregëtisë në rrethet tregëtare.	2005-2008	Donatorë, Bashkitë	600,000	Ndricimi i zonave tregëtare do të çojë drejt një rritjeje të aktivitetit ekonomik duke ndihmuar në këtë mënyrë në uljen shkallës së asistencës sociale dhe papunësisë.
Infrastrukturë e pamjaftueshme telefonike dhe e komunikimeve	Shtirja e rrjetit me fibër optike nga Fieri në Gjirokastrë	Ndërtimi i rrjetit dhe përmirësimi i sistemit ekzistues për menaxhimin e një përdorimi në rritje.	205-2006	Albtelekom	300,000	Rrjeti i fibrës optike dhe sistemet telefonike janë elementet kyç për zhvillimin ekonomik dhe do të ndikojë indirekt dhe pozitivisht në shkallën e asistencës sociale dhe papunësisë.
	Sigurimi i rrjeteve telefonike, veçanërisht në zonat rurale	Rehabilitimi i rrjeteve ekzistuese.	2006	Albtelekom		

Objektivi 2: Arritja e Arsimit Parësor Cilësor Universal deri në Vitin 2010**Prioritetet Strategjike të Parashtruara**

SKZHES dhe Platformat Kombëtare	OZHM	KE ¹⁷²	Qarku i Gjirokastrës
1) 100% regjistrim në arsimin fillor; dhe 2) 90% regjistrim në arsimin e mesëm dhe jo më pak se 13.5 vjet arsim për nxënës.	1) 100% e vajzave dhe djemve që mbarojnë arsimin fillor.	1) Rritja e nivelit të arsimit të përgjithshëm, arsimit të lartë, trainimeve profesionale, dhe nxitja e bashkëpunimit mes të rinjve; 2) Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme për zbatimin e standarteve të larta në të gjitha nivelet e arsimit; 3) Përmirësimi i frekuentimit të shkollës në arsimin fillor dhe të detyruar, 4) Ekuilibrimi i kërkesës dhe ofertës nëpërmjet konsolidimit të arsimit në zonat rurale dhe optimizimit të burimeve njëzëre dhe teknike; dhe 5) Riorganizimi i formimit profesional për të plotësuar kërkesat e tregut të punës	1) 100% e vajzave dhe djemve që mbarojnë arsimin fillor. 2) Rritje e regjistrimit në nivel universitar dhe të mesëm për meshkujt dhe femrat; 3) Harmonizimi i kurrikules dhe teksteve shkollore të përmirësuara për t'ju përgjigjur kërkesave të tregut nëpërmjet eliminimit të stereotipeve gjinore dhe përfshirjes së realitetit historik të popullsisë minoritare; dhe 4) Romët-Cështje arsimore specifike të adresuara.

Përshkrimi

Qarku i Gjirokastrës është njohur historikisht për nivelin e lartë të arsimit të banorëve të tij, megjithëse situata ka ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme gjatë dekadës së fundit. Si rezultat i ndryshimeve të shpejta politike, sociale dhe ekonomike, sistemi i arsimit është përkeqësuar. Sistemi i tanishëm i arsimit nuk është i suksesshëm në tërheqjen dhe sigurimin e arsimit cilësor për të gjithë fëmijët në moshë të arsimit fillor. Gjithashtu, përqindja e atyre të regjistruar në arsimin e mesëm është mjaft e ulët, ndërsa arsimi profesional nuk plotëson nevojat e tregut. Është prioritet që të gjithë fëmijëve, vajza dhe djem të Qarkut të Gjirokastrës, t'u sigurohet të paktën arsimi 8 vjecar. Shkalla e tanishme e regjistrimit prej 96%, e shoqëruar me përkeqësimin e standarteve të arsimit kërkon ndërhyrje të menjëhershme. Shkaku kryesor i rënies së shkallës së regjistrimit është rënia e kërkesës. Prindërit, veçanërisht ata të varfërit, po bëhen gjithnjë e më shumë të pandërgjegjshëm se kosto e mosregjistrimit të fëmijëve në shkollë do të thotë më pak mundësi për ta në të ardhmen, sidomos në periudhë afatgjatë. Shëndeti i keq dhe infrastruktura e keqe e ndërtesave në një shkallë më të ulët

kontribuojnë në kërkesën e ulët.

Si rrjedhojë, adresimi i kësaj rënieje për arsimin është urgjente. Ndihma e familjeve të prapambetura ekonomikisht, parandalimi i largimeve nga shkolla dhe rritja e ndergjegjësisimit në favor të arsimit të vajzave dhe djemve është kritik. Megjithatë, nxitja për arsim, do të jetë e suksesshme vetëm nëse përmirësohet cilësia e arsimit. Kjo është e vërtetë jo vetëm në lidhje me rinovimin e infrastrukturës dhe vlefshmërinë e pajisjeve por gjithashtu edhe me kualifikimin e mësuesve, motivimin dhe përgjegjshmërinë. Migrimi i shpejtë i banorëve nga zonat e largëta në zonat rurale dhe nga zonat rurale në ato urbane kanë ndryshuar kushtet e ofertës dhe kërkesës për arsim. Tani ka shkolla në vendodhje të largëta me numër të pamjaftueshëm të fëmijëve dhe gjithashtu shkolla në zonat rurale dhe urbane që janë tejet të mbipopulluara. Rifillimi i investimeve dhe një plan taktik janë të domosdoshme. Një ndërhyrje përfshin restaurimin dhe rindërtimin e shkollave në zonat rurale dhe urbane që përfshin pajisjet e duhura. Një ndërhyrje tjetër sillet rreth një programi të shkollës fillore për zonat e largëta dhe rurale. Të dyja janë kritike për zhvillimin e

¹⁷² Informacioni për këto prioritetet është marrë nga "Programi CARDS i Komitetit Europian: Dokument i Strategjisë së Vëndit,

Shqipëria 2002-2006" botuar nga Drejtorja e Marrëdhënieve me Jashtë për Ballkanin Perëndimor, KE.

arsimit në qark dhe përputhen drejtperdrejt me SKZHES. Mësuesit e pamjaftueshëm me diplomë është një shqetësim tjetër në dritën e faktit se shumë janë pa kualifikimin bazë. Këshilli i Qarkut, synon të zëvendësojë stafin jo të përshtatshëm me staf që është i arsimuar dhe të ndërmarë një program trainimi për përmirësimin e aftësive të mësuesve në mënyrë që të jenë në linjë me teknikat moderne.

Fatkeqësisht, nuk ka asnjë të dhënë të besueshme mbi përbërjen gjinore të mësuesve në qarkun e Gjirokastrës. Vetëm me një proporcion të barabartë të mësuesve meshkuj dhe femra nxënësit do të marrin një arsim të balancuar dhe do të ekspozohen ndaj modeleve të roleve me pozitive. Prandaj është e këshillueshme të mblidhen të dhënat e disagreguara sipas gjinisë dhe zhvillojnë politika dhe programe që eliminojnë feminizimin e profesionit dhe sigurojnë një balancë gjinore në trupat mësimore. Shpeshherë, përfshirja e komunitetit dhe prindërve, si përfitues të sistemit arsimor pothuajse mungon sepse arsimi fillor mendohet të jetë përgjegjësi e pushtetit qëndror dhe vendor. Mungesa serioze në mekanizmat për monitorimin direkt të mësuesve nga prindërit, shpesh rezultojnë në rrethana ekstreme ku mësimi është ose mediokër, ose më keq, mungon tërësisht veçanërisht në zonat e thella dhe rurale. Bazuar në këtë situatë, është kritike të zhvillosh mekanizma përgjegjëshmërie që synojnë mësuesit. Për shembull, organizimi i komiteteve të prindërve me gjini të balancuar, për të vlerësuar mësuesit, metodat e tyre dhe angazhimet e tyre do të pengonte për të influencuar sitemet ekzistuese të mësuesve për të përvetësuar praktika që bazohen kryesisht në lidhje private dhe politike.

Një objektivi tjetër kryesor është të rritet në shkallë të gjerë regjistrimi në shkollat e mesme dhe universitete dhe gjithashtu përshtatja e arsimit profesional me nevojat e tregut. Këto çështje nxjerrin në pah se ka ndryshime të mëdha në shkallën e regjistrimit midis rinisë rurale dhe urbane. Në veçanti, regjistrimi në arsimin e mesëm për rininë urbane është sa dyfishi i rinisë rurale. Dhe, shkalla e regjistrimit në universitete për rininë urbane është gati pesë herë më e lartë se për rininë rurale. Së fundi, për shkak se trainimet profesionale në qarkun e Gjirokastrës nuk janë të suksesshme në adresimin e nevojave të tregut për arsimin profesional, ka një nevojë për të ristrukturuar dhe përmirësuar atë çfarë këto trainime profesionale ofrojnë. Çdo strategji e tillë duhet të paraprihet nga vlerësimi i nevojave të tregut.

Ka gjithashtu një ndryshim të konsiderueshëm gjinor në arsim në qark dhe shkalla e analfabetizimit është më e lartë tek burrat se te gratë. Për më tepër duke marrë në

konsideratë shkallën e popullsisë midis djemve dhe vajzave në moshë shkollë, duhet të pritet që femrat do të regjistroheshin më shumë në shkollat në të gjitha nivelet. Kjo megjithatë nuk është e vërtetë ndërsa më pak femra se meshkuj janë diplomuar në të gjitha bashkitë. Femrat i kalojnë meshkujt në mbarimin e arsimit më të ulët fillor në bashkitë e Përmetit dhe Gjirokastrës (jo në Tepelenë), por në çdo kategori tjetër më të lartë të arsimit kryerja e shkollës nga meshkujt i kalon femrat. Është e dukshme që, në pajtim me konventat sociale shumë besojnë se grave nuk iu nevojitet i njëjti nivel shkollimi me burrat, gjë që kontribuon në uljen e regjistrimit të femrave në shkollë pas shkolles fillore. Përveç kësaj, problemet e sigurisë që lidhen me kërcënimin e trafikimit mund të luajnë një rol për shkak të distancave të larta midis shtëpive dhe shkollave. Masa duhet të merren për të eliminuar ndryshimet gjinore në arsim dhe për të siguruar të drejta të barabarta të vajzave dhe grave për tu arsimuar.

Synimet

- 2.1 Të eliminohet tërësisht përqindja e largimeve nga shkolla dhe të përmirësohet cilësia e arsimit më vizionin për të ofruar 4 vjet të arsimit fillor universal për të gjithë djemte dhe vajzat në vitin 2006, dhe 8 vjet të arsimit fillor për të gjithë fëmijët në vitin 2010.
- 2.2 Të rritet në shkallë të gjerë regjistrimi i nxënësve meshkuj dhe femra në shkollat e mesme dhe universitete, dhe të harmonizohen trainimet profesionale me kërkesat e tregut.

Treguesit

A). Ndjekja e Shkollës në Zonat Rurale për

Arsimin e Mesëm: Në vitin 2002 në dokumentin e titulluar “Standartet Europiane në arsim dhe Trainim: Përmbledhje e Këshillit Europian të Lisbonës,” Komisioni Europian iu bëri thirrje të gjitha shteteve antare të përgjysmojnë shkallën e të larguarve heret nga shkolla (në përputhje me statistikat e regjistruara për vitin 2002) me qëllim që të arrihet mesatarja prej 10% e BE ose më pak. “Të larguarit heret nga shkolla” përcaktohen si 18-24 vjeçare që kanë kryer vetëm nivelet më të ulta të arsimit të mesëm. Tashmë ka një tendencë në rënie të shkollës së largimit nga shkolla në vendet e BE. Mesatarja e tanishme e BE është 19%, ndërsa tre vendet me performancë më të mirë të BE (Suedia, Finlanda dhe Austria) kanë një mesatare prej 10.3%. Në Portugali shkalla e tanishme është 45%,

në Spanjë 29% dhe në Itali 26%. Synimi i shkallës së largimit nga shkollat e mesme është veçanërisht i dobishëm për qarkun e Gjirokastrës sepse ky është niveli i shkollimit ku përballen problemet më të mëdha. Mundësia e arritjes së shkallës së largimit 10% është e dyshimtë, megjithatë, ka faktorë të shumtë që influencojnë në aftësinë ose dëshirën e studentëve për të ndjekur shkollën.

B). Shkalla Mësues/Nxënës në Arsimin e

Mesëm: Mesatarja e BE është 15.6 nxënës për mësues në arsimin e mesëm. Siç vërehet në grafikun e treguesve të parashikuar, është dëshira për të ndryshuar pak nga shkalla e tanishme në Qarkun e Gjirokastrës. Ndërsa në dukje e thjeshtë për tu bere, kjo aktualisht përfaqëson një sfidë të madhe meqë ka gjithashtu njësynim për të rritur ndjekjen e shkollës së mesme me rreth 50%. Kështu, numri i mësuesve nuk mund të mbetet statik sepse popullsia e nxënësve do të

rritet. Një tregues më i rëndësishëm që kjo strategji rekomandon të mblidhet në të ardhmen është numri i nxënësve për klasë e cila është shpesh më e dobishme në gjykimin e cilësisë së arsimit të nxënësve.

C). Niveli i Arsimit të Mësuesve në

shkollat fillore: Ky tregues përdoret për të matur përqindjen e mësuesve të fillores me diplomë universiteti kundrejt numrit total të mësuesve të shkollave fillore. BE po zhvillon një metodologji për të krijuar një tregues standart për kurset e ndryshme të panumërta të trainimit të mësuesve të ofruara brenda saj. Asnjë standart i aplikueshëm në kontekstin shqiptar nuk ekziston. Ndërsa treguesit aktual janë vendosur bazuar në supozimin se të gjithë mësuesit e fillores duhet të kenë një diplomë, është rekomandim që ky tregues të rishikohet në dritën e treguesve të BE.

Treguesit e Tanishëm dhe të Parashikuar:

Objektivi 2: Kryerja e Arsimit Fillor								
Synimi	Treguesit	Mesatarja Kombwtare e Shqipwrisw	Pikwnisja e Qarkut tw Gjirokastrws	2006	2009	2012	2015	Mesatarja BE (Tw dhwna nga Eurostati)
2.1.-2.2.	1. %e ndjekjes së shkollës në zonat rurale për arsimin e mesëm për (15-19 vjec)	29.28% (2000, Vlerwsimi i kushteve Socio-Ekonomike tw Bashkive nw Shqipwri – UNICEF)	40.04 (2003, Regjistri Statistikor i Bashkive / Kwshill Qarku)	40	50	60	70	90% (Synimi KE pwr 2010)
2.1.	2. shkalla Nxënëes / Mësues në Shkollat e mesme	22:1 (Ministria e arsimit siç citohet nw Treguesit sipas Prefekturws INSTAT 2002-2003)	19:1 (Ministria e arsimit siç citohet nw Treguesit sipas Prefekturws INSTAT 2002-2003)	19:1	18:1	17:1	16:1	15.6:1 (2002)
2.1.-2.2.	3. Niveli i arsimit të mësuesve në shkollat fillore (% me diplomë Universiteti)	26% (2000, Vleresimi i kushteve Socio-Ekonomike tw Bashkive nw Shqipwri – UNICEF)	35.33 (2000, Vleresimi i kushteve Socio-Ekonomike tw Bashkive nw Shqipwri – UNICEF)	45	55	65	75	J/A

Programi i Zhvillimit

Synimi 2.1.: Të eliminohet tërësisht përqindja e braktisjes së shkollës dhe të përmirësohet cilësia e arsimit me vizionin për të ofruar 4 vjet të arsimit fillor universal për të gjithë djemtë dhe vajzat në vitin 2006, dhe 8 vjet të arsimit fillor për të gjithë fëmijët në vitin 2010.

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Afati Kohor	Partnerët e Mundshëm	Kosto në Euro	Efekti
Kuptim i pamjaftueshëm i shkaqeve të braktisjes dhe ndërhyrjet potenciale të mundshme	Përgatitja e strategjisë së eliminimit të largimeve	Identifikimi i shkaqeve kryesore të largimeve dhe përgatitja e prioritetëve në termat e çështjeve ekonomike, sociale, kulture dhe gjinore, përqasjet pedagogjike për studentet e lënë mënjanë dhe cilësinë e arsimit në zonat e lëna mënjanë.	2005	KQ, QSH, donatorët	20,000	Situata aktuale e ndjekjes së shkollës nuk është monitoruar shumë. Një sistem llogaritës i thjeshtë dhe i standartizuar do të lejojë identifikimin e nxënësve që nuk ndjekin shkollën dhe rekomandimet e tyre për ndërhyrjet e duhura.
Niveli i ulët i pjesëmarrjes së femrave në arsimin e mesëm	Vlerësimi i pjesëmarrjes	Kryerja e një vlerësimi të thelluar mbi numrin e vajzave që ndjekin shkollën e mesme dhe një studim të gjerë me komunitetin mbi arsyet pse vajzat lënë shkollën.	2005-2006	Drejtorja e Arsimit Gjirokastër, KQ, Organizatat Ndërkombëtare, OJF, OBK, nxënësit, familjet, mësuesit	75,000	Vlerësimi do të çojë në krijimin e programeve të përshtatshme dhe të adresojë nevojat e nxënësve femra për të siguruar regjistrimin e tyre në shkollat e mesme, duke influencuar kështu pozitivisht treguesin e ndjekjes së shkollës.
	Fushatë informimi "Arsimi është një e drejtë"	Fushatë e informimit publik dhe medias duke theksuar nevojën për arsimimin e femrave.	2005-2006	Drejtorja e Arsimit Gjirokastër, KQ, Organizatat Ndërkombëtare, OJF, OBK, media lokale, familjet, mësuesit	60,000	Edukimi i qytetarëve të qarkut të Gjirokastër mbi nevojën për arsimimin e femrës dhe edukimi i të drejtave të njeriut do të ndikojë pozitivisht treguesin e ndjekjes së shkollës nga inkurajimi i nxënësve femra për të ndjekur shkollën.
Kërkesë e ulët për arsimin fillor për shkak të varfërisë dhe ndërgjegjësimit të pamjaftueshëm prindëror.	Ndihmë për familjet e varfëra, me vëmendje të veçantë tek familjet romë, që nuk i regjistrojnë fëmijët e tyre në shkollë	Ndihma do të përfshijë ushqime falas (ose kompensime) dhe tekste shkollore për familjet e zgjedhura.	2005-2008	Kryqi Kuq, drejtoritë e shkollave	150,000	Varfëria është një faktor udhëheqës që influencon nxënësit duke shkaktuar largimin e tyre nga shkolla. Mbështetja e familjeve nëpërmjet programeve të vazhdueshme ose ndihmë të menjëhershme do të lejojë më shumë nxënës të qëndrojnë në shkollë, duke ndikuar kështu pozitivisht treguesin e ndjekjes së shkollës.
	Program për fëmijët-në-rrezik	Krijimi i klasave për fëmijët me paaftësi për të mësuar, duke përfshirë 1 orë shtesë 3 herë në javë, pajisja e fëmijëve me materiale për të mësuar dhe përgatitja e vizitave të mësuesve në shtëpi.	2005-2008	Kryqi Kuq, drejtoritë e shkollave	350,000	Krijimi i klasave shtesë do të ndikojë pozitivisht treguesin e ndjekjes së shkollës.
	Rritja e kapacitetit të medias dhe fushatë ndërgjegjësimi	Sensibilizimi dhe trainimet e medias për të informuar publikun dhe frymëzuar debate rreth çështjeve të shkollës dhe sensibilizimin e arsimit të grave.	2005-2006	KQ, OJF, media lokale, institucionet kërkimore, Drejtoritë e arsimit, mësuesit, prindërit, nxënësit	20,000	Trainimi i medias për të transmetuar mesazhe për arsimin dhe investigojë dhe raportojë mbi problemet e shkollës dhe metodat e reja të arsimit do të rrisë shqetësimin mbi çështjet që lidhen me ndjekjen e ulët të shkollës. Pas trainimit, fushatat e ndërgjegjësimi të publikut mbi problemin e largimeve nga shkollat dhe si ai

		Informacion i shpërndarë gjerësisht dhe ndërgjegjësimit nëpërmjet një fushatë të shumë mediave duke përdorur fëmijët, të rinjtë dhe mësuesit si folës.	2005-2006	KQ, OJF, media lokale, Drejtoritë e arsimit, mësuesit, prindërit, nxënësit	70,000	ndikon në zhvillimin e qarkut do të gjenerojë më shumë përfshirje të publikut në këtë çështje duke ndikuar kështu direkt treguesin mbi ndjekjen e shkollës.
Paaftësi për të ofruar arsim 8 vjeçar të standardit të lartë në termat e : - Infrastruktura dhe pajisjeve; - Kualifikimit motivimit dhe përgjegjshmërisë të mësuesve; dhe - Programeve tërheqëse me cilësi të mirë, me tekste të rinovuara, gjini- perceptuese që përfshijnë elemente të historisë dhe kulturës rome	Programi i infrastruktura të shkollës	Riparimi i shkollave.	2005-2006	QeSh, bizneset, donatorët	500,000	Rehabilitimi strategjik dhe rindërtimi i shkollave do të risë shkollën e ndjekjes duke ndikuar kështu pozitivisht treguesin e ndjekjes së shkollës.
		Ndërtimi i shkollave të reja.	2005-2010			
		TIK për projekte të shkollave.	2005-2010	Projekte lab për kompjuter për shkollat e mesme, trainime për ICT për mësuesit dhe nxënësit dhe në shkollat fillore të paktën 1 lab kompjuteri me lidhje interneti	1,800,000	Përmirësimi i Infrastruktura të TIK në shkollë do të ndikojë pozitivisht të gjithë treguesit.
	Programi i shkollës fillore	Studim fizibiliteti mbi programin e përqëndrimit të shkollave fillore (konvikte dhe /ose transport).	2005	Drejtoritë e Arsimit, Shoqëria Civile, donatorët	30,000	Një rritje në ndjekjen e shkollës fillore në mënyrë jo direkte do të ndikojë treguesin e ndjekjes së shkollës së mesme.
Projekt pilot për 1 shkollë fillore, duke përfshirë restaurimin, ndërtimin e konviktit dhe/ose rregullimin e transportit.		2006-2007	QeSh, donatorët,	150,000		
Programi i trainimit të mësuesve	Zbatim i programit të trainimit brenda-qarkut (Ditët e Zhvillimit Profesional).	2005-2009	Drejtoritë e Arsimit, OJF, OBK, mësuesit, donatorët	80,000	Përmirësimi i arsimit të mësuesve do të ndikojë pozitivisht dhe direkt treguesin e arsimit të mësuesve.	
	Zbatim i programit të trainimit ndër-qarkor.			80,000		
	Bursa për mësuesit për të lejuar studime jashtë si dhe trainime të kolegëve pas kthimit.			300,000		
	Mësime me bazë komuniteti.			200,000		
	Programe trainimi mbi të drejtat e minoritetit	Sensibilizimi i mësuesve mbi shkaqet e diskriminimit të fëmijëve rome dhe si të mbështesin tolerancën në klasë.	2005	Drejtoritë e Arsimit, mësuesit e shkollave, OJF rome, Donatorët komuniteti	20,000	Ky projekt do të ndikojë pozitivisht treguesin e ndjekjes së shkollës.
Projekt pilot i përgjegjshmërisë	Mbështetja e krijimit të komiteteve të prindërve për 10 shkolla, ku prindërit do të kenë mundësinë për të vlerësuar metodat e mësuesve, angazhimin dhe performancën.	2005-2007	Drejtoritë e Arsimit, prindërit, mësuesit	85,000	Vlerësimi i mësuesve do të çojë në standarde të përmirësuara të arsimit duke ndikuar pozitivisht treguesin e ndjekjes së shkollës.	

Synimi 2.2: Të rritet në shkallë të gjerë regjistrimi i nxënësve meshkuj dhe femra në shkollat e mesme dhe universitete, dhe të harmonizohen trainimet profesionale me kërkesat e tregut.

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Afati Kohor	Partnerët Potenciale	Kosto në Euro	Efeti
Kërkesë e ulët për shkollë të mesme dhe arsim universitar, kryesisht në zonat rurale dhe nivel i ulët i ndjekjes nga femrat në zonat rurale dhe urbane	Program bursash për zonat rurale dhe urbane	Përgatitja e studimeve periodike mbi numrin e studentëve meshkuj dhe femra që do të promovohen në shkollë të mesme dhe arsimin universitar	2005-2010	Drejtoritë e Arsimit, drejtoritë e shkollave, QeSh, donatorët	Pa kosto	Ky projekt do të ndikojë pozitivisht treguesin mbi ndjekjen e shkollës duke theksuar çështjet që kontribuojnë në shkollën e largimit të studentëve nga shkolla
		Zbatim i programit të nxitjes së studentëve, që synon rritjen e ndjekjes së shkollës, reduktimin e ndryshimeve urbane-rurale dhe diferencat gjinore.	2005-2010	Drejtoritë e Arsimit, drejtoritë e shkollave, QeSh, donatorët	75,000	

Mungesë e harmonizimit midis trainimeve profesionale dhe kërkesave për punë në treg	Strategji e arsimit profesional që është e balancuar nga ana gjinore	Kryerja e vlerësimit të nevojave të tregut.	2005	QeSh, Drejtoritë e Arsimit, Donatorët, OJF	20,000	Krijimi i një sistemi të arsimit profesional që lejon studentët të zgjedhin rrugën e karrierës që janë të drejtuara nga tregu dhe në interes të tyre. Kjo do të çojë në një ndikim pozitiv në treguesin e ndjekjes së shkollës.
		Projekt pilot bazuar në një shkollë industriale.	2005-2006	QeSh, Drejtoritë e Arsimit, Donatorët, OJF		

Qëllimi 3: Përmirësimi i Kujdesit Shëndetësor

Prioritetet strategjike

SKZHES dhe Platforma Kombëtare ¹⁷³	OZHM	BE ¹⁷⁴	Qarku Gjirokastrë
1) Përmirësimi i aksesit dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore në të gjithë vendin duke përfshirë etikën profesionale;	1) Të ulët me dy të tretat shkalla e vdekshmërisë foshnjore të fëmijëve nën 5 vjeç;	1) Rritja e mjeteve financiare për këtë sektor;	1) Përmirësimi i aksesit ndaj shërbimeve të kujdesit shëndetësor në zonat rurale dhe urbane;
2) Përmirësimi i treguesve të shëndetit nëpërmjet ndërhyrjeve specifike në sektorë të veçantë të shëndetësisë;	2) Reduktimi 75 % i shkallës së vdekshmërisë amtare; dhe	2) Riorganizimi i shërbimeve shëndetësore;	2) Përmirësimi i infrastrukturës së kujdesit shëndetësor, pajisjeve dhe kushteve të shërbimit;
3) Reduktimi i shkallës së vdekshmërisë foshnjore pothuajse përgjysëm dhe reduktimi i vdekshmërisë së nënës rreth 50 %;	3) Rezistencë dhe ndalimi i përhapjes së HIV/AIDS, si dhe rastet e sëmundjeve të tjera të rrezikshme.	3) Përmirësimi i infrastrukturës dhe pajisjeve	3) Rritja e cilësisë së ofrimit të kujdesit shëndetësor duke përfshirë nivelin e stafit;
4) Rritja e aksesit të grave ndaj shërbimeve të kujdesit shëndetësor;		4) Promovimi i pjesëmarrjes së sektorit privat në ofrimin e shërbimeve shëndetësore.	4) Reduktimi dhe eliminimi i vdekshmërisë foshnjore dhe amtare;
5) Eliminimi i diskriminimit të femrave në kujdesin shëndetësor sidomos në zonat rurale; dhe			5) Zbutja e privimit të romëve në aksesin e shërbimit shëndetësor
6) Ndihma për viktimat e dhunës.			6) Eliminimi i të gjitha formave të dhunës ndaj grave.

Përshkrimi

Zhvillimi i strategjisë për shëndetësinë do të jetë një ndërmarrje e madhe për Këshillin e Qarkut duke dhënë problemet sektoriale dhe ndryshimet në politikën kombëtare të shëndetit. Sektori i shëndetit në qarkun e Gjirokastrës vuan nga një numër problemesh që rezultojnë në cilësi të ulët të shërbimit dhe mbulim të pamjaftueshëm, kryesisht në zonat rurale. Përveç kësaj mbetet shkallë e lartë e vdekshmërisë foshnjore dhe amtare, të cilat krahasuar me vendin fqinj, Greqinë, janë shumë të larta. Vdekshmëria foshnjore në Greqi për vitin 2003 ishte 4.8 për 1,000-lindje dhe vdekshmëria amtare ishte 9 për 100,000.¹⁷⁵ Përmirësimet

akses dhe cilësinë e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor për zonat rurale dhe urbane, janë kritike. Infrastruktura ekzistuese e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, duke përfshirë shtretërit, ujë i pijshëm, dhe elektricitet, është e varfër. Më keq akoma është vlefshmëria e pajisjeve të domosdoshme, ku shpesh, edhe pajisjet bazë mungojnë. Ka personel mjekësor të pa trainuar, që janë të demoralizuar dhe të pamotivuar për punën e tyre. Zakonisht, doktorët që punojnë në qendrat e shërbimit shëndetësor parësor dhe ambulator, ndërsa janë praktikues të mirë, janë shpesh të panjohur me praktikatat moderne të

¹⁷³ Informacioni për prioritetet gjinore është marrë nga "Platforma e veprimtimit për përmirësimin e statusit të gruas".

¹⁷⁴ Informacioni për prioritetet e ndërhyrjeve në sektorin e shëndetësisë janë marrë nga "Komuniteti Europian, Programi CARDS: Strategjia e Shqipërisë 2002-2006", publikuar nga KE, Drejtoria e Marëdhënieve me jashtë për Ballkanin Perëndimor.

¹⁷⁵ Megjithatë "Qeverisja " nuk është në mënyrë specifike një OZHM, dokumenti i përmbledhur për Zhvillimin e Mijëvjeçarit (Millennium Development Compact) jep informacion në këtë seksion dhe përqendrohet në në qeverisjen e mirë si një aspekt themelor i arritjes dhe zbatimit të vazhdueshëm të OZHM-ve dhe objektivave të tjerë.

diagnostikimit dhe trainimit. Si rezultat, pacientet anashkalojne qendrat e kujdesit shendetesor paresor dhe shkaktojne nje mbingarkese te zonave te emergjences se spitaleve.

Për të adresuar këto mangësi, aftësitë e doktorëve duhet të përmirësohen me anë të arsimit të vazhdueshëm nëpërmjet programeve të partneritetit me spitalet në Greqinë fqinje ose Itali. Rritja e numrit të personelit mjekësor do të arrihet nëpërmjet një projekti që do të ofrojë inkurajim të diplomuarve në mjeksi të vijnë në qark dhe të mbeten aty. Optimist është fakti që një degë e re infermierie është hapur në Universitetin e Gjirokastrës “Eqerem Çabej”, dhe si rezultat ka mundësi reale për të krijuar kurse trainimi të përhershme për personelin shëndetsor të punësuar. Megjithatë, aritja e këtyre objektivave të kujdesit shëndetsor do të jetë e mundshme vetëm nëse fëmijët, nënat, dhe familjet në përgjithësi, janë edukuar dhe informuar rreth rëndësisë së parandalimit. Një program ambicioz për edukimin shëndetsor, bazuar në kujdesin parandalues, do të jetë ndërhyrja më efektive. Programi do të përfshijë përmirësime në kurrkulet e edukimit shëndetsor në shkollat fillore, trainimi i mësuesve në aspektet e ndryshme të edukimit shëndetsor, një fushatë edukimi shëndetsor publik nëpërmjet medias lokale duke u fokusuar mbi nënën dhe fëmijën, edukimi për ndërgjegjësimin ndaj HIV/AIDS në shkollat e mesme dhe në nivelet e universitetit.

Një hap tjetër do të përqëndrohet në një reformë të përgjithshme të shërbimit spitalor, se cilësia është shumë e ulët dhe korrupsioni shpesh i vë pacientët në rrezik. Mungesa e konkurrencës në ofrimin e shërbimeve në qark, për shkak të politikave ekzistuese kombëtare të sektorit të shëndetit, është një shkak kryesor i këtyre vështirësive. Për shembull, spitalet financohen nga buxheti i shtetit dhe ato zotërojnë shumë pak autonomi financiare. Gjithashtu, stafi mjekësor është shumë pak i paguar, por në dritën e këtij fakti, ka një mungesë të teknikave për ti ndihmuar ata të ngrenë moralin, ofrojnë inkurajim dhe nxitin qëndrime më pozitive. Kjo krizë nxjerr në pah nevojën e një rinovimi komplet të politikave të sektorit spitalor në përputhje me “Strategjinë e sistemit Shëndetsor për Shqipërinë, 2000-2010.”¹⁷⁶ Skema e manaxhimit të sistemit shëndetsor parashikon një gjysëm – privatizim të spitaleve për qëllimin e ofrimit të shërbimeve të pacientit nëpërmjet Institutit të Sigurimit Shëndetsor ose kompanive të ngjashme private të sigurimit shëndetsor. Pacientët do të kenë opsionin të zgjedhin shërbimet bazuar në cilësi, ndërsa në të njëjtën kohë, spitalet do të kenë një shkallë më të lartë autonomie në lidhje me punët si rekrutimi, motivimi i stafit mjekësor, dhe investimet. Kjo skemë projektohet për të rezultuar në një standart të përgjithshëm

më të lartë të cilësisë së shërbimit shëndetsor dhe eliminimin e plotë të korrupsionit. Është një synim i Këshillit të Qarkut Gjirokastrë për të inicjuar zbatimin e skemës, me mbështetjen e konfirmuar të kontakteve në spitalet e Greqisë dhe Italisë. Një prezantim fillestar i skemës së re parashikohet për periudhën 2006-2009, në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Raport Progresi për 2003.¹⁷⁷

Megjithëse skema adreson çështjet afat-gjata për rritjen e qëndrueshme, problemet afat-shkurtra, si ato të shumë pak shtretërve, ujit të pijshëm, dhe ngrohje e pamjaftueshme, duhet të adresohen menjëherë. Përveç reformës në infrastrukturë, aftësitë e stafit duhet të përmirësohen që të jenë në linjë me praktikatat e trajtimit dhe diagnostikimit bashkëkohor. Ky objektiv mund të arrihet nëpërmjet një programi partneriteti të hartuar me kujdes, që do të ndikojë tek familjet, doktorët, qendrat e shëndetit, dhe spitalet. Propozohet gjithashtu që lufta kundër korrupsionit në sektorin e shëndetit të kryhet duke kërkuar përgjegjshmërinë e stafit mjekësor dhe forcimin e standarteve të etikave profesionale. Përfundimisht, rëndësia e reduktimit dhe eliminimit të vdekshmërisë foshnjore dhe amtare nuk mund të mbi rithekskohet. Mënyra jo efektive dhe jo efektive në të cilën informacioni mbledhet, analizohet dhe raportohet duhet gjithashtu të bëhet më efektive. Për më tepër, vaksinimi i fëmijëve është një prioritet urgjent, veçanërisht për zonat e largëta dhe rurale. Fushatat e vaksinimit do të përfshijnë rritjen e aksesit, uljen e kostos, rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e imunizimit dhe trainimit të stafit. Theksi duhet të vihet gjithashtu në iniciativat që ndihmojnë edukimin mëmësor, si çështjet e shëndetit riprodhues, dhe krijimin e një rrjeti të grupeve të punës të organizatave jo-qeveritare që do të mbështesin këtë çështje.

Synimet

- 3.1. Përmirësimi i aksesit dhe cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetsor për popullsinë urbane dhe rurale.
- 3.2. Përmirësimi tërësor i cilësisë së shërbimeve të shëndetit në spitalet, në përputhje me skemën e reformës kombëtare.
- 3.3. Reduktim dhe eliminim i vdekshmërisë foshnjore dhe amtare, dhe lufta ndaj diskriminimit gjinor.
- 3.4. Rritja e ndërgjegjësimit dhe kapacitetit për të eliminuar dhunën kundrejt grave.

Treguesit

¹⁷⁶ Informacioni për këto ndërhyrje parësore është marrë nga “Programi CARDS i Bashkimit Evropian: Strategjia për Shqipërinë 2002-2006”, publikuar nga drejtorja e marrëdhënieve me jashtë dhe me

ballkanin perëndimor e Komisionit Evropian.

¹⁷⁷ Regjistri statistikor i bashkive, Këshilli i qarkut 2003.

A). Numri i shtretërve për 1,000 Banorë: Megjithëse shifrat e BE janë pak të datuara, treguesi 6.87 shtretër për 1,000 njerëz është akoma një nivel standart i dobishëm për qarkun. Kjo do të thotë që duhet të vlerësohet një rritje 33% në numrin e shtretërve në dispozicion për popullsinë për të arritur këtë standart. Megjithatë duhet patur parasysh se një studim i përshtatshëm mbi formën e kujdesit shëndetësor m të përshtatshëm për qarkun duhet të ndërmerret për të parë nëse ky lloj kujdesi është i përshtatshëm për qytetarët, ose nëse metoda të ndryshme të kujdesit (si shërbimet në shtëpi) do të përshtaten më shumë. Në të vërtetë, më shumë shtretër nuk janë mjaft. Në këtë fazë, kjo shkallë është akoma e dobishme nëse shoqërohet nga reforma të tjera të kujdesit shëndetësor.

B.) Numri i Farmacistëve për 1,000 banorë: Në BE, statistikën për këtë tregues janë jo të plota, megjithatë mesatarja e 2001 për vendet Austria, Danimarkë, Finlandë, Francë, Gjermani, Irlandë, Luksemburg, dhe Hollandë është .74 farmacistë për 1,000 njerëz. Në krahasim, shkalla e Turqisë për të njëjtin vit është .34 farmacistë për 1,000 njerëz, ndërsa në qarkun e Gjirokastrës është .07. Pra është e domosdoshme të rishikohen kërkesat e popullsisë për farmacistë; megjithatë është e qartë se ky sektor ka nevojë për përmirësim.

C). Numri i Dentistëve për 1,000 Banorë: Sipas

informacionit demografik të Eurostat për 1995, ka afërsisht 1 dentist për 1,634 njerëz në BE, që është një shkallë .61 dentistë për 1,000 njerëz. Në qarkun e Gjirokastrës, kjo shkallë është afërsisht 50% më e ulët se mesatarja e BE. Përsëri, duke konsideruar popullsinë relativisht të vogël në qark është e mundur që standartet e BE të arrihen. Duhet të vërehet se dentistët për numër popullsie nuk mund të jetë domosdoshmërisht treguesi më i saktë, kështu që një studim mbi kërkesën për shërbime dentare duhet të ndërmerret menjëherë dhe në të njëjtën kohë me përmirësimin në shërbimet dentare. Për më tepër, duhet të theksohet se një rritje e vogël në numrin e dentistëve që punojnë në Gjirokastrë nuk do të thotë domosdoshmërisht një përmirësim automatik në cilësinë e shërbimeve dentare ose një rritje në aksesin e publikut të gjerë. Prandaj, është e rëndësishme që ky tregues të mos shikohet i izoluar, por si një nga numrat për të matur progresin e politikës në këtë fushë.

D). Shkalla e vdekshmërisë foshnjore: Ky tregues përdoret gjithashtu si një tregues jo i drejtpërdrejtë për seksionin e reduktimit të varfërisë në këtë strategji. Për seksionin e shëndetit, shkalla e vdekshmërisë foshnjore konsiderohet si një tregues direkt duke përfaqësuar përmirësimin e kushteve të kujdesit shëndetësor (facilitete dhe infrastrukturë), shëndetin e nënave, aftësitë dhe kapacitetet e doktorëve, dhe aksesin ndaj shërbimeve të shëndetit.

Treguesit Aktualë e Të Parashikuar:

OBJEKTIVI 3: Përmirësimi i Kujdesit Shëndetësor (Kombinim i Objektivave të OMZH 4 & 5)								
Synimi	Treguesit	Mesatarja Kombëtare e Shqipërisë	Niveli Baze i Qarkut të Gjirokastrës	2006	2009	2012	2015	Mesatarja e BE (Të dhënat nga Eurostat)
3.1.-3.2.	2. Raporti i Shtretërve për 1000 banorë	3.26 (2001, OBSH HFA DB)	4.5 (2003, Regjistri Statistikor i Bashkisë e Këshillit të Qarkut)	4.5	5.0	5.5	6.0	6.87 (1994)
3.1.-3.2.	3. Raporti i Farmacistëve për 1000 banorë	.406 (1994, OBSH, HFA DB)	0.07 (2001, MeSH & Nivel Bashkie)	.10	.15	.30	.40	.74 (2001, statistika për vetëm 8 nga 15 vende të BE)
3.1.-3.2.	4. Raporti i Dentistëve për 1000 banorë	.411 (1998, OBSH, HFA DB)	0.19 (2001, MeSH & Nivel Bashkie)	.25	.30	.35	.40	.61 (1995)
3.3.	5. Shkalla e Vdekshmërisë foshnjore për 1000 banorë	20.5 (2000, MeSH)	14.95 (2000, Vlerësimi i Kushteve Ekonomiko-Sociale të Bashkive të Shqipërisë-UNICEF)	13	10	7	4.5	4.5 (2002)

Program Zhvillimi

Synimi 3.1.: Përmirësimi i dhënies dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore parësore për popullsinë në zonat urbane dhe rurale.

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Periudha Kohore	Partnerët Potencialë	Kosto në Euro	Efekt
Shërbim i pamjaftueshëm në zonat rurale dhe kushtet e këqija të qendrave shëndetësore dhe ambulatorë, referuar infrastrukturës dhe pajisjeve.	Kryerja e një studimi për vlerësimin e nevojave për mbulim nga shërbimi mjekësor	Studimi do të vlerësojë nevojat dhe planin e veprimit për të rritur shërbimet, e vendosura në fshatra, grupe fshatrash dhe një shërbim lëvizës.	2005-2006	MeSH, donatorët	20,000	Rritja e cilësisë dhe aksesimit të shërbimeve mjekësore do të ndikojë pozitivisht të gjithë faktorët.
	Projekt për shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor dhe për atë ambulator.	Ndërtimi i qendrave shëndetësore rurale duke i kushtuar vëmendje speciale ambjenteve për kujdesin e nënës e fëmijës, për çdo komunë dhe qendër ambulatorë sipas studimit të vlersimit të nevojave ¹⁷⁸ .	2005-2007	QeSH/MeSH/ Drejtorite Shëndetësore, komunat, donatorët	1,000,000	
Numër, aftësi, dhe motivim i pamjaftueshëm i stafit mjekësor	Trajnime te stafit aktual, te ulet mjekesor	Kurse trajnimi permanentë për stafin mjekësor të ulët të degës së infermerisë të hapur kohët e fundit në Universitetin e Gjirokastrës.	2005-2010	QeSH, Donatorët	300,000	Një komponent i kualifikimit pa shkëputje nga puna dhe nxitëse për mjekët, infermierët dhe dentistët, do t'i inkurajojë ata të qendrojnë në Qark, duke ndikuar kështu pozitivisht në të tërë treguesit.
	Inciativa e mjekëve të rinj	Dhënie stimujsh monetarë dhe nxitës të tjerë për të sapo-diplomuarit për mjekësi e stomatologji, për t'i bindur të punojnë në zonat rurale dhe ato të thella.	2005-2008	QeSH	400,000	
Nivel i ulët i edukimit shëndetësor	Programe edukimi publik, duke përfshirë fushatën parandaluese për HIV/AIDS	Përmirësimi i programit mësimor primar në mënyrë që të përfshijë më shumë edukim për shëndetin dhe trajnime për mësuesit.	2005-2007	MeSH, MoE	75,000	Duhet të theksohet se këto iniciativa kanë arritur gjerësisht një impakt që i kalon treguesit shëndetësore të përmendur (varfëri, edukim, qeverisje, etj). Këto projekte do të ndikojnë drejtpërdrejtë shkallën e vdekshmërisë foshnjore.
		Zhvillimi i një fushate edukimi shëndetësor publik e fokusuar tek nënat e fëmijët.	2005-2007	Media lokale, OJF, Drejtoritë e Shëndetit, donatorët	80,000	
		Zbatimi i një projekti të fushatës parandaluese për HIV/AIDS, në shkollat e mesme dhe në Universitetin e Gjirokastrës.	2005-2007	OJF, media lokale, mësuesit, donatorët	60,000	

Synimi 3.2.: Përmirësimi rrënjësor i cilësisë së shërbimit shëndetësor nëpër spitale, në përputhje me skemën e reformimit kombëtar.

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Periudha Kohore	Partnerët Potenciale	Kosto në Euro	Efekt
Kushte të këqija të infrastrukturës dhe aparateve në spitale	Pajisje e spitaleve me aparate dhe infrastrukturë.	Asistencë e konfirmuar për përmirësimin urgjent të infrastrukturës dhe aparateve.	2005-2007	QeSH, MeSH e Greqisë dhe Italisë	1,000,000	Infrastruktura me e mire për mjediset shëndetësore (duke përfshirë aparate me të mira dhe me moderne të pershtatshme për kushtet e Gjirokastrës) do të ndikojë pozitivisht të gjithë indikatorët.
Paaftësia profesionale e stafit mjekësor	Programe Partneriteti	Rotacione afatshkurtra dhe afatmesme të bëra në Gjirokastrë, Greqi dhe Itali të realizuara nga pjesëmarrësit në programin e partneritetit.	2005-2008	BE - Interreg 3 - MeSH Greke dhe Italiane, dhe vende të tjera donatore	500,000	Trajnime me të mira do të mundesojnë që të rritet numri i profesionistëve të afte dhe do ndikojnë pozitivisht të gjithë treguesit.
		Dhënia e një serie seminaresh për doktorët dhe dentistët nga doktorë të BE ne lidhje me problemet mjekësore.	2005-2008		90,000	
Sjellje jo profesionale dhe joetike nga një pjesë e stafit mjekësor	Nxitje dhe forcim i etikës profesionale	Hartimi i Kodit të Sjelljes dhe prezantimi i tij në një konferencë në rang qarku.	2005	USAID, Fondacioni SOROS, dhe donatorë të tjerë	10,000	Trajnimet me të mira do të mundesojnë që të rritet numri i profesionistëve të afte dhe si rrjedhojë do ndikojnë pozitivisht të gjithë treguesit.
		Zbatimi i Kodit të Sjelljes në 3 spitale e qyteteve, duke përfshirë vlerësime të efektivitetit të tij.	2006-2007	USAID, Fondacioni SOROS, dhe donatorë të tjerë	15,000	
Mungesë konkurrence në sigurimin e shërbimeve të	Prezantim i pjesshëm i	Trajnime për menaxhimin e skemës	2006	MeSH, Greqia, Italia	15,000	Te gjithë treguesit do të ndikohen pozitivisht nga

¹⁷⁸ Nevojat e parashikuara për periudhën afat-shkurtër (2005-2007) do të adresohen bazuar në një vlerësim të bërë nga Këshilli i Qarkut, i cili do të

identifikojë kostot e ndërhyrjeve strategjike dhe kostot e sakta të projektit.

kujdesit shendetesor, fonde të pamjaftueshme, dhe motivim, nxitje dhe moral i ulët i stafit, për shkak të skemës ekzistuese të menaxhimit publik	skemës se propozuar të pseudo-privatizimit të spitaleve, e cila u jep pacientëve më shumë mundësi zgjedhjeje dhe spitaleve një autonomi më të madhe	Akreditimi i spitaleve për shërbimet që ato kanë kapacitet t'i sigurojnë.	2006	MeSH, spitalet	20,000	këto iniciativa.
		Përgatitja e një plani për të integruar skemën e re të menaxhimit, duke përfshirë nevojat e buxheteve, infrastrukturës dhe aparateve, dhe procedurat e rekrutimit.	2006	MeSH, Drejtoria Shëndetësore, donatorët	40,000	
		Programe partneriteti me spitale greke dhe Italiane, ose me spitale të tjera të huaja, të cilët e kanë zbatuar suksesshëm këtë lloj skeme.	2006-2007	BE - Interreg 3 - Greqia, Italia dhe vende donatore të tjera	150,000	

Synimi 3.3.: Reduktimi dhe eliminimi i vdekshmërisë foshnjore dhe të nënës, dhe luftimi i diskriminimit gjinor.

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Periudha Kohore	Partnerët Potencialë	Kosto në Euro	Efekti
Mbledhja e dobët e të dhënave, analizës, raportimit të vdekshmërisë së nënës e fëmijës, dhe mungesa e të dhënave të vecuara mbi vdekshmërinë foshnjore	Krijimi i një sistemi modern monitorimi për vdekshmërinë e nënës e fëmijës, raportimi dhe analizimi, dhe mbledhja e të dhënave të vecuara	Trajnim i personelit ose punësimi i ekspertëve.	2005	MeSH, Drejtoritë Shëndetësore	85,000	Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave që lejon një analizë dhe parandalim më të mirë, duke ndikuar kështu pozitivisht treguesin e vdekshmërisë foshnjore.
		Krijimi i një strukture të modeluar bazuar në sukseset e sistemeve të ngjashme të vendeve të BE.	2005-2006	QeSh/MeSH /Drejtoritë Shëndetësore	125,000	
Sëmundjet që prekin fëmijët si pasojë e mungesës së vaksinimit	Fushatë Vaksinimi për fëmijët.	Zvogëlimi i kostos së vaksinave (ritrja e ndërgjegjësimit, shpërndarje e vaksinave, dhe trajnimi i stafit në lidhje me 3.1.).	2005-2010	QeSH/MeSH, Drejtoritë e Shëndetit, qytetarët e Qarkut të Gjirokastrës	400,000	Fëmijet që nuk janë vaksinuar kundër sëmundjeve si poliomieli, shytat dhe rubeolës do të përfitojnë nga ky program, duke ndikuar kështu pozitivisht treguesin e vdekshmërisë foshnjore.
Mungesa e shëndetit riprodhues dhe shërbimeve të planifikimit familjar	Krijimi i një programi të shëndetit riprodhues dhe planifikimit familjar	Trajnim i personelit shëndetësor se si të ofrojnë shërbime të lehta për t'u përdorur, për të stimuluar kërkesën.	2005-2006	QeSH/MeSH, Donatorët, qytetarët e Qarkut të Gjirokastrës	30,000	Përmirësimi i shërbimit shëndetësor në fushën e planifikimit familjar dhe gjinekologjisë, i kombinuar me një fushatë ndërgjegjësimit publik, do ketë një efekt direkt në treguesin e vdekshmërisë foshnjore
Edukim i pamjaftueshëm i nënës për problemet e nënës dhe fëmijës, dhe edukim jo i mjaftueshëm i shëndetit të fëmijës	Fushatë Ndërgjegjësimit Publik	Zbatimi i një fushate publike ndërgjegjësimit për nënat, me praninë e shumë mediave, për problemet e nënave dhe fëmijëve.	Shiko Synimin 3.1 Programe të edukimit publik, fushata ndërgjegjësimit dhe trajnime të medias.			Përmirësimi i shpërndarjes së informacionit mbi problemet e shëndetit të nënës dhe fëmijës do ketë ndikim direkt në treguesin e vdekshmërisë foshnjore.
	Organizim i Grupeve të punës të OJFve	Ngritja e një grupi pune me pjesëmarrjen e OJF-ve dhe shumësektorëve QeSh/MeSH/ Drejtorive të Shëndetit, që do i dedikohet "rrahjes së ideve" mbi problemet e shëndetit të fëmijëve dhe zgjidhjeve të tyre (vëmendje të njëjtë ndaj djemve dhe vajzave)	2005	OJF-te, donatorët	30,000	Partneritetet në nivel Qarku mes OJF-ve, organizatave të shoqërisë civile, dhe komuniteteve mund të çojnë në gjetjen e zgjidhjeve lokale, të reja të problemeve që lidhen me shëndetin e nënës dhe fëmijës, duke pasur një ndikim direkt mbi treguesin e vdekshmërisë foshnjore.

Synimi 3.4.: Përmirësimi i ndërgjegjësimit dhe kapaciteteve për të eliminuar dhunën ndaj grave

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Periudha kohore	Partnerët Potencialë	Kosto në Euro	Efekti
Mungesë ndërgjegjësimit për dhunën gjinore dhe mungesë e kapaciteteve për të luftuar dhunën gjinore	Studim shpjegues	Ndërmarrje kërkimesh mbi dhunën familjare për të vlerësuar shkallën e problemit në qark.	2005	Instituti I Kërkimeve, Universiteti i Gjirokastrës, OJF grash, Komuniteti i Donatorëve	20,000	Edhe pse nuk ndikon në treguesit shëndetësor të përmendur, ky ka pasojë pozitive në fusha si arsimit, varfëria, qeverisja etj. Ky projekt do të përmirësojë informimin rajonal për dhunën në familje.
	Fushata Ndërgjegjësimit Publik	Bashkëpunim me mediat lokale për shpërndarjen e informacionit për dhunën kundër grave.	2005-2007	Media, OJF Grash Departamenti i Edukimit, Komuniteti i Donatorëve	50,000	Edhe pse nuk ndikon në treguesit shëndetësor të përmendur, ky projekt ka pasojë pozitive në fusha si arsimit, varfëria, qeverisja etj. Ky projekt do të përmirësojë ndërgjegjësimin për dhunën kundër grave dhe pasojave të saj shkatërruese.

	Ngritje Kapacitetesh	Sensibilizon dhe ngre kapacitetet e juristëve, policise, personelit mjeksor, mësuesve, punonjësve sociale, dhe personelit të mediave, mbi dhunën gjinore; sensibilizon dhe ngre kapacitetet e nxënësve të shkollave të mesme dhe studentëve të universitetit mbi dhunën e takimeve.	2005-2008	Gjykata, Policia, Institucione Shëndetësore, Shkollat, Mediat, Qendra Këshillimi, Drejtoria Arsimore	80,000	Edhe pse nuk ndikon në treguesit shëndetësor të përmendur, ky projekt ka pasoja pozitive në fusha si arsimit, varfëria, qeverisja etj. Ky projekt do të përmirësojë mundësinë për të luftuar dhunën gjinore, kapacitetin e tërë sektorëve për ta eliminuar atë dhe për të përmirësuar ndërgjegjësimin e traditave patriarkale që ligjërojnë pabarazitë gjinore në një lidhje, përmirësim të barazisë së fuqive nëpërmjet fuqizimit të grave të reja.
	Shpërndarja e shërbimeve	Vlerësim i nevojave për qendra këshilluese dhe qendra strehimi për të mbijetuarit e dhunës në familje; krijimi i qendrave të strehimit dhe qendrave këshilluese për të mbijetuarit e dhunës dhunës në familje.	2005-2008	Instituti i Kërkimeve, Universiteti i Gjirokastrës, OJF Grash, Komuniteti i Donatorëve, Qeveria Vendore	90,000	Edhe pse nuk ndikon në treguesit shëndetësor të përmendur, ky projekt ka pasoja pozitive në fusha si arsimit, varfëria, qeverisja etj. Ky projekt do të përmirësojë informacionin për mungesat e shërbimit të strehimit të mbijetuarve nga dhuna gjinore, dhe do të përmirësojë kapacitetet për të siguruar asistencë dhe për të dhënë shërbime për të mbijetuarit nga dhuna në familje.

OBJEKTIVI 4: Garantimi I Qendrueshmerise se Mjedisit

Prioritetet Strategjike të Parashtruara

SKZHES dhe Platforma Kombetare	OZHM	BE ¹⁷⁹	Qarku i Gjirokastrës
<ol style="list-style-type: none"> Ristrukturimi dhe konsolidimi i strukturave të menaxhimit të mjedisit në nivelin e qeverisjes vendore dhe ngritjen e burimeve njerëzore; Plotësimi i kuadrit ligjor për menaxhim të përbashkët të pyjeve e kullotave nga shteti dhe banorët; Përmirësimi i rolit të zbatimit të ligjit në konsolidimin e platformës institucionale; Kontroll i degradimit mjedisor, rehabilitim i zonave të ndotura, dhe qëndrueshmëri në rritje e burimeve natyrore; dhe Monitorim dhe kontroll ndaj peshkimit të paligjshëm 	<ol style="list-style-type: none"> Integrimi i parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programet e vendit; dhe Ruajtja e burimeve natyrore. 	<ol style="list-style-type: none"> Lufta kundër degradimit të mjedisit me vëmendje të vecantë ndaj: <ul style="list-style-type: none"> Cilësisë së ujit, Ndotjes së ajrit, Monitorimit të niveleve të ndotjes, Promovimit të eficensës së energjisë, Sigurisë së uzinave industriale, Planifikimit urban, Manaxhimi i mbeturinave, Dhe mbrojtjes së pyjeve, florës dhe faunës; Garantimi I integritetit të problemeve të mjedisit në politikat dhe programet sektoriale; Integrimi i parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm me përdorimin e burimeve njerëzore; dhe Përmirësimi i situatës në zonat e përcaktuara si zona "të nxehta". 	<ol style="list-style-type: none"> Ruajtja e burimeve natyrore të rinovueshme, në vecanti tokave pyjore; Furnizim universal me ujë të pijshëm sa më cilësor dhe eliminim i duhur i mbetjeve të ngurta; dhe Integrim i parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programet e qarkut, me vëmendje të vecantë ndaj humbjes së burimeve mjedisore.

Përshkrimi

Qarku i Gjirokastrës është përballur me një sërë problemesh mjedisore, shumë prej të cilave vijnë si

pasojë e varfërisë. Aktivitete të paligjshme, siç është prerja e pemëve për prodhimin e lëndës së drurit,

¹⁷⁹ Informacioni për prioritetin I në këtë seksion të objektivit të Proesit të Stabilizim Asocimit i marrë nga raporti i bërë në Qershor 2001 nga BE i titulluar "On the Work of the EU/Albanian High Level Steering Group" në përgatitjen e Stabilizim

Asocimit marrësja me Shqipërinë. Informacioni për prioritetin 2-4 është marrë nga programi i BE "CARDS": Strategjia për Shqipërinë 2002-2006", publikuar nga zyra e Marrëdhënive me Jashtë e BE për Ballkanin Perëndimor.

lidhjet e paligjshme të sistemit të rrjetit uhor, super shrytëzimi i kullotave, dhe vjelja e pakontrolluar e barërave dhe bimëve mjeksore, janë të shoqëruara të gjitha me varfërinë e të ardhurave. Përveç varfërisë ka dhe faktorë të tjerë që kanë rritur problemet mjedisore. Këtu përfshihet edhe një mungesë e theksuar e vizionit të qartë dhe një planifikim strategjik në nivel qarku, bashkie dhe komune, investimet publike të pamjaftueshme, dhe ndërgjegjësimi i pamjaftueshem i komunitetit për pasojat e menjëhershme apo afatgjatë të degradimit mjedisor. Gjatë dekadës së kaluar qarku ka vuajtur jo vetëm shpyllëzimin e shfrenuar nga zjarret dhe prerjet, por gjithashtu edhe nga përpjekjet e pakta për rimbjelljen dhe nga gjuetia diskriminuese, e cila ka vënë në rrezik egzistencën e kafshëve të egra. Dështimi i adresimit të problemeve të pyjeve vetëm sa demtojnë rëndë erozionet problematike të maleve, përmbytjet, si dhe rrëshqitjen e dheut. Prandaj një prioritet kryesor për qarkun është mbrojtja dhe zhvillimi i potencialeve të rinovueshme, si pyjet, zonat e gjelbra urbane, ekosistemet e tokës dhe të qëndrueshme, vecanërisht nëpërmjet rimbjelljes dhe vendosjes së masave mbrojtëse.

Për më tej, ripyllëzimi, mbrojtja, zhvillimi dhe mirëmbajtja e ekosistemit janë prioritetet e qarta. Dy projekte pilot të identifikuar, i pari pylli i Hotoves dhe pylli në Sotirë, mbështetur nga Banka Botërore, do të nenvizojë fillimin e programeve të reja për mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve të tjera, luginave dhe vendeve të gjuetisë, siç është lugina e Bëncës, gryka e Këlcyres, uji i ftohtë i Tepelenës, fushat Cajupi, dhe Llufe në Nivicë. Padyshim që do të zgjerohet numri i vendeve të gjuetisë siç është Carcovë, pylli Hotovë, Izvor dhe Radat për lepujt dhe drerin, Sinanaj-Salari për mëllenjat e tij, dhe Bënça për derrat e egër të saj, lepujt, drerin dhe fazanët. Qytetet e Qarkut të Gjirokastrës kanë pësuar ndryshime rrënjësore gjatë viteve të tranzicionit. Zonat e gjelbra urbane janë reduktuar dhe hapsirat publike vuajnë nga ajri i ndotur. Përmirësimi i jetës së popullsisë urbane do të kërkojë gjithashtu rehabilitimin e siperfaqeve të gjelbra, duke përfshirë parqet e qytetit dhe të tjera projekte të vogla.

Një tjetër prioritet i rëndësishëm për Qarkun është edhe reduktimi i erozionit, duke përfshirë rrëshqitjen e tokës, ndërtimet me copa shkëmbore, dhe kanalizimet e ujit gjatë stuhive. Një prioritet tjetër në fushën mjedisore është të bëjë të mundur pajisjen e banorëve në zona urbane dhe rurale me ujë të pijshëm të shëndetshëm e cilësor dhe të reduktojë rreziqet për shëndetin si pasojë e mbeturinave solide. Megjithatë statistikat janë të pamjaftueshme, dhe lidhjet e paligjshme në rrjetin e sistemit uhor mund të krijojnë probleme dhe rreziqe

serioze për shëndetin. Si vijim, urbanizimi i zonave të reja të sapo krijuara me problemet e tyre të kanalizimeve ndikojnë në burimet e ujit të pijshëm. Ndërkohë, burimet e ujit në disa zona rurale janë lënë të pambrojtura. Gjithashtu ka raste që si pasojë e stuhive uji i pijshëm përzihet me ujra të tjera duke u bërë kështu një burim i madh rreziku për shëndetin. Duke u bazuar nga kjo situatë delikate të përmendur më lart, është më se e domosdoshme dhe vitale mbrojtja e sistemit të rrjetit të ujit si dhe të burimeve të tij në zonat rurale, investimi në infrastrukturën ujore në zonat e reja të urbanizuara, riparimi i infrastrukturës së rrjetit të ujit në zonat rurale, si dhe ngritja e ndërgjegjësimit për problemet dhe riskun për shëndetin.

Një aspekt tjetër për të përmirësuar lidhjet me nivelin e pastërtisë së ujit sipas standarteve të BE, për të mbështetur këtë, një objekt për monitorimin e pastërtisë së ujit duhet të vendoset, si dhe të ndryshohen metodat e pastrimit të ujit duke kaluar nga klorinimi në teknologji më ambjentaliste. Mbeturinave inerte përbëjnë gjithashtu një shqetësim për qëndrat urbane në Qarkun e Gjirokastrës. Situata e tanishme ndikon në shëndetin e banorëve, kështu që përmirësimi i manaxhimit të mbeturinave inerte është mëse i domosdoshëm.

Përmirësimi në këtë sektor duhet të jetë kompleks duke përfshirë dhe duke mësuar nga eksperiencat më të mira për, mbushjen me dhe të gropave, kontraktimi i kompanive private, ndërmarja e inisiativave të komunitetit për të bërë aktivitete pastrimi, formulimi i politikave ricikluese, ngritja e ndërgjegjësimit, dhe vendosja e kontenerëve riciklues. Duhet të theksohet që është e nevojshme të mësohet nga eksperiencat më të mira dhe të dizajnohen politika të reja. Rasti i suksesshëm i përmirësimit të sistemit manaxhues së mbeturinave inerte është Bashkia e Tiranës, me ndihmën e krahinës së Catawbas, SHBA, dhe USAID-it, shërbejnë si një guidë e shkëlqyer. Kështu që asistencë teknike nga Bashkia e Tiranës do të jetë pika e referimit për përmirësimin e sistemit.

Principi i integritetit për një zhvillim të qëndrueshëm në politikat rajonale dhe kthimi i burimeve mjedisore është gjithashtu mjaft i rëndësishëm. Identifikimi i problemeve ambjentaliste, dhënia me përparësi e ndërhyrjeve, krahasimi i këtyre ndërhyrjeve me legjislativin ekzistues dhe zhvillimi i një programi krahasues janë pjesë përbërëse për politiken manaxhuese (EMP) për Qarkun e Gjirokastrës. Studimi i EMP do jetë si produkt i një procesi pjesëmarrës, duke përfshirë ketu burra e gra, por nuk duhet të pengojë progresin e sapo identifikuar të problemeve prioritare, siç është kërcënimi i specieve dhe banesave të tyre, ndërtimi i kapaciteteve, manaxhimi i tokës dhe i pyjeve, dhe çështjeve të emergjencës civile.

Synimet:

- 4.1. Rikthimi i vëmendjes ndaj burimeve të rinovueshme natyrore, duke i kushtuar vëmendje të veçantë mbrojtjes dhe zgjerimit të sipërfaqeve të gjelbëra, pyjeve dhe parqeve/zonave natyrore që mbrohen.
- 4.2. Bërja e mundur për të pajisur me ujë të pijshëm si burra e gra në zona urbane apo rurale qofshin ato, dhe ulja e rrezikut për shëndetin nëpërmjet sistemit të mbledhjes dhe depozitimit të mbeturinave në vendet e caktuara.
- 4.3. Përfshirja e parimit të qëndrueshmërisë së mjedisit në politikat dhe programet e qarkut, si dhe të ruajtjes së burimeve natyrore.

Treguesit

A). Sipërfaqja e tokës së mbuluar me pyje: Një pjesë e rëndësishme e qëndrueshmërisë së mjedisit të qarkut lidhet me sipërfaqen pyjore – jo vetëm për jetesën e botës shtazore, por edhe për prosperitetin ekonomik që do të ulte veprimtarinë e paligjshme. Është më se e njohur

që qarku i Gjirokastrës është përballur me një degradim të konsiderueshëm të pyjeve. Aktualisht, vetëm 25.77% e tokës është e mbuluar me pyje, e cila është një shifër mjaft e ulët e krahasuar me të shkuarën. Për fat të keq, statistikat e së kaluarës mbi sipërfaqen pyjore mungojnë, prandaj ne mund të vendosim treguesin vetëm në mënyre arbitrare në një mënyre modeste 2-3% rritje për 6 vjetët e parë të strategjisë.

B). Rrezikimi i Faunës: Sipas të dhënave, Qarku i Gjirokastrës ka një përqindje më të ulët të specieve të rrezikuara sesa mesatarja e BE. Kjo nuk duhet të keqinterpretohet si një tregues që nuk paraqet probleme ambjentaliste. Në fakt, mbetet një nevojë urgjente në qark për të mbrojtur dhe ruajtur të gjitha llojet e kafshëve dhe insekteve, si dhe vendbanimet e tyre. Për të ndaluar numrin gjithmonë në rritje të specieve të rrezikuara dhe përmirësimin e gjëndjes së tyre kërkon përpjekje të mëdha në emër të gjithë aktorëve dhe qarku i Gjirokastrës do të përpiqet të arrijë nivelin më të ulët të mundshëm të specieve në rrezik.

Treguesit Aktualë e Të Parashikuar:

Synimi	Treguesit	Mesatarja Kombetare e Shqipërisë		Niveli Baze i Qarkut të Gjirokastrës	2006	2009	2012	2015	Mesatarja e BE (Të dhëna nga Agjencia Europiane e Mjedisit)
4.1.- 4.3.	1. Përqindja totale të mbuluar me pyje.	35 (2000, UNECE)		25.77 (2003, Kadastra/ Këshilli i Qarkut)	28%	30 %	33%	40%	N/A
4.1.- 4.3.	2. Fauna e rrezikuar (%)	Gjitarët	56 (2000, UNECE)	22.5% (7 nga 31 lloje)	22.5	15	5	0	Nga 250 llojet, 42% janë të kërcënuara (1993)
		Shpendët	31 (2000, UNECE)	5.3% (5 nga 93 llojet)	5.3	4	2	0	Nga 520 llojet, 15% janë të kërcënuara (1993)
		Zvarranikët	n/a	100% (Të gjitha)	100	75	50	0	Nga 199 llojet, 45% janë të kërcënuara (1993)
		Peshq të ujërave të ëmbla)	n/a	45.5% (5 nga 11 llojet)	45.5	30	15	0	Nga 227 llojet, 52% janë të kërcënuara (1993)

Programi i Zhvillimit

Synimi 4.1.: Reduktimi i humbjes së burimeve mjedisore të rinovueshme duke përqëndruar vëmendjen në rritjen e zonave pyjore, parqeve urbane dhe zonave të mbrojtura.

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Kuadri kohor	Partnerët e mundshëm	Kosto në Euro	Efeti
Çpyllëzimi i shkaktuar nga prerjet pa leje dhe zjarret	Projekt për mbjelljen e pemëve	Ndërmarrja e një studimi për pyllëzimin për të përcaktuar zonat parësore.	2005	QSH/Drejtoria e përgjithshme e pyjeve, ARM	25,000	Ri-pyllëzimi do të ndikojë direkt në treguesin 1 dhe indirekt në treguesin 2, sepse do të sigurojë banim për disa nga speciet e paraqitura në tabelën e treguesve.
		Ripyllëzim i shpejtë I zonave parësore.	2005-2006	QSH/Drejtoria e përgjithshme e pyjeve, komunitetet lokale, shkollat, ARM	400,000	
Mungesa e mbrojtjes, investimeve dhe mirëmbajtjes së ekosistemeve	Ndërmarrja e një studimi për të identifikuar ndërhyrjet e duhura dhe caktojë ndërhyrjet parësore për ekosistemet, zonat pyjore dhe të gjuetisë	Studimi do të përqendrohet në pyjet dhe luginat tashmë të identifikuar.	2005-2006	OJQ, ARM, donatorë, Shkolla pyjore në Tiranë	50,000	Këto ndërhyrje do të ndikojnë pozitivisht tek të gjithë treguesit nëpërmjet mbrojtjes së vendbanimeve.
	Projekte pilote për pyjet në Hotovë dhe në Sotirë	Projektet synojnë kthimin e dy pyjeve në parqe kombëtare të mbrojtura.	2006-2010	QSH, Banka botërore	250,000	
Përkeqësimi i hapësirës së gjelbër urbane dhe ndotja e qytetit	Programi urban për Gjirokastrën 'pastrim & gjelbërim'	Rehabilitim në shkallë të vogël për parqet, mbrojtjen e terrenit në unazën e qytetit, ripyllëzim, dhe projekte të tjera të vogla	2005-2007	Komunitetet lokale, UNDP, donatorë të tjerë, ARM	1,500,000	Rehabilitimi i hapësirave të gjelbra urbane do të ndikojë direkt në treguesin e parë.
Erozioni i rëndë i tokës	Projekt për reduktimin e erozionit	Lokalizimi i erozionit, duke përfshirë hapësirat në mal dhe fushë, si dhe caktimin e ndërhyrjeve parësore.	2005-2006	OJQ, donatorë, ARM	60,000	Erozioni shkakton humbje të madhe në zonat e gjelbra dhe ato pyjore çdo vit. Reduktimi ose eliminimi i erozionit në pyje dhe vendbanime do të ndikojë treguesit 1 dhe 2.
		Projekt për reduktimin dhe eliminimin e erozionit, duke përfshirë ndërtimin e digave malore dhe kanalizimin e ujit.	2005-2010	OJQ, donatorë, ARM	600,000	

Synimi 4.2.: Sigurimi për burrat dhe gratë, në zonat urbane dhe rurale, i ujit të pijshëm me cilësi dhe siguri të lartë, dhe reduktimi i rreziqeve shëndetsore të shkaktuara nga grumbullimi i papërshtatshëm i mbetjeve të ngurta

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Kuadri kohor	Partnerët e mundshëm	Kosto në Euro	Efeti
Siguria e pamjaftueshme e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme dhe strukturës së dobët të ujrave të zeza në zonat e periferisë	Program mbi riparimin dhe mbrojtjen e sistemit të ujit	Riparim i menjëhershëm i sistemeve të furnizimit me ujë.	2005-2006	Komunitetet lokale, OJQ, donatorë	120,000	Një sistem i sigurtë furnizimi me ujë nuk do të ndikojë direkt tek treguesit në seksionin e mjedisit. Megjithatë raporti i vdekshmërisë foshnjore do të ndikohet pozitivisht.
		Vëzhgim mbi lidhjet e paligjshme për të realizuar shkëputjet.	2005-2007	Komunitetet lokale, OJQ, donatorë		
	Projekti i investimeve urgjente në kanalizimet e ujrave të zeza	Ndërmarrja e një studimi për të identifikuar ndërhyrjet urgjente tek ujrat e zeza, veçanërisht në zonat e reja të krijuara në periferi të qytetit.	2005	OJQ, donatorë, institucione kërkimore	30,000	
		Projekt investimesh të pjesshme për ujrat e zeza.	2005-2006	QSH, donatorë		
Mbrojtje e pamjaftueshme e burimeve ujore në zonat rurale	Fushatë ndërgjegjësimi mbi mbrojtjen e burimeve ujore dhe një projekt	Fushata do të përqendrohet në komunitetet rurale më të dëmtuara dhe do të realizohet nga OJQ, sistemi arsimor dhe media.	2005-2007	Drejtoritë e shëndetit publik, OJQ, media	50,000	Fushata e ndërgjegjësimit do të ndikojë direkt në të gjithë treguesit.

STRATEGJIA E ZHVILLIMIT TE QARKUT GJIROKASTER 2005

	në shkallë të vogël mbi mbrojtjen e burimeve ujore	Riparimi i mjeteve për burimet ujore.	2005-2008	Komunitetet, UNDP	100,000	
Cilësi e dobët e ujit	Projekt për testimin dhe politikën e ujit	Zhvillimi i një politike rajonale për cilësinë e ujit në përputhje me standartet kombëtare dhe ato të BE.	2005-2007	Komunitetet lokale, MPP, OJQ, donatorë, institucione kërkimore	35,000	Përmirësimi i mjeteve të testimit të ujit, dhe politikës përkatëse që rregullon standartet sanitare do të ndikojë pozitivisht tek të gjithë treguesit.
		Modernizimi i mjeteve ekzistuese lokale për testimin dhe monitorimin e ujit.	2005-2007	Komunitetet lokale, MPP, OJQ, donatorë, institucione kërkimore	300,000	
Sistem i papërshtatshëm për menaxhimin e mbetjeve të ngurta	Projekt për menaxhimin e mbetjeve të ngurta	Asistencë teknike mbi menaxhimin e mbetjeve të ngurta nga Bashkia e Tiranës, duke përfshirë vizitë studimore në Catawba County, SHBA.	2005	OJQ, USAID, Catawba county SHBA	150,000	Iniciativat mbi menaxhimin e mbetjeve të ngurta do të ndikojnë pozitivisht tek të gjithë treguesit përmes pastrimit, rregullimit, dhe riciklimit të duhur dhe zhdukjes së mbeturinave.
		Rigjenerim i territorit.	2005-2007	Donatorë	300,000	
		Sistem privat për mbledhjen e mbetjeve të ngurta.	2005-2007	Bashkia e Tiranës, OJQ, USAID, donatorë të tjerë	1,500,000	
		Aktivitetet të komunitetit dhe OJQ për pastrimin dhe formulimin e politikave për riciklimin, duke përfshirë dhe fushata ndërgjegjësimiti.	2005-2007	OJQ, USAID, donatorë të tjerë	1,200,000	
		Instalimi i njësie të riciklimit të mbeturinave.	2007	Bashkia e Tiranës, OJQ, USAID, donatorë të tjerë	1,200,000	

Synimi 4.3: Integrimi i parimit të zhvillimit të barabartë dhe të qëndrueshëm në politikat dhe programet rajonale dhe humbja e burimeve mjedisore

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Kuadri kohor	Partnerët e mundshëm	Kosto në Euro	Efekt
Mungesa dhe papërshtatshmëria e planeve mjedisore të bashkive dhe komunave	Projekt për planifikimin mjedisor lokal	Ushtrime mbi planifikimin mjedisor përmes grupeve të punës të përfaqësuar në barazi gjinore, nga bashkitë dhe komunat.	2005-2007	ARM, OJQ, SIDA, UNDP	90,000	Planifikimi mjedisor lokal do të ndikojë pozitivisht tek të gjithë treguesit.
	Krijimi i një autoriteti të decentralizuar për pyjet	Identifikimi i përgjegjësive politike dhe menaxheriale të autoritetit vendor për çështje që lidhen me pyjet.	2005-2007	QSH, donatorë	100,000	
Mungesa e njohurive të avancuara mbi speciet e kërcënuara dhe ato në rrezik	Projekt për katalogimin e vendbanimeve dhe specieve në rrezik	Vëzhgim shumëvjeçar për të skeduar speciet e kërcënuara dhe ato në rrezik dhe vendbanimet në qark.	2005-2010	QSH, ARM, OJQ, institute kërkimore, donatorë, komunitetet vendore	500,000	Rritja e njohurive për speciet e kërcënuara (bimë, kafshë, insekte, zvarranikë, peshq) do të ndikojë në planifikimin më efektiv të iniciativave që do të trajtojnë shkaqet kryesore të rrezikut, duke ndikuar pozitivisht në treguesin 2.
Mungesa e ekspertizës në qeveri dhe në shoqëri civile mbi çështjet e qëndrueshmërisë mjedisore dhe të iniciativave planifikuese që konsiderojnë mjedisin.	Projekt aftësimi me komponent mjedisin	Aftësim me barazi gjinore për integrimin e qëndrueshmërisë mjedisore në planifikimin e zhvillimit, si dhe trajnime dhe vizita shkëmbimi brenda dhe jashtë Shqipërisë.	2005-2007	QSH, OJQ, institute kërkimore dhe donatorë	80,000	Njohuritë për qëndrueshmërinë mjedisore dhe përfshirja e tyre në ciklin e projekteve do të ndikojë pozitivisht në të dy treguesit.
Mungesa e një menaxhimi të qartë të tokës	Projekt planifikimi për parkun	Ndërmarrja e një studimi mbi strukturat menaxhuese dhe kufijtë e pyjeve dhe kullotave, dhe zhvillimi i një strategjie për menaxhim dhe kufizim të përmirësuar duke përdorur GIS dhe teknologjitë dixhitale.	2005-2010	QSH, OJQ, institute kërkimore dhe donatorë	450,000	Strategjitë e qarta mbi kufizimin e tokave dhe përgjegjësitë për menaxhimin e tyre do të çojnë në një planifikim më të mirë për mbrojtjen, rehabilitimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të tokës, duke ndikuar pozitivisht tek të gjithë treguesit.
	Projekti për kullotat dhe pyjet 'Përdorim dhe Drejtë'	Ndërmarrja e një studimi mbi strukturat menaxhuese dhe kufijtë e pyjeve dhe kullotave, dhe zhvillimi i një politike për përmirësimin e menaxhimit dhe qartësimin e kufizimeve.	2006-2010	QSH, OJQ, institute kërkimore dhe donatorë	500,000	
Mungesa e kapaciteteve për menaxhimin e fatkeqësive	Projekt aftësimi për zyrën e emergjencave civile	Ndërtimi i kapaciteteve të zyrës për të ndërmarrë të gjitha aspektet e menaxhimit të fatkeqësive nëpërmjet dhënies së kompjuterave, komunikimit dhe pajisjeve.	2005-2007	Donors	20,000	Megjithëse ky projekt nuk ndikon direkt në ndonjë tregues mjedisor, menaxhimi i fatkeqësive është një kriter për zhvillim të qëndrueshëm njerëzor dhe arritjen e OZHM-ve.

Objektivi 5: Përmirësimi i qeverisjes

Prioritetet strategjike të bashkërenditura

SKZHES dhe Platformat kombëtare ¹⁸⁰	OZHM ¹⁸¹	BE ¹⁸²	Qarku i Gjirokastrës
1) Riformim i thelluar dhe modernizim i institucioneve të shtetit në përputhje me standartet e një shoqërie demokratike dhe të një ekonomie të orientuar në treg, dhe 2) Përgjegjësi e rritur e barazuar në gjini në strukturat dhe komitetet qeveritare, në sistemin e drejtësisë dhe në të gjitha fushat e administratës publike.	1) Fuqizimi i të varfërve përmes qeverisjes demokratike, sepse institucionet politike duhet t'i lejojnë të varfërit të marrin pjesë në vendimet që ndikojnë në jetën e tyre dhe t'i mbrojnë ata nga vendim-marrja arbitrare, dhe e papërgjegjshme e qeverisë dhe forcave të tjera.	1) Kontroll financiar publik i brendshëm i fuqizuar dhe institucione të jashtme auditimi; 2) Zhvillimi dhe hyrja në fuqi i një kuadri rregullator të përmirësuar për prokurimet publike; 3) Pjesëmarrja e të gjithë komponentëve të shoqërisë civile në zbatimin dhe monitorimin e një programi anti-korrupsion; 4) Burime financiare në rritje për qeveritë vendore; dhe 5) Sigurimi i një trajnimit të duhur për personelin e qeverisë vendore.	1) Fuqizimi i qeverisjes vendore dhe rritje e pjesëmarrjes qytetare; 2) Vendosja e një administrate publike vendore të pavarur, transparente dhe të barazuar në gjini; 3) Stimulimi i zhvillimit të biznesit në qark; dhe 4) Përmirësimi i mbledhjes së të dhënave të grupuara në gjini, dhe zbatimi i zgjeruar politikave dhe programeve integruese gjinore.

Përshkrim

Përmirësimi i qeverisjes është një kriter bazë për arritjen e OZHM-ve në nivel qarku, pasi vetëm me anë të qeverisjes rregullat mund të zbatohen, politikat e ambjentit në nivel vendor bëhen më efektive, dhe rolet e pjesmarrësve bëhen të përcaktuara dhe respektohen. Në një kontekst më të gjerë, mirë qeverisja është edhe një kusht primar për integrimin Evropian dhe gjithashtu është një nevojshmëri politike për të tërhequr ndihmat e donatorëve drejt Shqipërisë. Si e tillë, kjo përfaqëson një prioritet ndërsektorial në të gjitha agjendat strategjike kombëtare, të tilla si SKESZH, procesi i Stabilizim Asocimit, edhe OZHM-te. Problemet e qeverisjes në nivel rajonal në Gjirokastrë janë të shumta. Problemet përfshijnë mosnjohshmëri në fuqizimin e qeverisë vendore, nivel i ulët i pjesmarrjes qytetare, rekrutimi i punonjësve publik duke u bazuar në asocimet politike apo private, transparencë jo eficiente dhe simbolike në sistemin administrativ, kapacitete jo të duhura të qeverisë vendore në menaxhimin e zhvillimit të biznesit vendor, dhe një mungesë e vendosjes së prioriteteve të çështjeve sensitive gjinore. Veçanërisht, përta i përket çështjeve gjinore, mungesa e barazisë

është më e dukshme në qarkun e Gjirokastrës, kur vëmë re pjesmarrjen e grave në institucionet qeverisëse dhe në arenën politike. Në një sondazh të bërë në 65 institucione në qarkun e Gjirokastrës, vetëm 9 gra, duke përfaqësuar vetëm 13.8% të atyre që mbajnë pozicione drejtuese, pra që ushtrojnë punë të nivelit hierarkik të lartë. Përta i përket rrafshit politik dhe administratës publike, vetëm 4.6% të anëtarëve të zgjedhur në Këshillin e Qarkut janë gra, dhe vetëm një numër i vogël prej 6% të anëtarëve të zgjedhur në komuna dhe bashkësi janë gra¹⁸³. Për më tepër, politikat e qeverisjes së qarkut, programet dhe buxhetet kanë si mangësi të plotë perspektivat gjinore. Nuk ka asnjë mekanizëm institucional, të tillë si komisionet vendore që merren me gratë dhe çështjet gjinore, kordinues të çështjeve gjinore, apo trajnimit me ndjeshmëri ndaj çështjeve gjinore për punonjësit e qeverisë së qarkut, në menyre që të rrisin aftësinë e grave. Nuk janë bërë përpjekje as për të rritur pjesmarrjen e grave në vendim marrje apo lidhshmëri. Kështu rezulton se ka një nevojë të domosdoshme për të ndërtuar kapacitete për gra kandidatë në politikë dhe punonjës në qeverisje.

180 Prioritetet për barazinë gjinore janë marrë nga Platforma për veprim në përmirësimin e statusit të grave në Shqipëri.

181 Megjithatë "Qeverisja" nuk është në mënyrë specifike një OZHM, dokumenti i përmbledhur për Zhvillimin e Mijëvjeçarit (Millennium Development Compact) jep informacion në këtë seksion dhe përqendrohet në në qeverisjen e mirë si një aspekt themelor i arritjes

dhe zbatimit të vazhdueshëm të OZHM-ve dhe objektivave të tjerë.

182 Informacioni për këto ndërhyrje parësore është marrë nga "Programi CARDS i Bashkimit Evropian: Strategjia për Shqipërinë 2002-2006", publikuar nga drejtorja e mardhënëve me jashtë dhe me ballkanin perëndimor e Komisionit Evropian.

183 Regjistri statistikor i bashkive, Këshilli i qarkut 2003.

Faza e parë në fushën e qeverisjes është fuqizimi i komunave dhe bashkive, ndërsa rritet pjesmarrja e banorëve duke i kushtuar vëmendje të vecante pjesmarrjes së grave. Një legjislacion i tërë, duke përfshirë kushtetutën dhe strategjinë kombëtare të decentralizimit për autonominë vendore dhe Ligjin mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Pushtetit Vendor synon delegimin e autoritetit dhe burimeve të PV, me qëllim që t'i sjelli ata më afër qytetarëve. Megjithatë, ndërsa decentralizimi është një prioritet i lartë për Shqipërinë, autoriteti i pushtetit vendor në lidhje me qartësinë e funksioneve për tu kryer është akoma i dobët, baza e tyre ekonomike është e hollë, dhe kapaciteti njerëzor i pamjaftueshëm. Nën këto rrethana, pushtetet vendore janë pasive dhe varësia financiare mbi pushtetin qendror është e ekzagjeruar. Për kohën e tanishme, nuk ka funksione ekonomike në nivele lokale në termat e rritjes së të ardhurave, shpenzimit dhe shërbimit, investimet dhe borxhet.

Mungesa e autoritetit të duhur dhe burime të pamjaftueshme në qarkun e Gjirokastrës, dobëson lidhjen midis qytetarëve si konsumatorë dhe votuesve (vecanërisht të varfërit) dhe atyre që janë zgjedhur, sepse tashmë qytetarët nuk kanë pritshmëri nga pushteti vendor. Pra, fuqizimi i njësisve qeverisëse në termat e autoritetit, kapacitetit dhe burimeve (ekonomike dhe njerëzore) është piknisja për demokracinë e nivelit funksional lokal. Nga ana tjetër, duke sjellë shërbimet më afër qytetarëve, i ndihmon ata të përmirësojnë statusin e tyre social dhe ekonomik që përfshin reduktimin e varfërisë. Kjo bën që pjesmarrja qytetare të bëhet më kuptimplote dhe më tërheqëse. Që të ndodhë pjesmarrja qytetare, ajo duhet të mbështetet dhe inkurajohet. Kështu, Këshilli i Qarkut, synon të nxisë pjesmarrjen e qytetarëve në çështjet lokale përmes krijimit të partneriteteve afatgjatë me organizatat e shoqërisë civile në nivel lokal.

Një mënyrë tërheqëse për iniciimin e pjesmarrjes qytetare në periudhë afat-shkurtër është nëpërmjet procesit të përgatitjes së buxhetit. Pjesmarrja qytetare në priorizimin e projektit dhe financimi përmes buxhetimit lokal ndihmon banorët jo vetëm të aksesojnë fondet e pushtetit vendor, por gjithashtu të mësojnë rreth përfitimeve nga pjesmarrja. Mësimi nga praktikat e mira, si rasti i projektit CESEDA i financuar nga USAID/World Learning, inkurajon pjesmarrjen e ardhme dhe përfshirjen. Përmirësimi i shërbimeve për qytetarët, nuk është i mundur pa krijimin e një administrate publike lokale profesionale, të besueshme, transparente dhe të balancuar nga ana gjinore. Këshilli i Qarkut të Gjirokastrës do ta bëjë këtë një synim themelor. Tani, administrata publike në nivel lokal vuan

nga emërimet e njëanshme që rezultojnë në punësimin e zyrtarëve publike me aftësi dhe arsim të pamjaftueshëm që krijon paqëndrueshmëri në administratë, inkurajon influencë serioze politike dhe performancë jo të kënaqshme. Stabiliteti administrativ është një problem kryesor sepse ka një mungesë të bazes ligjore mbi të cilin të bëhen rekrutimet, promovimet dhe largimet nga puna, përveç faktorëve të tjerë psikologjikë dhe kulturalë. Kështu, në nivelin e Këshillit të qarkut është e rëndësishme të bihet dakort mbi rregullat dhe forcimin e mekanizmave në lidhje me rekrutimin e balancuar gjinor, promovimin dhe largimin nga puna. Ky grup rregullash mund të bazohet në Ligjin e Shërbimit Civil, megjithëse mundet të ishte më fleksibël.

Një fushë tjetër problematike është mungesa e njohurive nga zyrtarët lokalë mbi interesat e privatëve, komunave, bashkive si dhe mungesa e mekanizmave për të mbrojtur interesat publike. Një kod etike është një instrument i duhur me të cilin mund të krijohet një ambjent moral në të gjitha nivelet. Synimi është të përgatitet dhe zbatohet një kod etikash për të gjitha komunat dhe bashkitë, duke përfshirë Këshillin e Qarkut, bazuar në shembujt nga Vlora dhe Bashkitë e tjera, të mbështetura nga USAID nëpërmjet MSI dhe OJQ-ve shqiptare. Kapacitetet Institucionale në lidhje me kryerjen e funksioneve të caktuara janë gjithashtu një problem për qarkun. Si rezultat do të kryhet në një periudhë afat-shkurtër vlerësimi i nevojave organizative e ndjekur nga rimodelimi i strukturës organizative. Përgatitja e një manuali të brendshëm për qartësimin e procedurave është gjithashtu një prioritet.

Ka sasi të mëdha informacioni të prodhuar në nivel lokal dhe qarku nga komunat, bashkitë, shëndetsia, arsimi, taksat dhe doganat, KESH, dhe agjencitë e telefonit. Megjithatë, një numër aktorësh të tjerë të rëndësishëm janë në nevojë për informacion, si qytetarët në lidhje me shërbimet publike, bizneset në lidhje me taksat dhe doganat, komunat dhe bashkitë në lidhje me performancën e funksioneve të tyre, dhe universitetet dhe agjentët e tjerë të zhvillimit për nevojat e tyre specifike. Në këto rrethana, ndërtimi i një sistemi të manaxhimit të informacionit (MSI) dhe ofrimi për të gjitha palët akses të besueshëm dhe në kohe të të dhenat është themelor. Të gjitha projektet dhe programet të prioritzuara në strategji duhet të ndikojnë në jetën e njerëzve. Si rrjedhojë, është e rëndësishme të monitorohen efektet e ndërhyrjes mbi kushtet e jetesës. Mbi këtë bazë, krijimi i një njësie për monitorimin e strategjise së Zhvillimit të Qarkut në linjë me OZHM do të ndihmojë krijimin e një lidhje midis ndërhyrjeve dhe ndikimit të njerëzit.

Synimet

- 5.1. Fuqizimi i pushtetit vendor dhe rritja e pjesmarrjes së qytetareve.
- 5.2. Krijimi i një administrate publike profesionale, të besueshme, transparente dhe të balancuar nga ana gjinore që nuk influencohet nga interesat politike ose private, dhe që është e aftë t'u sigurojë të gjithë qytetarëve, shërbime publike pa anshmëri politike.
- 5.3. Integrimi gjinor në politikat, programe dhe buxhete, dhe mbledhja e të dhenave jo të agreguara.

Treguesit

A). Numri i mbledhjeve të mbajtura në Këshillin e Qarkut për të rishikuar Progresin e Zbatimit të strategjisë së Zhvillimit të Qarkut: Sapo të fillojë zbatimi i Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut, një tregues i rëndësishëm për Këshillin e Qarkut do të jetë rishikimi i përpjekjeve të tyre për zbatimin dhe arritjen e synimeve të përcaktuara në strategji. Rishikime të tilla duhet të ndodhin në bazë tremujore dhe duhet të konsiderojnë treguesit e përcaktuar përmes këtij dokumenti si mënyrë kryesore për të matur progresin në arritjen e synimeve të tyre.

B). Numri i Organizatave Aktive të Shoqërisë Civile (OSHC): Tashme ka 50 OshC të regjistruara zyrtarisht në qarkun e Gjirokastrës. Megjithatë, nga këto, vetëm 16 operojnë aktivisht. Nëpërmjet Dokumentit Strategjik të Vendit, BE ka treguar se pjesmarrja e shoqërisë civile, vecanërisht përfshirja e atyre që lidhen me iniciativat e antikorrupsionit, duhet të jetë një synim prioritar. Në termat e matjes së përmirësimeve në këtë fushë, progresi mund të shfaqet nëpërmjet sjelljes së një numri të OSHC "aktive" pranë atyre të regjistruara zyrtarisht në qark. Kështu, nga viti 2015, qarku duhet të synojë rritjen e numrit të OSHC aktive vecanërisht në zonat rurale. Në mbështetje të këtij procesi, një tregues tjetër që mund të përdoret për të ndihmuar matjen e këtij synimi do të ishte fillimi i vlerësimit të numrit të mbledhjeve publike të iniciuara nga OSHC në qark.

C). Numri i qëndrave Funktionale të Aksesit Publik (PAC):

Një aspekt integral në termat e matjes së fuqisë së shoqërisë civile është vlerësimi I aftësisë së qytetarëve për të aksesuar informacionin rreth pushtetit vendor, shërbimeve dhe aktiviteteve. Sipas raportit të Zhvillimit Njerëzor, viti 2001 nga Bullgaria, 47.5% e atyre që u studiuan deklaruan se ata vizitonin një site interneti të bashkisë, ku 19.2% kërkonin informacion rreth shërbimeve të bashkisë, 18.9% shikonin buxhetin e bashkisë, dhe 18.7% vizitonin site për të lexuar strategjinë e zhvillimit të bashkisë. Aktualisht ka dy PAC në qarkun e Gjirokastrës por të dyja janë të vendosura në bashkinë e Gjirokastrës. Ndërsa zhvillimi i një rrjeti të zgjeruar të PAC në qark në vitin 2015 varet disi nga faktorët teknike dhe të kapacitetit (p.sh., fuqia e rrjetit, zgjerimi i tregut të ISP) zgjerimi i tij është vital në lidhjen e qytetarëve të qarkut të gjirokastrës me pushtetin e tyre vendor dhe me rrjetin global të informacionit. Përpjekje duhet të bëhen për të rritur numrin e siteve të PAC nga dy site që janë në operim në 10 site në 2015.

D). Përqindja e grave në Këshillin e Qarkut:

Aktualisht, ka vetëm 2 gra nga 43 në Këshillin e Qarkut. Në nivel kombëtar është të disagregosh pjesmarrjen e grave në shërbimin publik nga pjesmarrja e grave në sektorë të tjerë të forcave të punës. Të dhënat nga Raporti i Zhvillimit Njerëzor tregojnë se mesatarisht në nivel kombëtar, 29.2% gra janë të "vetëpunësuar, punëdhënëse ose mbajnë pozicione vendim-marrje në administratën publike." Megjithatë, përveç mungesës së të dhënave, përmirësimi i përqindjes gra/burra në shërbimet publike të qarkut është komponent i rëndësishëm për krijimin e sistemeve të punësimit publik të ndjeshme ndaj gjinisë, në qark. Për më tepër, përmirësimet këtu janë në linjë me objektivat e propozuara të kuadrit kombëtar, "Platforma e veprimit për përmirësimet të statusit të gruas në Shqipëri 2002-2005," që përcakton si synim një "ritje në përgjegjësitë e ndara sipas gjinisë në njësitë qeverisëse dhe në komitete, në sistemet e gjyqimit dhe në të gjithë zyrat e administratës publike". Si rrjedhim, në vitin 2015, barazia në shërbimet publike të qarkut do të rritet, nëse është e mundur në pikën e barazisë gjinore.

Treguesit Aktualë dhe të Parashikuar:

Treguesit Aktualë dhe të Parashikuar:

QELLIMI 5: Përmirësimi i Qeverisjes								
Synimi	Treguesit	Mesatarja Kombetare shqiptare	Viti Bazë Qarku Gjirokastrër	Të dhënat bazë	2006	2009	2012	2015
5.1.-5.4.	2. # mbledhjeve të mbajtura në Këshillin e Qarkut për të rishikuar progresin në zbatimin e strategjisë	n/a	2001	0	4	4	4	4
5.1., 5.3., 5.4.	3. Numri i Organizatave të shoqërisë civile (OSHC)	200 ¹⁸⁴	2003	16 ¹⁸⁵	20	30	40	50
5.1., 5.2., 5.3.	4. Numri i Qëndrave funksionale të Aksesit Publik	n/a	2003	2	4	6	8	10
5.1.-5.4.	5. shkalla Meshkuj/Femra në shërbimet publike të qarkut	Tbd	4.6%	4.6% (2 gra nga 43 antare gjithsej të Këshillit të Qarkut) (2003, regjistri statistikor Bashki/ Këshill Qarku)	8	12	15	20

Program zhvillimi

Synimi 5.1.: Fuqizimi i Pushtetit Vendor dhe rritja e pjesëmarrjes qytetare.

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Afati kohor	Partnerët e mundshëm	Kosto në Euro	Efekti
Autoriteti i pamjaftueshëm dhe burime të transferuara të pushtetit vendor	Delegim i autoritetit dhe burime duke përfshirë asete dhe burime njerëzore, të pushtetit vendor	Funksione të përcaktuara qartë dhe kryerja e delegimit të burimeve, kryesisht në shëndet dhe arsim.	2005-2007	UNDP, Shoqata e Bashkive, MeA, Me Sh, MePV, dhe bashkitë, qarqet dhe komunat, donatorët	75,000	Rritja e kapaciteteve dhe zbatimi i politikave të decentralizimit do të ndikojë pozitivisht të gjithë treguesit.
		Transferimi i pronave dhe regjistrimi i tokës.	2005-2007		200,000	
		Rritja e kapaciteteve për gjenerimin e të ardhurave, duke përfshirë taksën e biznesit të vogël dhe taksën e tokës.	2005-2007		75,000	
		Rritja e kapaciteteve në termat e planifikimit strategjik, identifikimi dhe formulimi i projekteve, dhe ngritja e fondeve.	2005-2008		50,000	
Pjesëmarrje minimale qytetare në proceset e vendimmarrjes duke përfshirë përgatitjen e buxhetit.	Partneritet OSHC qeveri	Trainimi i stafit të PV mbi metodat me pjesëmarrje.	2005-2007	Donatorët, OSHC, qytetarët, komunat dhe bashkitë në Qarkun e Gjirokastrës, UNDP	30,000	
		Krijimi i një sistemi informacioni të PV të hapur për publikun me qëllim që të sigurohet një informim në kohë dhe informacion lehtësisht i kuptueshëm mbi shërbimet e PV dhe vendimet.	2005-2009		60,000	
		Nxitja e dialogut të rregullt me qytetarët meshkuj dhe femra nëpërmjet krijimit të një sistemi të mbledhjeve publike në salla publike.	2005-2015		100,000	
	Buxhetim me pjesëmarrje	Mbështetja e procesit të buxhetimit me pjesëmarrje në bashkitë dhe komunat.	2005-2009	UNDP, USAID, World learning		

¹⁸⁴ SPAI Konferenca Rjionale për Shoqërinë civile, "Fuqizimi i shoqërisë Civile ndaj Korrupsionit në Europën jug lindore", Shtator 2001. Kjo shifër bazohet në numrin e OSHC që janë "aktive" në vend

(kundrejt numrit të atyre thjesht të regjistruara në nivel kombëtar)
¹⁸⁵ Ndërsa ka 50 OSHC të regjistruara, vetë 16 nga ato vlerësohen të jenë aktive.

Synimi 5.2: Krijimi i një administrate publike profesionale, të besueshme, transparente dhe të balancuar nga ana gjinore që nuk influencohet nga interesat politike ose private, dhe që është e aftë t'iu sigurojë të gjithë qytetarëve, shërbime publike pa anshmëri politike.

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Afati kohor	Partnerët e mundshëm	Kosto në Euro	Efekt
Mungesa e stabilitetit dhe administratës publike pa anshmëri politike për shkak të rregullave jo të qarta të rekrutimit , dhe largimit nga puna	Rregulla rajonale në shërbimet civile dhe në administratën publike	Marëveshje mbi forcimin e rregullave në nivelin e Këshillit të Qarkut, komunë dhe bashki në lidhje me punësimin zyrtar, të balancuar nga ana gjinore, promovimin dhe largimin nga puna.	2005-2007	UNDP, Bashkitë, komunat, DAP, donatorët, MSI, USAID, OShC	125,000	Ky "kod i kryerjes" do t'i japi formë parametrave të sjelljes së duhur në fushat e rekrutimit, trainimit, avancimit në karrierë, pra përmirësimi të cilësisë së shërbimeve publike duke ndikuar direkt pozitivisht të gjithë treguesit .
Mungesa e efikasit në shpërndarjen e shërbimeve dhe manaxhimin financiar	Vlerësimi i nevojave organizative	Kryerja e vlerësimit të nevojave organizative për një matje më të saktë të asaj që njësitë specifike duhet të përmirësojnë dhe dhënia e rekomandimeve për të adresuar mungesat.	2005	UNDP, Bashkitë, komunat, DAP, donatorët,	75,000	Këto iniciativa ndikojnë të gjitha nivelet e pushtetit vendor dhe fuqitë e tyre. Si rrjedhim të gjithë treguesit do të jenë të ndikuar pozitivisht.
	Rishikimi i strukturës organizative	Krijimi i diagrameve organizative citati i misionit dhe TeR për njësitë e shpërndarjes së shërbimeve dhe manaxhimit financiar brenda departamenteve të pushtetit vendor.	2005-2009	UNDP, Bashkitë, komunat, keshilli i qarkut, DAP, donatorët,	110,000	
	Manuale të procedurave të punës	Përgatitja e një manuali të brendshëm që do të përdoret për të qartësuar proceset dhe procedurat e punës.	2005	UNDP, Bashkitë, komunat, keshilli i qarkut, DAP, donatorët,	30,000	
Mungesa e punonjësve dhe kandidatëve politike femra në pushtetin vendor	Fuqizimi i kandidatëve politike femra dhe nxitja e punësimit të femrave	Kryerja e trainimeve për lidhshmëri për kandidatet politike femra dhe zyrtarët vendorë; krijimi i mekanizmave për të rritur dhe promovuar punësimin e grave në nivelet e pushtetit vendor.	2005-2009	Pushteti Vendor, MePCS, Komiteti për mundësi të barabarta, OJQ të grave, donatorët	50,000	Përmirësimi i pjesëmarrjes së grave në pozicionet autoritative dhe rolet e vendimmarrjes , dhe barazi më e madhe gjinore në termat e punësimit në pushtetin vendor , duke ndikuar pozitivisht shkallën meshkuj/femra në treguesin e shërbimit publik në qark.
Mungesë e ndjeshmërisë gjinore mes zyrtarëve të pushtetit vendor	Ndjeshmëria gjinore dhe forcimi i kapaciteteve të zyrtarëve të pushtetit vendor	Dhënie trainimesh mbi ndjeshmëri gjinore për zyrtarët e pushtetit vendor; shpërndarje publikimesh (udhëzues, manuale) mbi çështjet gjinore dhe integrimin gjinor.	2005-2007	Pushteti Vendor, MPCS, Komiteti për Mundësi të Barabarta, OJQ-të e Grave, Komuniteti donator	40,000	Rritja e ndjeshmërisë gjinore mes zyrtarëve qeveritarë do të çojë drejt programeve dhe politikave të hapura e përmirësuar gjinore, duke ndikuar kështu pozitivisht raportin femër/mashkull në treguesin shërbimit publik të qarkut.
Mungesë e politikës gjinore që kordinon grupet dhe personat e kontaktit në pushtetin vendor	Krijimi i një grupi koordinues gjinor dhe zgjedhja e personave të kontaktit	Krijimi i një politike gjinore duke kordinuar njësitë me mandat të qartë, stafin e duhur dhe shpërndarjen e përshtatshme të burimeve në pushtetin vendor; zgjedhja e personave të kontaktit për çështjet gjinore.	2005-2008	Pushteti Vendor, MPCS, Komiteti për Mundësi të Barabarta, OJQ-të e Grave, Komuniteti donator	40,000	Efiçence e rritur në adresimin e problemeve gjinore, si rrjedhojë ndikim pozitiv në raportin femër/mashkull të treguesit të shërbimit publik të qarkut .
Menaxhim i varfer il informacionit, dhe transparencë jo e mjaftueshme	Projekti i Sistemeve të Menaxhimit të Informacionit	Ndërtimi i SMI ne komuna dhe bashki, dhe zhvillimi i trainimeve ne hardware, software, i stafit te PL	2005-2010	UNDP, Bashkite, komunat, DAP, donatorët	400,000	Sistemet e menaxhimit të informacionit do të ofrojnë mekanizma të rëndësishëm monitorimi dhe vlerësimi qe do të jenë të arritshme për publikun, nëpërmjet qendrave të aksesit publik të krijuara. Shërbimet publike më efikase, bashkëpunimi më i mirë, dhe funksionet e monitorimit dhe vlerësimit do të ndikojnë pozitivisht mbi të gjithë treguesit.
	Projekti i përmirësimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit	Trainim mbi Hardware dhe TIK për stafin e PV dhe prezantimi i pikave të aksesit të shërbimit publik nëpër qark për të rritur aksesin publik në shërbime.	2008-2015	PNUD, Bashkite, Komunat, DAP, donatorët	100,000	
Mungesë kapacitetesh për të monitoruar zbatimin e Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut	Projekti i monitorimit të Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut	Ndërtimi i nje sistemi monitorimi, të bazuar mbi RBM (efektet e programeve/projekteve mbi kushtet dhe jetët e njerezve)	2005	PNUD, Bashkitë, Komunat, KQ, donatorët	100,000	
		Trainimi stafit te Keshillit te Qarkut mbi monitorimin e sistemeve dhe menaxhimin e rezultateve	2005	PNUD, Bashkite, Komunat, KQ, donatoret	25,000	
		Monitorimi I realizimit te Strategjise se Zhvillimit te Qarkut	2005-2015	PNUD, Bashkite, Komunat, KQ, donatoret	40,000	

Synimi 5.3.: Integrimi gjinor në politikat, programet dhe buxhetet, dhe mbledhja e të dhënave gjinore të shkëputura

Problemi	Projekti	Përshkrimi	Periudha Kohore	Partnerët Potencialë	Kosto në Euro	Efekti
Mungesë e komponentit gjinor në politikat, programet dhe buxhetet e qarkut	Integrimi gjinor i politikave, programeve dhe buxheteve të qarkut	Institucionalizimi i analizave gjinore të politikave, programeve dhe buxheteve të qarkut. Integrimi i gjinisë në të gjitha buxhetet, programet dhe politikat qeveritare. Rritje e shpërndarjes së burimeve në buxhetin e qarkut për problemet gjinore, veçanërisht në shëndetësi, arsim dhe bujqësi.	2005-2009	Pushteti Vendor, MoLSA, Komiteti për Mundësi të Barabarta, OJQ-të e Grave, Komuniteti donator	300,000	Përmirësimi i makinerisë së qarkut për të zhvilluar gratë dhe për të promovuar barazinë gjinore, duke ndikuar kështu pozitivisht raportin femër/mashkull në treguesin shërbimit publik të qarkut.
Mungesë e të dhënave gjinore të shkëputura për qarkun	Shkëputja dhe shpërndarja rregullisht e të dhënave të qarkut	Përpunimi i udhëzimeve dhe modeleve për të përmbledhur të gjitha të dhënat e qarkut dhe zhvillimi i një Qendre Të Burimeve të Informacionit dhe Zhvillimit për Çështjet e Gjinisë.	2005-2007	INSTAT, Pushteti Vendor, Komiteti për Mundësi të Barabarta, Komuniteti Donator	200,000	Cilësia e përmirësuar e analizave në lidhje me statusin e burrave dhe grave, aftësia e përmirësuar për të hartuar politika dhe programe nga të cilat do të përfitojnë si gratë edhe burrat, si rrjedhojë ndikim pozitiv në raportin femër/mashkull të treguesit të shërbimit publik të qarkut.

Aneks 1 - Shënim metodologjik për zgjedhje të projektit dhe prioritizimin

Programet e mëparshme të zhvillimit janë bazuar mbi një përfaqje holistike, duke marrë në konsideratë fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet e Qarkut të Gjirokastrës. Programet dhe projektet synojnë drejt harmonizimit të fuqive, në termat e burimeve dhe avantazheve krahasuese, me mundësitë. Objektivi është eliminimi i dobësive dhe shmangia e kërcënimeve pa

marrë parasysh nëse programet dhe projektet funksionojnë në nivel pushteti qendror apo vendor. Megjithatë, derisa ekziston shpesh një mizëri dobësish dhe pak mundësi për t'i eliminuar ato, është e rëndësishme t'i prioritizojmë ato. Si rrjedhojë, sistemi i mëposhtëm është përdorur për të prioritizuar programet dhe projektet për Qarkun e Gjirokastrës.

Kriteri	Prioriteti					
	Shume i larte	I larte	Mesatar	I ulet		
Funksioni i pushtetit vendor	Ndikimi mbi uljen e varferisë	Direkt x 3	4	3	2	1
		Indirekt x 2	4	3	2	1
	Efekti i shumëzimit	Direkt x 2	4	3	2	1
		Indirekt x 1.5	4	3	2	1
Funksioni i pushtetit qendror	Ndikimi mbi uljen e varfërisë	Direkt x 2	4	3	2	1
		Indirekt x 1	4	3	2	1
	Efekti i shumëzimit	Direkt x 1.5	4	3	2	1
		Indirekt x 1	4	3	2	1

Kjo Strategji e Zhvillimit të Qarkut të Gjirokastrës bën thirrje për pjesëmarrje të fuqishme që përfaqësojnë institucionet publike, si Këshilli i Qarkut, bashkitë, komunat, pushtetit qendror, sektorin privat, parlamentin, shoqërië civile, dhe

donatorët. Roli i Këshillit të Qarkut është të zhvillojë vizionin, të krijojë një vazhdimësi dhe afat kohor për ndërhyrjet, dhe të influencojë pushtetin qendror dhe komunitetin e donatorëve, për të mbështetur strategjinë.

Aneks 2 – Përshkrimi i treguesit

Përshkrimi i treguesit

Ky seksion jep një përshkrim narrativ të çdo treguesi,

rëndësine e tij, dhe metodologjinë llogaritëse.

QELLIMI 1. ZHDUKJA E URISE DHE VARFERISE EKSTREME

1. Treguesi i Forcë së Punës: Shkalla e Papunësisë
2. Treguesi Ndhmës Sociale: % e Familjeve që përfitojnë nga Asistenca Sociale
3. Shkalla e Vdekjes Foshnjore

1. Shkalla e Papunësisë

Njësia e Matjes: Shkalla e Punësimit/Papunësisë.

Punësimi: Kjo njësi përfaqëson të gjithë personat e punësuar gjatë kohës së referencës së statistikës (p.sh. 2001), dhe përfshin kategoritë e mëposhtme të punonjësve:

- Sektori bujqësor;
- Industrinë jo-bujqësore;
- Punonjësit me kohë të pjesshme;
- Punonjësit me kohë të plotë;
- Personat e vetë-punësuar;
- Punonjësit pa pagesë në ndërmarrjet e familjes;
- Ndhmësit shtëpiakë.

Ata të cilët kanë me shumë se një punë, janë numëruar vetëm një herë. Personat me një punë por që nuk kanë qenë në punë për kohësisht gjatë periudhës së referencës për arsye sëmundjeje, trainimi, ose leje lindjeje, janë gjithashtu të përfshirë në keto të dhëna.

Papunësimi: Kjo njësi përfaqëson personat të cilët nuk kanë qenë të punësuar gjatë kohës së referencës, por që kanë qenë duke kërkuar punë rregullisht, ose kanë qenë duke pritur të punësohen prapë në një punë nga e cila i kanë pushuar.

Shkalla e Papunësisë: Kjo njësi është papunësia si një përqindje e forcës së përgjithshme të punës.

Përkufizimi: Papunësia është ndarja e forcës së punës që është e pa zënë me punë por që ofrohet dhe/ose kërkon punë.

Përlogaritja: Popullsia e papunë/ fuqia punëtore * 100.

Burimet e të Dhënave: Instituti Kombëtar i Statistikave (INSTAT) 2003 dhe për Nivelin Rajonal 2003, Regjistri Statistikor i Bashkive, Këshilli i Qarkut (nivel qarku).

Rëndësia: Shkalla e papunësisë është një tregues i shëndetit të përgjithshëm të ekonomisë. Një nivel i ulët tregon një ekonomi të fortë ku punëkërkuësit mund të gjejnë punë shpejt, ndërsa një nivel i lartë i papunësisë tregon një ekonomi të dobët. Nga ana tjetër, bizneset mund të gjejnë punëtorë më lehtë kur niveli i papunësisë është i lartë. Përkufizimi i punësimit është i gjerë ndërsa njerëzit në qarkun e Gjirokastrës shpesh janë të përfshirë në një sërë aktiviteteve që sjellin të ardhura në të njëjtën kohë.

2. Përqindja e Familjeve që Përfitojnë nga Asistenca Sociale

Masa e Matjes: Përqindja

Përkufizimi: Asistenca sociale është një skemë mujore e financuar nga qeveria që ofron të ardhura për person si një metodë e mbrojtjes sociale dhe për të ndihmuar njerëzit në përfitimin e shërbimeve. Shuma ndryshon për familje në varësi të një numri kriteresh.

Përlogaritja: Numri i popullsisë nën skemën e asistencës sociale përkundër numrit të përgjithshëm të popullsisë së bashkisë.

Burimet e të Dhënave: INSTAT 2003 (niveli kombëtar) dhe Regjistri Statistikor i Bashkive 2003, Këshilli i Qarkut (nivel qarku).

Rëndësia: Në parim mbrojtja sociale është krijuar për të ofruar asistencë në të holla dhe shërbime për njerëzit në nevojë. Grupet që përfitojnë përfshijnë familje të varfëra pa të ardhura ose të ardhura të pamjaftueshme nga burimet e tregut ose jo të tregut që nuk i mundësojnë ato për të plotësuar nevojat minimale të jetesës.

Megjithëse nuk ka një bazë të dhënash të qarta (si përshembull numri i perfituesve dhe rajonet geografike të tyre krahasuar me statistikën e varfërisë), ekziston një lidhje e fortë e dukshme midis përftuesve të asistencës sociale dhe varfërisë ekonomike, që e bën këtë një tregues të vlefshëm për varfërinë (por vetëm si një prej disa treguesve të varfërisë).

3. Niveli i Vdekshmërisë Foshnjore

Njësia e Matjes: Përqindje (për 1,000).

Përkufizimi: Niveli i vdekshmërisë foshnjore është numri i vdekjeve të foshnjave nën moshën një vjeç, për 1.000 lindje të gjalla në të njëjtën kohë.

Përlogaritja: Numri i Fëmijëve nën 1 vjeç përkundër numrit total të lindjeve të gjalla * k (1,000).

Burimet e të Dhënave: Ministria e Shëndetësisë (niveli kombëtar) dhe Vlerësimi i Konditave Social-Ekonomike të Bashkive në Shqipëri - 2000, UNICEF (niveli rajonal).

Rëndësia: Niveli i vdekshmërisë foshnjore konsiderohet si një tregues i rëndësishëm shëndetësor dhe në tregues i zakonshëm për zhvillimin e përgjithshëm social të një shoqërie. Dallimet në nivelin e vdekshmërisë foshnjore midis rajoneve ose brenda për brenda tyre shpesh janë tregues të fortë të pabarazisë ekonomike, pabarazisë në marrjen e kujdesit shëndetësor dhe tregues të ndryshëm të pabarazisë gjinore.

QËLLIMI 2. ARRITJA E EDUKIMIT PARËSOR

1. Ndjekja e Shkollës në Zonat Rurale për Arsimin e Mesëm (moshat 15-19)
2. Përqindja Nxënës/Mësues në Arsimin e Mesëm

3. % e Mësuesve me Arsim Universitar në Shkollat 8-vjecare

1. Ndjekja e Shkollës në Arsimin e Mesëm

Njësia e Matjes: Përqindja.

Përkufizimi: Popullsia e moshës 15-19 vjeç që ndjek arsimin e mesëm.

Burimi i të Dhënave: Vlerësimi i Kushteve Social-Ekonomike të Bashkive në Shqipëri - 2000 – UNICEF (niveli kombëtar) dhe Regjistri Statistikor i Bashkive, Këshillit të Qarkut (niveli qarku).

Rëndësia: Ky tregues ka një rëndësi të vecantë në reflektimin e arritjeve të fundit në procesin bazë arsimor. Ky është një masë përmbledhëse e efikasitetit të sistemit arsimor. Një përqindje e lartë në ndjekjen e arsimit nga moshat 15-19 vjeçare është tregues i një niveli të lartë të pjesmarrjes dhe vazhdimit të arsimit fillor. Për shkak se personat që përfshihen në këtë grup moshë po hyjnë në moshën e të rriturve, monitorimi i ndjekjes së shkollës nga ana e tyre është i rëndësishëm në lidhje me politikën e burimeve njerëzore kombëtare si dhe për të ndjekur dhe parashikuar progresin në këto moshë. Ky tregues mund të përdoret në analiza për të ilustruar presionet e ndryshme social-ekonomike me të cilat has kjo pjesë e popullsisë. Është një tregues veçanërisht i vlefshëm kur kombinohet me të dhëna të tjera të shkëputura gjinore.

2. Përqindja Mësues/Nxënës në Arsimin e Mesëm

Njësia e Matjes: Raporti.

Përkufizimi: Numri mesatar i nxënësve për mësues në arsimin e mesëm në një vit shkollor të dhënë. Mësuesit janë përcaktuar si personat të cilët, me aftësitë e tyre profesionale, udhëheqin dhe drejtojnë

eksperiencat mësimore të nxënësve në fitimin e njohurive, sjelljeve dhe aftësive që janë parashikuar në një program të përcaktuar kurrikule.

Përlllogaritja: Numri i nxënësve në arsimin e mesëm/mësuesve në arsimin e mesëm.

Burimet e të Dhënave: Ministria e Arsimit e cituar në INSTAT Treguesit sipas Prefekturave 2002 – 2003.

Rëndësia: Ky tregues përdoret për të matur nivelin e inputit të burimeve njerëzore, në lidhje me numrin e mësuesve, në lidhje me numrin e nxënësve. Megjithë të qënurit një tregues i vlefshëm për të gjykuar ndërveprimin e përgjithshëm nxënës/mësues, ai kombinohet më mirë me një tregues të dytë “nxënës për klasë”.

3. Niveli Arsimor i Mësuesve

Njësia e Matjes: Përqindja.

Përkufizimi: Niveli arsimor i mësuesve.

Përlllogaritja: Numri i mësuesve me një diplomë universiteti krahasuar me numrin total të mësuesve në arsimin fillor.

Burimet e të Dhënave: Vlerësimi i Konditave Social-Ekonomike të Bashkive në Shqipëri 2000 – UNICEF (niveli rajonal).

Rëndësia: Ky tregues përdoret për të matur nivelin e inputit të burimeve njerëzore, në lidhje me arsimin e mësuesve. Megjithëse nuk ka domosdoshmërisht një lidhje të drejtpërdrejte midis nivelit të arsimit të mësuesve dhe cilësise së mësimave dhënë nxënësve, ky tregues është i vlefshëm sepse ai na jep një të dhënë bazë për sa i përket cilësise së përgjithshme të trupës mësimore në rajon dhe ilustron informacion të rëndësishëm, në lidhje me bazën e aftësive ekzistuese të cilat mund të përmirësohen nëpërmjet trainimit të mëtejshëm.

QËLLIMI 3. PËRMIRËSIMI I KUJDESIT SHËNDETËSOR

1. Raporti i Shtretërve/Farmacistëve/Dentistëve për 1,000 Banorë
2. Përqindja e Vdekshmërisë Foshnjore/ për 1,000 Lindje të Gjalla
3. Raporti Krevate /Farmacistë/Dentistë për 1,000 banorë

Njësia e Matjes: Raporti.

Përkufizimi: Numri i farmacistëve, dentistëve, dhe shtretërve për popullsinë.

Përlllogaritja: Raporti i farmacistëve/dentistëve/shtretërve për 1,000 banorë.

Burimi i të Dhënave: Baza e të Dhënave të WHO HFA (niveli kombëtar) dhe Regjistri Statistikor i Bashkive – 2003, Këshilli i Qarkut, dhe MSH - 2001 (niveli rajonal).

Rëndësia: Mungesa e personelit të shërbimit mjekësor do të thotë që popullsia ka më pak akses ndaj shërbimeve shëndetësore esenciale. Mungesa e shtretërve shpesh tregon cilësinë e keqe të shërbimeve shëndetësore dhe mundësisë për t'u përkujdesur për pacientë me kohë të gjatë. Duhet të vihet në dukje se asnjë nga këto tregues nuk mund të përdoret veçmas sepse shumë shtretër pa specialistë dhe shumë specialistë pa shtretër janë të pavlerë.

2. Përqindja e Vdekshmërisë Foshnjore

Njësia e Matjes: Përqindje (për 1,000).

Përkufizimi: Përqindja e vdekshmërisë foshnjore është numri i vdekjeve të foshnjave nën një vjeç, në një periudhë të caktuar kohore, për 1,000 lindje të gjalla në të njëjtën kohë.

Përlogaritja: Numri i fëmijëve nën 1 vjeç përkundër numrit të përgjithshëm të lindjeve të gjalla * k (1,000)

Burimi i të Dhënave: Ministria e Shëndetësisë (niveli kombëtar) dhe Vlerësimi i Konditave Social-Ekonomike të Bshkive në Shqipëri 2000 - UNICEF (niveli rajonal).

Rëndësia: Përqindja e Vdekshmërisë Foshnjore konsiderohet një tregues i rëndësishëm i shëndetit dhe një tregues i zakonshëm i zhvillimit të përgjithshëm social të një shoqërie. Pabarazitë në përqindjen e vdekshmërisë foshnjore midis rajoneve ose brenda për brenda tyre shpesh janë tregues të fuqishëm të pabarazisë ekonomike, pabazarisë në aksesin ndaj shërbimit shëndetësor dhe manifestues të ndryshëm të pabarazisë gjonore.

QËLLIMI 4: GARANTIMI I QËNDRUESHMËRISË SË MJEDISIT

1. Raporti i Sipërfaqes së Tokës të Mbuluar nga Pyjet
2. Përqindja e Faunës së Rrezikuar
1. Raporti i Sipërfaqes së Tokës të Mbuluar nga Pyjet

Njësia e Matjes: Përqindja.

Përkufizimi: Përqindja e sipërfaqes së pyllëzuar në krahasim me sipërfaqen e përgjithshme të rajonit.

Përlogaritja: Sipërfaqja e mbuluar nga pyjet e pjestuar me sipërfaqen totale.

Burimi i të Dhënave: Regjistri Statistikor i Bashkive 2003, Këshilli i Qarkut (niveli rajonal).

Rëndësia: Qëllimi i treguesit është të na tregojë sipërfaqen e mbuluar nga pyjet gjatë një periudhe të caktuar kohore. Pyjet i

shërbejnë roleve të shumëfishta ekologjike, social-ekonomike dhe kulturore në shumë vende në të njëjtën kohë janë disa nga ekosistemet më të shumëllojshme dhe të përhapura. Pyjet ofrojnë shumë burime dhe funksione të rëndësishme ku përfshihen: prodhimet e drurit, mundësitë argëtuese, vendbanimi për kafshët e egra, ruajtjen e tokës dhe ujit, dhe një filtër për ndotësit. Ato mbështesin punësimin dhe përdorimin tradicional, dhe biodiversitetin. Ka një shqetësim të përgjithshëm për sa i përket ndikimit të njeriut në shëndetin e pyllit, dhe procesin natyror të rritjes dhe rigjenerimit të pyjeve.

2. Përqindja e Faunës së Rrezikuar

Njësia e Matjes: Përqindja.

Përkufizimi: Përqindja e gjitarëve, zogjve, zvarranikëve, insekteve dhe specieve të peshqve që janë të rrezikuara.

Përlogaritja: Numri i specieve të rrezikuara në seicilin nga grupet e mësipërm pjestuar me numrin total të specieve në atë grup.

Burimi: Libri i Kuq mbi speciet dhe mjedisin në Shqipëri.

Rëndësia: Përqindja e specieve të rrezikuara lidhet drejt për së drejti me ruajtjen dhe rehabilitimin e mjedisit të tyre. Kur peisazhi, grykderdhjet e lumenjve, liqenet, dhe mjedise të tjerë ruhen ose riparohen, numri i specieve të rrezikuara do të zvogëlohet. Natyrisht është e rëndësishme që procedurat rregulluese dhe shtrënguese të zbatohen dhe të aktivizohen në të njëjtën kohë.

QËLLIMI 5. PËRMIRËSIMI I QEVERISJES

1. Numri i Takimeve të Mbajtura nga Këshilli i Qarkut për të Rishikuar Progresin ndaj Zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit Rajonal

2. Numri i Organizatave Aktive te Shoqërisë Civile
3. Numri i Qendrave Funktionale të Aksesit Publik
4. Raporti Femra/Meshkuj në Shërbimet Publike Rajonale

1. Numri i Takimeve të Mbajtura nga Keshilli i Qarkut për të Rishikuar Progresin ndaj Zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit Rajonal

Njësia e Matjes: Numri total.

Përkufizimi: Numri i takimeve të Këshillit të Qarkut të mbajtura specifikisht për të rishikuar progresin e zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut të OZHM.

Përlogaritja: Mbledhja e të gjithë takimeve të Këshillit të Qarkut të mbajtura në lidhje me zbatimin e përgjithshëm të Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut të Gjirokastrës.

Burimet e të Dhënave: Keshilli i Qarkut Gjirokastrë.

Rëndësia: Me nisjen e zbatimit të Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut, një tregues i rëndësishëm i qeverisjes së mirë për Këshillin e Qarkut do të jetë rishikimi i përpjekjeve të tyre drejt zbatimit dhe arritjes së synimeve të nxjerra në SZHQ. Rishikime të tilla do të behen në baza tremujore dhe do t'i konsiderojnë treguesit që janë nxjerrë në këtë dokument si mjetet kryesore për të matur progresin në arritjen e qëllimeve të strategjisë.

2. Numri i Organizatave Aktive të Shoqërisë Civile (OSHC)

Njësia e Matjes: Numri total.

Përcaktimi: OSHC-të e regjistruara që aktualisht janë duke kryer aktivitete brenda qarkut dhe/ose në qark/rreth/bashki, ose forume, diskutime, mbledhje në nivel komune.

Përlogaritja: Mbledhja e të gjitha OSHC-ve aktive për një total.

Burimet e të Dhënave: Zyra Rajonale e OSCE në Gjirokastrë.

Rëndësia: Një grupim aktiv i OSHC-ve do të sigurojë zhvillimin e drejtuar nga qytetarët dhe do të ndihmojë në monitorimin dhe zbatimin e OZHM-ve të Strategjisë së Zhvillimit të Qarkut. BE ka treguar gjithashtu se pjesëmarrja e shoqërisë civile, veçanërisht përfshirjet në lidhje me iniciativat e anti-korrupsionit, duhet të jetë një synim prioritar për qarkun.

3. Numri i Qendrave Funktionale të Aksesit Publik (QAP)

Njësia e Matjes: Numri total.

Përkufizimi: Numri i qendrave funksionale të aksesit publik, që japin informacion mbi qeverisjen vendore, biznesin, shërbimet dhe aktivitetet.

Përlogaritja: Mbledhja e të gjitha QAP-ve aktive për një total.

Burimet e të Dhënave: Keshilli i Qarkut të Gjirokastrës

Rëndësia: Një aspekt integral në termat e matjes së fuqisë së shoqërisë civile, është të vlerësojë aftësinë e qytetarëve për të marrë informacion mbi pushtetin vendor, biznesin, shërbimet dhe aktivitetet. Aktualisht janë dy QAP në qarkun e Gjirokastrës. Të dyja ndodhen në Bashkinë e Gjirokastrës. Ndërkohe që zhvillimi i një rrjeti të zgjeruar të QAP-ve në qark deri me 2015 është deri diku kontingjent mbi një numër faktorësh teknikë dhe aftësish (p.sh. rrjet i qëndrueshëm i furnizimit me energji, treg i zgjeruar i ISP), zgjerimi i tij është tejet i rëndësishëm si për të lidhur qytetarët e qarkut të Gjirokastrës me pushtetin e tyre vendor ashtu dhe për rrjetin global të informacionit.

4. Përqindja e Grave në Këshillin e Qarkut

Njësia e Matjes: Përqindja.

Përkufizimi: Numri i grave në Këshillin e Qarkut si një përqindje e numrit total të anëtarëve.

Përlogaritja: Përqindja (numri i anëtarëve femra të Këshillit të Qarkut përkundrejt numrit total të anëtarëve).

Burimi i të Dhënave: Këshilli i Qarkut

Rëndësia: Është e rëndësishme për njësitë e pushtetit vendor në Qarkun e Gjirokastrës për të arritur një shërbim civil të balancuar gjinor. Diskriminimi mbi bazën e gjinisë është një shkelje e të drejtave të njeriut.

Një Shënim mbi Treguesit dhe Grupet e të Dhënave

Treguesit e dhënë në këtë dokument do të ofrojnë një të dhënë përkundër së cilës do të monitorohet progresi në të ardhmen. Disponimi i informacionit të besueshëm mbi shumë anshmëri dhe jetës në qark është i rëndësishëm për përcaktimin dhe zbatimin e treguesve efektive për të arritur qëllimet e OZHM. Mangësitë e të dhënave statistikore përkatëse në nivelin e bashkisë ishte

një faktor i rëndësishëm pengues për parashikimin e treguesve. Shpesh, shumë nga studimet e bëra nga INSTAT nuk ofrojnë të dhëna të shkëputura në nivelin e bashkisë. Duke e vështirësuar edhe më shumë çështjen, Shqipëria ka kaluar një tranzicion të turbullt, me alternime midis periudhave të qetësise relative dhe rritjes së qëndrueshme si dhe hapave prapa të parashikuar të periudhave (1997, 1999), duke shtrembëruar çdo parashikim të bazuar mbi ecurinë e të dhënave të periudhës 1991-2001. Për më tej, të dhënat statistikore, duke i krahasuar me informacionin administrativ, nuk është përdorur gjerësisht deri në kohët e fundit. Të dhënat e mëparshme të mbledhura për matjen e këtyre treguesve në Shqipëri post-komuniste kanë qenë sporadike, inkonsistente dhe të vështira për t'u krahasuar në kohë për shkak të diferencave në metodologjinë e mbledhjes së të dhënave dhe mostrave. Është e qartë se punë shtesë është e nevojshme nëpërmjet përpjekjeve të mirë koordinuara midis të gjithë të interesuarve për të pasur më shumë të dhëna të besueshme (të marra nga shumë burime) dhe të përmirësojë kapacitetet rajonale për të monitoruar progresin/regresin në lidhje me OMZH. Rruga më e mirë për të parashikuar treguesit do të ishin seritë në kohë të bazuara në të dhëna të besueshme. Për shkak të vështirësive të lartpërmendura, rekomandohet që treguesit dhe parashikimi i tyre të rishikohen rregullisht dhe të përshtaten. Këta tregues nuk duhet të shikohen si pika reference statike, megjithëse treguesit për arritjen e OMZH deri më 2015 duhet të qëndrojnë, nëse janë të arritshëm.

